

# Pesë temat e arta të Kur'anit Famëlartë



*Muhamed el-Gazali*





PESË TEMAT E ARTA TE KUR'ANIT FAMILARTË

*Muhamed el-Gazali*

© L O G O S - A  
2 0 0 9



S H K U P  
P R I S H T I N Ë  
T I R A N Ë

Muhamed el-Gazafi  
PESË TEMAT E ARTA TË KUR'ANIT FAMILIARTE

Boton: Logos-A  
Biblioteka: Mendimi Islam

Për botuesin: Adnan Ismaili  
Kryeredaktor: Husamedin Abazi  
Redaktor bibliotekë: Nexhat Ibrahim

Redaktor gjuhësor: Zekerija Ibrahim  
Redaktor artistik & disenji: Edi Agagjyshe  
Redaktor teknik: Afrim Gashi

Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup  
Shtypi: Focus - Shkup

Copyright©Logos-A, 2009

Shënimi i CIP katalogut i këtij libri gjendet në  
Bibliotekën Kombëtare Universitare

ISBN 9989-58-298-X

[www.logos-a.com.mk](http://www.logos-a.com.mk)

*Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.  
Ky libër mund të kopjohet pjesërisht për përdorim personal dhe jofitimproris.  
Kjo rekomandohet për qëllime promovuese të librit  
apo edhe për afirmimin të kulturës së leximit në përgjithësi.  
Por, nuk lejohet riprodhimi, transmetimi apo kopjimi i këtij libri në tërësi  
pa lejen paraprake të Logos-A.*

# PESË TEMAT E ARTA TË KUR'ANIT FAMËLARTË

*Muhamed el-Gazali*

E PËRKTHIEU NGA ARABISHTJA:

*Sadush Tahiri*

TITULLI I ORIGINALIT:

*Muhamed el-Gazali*

*El-Mehaviru el-Hamse lil-Kur'ani-l-kerim*

*Dar-esh-Shuruk, Kairo, 2005*



**Përmbajtja:****PARATHËNIE 7****TEMA E PARË 31***Allahu është Një dhe i Vetëm 31**Teuhidi – ligj i ekzistencës dhe sistem i jetës 44**Kaderi (përcaktimi hyjnor) dhe Detyrimi 48**Nuk është i dobishëm gjahu pas dyshimeve për t'iu shmangur  
kështu përgjegjësisë 63**Hadithe mbi Kaderin 73**Kur'ani pastron doktrinat e besimit dhe sjelljet 78***TEMA E DYTË 87***Gjithësia e dëshmon Krijuesin e saj 87**Udhëtimi kontemplues 107**Shpirtërorja në Islam: e vërteta dhe horizontet 107**Lidhshmëria e dhikrit dhe lutjes me dëshmitë e krijesave në tokë  
dhe në qiell 111**A është zgjidhja izolimi i besimtarit? 117**Shpirtërorja e ashtuquajtur 122**Pakica punëtore është gjithmonë më e rëndësishme se shumica e  
papunë! 125**Gabimet dhe devijimet 129*

**TEMA E TRETË 141**

*Rrëfimet kur'anore 141*

*Rrëfimet kur'anore – mjete për edukim 152*

*Kuptimi i fesë 165*

*Qëndrimi i myslimanëve ndaj misionit të tyre 173*

*Përmasat shpirtërore dhe shoqërore të Islamit 181*

*Fanatizmi ndaj arabëve 193*

*Rrëfimi i diturisë dhe i sundimit në historinë tonë 195*

*Hilafeti Osman 200*

**TEMA E KATËRT 200**

*Ringjallja, llogaria dhe shpërbëimi 213*

*Morali i atyre që e dëshirojnë dhe e kërkojnë ahiretin 222*

*Koment tematik i sures El-Vakia (Ngjarja e Kiametit) 237*

*Koment i hollësishëm i sures El-Vakia 251*

*Argumenti i parë: 261*

*Argumenti i dytë: 262*

*Argumenti i tretë: 264*

*Argumenti i katërt: 267*

*Argumenti i pestë: 268*

**TEMA E PESTË 273**

*Sfera e edukimit dhe ligjet hyjnore 273*

*Atë që All-llahu e do dhe atë që nuk e do 278*





## *Parathënie*

*All-llahu është Një dhe i Vetëm  
Gjithësia e dëshmon Krijuesin e saj  
Rrëfimet kur'anore  
Ringjallja, llogaria dhe shpërblimi  
Edukata dhe ligjet hyjnore*

Janë këto pesë temat qendrore për të cilat Kur'anit famëlartë flet gjerë e gjatë. Dijetari, mësuesi dhe imami ynë, Muhammed el-Gazali, erdhi në përfundim se këto pesë tema qendrore të Kur'anit famëlartë janë thelbi i të gjitha çështjeve të tjera të cilat radhiten nën to. Ai është i mendimit se muslimanët e trajtojnë komentin e Kur'anit famëlartë me një trajtim pjesor dhe tekstual, duke mos i shtjelluar të dhënat kur'anore në nivelin e tyre të duhur dhe prej tyre t'i nxjerrin vlerat kur'anore të cilat i vendosi All-llahu i Madhërishëm për t'i udhëzuar muslimanët – me Kur'anin – drejt asaj që është më e mirë dhe më e qëndrueshme!

\* \* \*

Kishte kaluar një kohë e gjatë në historinë tonë, në të cilën metodologjia greke e kishte mbizotëruar metodologjinë islame. Librat e filozofisë greke ishin përkthyer në gjuhën arabe. Ato ishin bërë burim i mendimit tonë dhe model mbi të cilin do t'i vlerësojmë gjërat që i kemi. Kujtoj se do të duhej të ishte e

kundërta. Ne dallohemi me mendim të shëndoshë, me besim më të pastër dhe me shpallje të saktë, e cila vërteton bindshëm çdo gjë. Pikërisht për këtë, perceptimi ynë islam i All-llahut është perceptim të cilin e meriton madhështia e All-llahut dhe që e çmon All-llahun me njohje meritore.

Kjo vlen edhe për perceptimin kur'anor për gjithësinë. Ai është perceptimi më i saktë dhe më i shëndoshë, është prova më e madhe që dëshmon madhështinë e Krijuesit. Krijimi i saj i shkëlqyeshëm është shenja më e madhe që e dëshmon Krijuesin Madhështor, rendi i saj i saktë dhe lëvizja precize që asnjëherë nuk ndryshon janë dëshmitë e këtij Krijuesi Madhështor. Ky perceptim kur'anor për gjithësinë është gjithashtu perceptimi yni më i fuqishëm. Kur'ani famëlartë u kushton rëndësi të veçantë provave në gjithësi dhe mrekullive të tij, ndërkohë që muslimanët u treguan të pakujdesshëm. Ata - në vend se të thellohen në kuptimin e këtyre provave të mëdha kur'anore - e shpikën ilmu-l-kelamin (metodologjinë dialektike) që i përngjante metodologjisë dialektike të Aristotelit. Ky ishte njëri ndër faktorët e dobësimit të raportit të muslimanëve me Kur'anin, si dhe faktor i ngadalësimit të ndikimit të tyre aktiv në civilizim.

\* \* \*

Është për t'u habitur që një pjesë e konsiderueshme e Kur'anit famëlartë e trajton atë që quhet "rrëfime kur'anore". Trajtimi i këtyre rrëfimeve nuk bëhet vetëm për atë që Kur'ani të jetë libër i historisë që i dëshmon saktë ndodhjet e së kaluarës ose të jetë libër

që ngërthen mrekulli. Çështja e trajtimit të këtyre rrëfimeve është më e thellë se kjo që mendohet, edhe pse trajtimi i tyre është pjesë e mrekullisë kur'anore!

Qëllimi kryesor i trajtimit të këtyre rrëfimeve është që myslimanët t'i kuptojnë ligjet e All-llahut që funksionojnë në shoqëri dhe gjithësi dhe të mos mëtojnë t'i kapërcejnë ato. Myslimanët duhet ta kenë të qartë se bashkëveprimi i saktë me këto ligje është faktori i vetëm që i bën ata ta meritojnë sundimin dhe përqendrimin në këtë botë. Këta gjithashtu duhet të kuptojnë se historia është mbamendja e nevojshme e së tashmes dhe së ardhmes.....është kompjuteri që e furnizon të tashmen me të dhëna dhe informacione të sakta që shërbejnë për arritjen e vendimeve të sakta të së ardhmes!

\* \* \*

Kur'ani famëlartë flet gjerë e gjatë për ringjalljen, llogarinë dhe shpërblimin në Ditën e Kiametit. Këto gjëra na shfaqen para sysh njësoj sikur ne t'i shohim. Ndërkaq ne nuk duhet të habitemi nga kjo, sepse e tashmja dhe e ardhmja përbëjnë një terminologji të posaçme që vlen vetëm për ne, ndërkaq që për diturinë e All-llahut nuk kanë fare domethënie: e tashmja dhe e ardhmja për All-llahun janë një.

All-llahu i Madhërishëm deshi që e fshehta (gajbi) të manifestohet dukshëm në mendimet dhe sjelljet tona, e me këtë të na edukojë me edukatë të veçantë. Ngase, sado që të tjerët të sajajnë intriga dhe gënjeshtër – ne jemi besimtarë "të cilët e besojnë në të fshehtën (gajbin)". Ky besim i yni është i paluhatshëm dhe

është pjesë e besimit tonë në All-llahun. Ai gjithashtu është njëra nga metodat e edukimit dhe përmirësimit. E si të mos jetë kështu kur rrëfimi kur'anor na bën të ndiejmë se ai u flet fuqive që ekzistojnë në njeriun, e të cilat kanë nevojë për një bisedë të tillë! Nuk është e mundur që njeriu të jetojë ose gjithësia të mbikëqyret vetëm me mendjen!!

\* \* \*

Janë këto pesë temat qendrore të Kur'anit famëlartë për të cilat shkroi dora e shtrenjtë e mësuesit dhe imanit tonë të nderuar Muhammed el-Gazali. S'do mend se ai është njëri nga ata që qëndron në maje të lartë të atyre që sot numërohen si të rrallë.

All-llahu e shpërbleftë dhe e bekoftë atë dhe punën e tij.

*Dr. Abdul-Halim Uveys*

## *Me emrin e All-llahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit*

Kur të tjerët i pyesin myslimanët: A ekziston Shpallje e All-llahut që e udhëzon botën drejt fakteve dhe që i nxjerr njerëzit nga errësirat në dritë? – përgjigja e tyre është gjithmonë e njëjtë: Po, ky është Kur'an-i famëlartë! Është ky Libri i cili i ngërthen udhëzimet e Musait, Isait dhe Muhammedit, sikundër që ngërthen edhe porositë të cilat e rregullojnë jetën e njeriut dhe i mban në rrugën e drejtë. Është ky Libri i përjetshëm dhe i përhershëm, në të nuk ka gjëra të mendjes së njeriut dhe nuk ka kurrfarë dyshimi. Bindja e shëndoshë është vetëm në këtë Libër.

Myslimanët e mbështesin përgjigjen e tyre me këto dy prova:

- 1 – Historike
- 2 – Tematike

Historia tregon se Muhammedi s.a.v.s. arriti që me këtë Kur'an ta themelojë shtetin i cili do të shtrihet në tërë Gadishullin Arab. Ajo gjithashtu tregon se me këtë Kur'an ai arriti të ballafaqohet me shtetin romak dhe persian, se vetëm për disa vite ai arriti ta mposhtë sundimin e tyre. Prej tani ai do të jetë i vetmi që do ta udhëheqë botën!

Shteti në fjalë filloi të funksiononte në kohën e të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s.; Kur'ani lexohej në një territor sa gjysma e territorit të Evropës; lexohej në xhami, në fjalimet javore, në namazet e përditshme, në mesin e atyre që e adhuronin All-llahun në mëngjes dhe në mbrëmje, si dhe në mesin e ushtarëve kur sulmojnë dhe kur pushojnë.

Kur'ani është kushtetuta e cila i rregullon të gjitha çështjet e këtij shteti të sapoformuar dhe bazë e qeverisjes së tij. Ajetet e këtij Libri shtrihen kudo. Ato janë të njohura për secilin, janë të zakonshme dhe shërbejnë për përdorim të përgjithshëm, njësoj sikur monedhat që janë të njohura, të zakonshme dhe që shërbejnë për përdorim të përgjithshëm. Ndodh që monedhat të falsifikohen dhe pas një kohe të zbulohen, ndërsa Kur'ani asnjëherë nuk u falsifikua. Madje asnjëri nuk u përpoq ta falsifikonte atë, madje edhe sikur të përpiqej, me siguri se do të zbulohej dhe do të shkatërrohej.

Nuk ka mus'haf tjetër, pos këtij që e kemi pranë, dhe sa të ekzistojë kjo botë nuk do të ketë ndonjë mus'haf tjetër. Është po ky mus'haf i kohës së vetë të Dërguarit s.a.v.s.!

Nuk kishte ndodhur më parë që ndonjë i Dërguar tjetër me Librin e tij të themelonte shtet! Këtë e bëri vetëm Muhammedi s.a.v.s.! Kur'ani, i shkruar me përpikëri dhe i lexuar me kujdes të madh, u bë një mur i rrallë që do t'i siguronte Islamit mbrojtje të pashoqe.

Është e pamundur që shpallja e Muhammedit ta kundërshtojë shpalljen e ndonjë të Dërguari para tij.

Për këtë All-llahu i Madhërishtëm thotë: *"Nuk të thuhet ty (o Muhamed) asgjë, përpos asaj që u është thënë të dërguarve para teje".*<sup>1</sup>

Hebraizmi dhe krishterizmi modern nuk u treguan të denjë të flasin për Zotin, sepse porositë e tyre përfshijnë gjëra që e cenojnë madhësitë e Tij ose që e zhvleftësojnë vlerën e madhësisë së Tij. Këto gjëra nuk mund të jenë porosi të shpalljes qiellore. Ato janë vetëm hamendje e njeriut. Pikërisht për këtë ne mysli-manët nuk mund të besojmë se Zoti është trup, se ai ka prind ose fëmijë, siç nuk mund të besojmë se Ai ka dërguar udhëzues i cili bën kurvëri, që dehet ose pinë alkool, qoftë pak ose shumë....! Kur'anit i Muhammedit, si edhe Tevratit i Musait më parë, janë udhëzim dhe dritë. All-llahu i Madhërishtëm në shpalljen e fundit i përmend ata në këtë kontekst: *"Thuajtu atyre: "Sillni një libër nga All-llahu, i cili udhëzon më mirë nga këta të dy, unë do ta pasoj atë, nëse thoni të vërtetën!" E nëse ata nuk të përgjigjen ty, dije se ata janë shkelës të dëshirave të veta. E kush është në humbje më të madhe, se ata që udhëhiqen nga dëshirat e veta, pa udhëzim prej All-llahut? Sigurisht, All-llahu nuk i udhëzon njerëzit keqbërës."*<sup>2</sup>

Kundërshtarët e Kur'anit flasin gjerë e gjerë kundër këtij të Dërguarit! Sikur ai kishte ardhur për të kërkuar pasuri ose pozitë! A nuk e dinë të mjerët ata se ky ishte njeriu më i përmbajtur në botë nga pasuria dhe pozita?!

E çfarë thanë ata që e dëgjuan Kur'anin për herë të parë?

<sup>1</sup> Fussilet, 43

<sup>2</sup> El-Kasas, 49-50

*“O Zoti Ynë! Ne dëgjuam një thirrës që na ftonte në besim: Besoni Zotin tuaj!” Dhe kështu besuam! O Zoti Ynë! Na i falë gjynahet tona, na i shlyej gabimet dhe bëna që të vdesim me të mirët!”<sup>3</sup>*

Çfarë kërkoi kumtuesi i Kur’anit prej atyre që e besuan dhe e ndihmuan? Prej tyre kërkoi që ta lusin All-llahun t’ia pranonte mundin e tij në jetë (xhihadin) dhe t’i dhuronte pozitë të lartë në ahiret (mekamu mahmud)!

Dëshmitë e mendjes dhe të dhënave që i kemi e mbështesin njëra-tjetrën se ky Libër: *“Atij nuk mund t’iafrohet gënjeshtër nga asnjëra anë. Kjo është shpallje prej një të Urti që meriton të gjitha lavdet.”*<sup>4</sup> Mendja nuk mund t’i pranojë dyshimet që i drejtohen Kur’anit!

Ne Myslimanët me plot bindje dhe me këmbëngulje themi: Nuk ekziston në botë shpallje tjetër, përveç këtij Libri në të cilin nuk ka dyshim dhe se vetëm domethëniet e këtij Libri e japin njohjen e plotë e të saktë të All-llahut.

Tani do të flasim për temat për të cilat flet Kur’ani famëlartë, për provën e dytë që e dëshmon saktësinë e Kur’anit dhe na bindë se është shpallje e All-llahut.

Valët e detit shumë herë nxjerrin në breg gjëra të panjohura. Sikur ato të nxjerrin një libër që nuk e dimë se nga ka ardhur, do të ishte e udhës që së paku të interesohemi se çfarë përmban ai libër?! Edhe stuhitë e mëdha sjellin nga larg gjëra të panjohura. Sikur ato të sjellin ndonjë libër që nuk e dimë se kush e solli, do të ishte e udhës që së paku të interesohemi se

<sup>3</sup> Ali-Imran, 193

<sup>4</sup> Fussilet, 42



çfarë përmban ai libër?! Çfarë përmbajnë fletët e tij? A i përmbajnë lëvdatat e një race nga racat e botës? Apo i përmbajnë lëvdatat për ndonjë nga mbretërit e botës? Apo përmbajnë të dhëna të paqarta?

Këto do të ishin gjërat që do të na preokuponin në fillim.

Unë e mora Kur'anin që më kishte arritur dhe fillova ta shqyrtoj me vëmendje, që të njihem për së afërmi me gjërat që i përmban ai!

Qysh në lexim të parë ndjeva se ky Libër – fillim e mbarim – i orienton njerëzit drejt All-llahut, i ngacmon dhe i hulumton ndjenjat e tyre nga thellësitë që të lidhen me Të, të orientohen drejt Tij dhe të përgatiten për takimin me Të. Aty flitet vetëm për All-llahun dhe gjërat që i takojnë Atij! Aty flitet se jeta e kësaj bote duhet të jetë parapërgatitje për botën e pasme. Një zë i panjohur që vinte nga larg thoshte se Kur'ani është libër i Muhammedit! Këtë zhurmë do ta bënte lufta kulturore e kohës moderne.

E studiova Kur'anin Gjerë e gjatë dhe me plot seriozitet, me qëllim që të gjeja se çfarë kishte bërë Muhammedi për vete në këtë Libër. Për çudi, nuk arrita të gjej asgjë që do të dëshmonte se Muhammedi kishte bërë diçka për vete në këtë Libër, pos asaj se ai është një rob i cili nuk ka në dorë asgjë, as të mirën as të keqen, se është një rob si robërit e tjerë, edhe ai është i nevojshëm për All-llahun!

Ngazëllimi ndizet gjatë leximit të ajeteve të zbriura përreth 23 vjetëve të cilat flasin për lavditë dhe madhësitë e All-llahut dhe që i çrrënjosin pasionet dhe besëtytnitë të cilat i kishin larguar njerëzit nga Zoti i tyre bujar.

Çfarë ka të bëjë Muhammedi me këtë Libër për të cilin të tjerët thanë se ai e ka shkruar?!

Unë i lexova edhe librat e tjerë për të cilat kundërshtarët e Muhammedit thonë se janë libra qiellorë, por së shpejti thashë: Nëse është e vërtetë se këto libra janë të qiellit, ndërsa libri i Muhammedit është nga toka, atëherë kjo do të thotë se Muhammedi qenka më i aftë se Zoti i fesë për të bërë një fe! Se ai flet më rrjedhshëm për lëvdatat dhe mirënjohjet e All-llahut se vetë All-llahu që flet për veten e Tij!!

Kundërshtimi i Kur'anit është marrëzi. Studimi i Kur'anit familartë m'i kultivoi ndjenjat e madhështisë së All-llahut, ndërsa këto ndjenja nuk i pata asnjëherë gjatë leximit të ndonjë libri tjetër. Ndjeva se zemra në kraharorin tim rrahu vetëm atëherë kur atë e prekën gishtat e fuqisë së lartë. Zemra ime filloi të rrahë pandërprerë. Veshët e mi dëgjuan dhe sytë e mi shikuan vetëm atëherë kur Ai që e ka në dorë dëgjimin dhe shikimin tonë bën që unë të dëgjoj e të shoh.

Një kohë isha i sëmurë. Mjekët më thanë se gjaku në këmbën time më ishte penguar. Ata e sollën një mjet dhe filluan të hulumtojnë vendin ku ishte penguar gjaku! Mu bë sikur e dëgjova një bulurimë të fshhtë dhe të pandërprerë. Ishte zëri i qarkullimit të gjakut nëpër vena, edhe pse ne nuk e dëgjojmë me veshët tanë që kanë fuqi të kufizuar!<sup>5</sup>

<sup>5</sup> Arritjet shkencore flasin se gjaku qarkullon nëpër vena sikur uji që qarkullon nëpër epruveta. Rrezet e mjeteve të shpikura që i kontrollojnë lëvizjet e gjakut e që i prekin rrëzatat e gjakut e shndërrojnë atë në zë të cilin ne e dëgjojmë. Gjaku, duke filluar nga zemra dhe qarkullimi i tij nëpër venat e trupit, krijon zë të cilin ne nuk e dëgjojmë me veshët tanë.

Ndjeva se trupi im vlon me gjallëri dhe lëvizje dhe se ky vlim e dëshmon Krijuesin e lartë i cili e ka bërë të tillë. Unë besoj se çdo gjë është nën mbikëqyrjen e All-llahut dhe se vetëm Ai është që kujdeset për to dhe për furnizimin e tyre: *"Është Ai që ju ka krijuar dëgjimin, shikimin dhe zemrën. Eh, sa pak që e falënderoni ju! Është Ai që ju ka sjellë në Tokë dhe para Tij do të mbli-dheni të gjithë. Është Ai që jep jetë dhe vdekje dhe Atij i përket ndërrimi i natës dhe i ditës. Vallë, a nuk kuptoni?"*<sup>6</sup>

I thashë mjekut: Sa do të ishte gjatësia e venave dhe kapilareve sikur ato të shtrihen në një vijë?

Në habi më tha: "Me siguri se do të formonin një lum prej disa milje!"

Thashë: "Ky lum që rrjedh me gjakun që në vete bart mijëra e mijëra rruaza të kuqe e të bardha lëvizë në brendi të venave të mia! Unë jam vetëm një nga pesë miliardë njerëz që si unë jetojnë në këtë sipërfaqe të tokës! Ndodh që edhe ata të ballafaqohen me atë që unë u ballafaqova, me sëmundjen e cila papritmas më goditi në këmbë.

Mbikëqyrësi i rrymave të jetës në botën e njeriut është ai që e mbikëqyrë dhe kujdeset për botën e gjerë, e ç'mbetet për botën e venave dhe të gjakut që përbën vetëm një pjesë të imët të botës së planetëve të cilët e ngushtojnë hapësirën e kozmosit dhe e plotësojnë ose e banojnë gjithësinë! Këta planetë lindin dhe perëndojnë, shkojnë dhe vijnë, ecin në qetësi drejt qëllimit që ne nuk e dimë dhe nuk e kemi të njohur!!

<sup>6</sup> El-Mu'minun, 78-80

Sa madhështor që është All-llahu, ndërsa sa të marrë janë injorantët dhe ata që e mohojnë Atë: *“Por Ne e godasim të pavërtetën, me të vërtetën, e cila e shkatërron atë dhe ajo zhduket. Dhe, mjerë për ju, për atë që i vishni (All-llahut). Atij i përket gjithkush që gjendet në qiej dhe në Tokë. Ata që janë tek Ai (engjëjt), nuk ngurrejnë për të adhuruar Atë e nuk ndiejnë lodhje.”*<sup>7</sup>

Ah sikur myslimanët t'i merrnin doktrinat e tyre vetëm nga Kur'ani! Me siguri se do të ishin të qetë dhe do t'i qetësonin të tjerët.

Disa lakmues të polemikave nuk u frikuan nga llomotitjet në çështjet e besimit (akides). Ata, pos që e devijuan veten, i devijuan edhe të tjerët. Këta u përngjanë atyre të cilët i mashtroi filozofia greke dhe iluzionet e tyre teorike. Filluan të flasin për bazat e fesë, por kjo u solli vetëm devijim edhe më të madh.

Shpëtimin nga këto rreziqe e gjejmë vetëm nëse i përmbahemi metodologjisë kur'anore dhe vetëm nëse ecim sipas shenjave të caktuara nga ai.

Para se ta shtjellojmë temën tonë, dua të theksoj një ngjarje që kishte ndodhur me njërin nga halifët e myslimanëve. Një ditë kalifi e kishte parë një fshatar që po rrinte para derës së tij dhe në mënyrë nënçmuese e pyeti: “Ku është Zoti yt? Kalifi u befasua me përgjigjen e cila i erdhi si një shuplakë: “Zoti im është duke përcjell” (u rri në pritë)!

Po, vërtet ashtu është: “Vërtet, Zoti yt është gjithnjë në pritë!”<sup>8</sup> I Lartëmadhëruar qoftë All-llahu që përcjell çdo gjë, ndërsa dënimi i Tij i përcjell mendjemdhënjtë dhe mëkatarët.

<sup>7</sup> El-Enbija`, 18-20

<sup>8</sup> El-Fexhr, 14

Këtë rrëfim e shënova vetëm pasi e dëgjova këtë pyetje të cilën një djalosh i mashtruar ia parashtrroi një njeriu duke i thënë: "Ku është All-llahu?". Duket se i pyeturi u kap në befasi, andaj edhe u hutua dhe heshti!

Mirëpo djaloshi i tha: "A nuk ekziston All-llahu?"

Po, gjithsesi – iu përgjigj njeriu.

Po ku është – pyeti prapë djaloshi.

Në çdo vend – iu përgjigj njeriu!

Pyetësit iu bë sikur i erdhi rasti të cilin po e priste gjatë kohë, andaj me mendjemadhësi të shëmtuar tha: "A është në vendet e ndotura dhe vendet e mbeturinave... dhe... dhe...?".

Nuk munda të rri i qetë, sepse e pashë se çështja kishte arritur aty ku nuk duhet, ndërhyra papritmas me qëllim që ta shpëtoja qëndrimin e saktë dhe ta thosha të duhurën.

Iu drejtova pyetësit dhe i thashë: "Kur dikush thotë se dielli ka hyrë në dhomë, kjo nënkupton se rrezet e diellit janë ato që kanë hyrë në dhomë, pra se ngrohtësia e tij ka hyrë në dhomë. Kjo do thotë se i mençuri asnjëherë nuk e kupton këtë se vërtet dielli ka zbritur nga lart dhe ka e zënë dhomën, se është ulur në karrige ose se ka fjetur në krevat!".

All-llahu i Madhërishëm tregon se çfarë u kishte ndodhur dy të dërguarve të Tij, Musait dhe Harunit kur ata ishin frikësuar nga pasojat e bisedës që do ta bënin me Faraonin, andaj All-llahu u tha: "Mos u frikësoni! Në të vërtetë, Unë jam me ju, dëgjoj dhe shoh".<sup>9</sup> Kjo do të thotë se Ai me mbështetjen dhe për-

<sup>9</sup> Ta Ha, 46

forcimin e Tij ishte me ta, e jo se ishte i ulur ose rrinte në këmbë në takimin që e kishin këta të dërguar kur po polemizonin me Faraonin. Kështu e kuptojnë këtë vetëm ata që janë të marrë. Neve nuk na takon ta humtojmë qenien e kësaj çështjeje (jam me ju), sepse ne jemi të paaftë.

Pyetësi tha: Unë e kam për qëllim që të mohoj personifikimin e Zotit!

Atëherë unë i thashë: "Metodat e Kur'anit familartë janë mbi çdo dyshim. Nuk duhet t'i zhvleftësojmë fjalët e atij që në përgjigjet e tij mbështetet në ajetet e qarta të Kur'anit.

Biseda rreth personifikimit të Zotit është bisedë qesharake dhe e thjeshtë. Ajo nuk zë vend në mendjen e njeriut të nderuar, andaj nuk duhet që për hir të saj t'i injorojmë fjalët e All-llahut të Madhërishëm që thotë: *"Ai i krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë, pastaj u ngrit mbi Fron. Ai e di çfarë hyn në Tokë dhe çfarë del prej saj, çfarë zbret prej qiellit dhe çfarë ngjitet drejt tij. Ai është me ju kudo që të gjendeni. Ai sheh gjithçka që bëni."*<sup>10</sup>

Dhe fjalët e Tij: "A nuk e di ti, se All-llahu di çdo gjë që është në qiej dhe në Tokë?! Nuk ka bisedë të fshehtë midis tre vetave, që Ai të mos jetë i katërti; as midis pesë vetave e që Ai të mos jetë i gjashti; as kur janë më pak, as kur janë më shumë, që Ai të mos jetë me ata, kudo që të ndodhen. Ai në Ditën e Kiametit do t'i njoftojë ata se çfarë kanë bërë. All-llahu di çdo gjë."<sup>11</sup>

<sup>10</sup> El-Hadid, 4

<sup>11</sup> El-Muxhadde, 7

Krijuesin e vendit dhe të kohës nuk e përfshinë koha e as vendi. Krijuesi i materies nuk u nënshtrohet ligjeve materiale. Është i mashtruar ai që dëshiron që me trurin e tij të kufizuar njerëzor ta perceptojë të vërtetën hyjnore. Në botën e materies ekzistojnë gjëra që ne nuk mund t'i shohim, siç janë grimca e atomit ose qeliza, andaj si të synojmë ta zbulojmë qenien hyjnore??

Unë e lexoj Kur'anin dhe e lë që domethëniet e tij të gdhenden në zemrën time, pa mos u futur në thellësitë e tyre dhe pa marrë guxim të thellohem në to.

Leximi i ajeteve të Kur'anit që e përshkruajnë njeriun që është pranë vdekjes, që është në prag të ahiretit dhe të shpirtit të tij që bëhet gati të përshëndetet me jetën e kësaj bote, në shpirtin tim e krijon një fotografi të tmerrshme. Unë i lexoj këto ajete dhe ndiej se shpirtin tim e ka pushtuar kjo fotografi, ndaj bëhem i nënshtroar: *"Atëherë, përse kur (diku) i vjen (shpirti) në grykë, para syve tuaj, ndërkohë që Ne jemi më afër atij se ju, por ju nuk e vini re. Përse pra, nëse nuk do të gjykoheni (në jetën e përjetshme), ju nuk ia ktheni shpirtin atij? Përgjigjuni kësaj, nëse e thoni të vërtetën!"*<sup>12</sup>

Ata që frikohen, përpiqen që këtyre ajeteve t'u japin një koment të përshtatshëm për ta. Kështu me shprehjen "Ne" ata nënkuptojnë "Engjëjt tanë". Ndërkaq që unë nuk frikohem dhe shprehjen "Ne" e kuptoj se është "Ne". Unë jam i bindur se All-llahu është më i madh se përftyrimet tona të kufizuara, siç jam i bindur se afërsia e Tij nuk kufizohet me orë ose me largësi!

<sup>12</sup> El-Vakia, 83-87

Ai është afër ashtu siç e ka përshkruar Ai veten e Tij, qoftë i Lartëmadhëruar emri i Tij, andaj është e pakuptimtë përpjekja që kjo afërsi të komentohet sipas asaj që i përshtatet ndjenjës sonë njerëzore.

A mund ta detyroj foshnjën që të ma përshkruajë mendjen e Anshtajnit? Apo, ta detyroj fëmijën e vogël të m'i shpjegojë metodat e Abas Akadit i cili i përshkruan gjenitë?

Unë e di se All-llahu është Ai që e mbikëqyrë pemën e cila është mbjellë dhe rritet pranë shtëpisë sime, siç e di se All-llahu është Ai që kujdeset për çastet e fundit të yllit polar që noton në orbitën e horizonteve të largëta, se Atë nuk e rëndon të merret me shumë çështje njëherazi, se Atij nuk i del nga dora asgjë, qoftë çështje e tokës ose e qiellit: *"...dhe Ai nuk e ka të rëndë t'i ruajë ato. Ai është i Lartë, Madhështori."*<sup>13</sup>

Ç'kuptim pra do të kishte pyetja rreth qenies së All-llahut? Pyetja rreth qenies së Tij konsiderohet vetëm se fëmijëri guximtare ose marrëzi.

Metoda kur'anore e cila flet për All-llahun dhe krijesat është ajo që e kënaq mendjen dhe zemrën e njeriut.

Unë nuk çaj kokë fare me ata që zemrat ua ka sëmurë polemika dhe mendjemadhësia, ndërkaq që mendjen ua ka sëmurë vetëmashtrimi dhe zbrazëtia.

Ishim të qetë kur në moshë të re mësonim për ajetet e paqarta (muteshabih) dhe kur u hidhnim sy drejtimit selef dhe atij halef. Këtë e bënim pa rrëgjim e alergji.

<sup>13</sup> El-Bekare, 255



Ne ishim të bindur se bota e dukshme (alemu esh-shehadeti) është fushë e studimit dhe e shqyrtimit, ndërsa bota e fshehtë (alemul-gajb) nuk është e tillë, sepse ne jemi të paaftë për ta kuptuar atë. Ky ishte shkaku që ne anonim kah drejtimi selef kur bëhej fjalë për temat të cilat nuk bënin pjesë në fushën e logjikës njerëzore.

Sidoqoftë, trashëgiminë tonë kulturore e cila bën te fjalë rreth ajeteve krejtësisht të qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë dhe atyre jo krejtësisht të qarta<sup>14</sup> (el-muhkem ve'l-muteshabih) e lexonim duke qenë tepër objektiv (neutral) dhe të qetë. Është e vërtetë se shumë herë kur e studionim konceptin mu'tezilit të ndikuar nga filozofia greke ndjenim pakënaqësi.

Cilët ishin faktorët e këtij veprimi? Faktorët që na shtyjnë të veprojmë kështu ishin:

1 - Ajetet krejtësisht të qarta e me kuptim të drejtpërdrejtë (muhkemat) i trajtojnë vendimet e prera të shpalljes, elementet më të rëndësishme ligjore dhe metodat edukative dhe udhëzuese. Pikërisht për këtë edhe quhen "thelbi i librit" (ummu-l-kitab). Ndërkaq ajetet jo krejtësisht të qarta (muteshabih) janë pak dhe nuk kanë të bëjnë fare me hallallin, haramin, vaxhibin ose nafilen. Janë ajete që flasin për Qenien e Shenjtë (All-llahun) dhe nuk është i domosdoshëm shqyrtimi i tyre në thellësi, andaj mjafton t'i kalojmë, sepse mendja nuk është e aftë për t'i studiuar.

Qysh në moshë të re u aftësua të bëjmë dallimin mes gjërave që janë të pakapshme për mendjen e njeri-

<sup>14</sup> Me kuptime alegorike.

ut dhe gjërave që i kupton mendja jonë, veçmas kur e dimë se Qenia e Tij është mbi aftësitë e mendjes sonë.

Shembuj të panumërt të këtyre gjërave i hasim në botën e materies, e të mos flasim për gjërat që janë jashtë materies!

2 – Gjuhët njerëzore nuk mund ta përshkruajnë përsosurinë e Qenies së All-llahut. Nocionet gjuhësore shërbejnë për t'i identifikuar gjërat që i njohim, i ndiejmë ose i imagjinojmë, por kur flasim me gjuhën tonë për All-llahun, atëherë ndiejmë se flasim për Atë që nuk e arrin mendja jonë dhe për të cilin na kaplon paaftësia e të kuptuarit. All-llahut nuk i shëmbëllen asgjë. Mua më duket se sistemi ynë logjik i shëmbëllen sistemit të përçimit të rrymës elektrike nëpër rrugë. Në qoftë se rrjeti ngarkohet me më shumë seç duhet, ai menjëherë digjet. Madhështia e All-llahut është mbi aftësitë e të menduarit tonë (mendjet tona nuk janë të afta për ta kuptuar Atë). Biseda për All-llahun e Lartëmadhërisëm bëhet duke mbështetur në formën aproksimative (përafërt). Dijetarët thonë: "All-llahu është diçka krejt tjetër prej çdo gjëje që mund të të shkojë nëpër mend."

Unë jam një nga pesë miliardë njerëz që banojnë dhe rrojnë në Tokë. Çdonjëri nga ne ka jetën e tij dhe brendinë e tij shpirtërore. Ky rotacion i krijesave është pjesë e vargut të gjallesave që ka filluar nga ezeli (pa fillimi) dhe do të ngelë i tillë deri në Ditën e Fundit.

Vallë, çfarë jam unë në këtë turmë të madhe të gjallesave? Jo më shumë se një grimcë rëre e hedhur në një kodër të lartë! Pastaj, çfarë janë njerëzit në krahasim me popujt e tjerë, me zvarranikët, shpendët,

bagëtitë, insektet, kafshët që ecin me dy këmbë dhe ato që ecin me katër këmbë?

Madje, çfarë është e tërë Toka, ajo që është mbi të dhe ajo që është nën të, në krahasim me gjithësinë e mbushur plot yje dhe planetë? Këto krijesa të mëdha shpërndahen në gjithësinë e gjerë ashtu sikur që shpërndahen grimcat e rërës në brigjet e deteve...?!

Unë në këtë gjithësi të gjerë dhe plot krijesa të mëdha jam një qenie pothuajse e humbur dhe e imët. Do të ishte mendjemadhësi e turpshme që unë të mos e di vlerën time dhe të mos i tejkaloj kufijtë e saj. Unë nuk arrij të përpiqem ta njoh qenien e All-llahut të Madhërishëm, Krijuesit të Lartë, në kohën kur unë nuk jam i aftë ta kuptoj vetveten dhe ta njoh shpirtin dhe trupin tim. Pikërisht për këtë unë nuk e mundoj vetveten me hulumtimin dhe studimin e ajeteve muteshabih (jo krejtësisht të qarta dhe me kuptim alegorik). Kujtoj se ajetet muhkemat (krejtësisht të qarta) janë të mjaftueshme për formimin e besimit tim dhe edukimit të shpirtit tim, veçmas janë të mjaftueshme për të më ndihmuar t'i kryej detyrat që i kam ndaj Zotit tim. Ato janë thelbi i Librit!

3. Mendoj se shfrenimi i njeriut për të biseduar dhe shkruar për botën e gajbit (botës së padukshme) dhe krijimi ose shpikja e përplasjeve dhe pështjellimeve rreth ajeteve muteshabih - qoftë në aspektin pozitiv ose në atë negativ - është në favor të despotizmit politik, bile është kënaqësi e madhe për vetëqeverisësit. Përplasjet rreth këtyre gjërave janë shumë të këndshme dhe të dëshiruara për ata që qeverisin me të padrejtë. Këta nuk duan që të zgjedhurit e popullit të

flasin dhe të diskutojnë për bazat e qeverisjes në Islam dhe për politikën e udhëheqjes së popullit! Shumë të mirëseardhura janë përplasjet mes myslimanëve rreth shikimit të All-llahut të Madhërishëm në Ditën e Kiametit.

Për fat të keq përplasjet e tilla u transferuan edhe në lëmin e fikhut (jurisprudencës islame). Masat e gjera të popullit filluan të merren me çështje dytësore të normave të ibadetit, duke i lënë anash çështjen e politikës qeverisëse dhe të politikës ekonomike, marrëdhëniet e Umetit islam me popujt e tjerë dhe mënyrën sesi të arrijnë ta përmbushin sa më mirë detyrën që e kanë kundrejt misionit të tyre madhështor!

Ringjallja e përplasjeve të hershme që kishin ndodhur mes gjeneratës së vjetër dhe asaj të re (selefit dhe halefit) është vetëm vazhdim i rrugës së devijimit, pështjellimit dhe shmangies së myslimanëve nga misioni i tyre madhështor dhe ngeljes së mëtejshme të shumë sëmundjeve që të veprojnë në mesin e tyre, veçmas ngecjes së tyre morale dhe shoqërore!

Dijetari Muhammed Abduhu në librin e tij "Trajtesa mbi teuhidin" ku gjerë e gjatë i shtjelloi gjërat lidhur me doktrinat e besimit u përpoq që përplasjet rreth këtyre gjërave t'i kufizojë në përplasje verbale mes atyre që nuk pajtoheshin mes vete! Ai konsideronte se atë që e refuzon njëra palë nuk është po ajo që e konfirmon pala tjetër. Ai pohon se të gjithë janë unikë rreth çështjeve kryesore të fesë: se All-llahu është i pastër nga çdo e metë dhe se Ai është i shenjtë. Është e vërtetë se në të shumtën e rasteve përplasjet e tilla janë vetëm një lloj polemike e pakuptimtë ose lojë e shprehjeve.

Do të doja që edhe njëherë t'u kthehem mësimëve tona në universitetin El-Ez'her të cilat ishin jashtëzakonisht të dobishme. Përshkrimi më i bukur i këtyre gjërave është përshkrimi i Imam Neveviut – All-llahu i Madhërishtëm qoftë i kënaqur me të – që mbetet i shquar me besnikëri dhe qartësi. Ai, lidhur me hadithin e të Dërguarit s.a.v.s.: *“Zoti im më erdhi në pamjen më të bukur....”*<sup>15</sup>, thotë: *“Së pari besimtari duhet të besojë se All-llahu i Madhërishtëm është i pastër nga çdo e metë dhe se Ai nuk i shëmbëllen asnjë krijese të Tij. Ai thotë: “Asgjë nuk i shëmbëllen Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha.”*<sup>16</sup>

Dhe fjalët e Tij: *“Thuaj: “Ai është All-llahu, Një dhe i Vetëm! All-llahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në anshim. Ai as nuk ka lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë.”*<sup>17</sup>

Besimi ndryshe e dëmton dhe e çrregullon besimin e njeriut mysliman. Dijetarët myslimanë janë njëzëri për gjërat e theksuara në Kur'an dhe në Sunet, ku kuptimi i tyre ezoterik na e bën të njohur shëmbëllimin e All-llahut të Madhërishtëm me disa nga krijesat e Tij. Ata thonë se në raste të tilla duhet të besohet e kundërta e asaj të cilën na e bën të njohur kuptimi ezoterik. Kurrsesi nuk bën që All-llahu i Madhërishtëm të përshkruhet me gjërat ezoterikë në kuptimin

<sup>15</sup> Transmeton Ahmed. Mësohet se ngjarja ka ndodhur në ëndërr, por megjithatë ëndrrat e të dërguarve janë të vërteta. Këtë e vërteton thënia e Ibn Abbasit, transmetuesit të hadithit në fjalë i cili thotë: *“Mendoj se i ka ndodhur në ëndërr”*.

<sup>16</sup> Esh-Shura, 11.

<sup>17</sup> El-Ilfas, 1-4.

e tyre të përgjithshëm. Dijetarët myslimanë gjërat e tilla i quajnë el-muteshabih (gjëra jo krejtësisht të qarta).

Lidhur me këtë dijetarët myslimanë janë të ndarë në dy drejtime: drejtimi selefit (pasuesit e tre gjeneratave të para pas vdekjes së Pejgamberit s.a.v.s.) dhe drejtimi halefit (pasuesit e gjeneratave të mëvonshme).

Drejtimi selefit beson se qëllimi i këtyre gjërave nuk është kuptimi i tyre ezoterik, andaj çështjen e tyre duhet ta lëmë në dijen e vetë All-llahut të Madhërishtëm, duke besuar se All-llahu i Madhërishtëm është i pastër nga shëmbëllimi me krijesat e Tij. Pikërisht për këtë ithtarët e këtij drejtimi nuk marrin përsipër ta përkufizojnë ndonjë kuptim të veçantë për këtë shëmbëllim. Besimi i tyre mbështetet në dorëzimin e tërësishtëm të këtyre gjërave në dijen e vetë All-llahut të Madhërishtëm dhe se vetëm Ai e di kuptimin e tyre të saktë. Këta mbështeten në fjalët e All-llahut: *“Por, kuptimin e tyre të vërtetë e di vetëm All-llahu.”* Dijetarët myslimanë preferojnë pushim të shkurtër në mbarimin e këtij ajeti, me qëllim që fjalët që vijnë pas tyre ta përmbajnë kuptimin e dëshiruar. Aty thuhet: *“Ndërsa ata që janë thelluar në dijen, thonë: ‘Ne i besojmë (Kur’anit). Të gjitha këto (vargje të qarta e alegorike) janë nga Zoti ynë!’ Këtë e kuptojnë vetëm mendarët”.<sup>16</sup>*

Ndërkaq ithtarët e drejtimit halefit – megjithëse besojnë se All-llahu i Madhërishtëm është i pastër nga çdo e metë dhe se nuk i shëmbëllen asnjë krijese të Tij – marrin guximin e komentimit të shprehjeve jo krejtësisht të qarta (me kuptim alegorik) duke parapëlqy-

<sup>16</sup> Ali Imran, 7

er një kuptim më konkret që mund t'i atribuohet All-llahut të Lartëmadhëruar. Hadithet e të të Dërguarit s.a.v.s., si: *"Zoti im më erdhi në pamjen më të bukur"* – që në një transmetim tjetër gjendet si: *"Kur ja unë isha me Zotin tim të Lartëmadhëruar që ishte në pamjen më të bukur"*, i komentojnë duke thënë: *"pamja e përmendur në hadith ka për qëllim atributet e madhështisë dhe përsosurisë që i takojnë vetëm Atij dhe me të cilat attribute Ai u është shfaqur të Dërguarit të Tij."*

Në përgjithësi unë nga natyra ime vazhdoj ta ndjek drejtimin selefit, edhe pse e mohoj tendencën e atyre që përpiqen t'i konsiderojnë për mosbesimtarë ata që marrin guxim t'i interpretojnë këto gjëra.

Prandaj mund të thuhet se Kur'anit famëlartë, me të gjitha ato që i përmban në vete, sillet rreth pesë temave qendrore.

*"All-llahu ka shpallur Fjalën më të bukur (Kur'anin) në formën e një libri, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe përsëriten. Prej tij u rrëqethet lëkura atyre që i frikësohen Zotit të tyre e, mandej qetësohen lëkura dhe zemrat e tyre, kur përmendet All-llahu. Ky Libër është udhëzim i All-llahut. Nëpërmjet tij All-llahu udhëzon kë të dojë. Ndërsa atë që All-llahu e shpie në humbje, s'mund ta udhëzojë kush."*<sup>19</sup>

Pjesët e Kur'anit që i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe që përsëriten në shumë vende na e bëjnë me dije se Kur'anit nuk mbështetet në shqyrtime thjesht teorike ose çështje që janë pjellë e lojës mendore.

Kurrsesi! Ky Libër i njofton njerëzit me All-llahun, e nxitë mendjen e njeriut dhe e thellon horizon-

<sup>19</sup> Ez-Zumer, 23

tin e tij të të menduarit. Njohjen e njerëzve më pas e shndërron në frikë ndaj All-llahut, e zgjon zemrën dhe ndërgjegjen e tij dhe e përgatitë njeriun për Ditën e Llogarisë. Sot kemi të bëjmë me ide që vijnë nga dheu i tokës, ato sillen e pështillen në kufijtë e baltës që ne e shohim. Kur'ani familartë i fton njerëzit të ecin dhe të rrojnë në Tokë fill pasi që kokat e tyre të jenë në qiell.



## *Tema e parë*

### *Allahu është Një dhe i Vetëm*

Është kjo tema e parë qendrore për të cilën flasin suret e Kur'anit famëlartë.

Në të kaluarën njerëzve u mungonte njohja e plotë e Zotit ose një njohje e tillë ishte e ngatërruar dhe e paqartë. Kështu, krahas adhurimit të Zotit, ata adhuronin edhe zota të tjerë që ishin pjellë e vetë mendjes së tyre. Fanatizmi i tyre ndaj këtyre zotave të ndryshëm dita-ditës bëhej edhe më i ashpër. Kishte ndodhur që jeta e tyre të lidhej më shumë me këta zota se që lidhej me Zotin e vërtetë. Këta zota e gëzonin edhe frikën e njerëzve që ua kishin në jetë.

Të dërguarit e All-llahut do të jenë ata që do ta kumtojnë shpalljen e All-llahut para këtyre njerëzve dhe do t'ua bëjnë me dije atyre se All-llahu është Një dhe i Vetëm. Këta të dërguar do ta kundërshtojnë ashpër besimin e tyre në zotat që ata i adhuronin, andaj edhe do të ballafaqohen me luftë të ashpër.

Shih se çfarë i tha populli të dërguarit Hud alejhi-selam: *"A mos na ke ardhur që të adhurojmë vetëm All-llahun e t'i lëmë zotat që kanë adhuruar prindërit tanë?! Atëherë na sill atë me të cilën na kërcënon, nëse je i sinqertë!"*<sup>20</sup>

<sup>20</sup> El-A'raf, 70

Kështu vepruan edhe popujt e tjerë me të dërguarit e tyre.

Në mesin e atyre që adhuronin zota të ndryshëm u gjetën edhe të tillë që në tërësi e mohonin Allahun! Ata besonin se jeta ka filluar nga zeroja dhe vazhdon të ecë nga të dojë. Se, nuk ka ndonjë urtësi të veçantë përse njerëzit lindin dhe vdesin.

Në të kaluarën numri i këtyre ishte i vogël në krahasim me ata që besonin në shumë zota, por sot ata janë në numër të madh dhe, për fat të keq, ka faktorë të ndryshëm që kanë kontribuar në mbështetjen e tyre. Madje, udhëheqja e botës gati se po bie në duart e tyre!

Në Lindje dhe në Perëndim dëgjohet zëri i tyre që thotë: "Nuk ka jetë tjetër përveç jetës së kësaj bote, ne jetojmë e vdesim e nuk do të ringjallemi më."<sup>21</sup>

Natyrisht që këta e mohojnë shpalljen, po prej nga të vijë ajo? Komenti i tyre lidhur me çdonjërin që e bartë dhe e kumton atë është: "Ai është vetëm një njeri që trillon gënjeshtër për All-llahun, prandaj nuk i besojmë atij."<sup>22</sup>

Kujtoj se këta ateistë janë edukuar dhe zhvilluar nën kujdesin e feve të pakuptimta tokësore ose nën kujdesin e feve të shtrembëruara qiellore. Këta ateistë kanë arritur ta vërejnë anën e errët të këtyre feve dhe nuk kanë pasur rast ta njohin të vërtetën nga burimi i tij i kthjellët. Këtyre u mungon drita me të cilën do të ecnin në rrugën e jetës, andaj preferojnë mosbesimin e padëshiruar dhe ateizmin.

<sup>21</sup> El-Mu'minun, 37

<sup>22</sup> El-Mu'minun, 38

Në radhët e këtyre u gjetën edhe persona me ndikim të madh në shoqëri, kryetarë të qeverive të ndryshme, të qeverive krishtere, sioniste, pagane dhe komuniste...! Fatkeqësia dhe epidemia e tyre është duke u përhapur edhe më tej, ndërsa ilaçi i vetëm për shërim është njohja e Islamit dhe përhapja e mësimave të tij.

Cili ishte qëndrimi i Kur'anit ndaj atyre që adhuronin shumë zota dhe të tjerëve që e mohonin Zotin në tërësi? Rrëfimi i Kur'anit familartë për All-llahun e Madhërishëm i bashkon dy gjëra:

E para: Nevojën e kësaj bote për All-llahun. Është bindës fakti se bota nuk mund të ekzistojë dhe të vazhdojë të jetojë pa mbikëqyrjen e All-llahut. Është e pamundur që bota të jetë e krijuar e të mos e ketë Krijuesin ose të ketë rregull të përsosur e të mos e ketë Rregulluesin!

E dyta: Krijuesi dhe Mbikëqyrësi i botës është Një dhe i Vetëm, Ai nuk ka rival e as të njëjtë, çdo gjë do të zhduket, por Ai është i Përjetshëm! Çdokush, qoftë njeri, xhind ose engjell, është rob që i nënshtrohet vetëm Atij. Atij i nënshtrohet çdo gjë dhe ky nënshttrim nuk e përjashton asnjërin, qoftë gjallesë e fshehur nëntokë ose engjell që rri nën Arshin e All-llahut dhe nuk e ngre kokën nga përlulja (sexhdeja): "Atij i përket ç'ka në qiej e ç'ka në Tokë, si dhe gjithçka që gjendet midis tyre e gjithçka që ndodhet nën tokë."<sup>23</sup>

Ai që farën dhe bërthamën e bën të mugullojë në ara dhe kopshte dhe Ai që i krijon frytet e pjekura dhe palmat e hurmat e larta me tufa frutash njëra mbi tjet-

<sup>23</sup> Ta-Ha, 6

rën është po Ai që bën të fiksë dita e agimit dhe që e shpërndanë dritën e tij në horizontet e larta të qiellit dhe të Tokës. Ky është All-llahu që i bën planetët të sillen rreth vetvetes ose ta nisin rrugën në kozmosin e gjerë pa ndonjë lëndë djegëse që do ta harxhonin ose pa ndonjë krah me të cilin do të fluturonin!

Faraoni - që atëkohë ishte i verbër në shpirt – mëtoi ta pyeste Musain për qenien e All-llahut! Përgjigja e vetme ishte: All-llahu i Madhërisëm njihet me emrat e Tij të bukur dhe me atributet e Tij të Larta, veçmas me gjurmët e Tij që është e pamundur t'i vishen dikujt tjetër.

Të shohim se çfarë na thotë Kur'ani famëlartë për këtë.

*"Faraoni e pyeti: "E ç'është Zoti i botëve? (Musai) u përgjigj: "Është Zoti i qiejve, i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet midis tyre, nëse besoni me bindje. (Faraoni) u tha atyre rreth vetes: "Vallë, a nuk po dëgjoni?! Ai tha: "Zoti juaj dhe Zoti i të parëve tuaj. (faraoni) tha: "me të vërtetë, i Dërguari që ju është sjellë, është i çmendur. (Musai) tha: "Zoti i Lindjes dhe i Perëndimit dhe i gjithçkaje që gjendet midis tyre, nëse kuptoni.""<sup>24</sup>*

Në pyetjen tjetër të Faraonit e shohim edhe këtë: *"(Faraoni) tha: "E, kush është Zoti juaj, o Musa? (Musai) tha: "Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar. (Faraoni) tha: "Si është gjendja e brezave të mëparshëm? (Musai) tha: "Dijenja lidhur me ta gjendet te Zoti im, në Libër, Zoti im nuk gabon dhe nuk harron! Është Ai që Tokën e ka bërë shtrat për ju, që ju ka*

<sup>24</sup> Esh-Shuara', 23-28

*shtruar rrugët nëpër të dhe që lëshon ujë nga qielli, me qëllim që, nëpërmjet tij, të rriten shumë lloje bimësh të ndryshme. Hani dhe kullotni bagëtinë tuaj! Këto, me të vërtetë, janë shenja për ata që janë mendarë. Ne ju kemi krijuar prej Tokës, aty do t'ju kthejmë dhe nga ajo do t'ju nxjerrim edhe një herë tjetër.”<sup>25</sup>*

All-llahu është i shtrenjtë dhe i lartësuar. Ai nuk lejon që ekzistimi i Tij t'i durojë thashë e thënat e njerëzve, që ata të pranojnë ose të refuzojnë. Njerëzit e verbër që nuk e ndiejnë madhësitë dhe dhuntitë e Tij dhe që nuk e falënderojnë Atë për të mirat e Tij, nuk meritojnë të kenë foltore nga ku do të flasin për Të. Këtyre nuk u merren në konsideratë dyshimet që i sajojnë!

Mjafton që Zoti i botëve të flet për vetveten, siç mjafton që vetë Ai ta flakë trillimin e tyre duke e përmendur madhësitë dhe lartmadhërinë e Tij. All-llahu është Ai që i meriton të gjitha madhësitë: “Ata që polemizojnë për shpalljet e All-llahut, pa pasur kurrfarë prove, kanë në zemrat e tyre vetëm mendjemadhësi, e cila nuk do t'i shpjerë në qëllimin e tyre. Prandaj kërko mbrojtje prej All-llahut! Me të vërtetë, Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha.”<sup>26</sup>

Unë shumë herë e vëzhgoj vetveten dhe nuk gjej vend për dyshim! Me buzën në gaz them: Në lëkurën time ka qindra mijë qime të cilat, siç thonë biologët, rriten dhe bien dhe në vendin e tyre dalin të tjera. Ndërsa disa prej tyre ngelin qysh kur lindim dhe mbesin deri në vdekje!

<sup>25</sup> Ta-Ha, 49-53

<sup>26</sup> Gafir, 56

Kush i mbolli këto qime apo këta drurë, qofshin të shkurtër apo të gjatë?

Në gjakun e trupit tim janë rruazat e kuqe dhe të bardha të gjakut. Numri i tyre është me miliona. Ato notojnë nëpër rrugët e tyre të caktuara e të drejta! Shkencëtarët pohojnë se këto rruaza të kuqe e të bardha të gjakut prodhohen në palcën kurrizore!

Vallë, sa gjeni janë fshehur brenda kësaj palce kurrizore për t'i prodhuar këto rruaza dhe që t'i furnizojnë me jetë dhe fuqi ato? Pse njerëzit i harrojnë gjurmët e Fuqisë së Lartë dhe fuqinë e All-llahut që e ka përsosur çdo gjë?

Unë nga thellësia e zemrës e urrej ateizmin, andaj edhe më tutje kujtoj se ai është sëmundje e jo ide.

Vallë, a është ide dhe mendim të them se: Dheu është ai që i ka nxjerrë në sipërfaqen e saj të mbjellat e arave me të lashta dhe frutat e shijshme?

Vallë, është ide dhe mendim të them se: Mitra e nënës është ajo që e krijon embrionin që e mban në të? Se mitra e nënës është ajo që i krijon bijtë dhe bijat?

Çfarë është kjo?

*"All-llahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai është mbikëqyrës i çdo gjëje. Të Tij janë çelësat e qiejve e të Tokës! Sa për ata që i mohojnë shpalljet e All-llahut, ata janë të humbur. Thuaju atyre: "Vallë, ju po më urdhëroni që të adhuroj dikë tjetër, përveç All-llahut, o të paditur!"<sup>27</sup>*

Lexuesi – gjatë meditimit për bisedat kur'anore për All-llahun – arrin t'i shohë faktet e ekzistencës së lartë, ndërkohë që i shpërfillë mohuesit e kësaj ekzistence.

<sup>27</sup> Ez-Zumer, 62-64

Është një ide tjetër që ka dominuar te shumica e njerëzve dhe që i ka larguar ata nga rruga e drejtë. Këta besojnë se All-llahu është i vërtetë, por me të janë edhe të tjerë që meritojnë të quhen zota!!

Arsyeja e cila e ka stolitur këtë çmenduri është se këta zota janë ndërmjetësues dhe afrues pranë All-llahut të Madhërishëm. Vetëm përmes këtyre ata krijojnë lidhje me Atë!

Kur'ani famëlartë e bëri të qartë se këta zota të trilluar janë vetëm emra që nuk kanë të emëruar, sepse ato janë pjellë e iluzioneve të pavërteta, se janë gënjeshtra për të cilat All-llahu nuk ka shpallur gjë.

Miza e imët është ajo e cila i mposhtë këta zota të trilluar! Mbështetja në këta zota është mbështetje në të kotën: *"E megjithatë ata adhurojnë në vend të Tij zota, të cilët nuk krijojnë asgjë e që vetë janë të krijuar, që nuk zotërojnë për veten as dëm e as dobi e që nuk janë në gjendje të japin as vdekjen, as jetën e as që të ringjallin."*<sup>28</sup>

Është për t'u çuditur që njerëzit janë të lidhur ngushtë me këta zota të rremë, madje më shumë se që janë të lidhur me vetveten. A nuk e shohim se për ata zota ata flijojnë edhe kafshë: "Ata kanë caktuar për All-llahun pjesë nga drithi dhe kafshët shtëpiake, të cilat i ka krijuar Ai dhe thonë sipas hamendjes së tyre: *"Kjo është për All-llahun, ndërsa kjo është për idhujt tanë"*. Mirëpo ajo pjesë që është për idhujt e tyre, nuk arrin te Zoti, kurse ajo që ata e kanë caktuar për All-llahun – ajo arrin te idhujt e tyre. Sa gjykim të shëmtuar bëjnë ata!"<sup>29</sup>

<sup>28</sup> El-Furkan, 3

<sup>29</sup> El-En'am, 136

Shirku i përhapur sot anembanë botës kërkon shqyrtim të thellë.

Buda është një filozof i vjetër, idetë e të cilit burojnë nga Toka. Pra, nuk është e njohur që ai ndonjëherë e ka drejtuar shikimin drejt qiellit. Ndërkaq ithtarët e tij e konsideruan për zot!

Në Indi dhe në Kinë ekzistojnë idhuj që janë të vendosur në varre të shenjta (vende që vizitohen për ta shenjtëruar ndonjërin). Idhujt e tillë i konsiderojnë për zota dhe bëjnë vepra me të cilat dëshirojnë të jenë sa më afër atyre, qofshin ato vepra të shëmtuara ose të pavlera.

Nuk ka dyshim se ka shumë rrugët të devijimit. Prandaj Islami u shpalli luftë të ashpër të gjitha këtyre rrugëve duke e trazuar mendjen njerëzore që të shmanget nga ato dhe të mos u besojë.

All-llahu i Madhërishëm thotë: *“Thuaju: “A i shihni ata që i adhurojnë në vend të All-llahut? Më tregoni, çfarë pjesë të Tokës kanë krijuar ata?! Mos vallë kanë ndonjë pjesë në krijimin e qiejve?! Më sillni një libër të shpallur para këtij (Kur’anit) ose ndonjë gjurmë tjetër të dijes hyjnore, nëse flisni të vërtetën! Kush është më i humbur se ai, i cili, në vend të All-llahut, u lutet atyre që nuk mund t’u përgjigjen deri në Ditën e Kiametit e që janë krejt të pavetëdijshëm ndaj lutjes së tyre.”<sup>30</sup>*

Goditjet e komunizmit arritën ta lëkundin këtë paganizëm duke bërë që ithtarët e tyre të kalojnë nga shirku në ateizëm, nga errësira në errësirë.

Me siguri atyre ende nuk u ka arritur porosia e shenjtë islame, teuhidi! Po kush do t’ua kishte shpjegu-

<sup>30</sup> El-Ahkaf, 4-5



ar atë?! Edhe sikur ta kishim predikuar atë në mënyrë teorike, neve do të na mungonin elementet e dashurisë që do t'i nxiste për të, sikundër që do të na mungonin elementet e frikës që do t'i nxisnin drejt Atij! Them kështu, ngase myslimanët nuk janë në nivelin e duhur të Kur'anit të tyre!! Ata janë në nivelin e tij! Me siguri se politika e tyre e brendshme dhe e jashtme bën që njerëzit të largohen nga rruga e All-llahut!!

Kujtoj se është e udhës t'u hedhim një sy doktrina-ve krishtere me qëllim që ta shpalosim esencën e tyre.

Isai i biri i Merjemes ishte njeri i mirë, i cili qysh ditën që u bë i Dërguar u detyrua t'i udhëzonte njerëzit drejt All-llahut Një dhe të Vetëm. Xhibrili, shpirti i shenjtë ose mbikëqyrësi i shpalljes, është engjëll i mirë roli i të cilit është bartja e shpalljes të zgjedhurit e njerëzve.

Isai i biri i Merjemes asnjëherë nuk kishte menduar të bëhej zot i dytë me All-llahun! As Xhibrili alejhis-selam asnjëherë nuk kishte menduar të bëhej zot i tretë me All-llahun. Isai dhe Xhibrili nuk do të lejonin t'i hyjnë këtij rreziku shkatërrues. All-llahu i Madhërishtëm thotë: *"Nuk është (e mundur për) një njeri të cilit All-llahu i ka dhënë Librin, dijeninë e gjerë dhe Profecinë, që t'u thotë njerëzve: "Bëhuni robërit e mi dhe jo të All-llahut". Përkundrazi, ai thotë: "Bëhuni robër të ditur të Zotit (që i zbatojnë porositë e Tij), sepse ua keni mësuar Librin të tjerëve dhe e mësoni edhe vetë! Ai njeri nuk do t'ju urdhërojë që engjëjt dhe profetët t'i merrni për zota. Vallë, si mund t'ju urdhërojë ai të bëheni mohues, pasi i jeni nënshtruar All-llahut?"*<sup>31</sup>

\* Ali-Imran, 79-80

Një kohë të gjatë krishterimi e njihte vetëm teuhidin e pastër dhe nuk i shoqëronte All-llahut asgjë në adhurim. Kështu vazhdoi deri me depërtimin e romakëve të cilët i ngatërruan doktrinat krishtere me trashëgiminë e tyre pagane dhe ua imponuan të krishterëve religjionin e tyre të vjetër. Tash e tutje do të ndodhte një ngatërrim i mësimëve dhe porosive krishtere të cilat do të paraqesin një kontradiktë të plotë: i ati zot, i biri zot, shpirti i shenjtë zot dhe të tre janë një! Si është e mundur?

I biri është mbytur për hir të babait, i cili e kërkoi flijimin e tij për hir të gjynahut që e kishte bërë Ademi! Biri i vetëm u bë kurban për këtë! Po pse? Çfarë ka të bëjë i biri i pafajshëm me babanë gjynahqar? Pse të derdhet gjaku i të birit? A nuk është e mundur të shfajësohet babai me ndonjë mënyrë tjetër? Nëse i biri është babai (sepse të gjithë janë një), atëherë si mund të paramendohet vrasja e njërit e jo e tjetrit? Çfarë nënkupton darka e fundit e Isait para se të ngjitet në qiell për ta marrë përsipër rolin e zotit, e që pastaj të thotë për bukën që e kishte ngrënë dhe për verën që e kishte pirë: ky është trupi im, ndërsa ky është gjaku im, që nga këto të dyja të bëhet sakrificë e shenjtë dhe ta bënte darkën hyjnore pjesë të mësimëve të fesë?

Të krishterët nuk pranojnë se besojnë në shumë zota!!! Ata thonë: ne besojmë në Zotin që është Një. Kujtoj se ky refuzim është nga gjërat që u ka mbetur nga trashëgimitë qiellore që i kanë dhe ndaj të cilave janë besnikë. Ah, sikur të kishin mbetur dhe të mos u ndodhte asgjë që do ta njolloshte kthjelltësinë e tyre!

E kur u thua atyre se ju thoni që Zoti është njëri prej Trinisë, ata thonë: Jo, Ai është Trinia e plotë. E kur i pyet për sferën hyjnore se a është e ndarë në tre pjesë, në të cilën çdokush e ka nga një të tretën, ata thonë: Jo, çdonjëri prej tyre, i ati, i biri dhe shpirti i shenjtë janë zota në vete dhe dallohen nga tjetri, por megjithatë të gjithë janë një!

Dëgjova që një prift dinak kishte thënë: i biri zot është atribut i diturisë, kurse shpirti i shenjtë zot është atribut i jetës!

Thashë më vete: Vallë, është e mundur që atributi i diturisë të mbytet dhe të lejohet që gjaku i tij të derdhet në kryq?

Individualiteti hyjnor (dhatu el-uluhijje) posedon shumëtribute të bukura, për të cilat ne do të gëzohehim në qoftë se bota do ta besonte këtë individualitet hyjnor. Do të gëzoheshim edhe sikur t'i besonin veçoritë e Tij të përsosura të cilat janë mjaft shumë.

Jam i bindur se atëherë të gjithë njerëzit do të binden dhe t'i besojnë shpalljes së Muhammedit: "Ai është All-llahu, Një dhe i Vetëm! All-llahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk ka lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë."<sup>32</sup>

Për fat të keq romakët nuk ngadhënjyen. Krishterimi ishte ai që ngeci larg dhe u përqesh. Mësimet pagane ishin ato që e zhvleftësuan çështjen e tij. Ah sikur të mos kishte ngadhënjyer mbreti Konstantin. Ah sikur priftërinjtë që e ndoqën t'i kishin mbetur besnikë fesë së tyre të vërtetë.

<sup>32</sup> El-İhlas

E ç'të thuhet tjetër përveç se: A nuk e shkatërruan fenë mbretërit, priftërinjtë dhe murgjit e fëlliqur që shitën vetveten dhe nuk fituan asgjë?

Në të kaluarën arabët i përshkruanin Zotit vajza, ndërsa më vonë ishin romakët ata që i përshkruanin Atij djalë dhe me dinakëri të plotë mundoheshin ta konsideronin për të tillë: *"Këto janë fjalët e tyre, nga goja e tyre, i imitojnë fjalët e jobesimtarëve të mëparshëm. I vraftë All-llahu! Si po shmangen (nga e vërteta)."*<sup>33</sup>

Natyrisht që Kur'ani do të jetë i ashpër në refuzimin e këtyre fjalëve që ata i thonë dhe do t'i hedh poshtë pa mëshirë. All-llahu i Madhërishëm dhe i Lartëmadhëruar nuk lejon që dikush të thotë se Ai ka vajza ose djem: *"Sa fjalë e rëndë është ajo që del nga goja e tyre! Ata flasin vetëm gënjeshtër."*<sup>34</sup>

Të gënjeshtër për njerëzit është krim, por si do të ishte të gënjeshtër për Zotin e botëve? Çfarë do të ishte devijimi i njerëzve nga rruga e vërtetë, nga Zoti Absolut të Cilit i përgjërohet gjithçka?

Askush të mos çuditet nga shprehjet e ashpra që i përdorë Kur'ani kur refuzon dhe i hedh poshtë fjalët e atyre që i veshin Atij të adhuruar tjetër dhe fëmijë!

*"Ata thonë: "I Gjithëmëshirshmi ka një bir. Keni thënë diçka vërtet të tmerrshme! Qiejt gati sa nuk copëtohen prej kësaj; Toka gati sa s'çahet e malet sa s'rrëzohen të thirrmutar. Ngaqë ata i veshin një bir të Gjithëmëshirshmit. Kurrë nuk i shkon (madhërisë) të Gjithëmëshirshmit të ketë një bir. S'ka krijesë që gjendet në qiej dhe në Tokë e që të mos vijë si rob para të Gjithëmëshirshmit. Sigurisht që Ai e njeh*

<sup>33</sup> Et-Tewbe, 30

<sup>34</sup> El-Kehf, 5

*mirë gjithsecilin prej tyre dhe i ka numëruar të gjithë saktësisht. Çdonjëri prej tyre, në Ditën e Kiametit, do të dalë fill i vetëm para Tij.”<sup>35</sup>*

Meqë këmbëngulësia dhe kokëfortësia e të krishterëve nuk mbaron vetëm me thënien se All-llahu ka bir, porse ata me zërin e tyre vazhdojnë të shfaq përkushtim ndaj të birit zot, Kur’ani famëlartë me zë të lartë deklaroi se Isai është vetëm njëri nga krijesat e Tij, ndërsa e tashmja dhe e ardhmja e tij varet nga vullneti hyjnorë, se të gjithë njerëzit janë në dorë të All-llahut Një dhe të Vetëm, në dorën e Mbizotëruesit, dhe se askush nuk mund t’i ikë vullnetit të Tij.

*“Pa dyshim, janë jobesimtarë ata që thonë: “All-llahu është Mesihu, i biri i Merjemes! Thuaj: “Kush mund ta pengojë All-llahun, nëse Ai dëshiron ta zhdukë Mesihun, të birin e Merjemes dhe nënën e tij, si dhe gjithçka që gjendet në Tokë? Vetëm All-llahut i takon sundimi i qiejve, Tokës dhe i çdo gjëje që gjendet midis tyre. Ai krijon çfarë të dojë dhe është i Plotfuqishëm për çdo gjë.”<sup>36</sup>*

Fjala: “Ai krijon çka të dojë” na bën ta kuptojmë çështjen e krijimit të Isait alejhius-selam pa baba dhe se ky lloj i krijimit nuk i jep të drejtën e hyjnore, siç nuk e ngritë asnjërin mbi shkallën e njerëzores.

Madhërisë së All-llahut nuk i shkon të ketë fëmijë. Ai është i Pasur dhe Absolut, është Mposhtësi i të gjitha krijesave, çdo krijesë ka nevojë për Të dhe jeta e çdo krijese varet vetëm prej Tij. All-llahu i Madhërisëm nuk varet nga asnjëri, Ai është i Vetëmjaftueshëm dhe Absolut. Ky është kuptimi i këtyre ajeteve:

<sup>35</sup> Merjem, 88-96

<sup>36</sup> El-Maide, 17

*“Ata thonë: “All-llahu ka një bir. Qoftë i lartësuar Ai! Ai është i Vetëmjaftueshëm, s’ka nevojë për asgjë. Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Ju nuk keni asnjë provë për atë që thoni. Pse thoni për All-llahun atë që nuk e dini?! Thuaj: “Sigurisht, atyre që shpifin gënjeshtër për All-llahun, nuk do t’u ecë mbarë. Ata do të kenë kënaqësi të shkurtër në këtë botë e pastaj do të kthehen te Ne dhe , ne, do t’u japim të shijojnë dënimin e ashpër për shkak se nuk besuan” .”*

### *Teuhidi – ligj i ekzistencës dhe sistem i jetës*

Asgjë nuk ekziston vetvetiu, qoftë në qiell ose në Tokë. Ne u përngajmë llambave elektrike të cilat nuk ndriçojnë vetvetiu, por që këtë e bëjnë me anë të rrymës përçuese e cila po që se ndërpritet, çdo gjë mbetet në errësirë. Ose, që ne jemi sikur motorët elektrikë që i lëvizin mjetet dhe veglat e punës me anë të fuqisë e cila përçohet deri tek ato, që në rast të ndërprerjes së fuqisë elektrike, asgjë nga këto mjete dhe vegla nuk punojnë.

Ne njerëzit jemi në këtë botë dhe rrojmë në të vetëm me fuqinë dhe vullnetin e All-llahut të Madhërishtëm. Kështu janë edhe gjallesat e tjera. Sikur të mos ishte All-llahu, ne do të ishim asgjë dhe nuk do të kishim ekzistuar fare!

All-llahu i Madhërishtëm thotë: *“Ai është i Pari dhe i Mbrami, i Dukshmi (me argumente) dhe i Padukshmi (me sy). Ai është i Dijshëm për çdo gjë!”*<sup>37</sup>

<sup>37</sup> Junus, 68-70

<sup>38</sup> El-Hadid, 3

Çdo gjë ndodh me emrin e All-llahut. Vetëtima dhe bubullima e qiellit në emër të Tij e lajmërojnë mbushjen e qiellit me re të rënda e me shi, me emrin e Tij bie shiu me buri dhe vetëm me e emrin e Tij pranvera vjen pas dimrit: *"Ai ju tregon juve vetëtimën, duke ju bërë të frikësoheni e të shpresoni; është Ai që krijon re të mëdha (me shi). Bubullima e madhëron Atë me falënderim, por edhe engjëjt, nga frika ndaj Tij; Ai i dërgon rrufetë dhe godet me to kë të dojë; - dhe ata përsëri diskutojnë për All-llahun, ndërkohë që Ai është i ashpër në ndëshkime".*<sup>39</sup>

Muhammedi, Isai dhe Musai nuk kanë asgjë në dorë dhe asgjë nuk bëjnë vetvetiu, edhe pse janë njerëz të mëdhenj e të shquar në histori. Vlera e tyre e lartë në këtë botë nuk i bën më shumë se robër që të sinqertë që iu përkushtuan Zotit të tyre dhe kënaqësisë së Tij. Pjesët e trupit të tyre janë sikur çdo pjesë tjetër e gjithësisë që i nënshtrohet All-llahut dhe që i shpreh lavdi Atij: *"Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, duke e lavdëruar..."*<sup>40</sup>

Njëshmëria e All-llahut është fakt i përhershëm dhe i pafund. Kujtoj se edhe nevoja e botës për All-llahun është e tillë. Çdo gjë në botë ka nevojë për Atë, kudo që është!

Vetëm All-llahut i takon fuqia absolute dhe vetëm Ai e ka vullnetin absolut. Vetëm Ai e bën atë që do, ndonëse injorantët dyshojnë në këtë: *"A nuk e sheh ti se, në të vërtetë, All-llahut i përuken në sexhde ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, edhe Dielli, edhe Hëna, edhe yjet, edhe malet, edhe drurët, edhe kafshët dhe shumë nga njerëzit? Por ka shumë njerëz (mohues), që meritojnë dënimin."*<sup>41</sup>

<sup>39</sup> Er-Rra'd, 12-13

<sup>40</sup> El-Isra', 44

<sup>41</sup> El-Haxhsh, 18

Këta shumë njerëz që e meritojnë dënimin e Tij, janë ata mohuesit e Tij, ose ata që i përshkruajnë Atij të adhuruar të tjerë! Po si është e mundur që krijesa të ngrihet në nivelin e Krijuesit? Po si është e mundur të jetë i barabartë i krijuari me Krijuesin? Libri i Muhamedit është ai që e bëri të qartë këtë fakt të çmueshëm. Prej tij kemi mësuar se Islami është ai që kërkohet nga njerëzit: harmoni me të gjitha krijesat në gjithësi që i nënshtrohen Atij: "A mos kërkojnë ata diçka tjetër përveç fesë së All-llahut, ndërkohë që Atij i përrulen të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, me hir e me pahir dhe tek Ai do të kthehen të gjithë?"<sup>42</sup>

Horizontet e qiellit dhe të gjitha anët e Tokës e madhërojnë All-llahun me lavdërim. E pse ne njerëzit të mos e marrim ngjyrën të cilën e ka çdo gjë në gjithësi? Mosrespektimi i All-llahut është dalje nga rregulli i përgjithshëm që dominon në gjithësi, është zëri i paturpshëm në mesin e zërave të melodive të këndshme që dëgjoen gjithkund dhe që e madhërojnë All-llahun me lavdërim të plotë: "A nuk e vëren ti, se All-llahun e lavdëron çdo krijesë që ndodhet në qiej dhe në Tokë, madje edhe shpezët krahëhapur?! Çdokush e di si t'i falet e ta lavdërojë. All-llahu e di mirë çfarë bëjnë ata. Vetëm All-llahut i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës dhe tek Ai kthehet çdo gjë."<sup>43</sup>

Nënshtrimi ndaj All-llahut varet nga njohuria që e ka njeriu: në disa raste është e kthjellët e në disa e ndotur. All-llahu i Madhërishëm e bëri të njohur vetveten para robërve të Vet me emrat e Tij të bukur.

<sup>42</sup> Ali-Imran, 83

<sup>43</sup> En-Nur, 42-43



Janë emrat Tij të bukur që i shpalosin atributet e përsosmërisë që shtrihen gjerë e gjerë në Kur'an dhe që nxisin habi.

Ndodh që në dhjetë rreshta kur'anorë t'i numërojmë gjashtëmbëdhjetë emra që e përshkruajnë All-llahun, sikur të jenë grumbulluar në një vend duke synuar që me një mijë lidhje t'i shtyjnë njerëzit drejt All-llahut. Lexoi këto ajete: *"Atyre që kanë mërguar për hir të All-llahut e kanë rënë dëshmorë apo kanë vdekur, me siguri, All-llahu do t'ju japë shpërblim të mirë. Pa dyshim, All-llahu është dhuruesi më i mirë. Ai do t'i shpie në një vend, ku do të jenë të kënaqur! All-llahu është vërtet i Gjithëdijshtëm dhe i Butë. Po, kështu është! Ai që merr hak për aq sa është dëmtuar e pastaj pëson sërish padrejtësi, me siguri, do të ndihmohet nga All-llahu. All-llahu është Shlyes i gjynaheve dhe Falës. Kjo është kështu, sepse All-llahu e ndërftoi natën te dita e ditën te nata dhe se All-llahu dëgjon dhe sheh gjithçka. Kjo është kështu, sepse All-llahu është e Vërteta (i vetmi që meriton të adhurohet), kurse gjithçka që adhurohet përveç Tij, është e pavërteta. Dhe, pa dyshim, All-llahu është më i Lartësuar dhe i Madhërishmi. A nuk e sheh ti se All-llahu lëshon shiun nga qielli e toka gjelbërohet?! Me të vërtetë, All-llahu i di të gjitha në hollësi dhe një mirë çdo gjë. Atij i përket ç'ka në qiej e ç'ka në Tokë. Me të vërtetë, All-llahu është i Vetëmjaftueshmi dhe i Denji për çdo lavd. A nuk e sheh ti, se All-llahu ka vënë në shërbimin tuaj gjithçka që është në Tokë dhe anijet që lundrojnë nëpër det me urdhrin e Tij?! Është Ai që e mban qiellin to mos bjerë në Tokë, kjo mund të ndodh vetëm me lejen e Tij. Vërtet, All-llahu është i Butë dhe i Mëshirshëm me njerëzit."*<sup>48</sup>

<sup>48</sup> El-Haxhsh, 58-65

Vallë, a thua ky hartim i mrekullueshëm, i cili i shpie njerëzit drejt Zotit të botëve dhe në zemrat e njerëzve i mbjell ndjenjat e mahnitjes dhe mburrjes me Krijuesin e qiejve dhe të Tokës..... është vepër e njeriut? Oh, po si është e mundur?!

Ne e dëgjuam thirrësin që na ftonte në besim: "Besojeni Zotin tuaj" dhe ne besuam! Vallë, a ka zë më të bukur e më të këndshëm se ky zë ose rrugë më të drejtë dhe më të dobishme se kjo rrugë?

Ne myslimanët – nga dashuria që kemi ndaj All-llahut – i duam të gjithë ata që na shpijnë te Zoti. Ne nuk gjejmë provë tjetër, përveç provës që e njohim, dhe që na shpie te Zoti ynë. Ne nuk duam t'i përmen- dim gjërat që i kanë të tjerët, gjithë kjo me qëllim që të mos shkaktojmë neveri! Ne e duam vetëm përkrahjen e të vërtetës!

### *Kaderi (përcaktimi hyjnor) dhe Detyrimi*

Dituria Hyjnore është e shënuar në Librin e qartë, të saktë dhe gjithëpërfshirës: "A nuk e di ti, se All-llahu di çdo gjë, që është në qiej e në Tokë? Të gjitha këto janë (shënuar) në Libër<sup>45</sup>. Me të vërtetë, kjo është e lehtë për All-llahun."<sup>46</sup>

Ky Libër e përmbledh botën e dukshme dhe të padukshme, i përfshin gjërat më të imëta dhe më të

<sup>45</sup> Në Leuhi Mahfudh – Librin e Ruajtur, ku është shënuar gjithçka, që nga fillimi i krijimit e deri në Ditën e Kiametit.

<sup>46</sup> El-Haxhsh, 70

mëdha, bile edhe grimat e atomit që nuk shihen dot me sy. All-llahut nuk i fshihet asgjë: *"Ai i di të gjitha të fshehtat. Atij nuk mund t'i fshihet asnjë grimë as në qiej, as në Tokë e nuk ka asgjë më të vogël apo më të madhe se ajo, që të mos jetë e shënuar në Librin e qartë."*<sup>47</sup>

Në një sqarim tjetër të përmbajtjeve të këtij Libri All-llahu i Madhërishtëm thotë: *"Ai e di ç'ka në tokë dhe në det, asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh)."*<sup>48</sup>

Natyrisht që jeta jonë, vitet, furnizimi ynë, detajet e jetës sonë dhe koha e vdekjes, janë disa nga përmbajtjet e këtij Libri. Nuk është e udhës që Zoti ynë të mos i dijë çështjet e krijesës së Tij ose të mos dijë rregullin të cilin e ka vendosur Ai për gjithësinë dhe banorët e saj, për Tokën dhe për ata që rrojnë në të ose të mos i dijë periudhat e zhvillimit të tyre dhe për mjetet që Ai i ka përgatitur për ta: *"Sido që të flisni ju, fshehtas spo haptas, Ai e di mirë ç'ka në zemrat tuaja. E si të mos dijë Ai që ka krijuar gjithçka, kur Ai njeh çdo gjë me imtësi dhe është i Mirinformuari?!"*<sup>49</sup>

Të gjithë njerëzit, besimtarë e jobesimtarë, plak e i ri, mësojnë nga ajo që është e shkruar në këtë Libër. Të gjitha krijesat, të gjalla e të ngurta, lëvizin në sferën e kësaj diturie të qartë që u paraprinë atyre. All-llahu i Madhërishtëm thotë: *"S'ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju, që të mos jetë e shënuar në Libër (Leuhi Mahfudh) më parë se ta krijojmë atë. Kjo për All-llahun është vërtet e lehtë!"*<sup>50</sup>

<sup>47</sup> Es-Sebe', 3

<sup>48</sup> El-En'am, 59

<sup>49</sup> El-Mulk, 13-14

<sup>50</sup> El-Hadid, 22

All-llahu i Madhërishëm i urdhëroi besimtarët t'i nënshtrohen kësaj diturie të pafund dhe t'i nënshtrohen të vërtetës së saj: *"Thuaj: "Do të na godasë vetëm ajo që na ka caktuar All-llahu; Ai është Mbrojtësi ynë dhe vetëm tek All-llahu le të mbështeten besimtarët."*<sup>51</sup>

Kjo dituri e lartë i përfshin krijesat, ndaj të cilave ne njerëzit zëmë shumë pak vend dhe asgjë nuk dimë për largësinë dhe vendndodhjen e tyre! Ç' dimë ne për Marsin, Siriusin<sup>52</sup> apo planetët e tjerë?

Dituria e tillë i përfshinë dy lloje veprimesh të jetës sonë në faqen e Tokës: një lloj për të cilin nuk dimë se si ka filluar, ku është duke shkuar dhe kur do të ndalet?! Ne nuk jemi përgjegjës për këtë lloj veprimi që ndodh në jetën tonë, sikundër që nuk ndikojmë fare në të mirën ose të keqen e tij, edhe pse jemi shumë të afërt me të!

Përcaktimet përreth nesh bëjnë shumëçka, që ne i kuptojmë dhe që nuk i kuptojmë. Këto shumëçka shndërrohen në pyetje praktike, përgjigjen e të cilave e gjejmë në sjelljet tona; ç'mendon, a do të durojmë në skamje dhe varfëri? A do të jemi mirënjohës i të mirave, mirëqenies dhe pasurisë?

Njeriu është krijesa e vetme e cila në të njëjtën kohë është e urdhëruar dhe e lirë. Ai është i aftë t'i drejtojë mundësitë që i fshehë në brendinë e qenies së tij dhe të krijojë dobi për vete dhe për rrethanat e krijuara përreth tij. Ai gjithashtu është i lirë të zgjedh nga këto dyja. Prandaj me plot të drejtë themi: Ne nuk do të pyetemi për gjërat që janë jashtë vullnetit tonë,

<sup>51</sup> Et-Tewbe, 51

<sup>52</sup> Siriusi është yll i cili adhurohej nga arabët paganë.

por gjithsesi se do të pyetemi për gjërat në të cilat e kemi lirinë e zgjedhjes.

Disave u vjen për shtati që disa herë t'i ngatërrojnë këto dy gjëra dhe kështu të krijojnë një polemikë të pakuptimtë, të paturpshme, me të cilën i kundërvihen All-llahut dhe të dërguarve të Tij. Me këta duhet të zhvillojmë një bisedë të gjerë.

All-llahu i Madhërisëm deshi – nga urtësia që ne nuk dimë – që të na krijojë dhe të na detyrojë. Në Kur'anin famëlartë thuhet qartë: *“Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë. Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh.”*<sup>53</sup>

Më vonë u paraqitën njerëz që supozuan se jeta është vetëm një dramë e paqartë teatrale! Këta gjithashtu supozuan se detyrimet janë vetëm gënjeshtër dhe se njerëzit, deshën ose nuk deshën, qysh herët, ecin drejt fatit të tyre të njohur! Të dërguarit janë mashtrues, janë përfundim i pjesëve teatraleose i pjesëve të fatkeqësisë!

Për çudi, shumë myslimanë e mbështetën këtë shpifje, bile pjesa dërmuese e myslimanëve janë ata që e mbulojnë veten e tyre me besimin “e detyrimit”, por nga turpi i All-llahut ata e fshehin këtë detyrim që e besojnë duke e preferuar heshtjen abstrakte.

Është e vërtetë se në formimin dhe përforcimin e kësaj paqartësie kontribuan disa transmetime, që në anën tjetër ishin shkak i çrregullimit të mendimit islam dhe shkak i rrënimit të civilizimit dhe shoqërisë.

Dituria hyjnore, gjithëpërfshirëse dhe e tërësishme është përshkruese dhe shpalosëse. Ajo e për-

<sup>53</sup> El-Mulk, 2

shkruan atë ka qenë, ndërsa e shpalos atë që do të jetë. Libri i qartë (leuhi Mahfudhi) i ka të shënuara të gjitha. Ai nuk e bën qiellin tokë, e as të ngurtën të gjallë. All-llahu i Madhërishëm na i përmend të gjitha këto me qëllim që para nesh ta shpalosë një aspekt të madhërisë së Tij, që ne ta vlerësojmë me vlerësimin e duhur. Ai na mëson se e ardhmja e jonë është e qartë për Të, edhe pse për ne është e panjohur. Megjithatë kjo nuk do të thotë se sprova me të cilën ballafaqohemi ne është fiktive dhe se ne, deshëm ose nuk deshëm, shkojmë drejt kësaj të ardhme.

Më duhet të them se kjo është hamendje, është kundërshtim i Kur'anit dhe i Sunetit dhe se ne me mundin dhe punën tonë shpëtojmë ose shkatërrohem. Thënia se shënimet e Librit janë ato që u paraprijnë gjërave dhe se ne nuk kemi fuqi për të ndryshuar gjë për gjërat e caktuara qysh nga ezeli....., e tërë kjo është devijim dhe shpifje: *"(Thuaju o Muhamed) Tashmë ju kanë ardhur nga Zoti juaj prova të qarta. Ai që i sheh ato, i sjell dobi vetes, ndërsa ai që i mbyll sytë para tyre, i bën dëm vetes. Unë nuk jam rojtari juaj."*<sup>54</sup>

*"Dhe thuaj: " E vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mos besojë."*<sup>55</sup>

Në fakt besimi i detyrimit është shkatërrim i shpalljes në tërësi, zhvleftësim i aktivitetit njerëzor qysh nga fillimi i krijimit e deri në Ditën e Kiametit, bile është përgënjeshtim i All-llahut dhe i të gjithë të dërguarve.

Meqë disa transmetime janë përgjegjëse për këtë fatkeqësi, do të ishte e udhës të bëjmë një sqarim të tyre.

<sup>54</sup> El-En'am, 104

<sup>55</sup> El-Kehf, 29

Ndodh që mësuesi t'u thotë nxënësve: "Unë mendoj se filan nxënësi do të kalojë, ndërsa filan nxënësi do të ngelë. Mendimi i mësuesit del i saktë kur nxënësit hynë në provimet e fundit të vitit! Duke u mburrur thotë "Fjala ime nuk shkon huq, doemos do të ndodhte ashtu siç kam thënë!".

A do të thotë kjo se mendimi i mësuesit është ai i cili bëri që nxënësi në fjalë të kalojë, e tjetri të ngelë? Kurrsesi! Njëri prej tyre kaloi për shkak të mundit që e kishte dhënë, ndërsa tjetri ngeli për shkak të lojës që po e bënte me shokët dhe nuk po ua vinte veshin mësimeve. Mendimi i mësuesit është vetëm pasqyrë e vendimit të tij të saktë.

Për All-llahun e Madhërishëm vlejnë shembujt më të lartë e më të çmuar. Dituria e Tij që ka për çdo gjë paraprakisht dhe që nuk lë asgjë mënjanë, nuk është shkak i shpëtimit e as i shkatërrimit, sepse është dituri e All-llahut për të cilën nuk ekziston e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja. Mendimi se shpëtimi i ndonjërit dhe shkatërrimi i tjetrit është shkak i detyrimit të All-llahut që çdonjëri ta bëjë atë që duhet ta bëjë për shpëtim dhe shkatërrim, është mendim i keq, andaj unë nuk shoh tjetër, pos kufrit (mosbesimit)!!

Pikërisht për këtë, ne me kujdes të veçantë do ta analizojmë hadithin e transmetuar në Sahihu Muslim ku thuhet: *"Pasha Atë që nuk ka zot tjetër përveç Atij, ndodhë që ndonjëri nga ju të punojë punë të banorëve të xhenetit, derisa të arrijë që mes tij dhe xhenetit të ketë vetëm një pëllëmbë, e t'ia kalojë shënimi i Librit, e të fillojë të punojë punë të banorëve të xhehenemit, e të hyjë në të.*

*Dhe ndodhë që ndonjëri nga ju të punojë punë të banorëve të xhehenemit.....*<sup>56</sup>

Nëse hadithi në fjalë e ka për qëllim madhështinë e diturisë së Zotit dhe se fillimet e disa njerëzve mund të jenë në kundërshtim me fundet e tyre, atëherë atë e pranojmë si të tillë, kuptohet pasi ta kemi shpjeguar mirë për ta shmangur paqartësinë dhe për ta mposhtur detyrimin.

Ndërkaq unë me plot bindje them që kuptimi i lehtë i hadithit në fjalë është i papranuar dhe është në kundërshtim me Librin dhe Sunetin.

Në këtë kontekst do të përmend se Imam Maliku në librin e tij "El-Muvetta" e ka shënuar hadithin e Aishes r.a. të cilin e transmeton Muslimi ku thuhet: *"Në fillim Kur'anit theksonte se mëndja e foshnjave duhej të arrinte deri në dhjetë herë për t'u konsideruar se ai nuk ka të drejtë martesë me mëndeshën. Por pastaj ky vendim u abrogua në pesë mëndje. I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. vdiq dhe ato mbetën të tilla në Kur'an."*<sup>57</sup> Imam Maliku thotë: "Nuk punohet sipas kësaj..." dhe e refuzoi hadithin. Është e drejtë e tij ta refuzojë atë, ngase Imam Maliku e ndërtoi drejtimin e tij juridik mbi parimin se edhe vetëm një mëndje e bën të ndaluar martesën me mëndeshën. Kështu mendojnë edhe hanefitët. Themi se transmetimet ahad<sup>58</sup> nuk e kanë të drejtën e kundërshtimit të gjërave të njohura nga Kur'anit dhe Suneti i të Dërguarit të Tij ose t'i vënë të vërtetat e fesë nën dyshim dhe akuzë.

<sup>56</sup> Muslim, vëll. 4/2036 numër 2643 Kaderi - mënyra e krijimit të Ademit

<sup>57</sup> Muslim, vëll. 2, fq. 1075 numër 1452 Mëndja / ndalesa me pesë mëndje. El-Muvetta, vëll. 2 fq. 608, numër 17/ Mëndja - Mëndja.

<sup>58</sup> Hadithet që i transmetojnë vetëm një transmetues.



Omer ibn el-Hattabi r.a. ishte pyetur për fjalët e All-llahut të Madhërishëm: *“Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë kundër vetes së tyre, u tha: “A nuk jam Unë Zoti juaj?” Ata u përgjigjën: “Po, dëshmojmë se Ti je”. Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni Ditën e Kiametit: “Këtë nuk e kishim ditur.””<sup>59</sup>*

Omer ibn el-Hattabi r.a. thotë: *“E kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s. të pyetej për këtë dhe ai tha: “All-llahu e krijoi Ademin me dorën e Tij të djathtë, e fërkoj kurrizin e tij dhe prej tij nxori pasardhës, dhe tha: “Këta i kam krijuar për xhenet dhe punë të banorëve të xhenetit do të punojnë.” Pastaj e fërkoj kurrizin e tij dhe prej tij nxori pasardhës për të cilët tha: “Këta i kam krijuar për xhehenem dhe punë të banorëve të xhehenemit do të punojnë.” Një njeri tha: “O i Dërguari i All-llahut, po pse atëherë të punojmë?” I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: “Kur All-llahu e krijon robin për xhenet, e bën të punojë punë të banorëve të xhenetit. Kështu (vepron) derisa të vdesë në punët e banorëve të xhenetit dhe e fut në xhenet. E kur All-llahu e krijon robin për xhehenem, e bën të punojë punë të banorëve të xhehenemit. Kështu derisa të vdes (gjendet) në punët e banorëve të xhehenemit dhe e fut në xhehenem.”<sup>60</sup>*

Hadithi në fjalë është i papranueshëm. Mendojmë se është hamendje e transmetuesve, bile mendojmë se

<sup>59</sup> El-A'raf, 172

<sup>60</sup> Tirmidhiu, vëll. 2/248, numër 3075, Tefsiri i Kur'anit – nga surja el-A'raf. Ebu Davudi, vëll. 4, fq. 226, numër 4703, Suneti – Kaderi

është shpërfillje e kuptimeve të qarta të Kur'anit famëlartë. Veçmas nëse shohim se ky hadith e nënkupton besimin e detyrimit (xheber).

Komenti ose shpjegimi i Omerit r.a. dukshëm i kundërshton gjërat e mirënjohura dhe të mirëkuptuara të ajeteve të qarta kur'anore. Ajetet me të cilat Allahu i Madhërishëm u flet mushrikëve sikur thonë: *"Atë që ju e keni bërë nuk ka rëndësi e as vlerë tek Unë, ju nuk keni arsye të shëndoshë e as argument të fortë. Unë ua dhashë mendjen që të mendoni dhe logjikoni, natyrën e pastër që ju nxiti në besim të pastër (teuhid) dhe rrugë të drejtë, ua shpalla Librin ku ishin të shtruara të gjitha urdhrat dhe ndalesat, aty e kishit ndalesën e ndjekjes së etërve injorantë, andaj pse i shpërfillët këto mësimet e porosit dhe e ulët kokën për tokë e u dhatë pas rrugëve të këqija e të shtrembëruara! E pse kujtoni se pas të gjitha këtyre shkoqitjeve dhe sqarimeve do të mund të largoheni nga Unë dhe nuk do të ktheheni tek Unë?!"*

Ky është komenti i ajeteve që bie në mendjen e çdo mendari. Ky pra është komenti i ajeteve që mund t'i kuptojë çdo lexues i Kur'anit.

Në vijim do t'i shtrojmë ajetet që flasin për këtë çështje:

*"Kur Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë kundër vetes së tyre, u tha: "A nuk jam Unë Zoti juaj?" Ata u përgjigjën: "Po, dëshmojmë se Ti je". Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni Ditën e Kiametit: "Këtë nuk e kishim ditur. Ose që të thoni: "Me të vërtetë, etërit tanë ishin idhujtarë para nesh, kështu që edhe ne jemi pasardhësit e tyre. A mos vallë dë to na shkatërrosh për veprat e atyre që*

*ndoqën mashtrimin? Kështu, Ne i shpjegojmë hollësisht shpalljet, që ata të kthehen (në rrugën e drejtë).“<sup>61</sup>*

Më thoni o ju mendarë: ku i gjeni gjurmët e detyrimit hyjnor këtu? Ku thuhet se All-llahu i Madhërishtëm i ka krijuar njerëz për xhehenem që deshën ose nuk deshën do të shkojnë drejt tij dhe i ka krijuar të tjerë për xhenet dhe që deshën ose nuk deshën do të shkojnë drejt tij duke qenë fatlumë!? Kujtoj se përmbajtja e disa transmetimeve të dobëta i krijon dëm të madh Islamit. Ne doemos t'i përmbahemi Librit të Zotit tonë dhe Sunetit të të Dërguarit Tonë. Kjo është rruga e të drejtëve dhe të parëve tanë.

Çdo mëtim për të anuar nga besimi i kaderit në besimin e detyrimit, llogaritet shkatërrim i qëllimshëm i fesë së All-llahut dhe shkatërrim i jetës së njerëzve. I kam parë disa autorë dhe transmetues që e shpërfillin vullnetin e njeriut, që e shkatërrojnë të tashmen dhe të ardhmen e njeriut, sikur u thonë njerëzve: Ju jeni të përcaktuar të bëni kështu, dituria juaj për atë që bëni është para veprimeve tuaja, andaj ju nuk mund t'i ikni asaj. Ju ecni drejt fatit të pandryshueshëm ku ju nuk keni dorë për ndryshim, andaj sado që të mundoheni, kurrë nuk do të dilni jashtë vijës së caktuar për ju! Unë me plot bindje them se këto fjalë të paturpshme nuk dalin nga leximi i vetëdijshëm i Librit të Zotit tonë, e as nga ndjekja e saktë e Sunetit të të Dërguarit tonë!!

All-llahu i Madhërishtëm u flet të gjithë njerëzve që rrojnë në këtë botë dhe u thotë: *“Drejtohu ti me për-*

<sup>61</sup> El-A'raf, 72-74

*kushtim në fenë e drejtë, para se të vijë prej All-llahut Dita, e cila nuk mund të shtyhet. Atë ditë, njerëzit do të ndalen: ata që nuk kanë besuar, do të mbajnë pasojat e mohimit, kurse ata që kanë bërë vepra të mira, i kanë përgatitur vetes (të mira)."*<sup>62</sup>

Vallë, a thua premtimi për ata që kanë bërë vepra të mira dhe që i kanë përgatitur vetes të mira që do t'ju vijë nga ana e Zotit është lojë dhe mashtrim?!

Pastaj, All-llahu i Madhërishtëm e përshkruan dënimin e atyre që i përgënjeshtrojnë dhe mohuan faktet e Zotit dhe u jep atyre ta shijojnë dënimin e përgatitur për ata. Prandaj thotë: *"Por, Ne do të bëjmë që mohuesit të shijojnë një dënim të ashpër dhe do t'i ndëshkojmë ata sipas veprave më të këqija që kanë bërë. Ky është "shpërblimi" për armiqët e All-llahut. Xhehenemi është vendbanimi i përhershëm i tyre. Ky dënim është për ata, ngaqë mohanin shpalljet e All-llahut".*<sup>63</sup>

A thua lidhshmëria e përsëritur mes veprës dhe "shpërblimit" na bën me dije se këta njerëz ishin njerëz të mirë, por që jetën e tyre e mori në dorë caktimi paprapak që vazhdonte për ata ose Libri që i bëri ata të dështojnë? A thua kjo hakmarrje e kobshme për kriminelët është ajo që i bëri këta të bëjnë punë të këqija e ta meritojnë "shpërblimin"?! Po sa i paqëlluar që është ky kuptim! Në Ditën e Kiametit njerëzit do ta korrin atë që kanë mbjellë për vete. Kur'ani është jashtëzakonisht i kujdesshëm në deklarimin e kësaj të vërtete: do të gjesh vetëm atë që e ke sjellë me vete dhe që e ke punuar! Kurrë nuk do të merresh në pyetje për gjërat

<sup>62</sup> *Er-Rrum*, 43-44

<sup>63</sup> *Fussilet*, 27-28

që nuk i ke bërë. Për gjërat që ke qenë i detyruar t'i bësh – përkundër vullnetit tënd – nuk do të merresh në llogari; i pafuqishmi, që nuk ka mundësi t'u bëjë ballë gjërave dhe ai që bën punë pa qëllim, nuk do të merren në llogari; për ata nuk vazhdon detyrimi!!

Mendo për fjalët e All-llahut të Madhërisëm: (Do t'u thuhet) "Hidhni në zjarr çdo jobesimtar, kryeneç. Pengues të të mirave, shkelës dhe dyshues (në fe); çdo njeri që ka besuar në zot tjetër, përveç All-llahut. Kështu pra, flakeni atë në dënimin më të rëndë! E, shoku i tij (djalli) do të thotë: "O Zoti ynë, unë nuk e kam mashtruar atë, por ai vetë ka qenë në humbje të madhe". Atyre (All-llahu) do t'u thotë: "Mos u grindni para Meje, Unë ju kam paralajmëruar me kohë. Fjala Ime nuk ndryshohet dhe Unë nuk jam i padrejtë me robërit e Mi".<sup>64</sup>

All-llahu i Lartmadhëruar na mëson se Ai nuk e do të padrejtën dhe se Ai i dënon vetëm ata që e kanë tepruar në krime dhe që janë keqbërës.

Megjithatë, disa nga ne besojnë se Ai i hedh në xhehenem disa vetëm pasi i ka detyruar të jenë në rrugën e xhehenemit dhe të bëjnë punë të zjarrit, duke u mbështetur në atë se Ai nuk pyetet për gjërat që i bën!! Se All-llahu nuk është i padrejtë për atë që ua sjell robërve të Vet!!

Pa dyshim se të menduarit e fillë paraqet verbërim të plotë në këtë jetë, gjë që nuk ka të bëjë fare me natyrën e krijuar nga ana e All-llahut dhe me shpalljen e Tij. Ne doemos duhet t'i largojmë njerëzit nga këto gjëra!!

<sup>64</sup> Kaf, 24-29

Shkak i kësaj sorollatje është keqkuptimi i ajeteve kur'anore, keqinterpretimi i tyre dhe transmetimi jo i denjë i haditheve.

Le të sjellim shembuj nga ajo që përmendëm. Sepse e vërteta u prezantohet njerëzve: ai që e pranon atë, All-llahu do t'ia hap zemrën dhe do t'ia ndriçojë mendjen, ndërsa ai që e refuzon, All-llahu do t'ia errësojë zemrën dhe do ta lë në hutë, ndërsa jeta e tij do të pësojë çrregullim të paparë.<sup>65</sup>

Atë që All-llahu e shpie në humbje (kriminelin), askush nuk mund ta shpëtojë, ai nuk do të gjejë asnjëherë as mbrojtës e as ndihmës. Për këtë All-llahu i Madhërishtëm thotë: *"Ata që All-llahu i shpie në humbje, askush nuk mund t'i udhëzojë në rrugë të drejtë! Ai i lë ata të enden në mosbesimin dhe humbjen e tyre."*<sup>66</sup>

Fjala e parë e këtij ajeti na mëson se atë që e dënon All-llahu me humbje, askush nuk mund t'i bëjë dobi, ndërsa fjalia e dytë na mëson se Ai e ka humbur robin për shkak të mendjemadhësisë dhe verbërisë së tij.

Megjithatë ka disa njerëz që ndalen në fjalinë e parë dhe e harrojnë të dytën. Këta e kuptojnë se mendjemadhësia e tyre është rezultat i dënimit të All-llahut me humbje! Pa dyshim që një kuptim i tillë paraqet mosnjohje të madhe, sepse dënimi i tyre me humbje është rezultat i mendjemadhësisë së tyre, andaj ky dënim për ta është rezultat e jo shkak.

<sup>65</sup> Është interesant fakti se jeta e njerëzve sot është bërë e paqëllimtë. Shkak i kësaj është largimi i besimit nga jeta e njeriut. Atë që duhet pasur parasysh, është fakti se në rast të largimit të besimit, natyra e njeriut do të jetë ajo e cila do ta dënojë këtë njeri. Pra, sot jemi duke e shijuar dënimin e natyrës sonë. (sh.p)

<sup>66</sup> El-A'raf, 186

Këtë e vërtetojnë fjalët e All-llahut të Madhërishtëm në një vend tjetër ku thuhet: *"Thua (o Muhamed): "Atyre që janë të humbur, i Gjithëmëshirshmi u dhëntë jetë", në mënyrë që, kur të shohin atë që u është premtuar: ose dënimin (në këtë jetë) ose Orën (e Kiametit), atëherë ta marrin vesh se kush ka pozitë më të keqe dhe rreth më të dobët. All-llahu ua shton udhëzimin atyre, që janë në rrugë të drejtë. Veprat e mira që mbesin, janë të shpërblyera më mirë te Zoti yt dhe kanë përfundim më të mirë."*<sup>67</sup>

Ndodh që disa kokëtrashë të qëndrojnë pranë ndonjë ajeti dhe ta kuptojë atë krejt ndryshe nga ajo që duhet të kuptohet, si p.sh. fjalët e All-llahut të Madhërishtëm: *"Thua ju: "All-llahu ka argumentin më bindës dhe, po të donte Ai, të gjithëve do t'ju përdhite në rrugë të drejtë!"*<sup>68</sup>

Ose fjalët e Tij: *"Sikur Ne të donim, do t'ia jepnim secilit udhëzimin e tij, por do të përmbushet Fjala Ime: "Me të vërtetë, do ta mbush xhehenemin me xhind dhe njerëz bashkërisht!"*<sup>69</sup>

Këto ajete dikush i kupton se All-llahu ka krijuar njerëz për xhehenem dhe ka krijuar të tjerë për xhenet, e pastaj të parët i fut në xhehenem, ndërsa të tjerët i fut në xhenet, sepse kështu është e shënuar paraprakisht në librin e tij dhe kështu duhet bërë!!

Kjo është mosnjohje e gjërave dhe paraqet injorancë. Ajetet e tilla nënkuptojnë se All-llahu është i Fuqishëm që t'i krijojë të gjithë njerëzit engjëj, të tillë

<sup>67</sup> Merjem, 75-76

<sup>68</sup> El-En'am, 149

<sup>69</sup> Es-Sexhde, 13

që nuk i kundërshtojnë urdhrat e All-llahut, por i zbatojnë menjëherë ato! Megjithatë Ai i krijoi njerëzit në formë tjetër, që të jenë të përshtatshëm dhe të lirë, të udhëzohen ose të devijojnë, andaj i futi në garë të përgjithshme ose i la të lirë në jetë për ta provuar dhe për të matur shkathësinë e tyre. Natyrisht që xhehenimi do të mbushet me ata që bien në këtë provim, ndërsa xheneti do të mbushet me ata që kalojnë në atë.

Edhe përkundër kësaj, Ai qysh nga fillimi i krijimit e di se çfarë do të ndodhë, por dituria e Tij nuk është vendimtare për shpëtimin e atij që shpëton dhe për shkatërrimin e atij që shkatërrohet.

Disa me zë të lartë mund të thonë: "Asgjë nuk ndodh pa lejen e All-llahut!".

Me qëllim që t'i përgjigjemi këtij dyshimi, themi:

"Ndodh që krimineli të shkojë në arën e grurit, kallinjtë e të cilit janë të pjekur, gati për t'u korrur, e ta ndezë zjarrin në të dhe, kur e kapin njerëzit, ai thotë: "Zjarri nuk kishte për t'u ndezur sikur të mos ishte oksigjeni të cilin e ka krijuar All-llahu në ajër! Ara nuk kishte për t'u ndezur sikur ambienti të mos e kishte këtë element! All-llahu është përgjegjës për krimin që e bëra, sepse asgjë nuk ndodh pa lejen e Tij!".

Vullneti i All-llahut është i shtrirë në çdo gjë dhe, sikur ai të na detyronte të veprojmë, nuk kishim për t'u llogaritur, andaj ne llogarisim për atë që e bëjmë vetë ne. Ne kurrë nuk do të mundemi që me këtë shpejtësi të bëjmë shpjegimin e lidhshmërisë mes vullnetit të All-llahut që është gjithëpërfshirës dhe lirisë së njeriut që të ecë në të djathtë ose në të majtë.



*Nuk është i dobishëm gjahu pas dyshimeve për  
t'iu shmangur kështu përgjegjësisë*

Çdo transmetim që dukshëm e dëmton lirinë e vullnetit njerëzor në krijimin e të ardhmes është i papranueshëm dhe nuk e meriton kujdesin tonë. Të vërtetat e fesë, të konfirmuara me logjikë dhe traditë, nuk i dobëson një hadith me zinxhir të dobët të transmetuesve ose me tekst të pabazë.

Megjithatë, sado që ta vëmë në dukje vullnetin njerëzor, nuk duhet të harrojmë se ne jemi brenda një anijeje të cilën valët e detit të jetës e hedhin andej-këtej, lart dhe poshtë. Pra valët e detit janë ato që e drejtojnë anijen, e jo e kundërta.

Kjo do të thotë se situatat që na rrethojnë dhe herë pas here ndryshojnë, na detyrojnë të marrim qëndrim të caktuar kundrejt tyre.

Ky qëndrim është veprim i yni dhe për të përgjigjemi! Ndërkaq, situatat që na rrethojnë nuk janë veprim i ynë, andaj edhe janë provim për ne që vendos rrugën e fatit tonë.

Mikrobet e sëmundjeve janë kudo në ajër. Kështu sikur çdo infektim të na godiste, ne qëmoti do të shkatërroheshim! Çfarë është ai sistem i imunitetit i fshehur në trupin tonë? Si na mbron? Dhe, si dështon?

Ç'rol kemi ne në format e karakterit trashëgues të veçorive fizike, psikologjike dhe shpirtërore? Kjo nuk është kompetencë e jona, edhe pse sfera ku provohemi është e kufizuar.

Bujku vetëm e lëvront tokën dhe në të e hedh farën për të cilën më pas nuk e di se çfarë bëhet! Ndodhë që ato t'i sjellin grumbuj të mirash, siç ndodhë që t'i sjellin edhe të mira të kufizuar, madje mund të ndodhë që munda t'i shkojë huq! Mundi i njerëzve në këtë botë e ndjek këtë rrugë.

Ndonjëherë ndodhë të vendosim dhe pas pak të shohim se ne vetvetiu heqim dorë nga ajo që kemi vendosur. Janë pengesat ato që dalin dhe e pengojnë atë, e ne nuk mund t'u bëjmë ballë atyre.

Shumë herë ndodhë t'ia vëmë veshin ndonjë impuls shpirtëror që na ngacmon kalimthi e të na çojë shumë lart ose të na shpie shumë poshtë.

Njeriu është rob i All-llahut, ai nuk është zot në Tokë. All-llahu deshë që ta krijonte atë në mënyrë të veçantë. Prandaj njeriu nuk është as tokë, as kafshë e as engjell. Ai është i lirë ta adhurojë ose ta kundërshtojë Zotin e tij, është i lirë të jetë i suksesshëm në përmbushjen e këtij adhurimi dhe t'i mposhtë të gjitha pengesat që i dalin para vetes. Nëse është i suksesshëm, shpëton, e nëse jo, atëherë ka humbur!

Njeriut nuk i bën fare dobi të thotë: Unë jam "tokë" dhe nuk e kam vullnetin tim! Ose, të thotë: Jam gjeth që e lëviz era dhe e çon kah të dojë! Kurrësi! Ti je njeri me vullnet të përsosur, i lirë për ta pas-truar shpirtin tënd dhe për ta shtypur atë me punë të këqija e të dështosh. Lëri marifetet se nuk bëjnë dobi: "Disa njerëz diskutojnë për All-llahun pa kurrfarë diturie, pa udhërrëfyes dhe pa Libër ndriçues. Ata e kthejnë mënjane kokën (nga mendjemadhësia), që të largojnë të tjerët nga rruga e All-llahut. Këta njerëz do

të poshtërohen në këtë botë, kurse në Ditën e Kiametit Ne do t'i bëjmë, që të shijojnë dënimin e zjarrit të ndezur fort. (duke u thënë): *"Ky (dënim) është për shkak të veprave tuaja, se All-llahu nuk është i padrejtë ndaj robëve të Tij."*<sup>70</sup>

Pasi të mbarojë jeta e kësaj bote, shpirti kthehet te Zoti i tij dhe atëherë do të jemi para dy skenave ose ndodhje të rëndësishme:

Aty do të jenë disa që jetën e kësaj bote e kanë kaluar në rrugë të All-llahut dhe janë përpjekur të punojnë vetëm mirë, andaj edhe kanë luftuar në rrugë të All-llahut dhe

Disa të tjerë që në këtë botë kanë jetuar të dalldisur e si mashtrues, që nuk u kanë dhënë rëndësi All-llahut dhe nuk i kanë vlerësuar mësimet e Tij.

Fatmirët i presin engjëjt duke u shprehur mirëseardhje dhe dashuri. Atyre u thonë: *"Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni xhenetit që ju është premtuar."*<sup>71</sup>

Ndërkaq fatmjerët do të kenë pritje të ngryset, vend të mbushur plot tym dhe kërcënim. Ata nuk do të shohin gjë nga errësira. Kjo do ta gjejë çdonjërin që ka mohuar e kundërshtuar. Atë ditë do ta kuptojë se paska qenë në humbje të qartë! Në atë çast të vështirë ai e shpreson kthimin. Ah, sikur edhe njëherë të kthehet në dynja e të fillonte një jetë tjetër, një jetë më të drejtë dhe më të ndritshme!!

*"Kur i vjen vdekja ndonjërit prej tyre (jobsimtarëve), ai thotë: "O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira në botën që kam lënë! Kurrresi! Me të vërtetë, kjo është një fjalë*

<sup>70</sup> El-Haxhsb, 8-10

<sup>71</sup> Fussilet, 30

*të cilën ai (kot) e thotë! Prapa (vdekjes së) tyre do të ketë një (kohë) ndarëse<sup>72</sup>, deri në ditën kur do të ringjallen.”<sup>73</sup>*

Në dhjetëra vende të Librit të All-llahut është e përsëritur kjo shpresë! Ah, sikur të ishte e mundur të përfitohet edhe një rast jete! Por jo, është kot të shpresosh një jetë tjetër. Provimi ka mbaruar! Nuk ka afat tjetër për ta korrigjuar dështimin!

Ky pendim i vonshëm flet për një të vërtetë të vetme; ndjenjat e kriminelit se ai e ka dëmtuar dhe i ka bërë padrejtë vetvetes, se ai është njeriu që me jetën e tij të pavlerë e të errët e ka krijuar vdekjen e tij!

Ai kurrë nuk do të mëtojë të gënjejë e të thotë: “Isha i detyruar për atë që e kam bërë! Ose të thotë që Libri është fajtor për atë që e bëra, aty i kam pasur të shkruara të gjitha që duhej t’i kisha bërë, ndonëse unë nuk doja t’i bëja! Megjithatë edhe sikur ai të mëtonte të shpifte gjëra të kota, All-llahu do t’ia mbyllte gojën dhe në vend të tij do flisnin gjymtyrët e trupit të tij e do të tregonin se çfarë kanë bërë dhe kush e shtyri t’i bënte ato! All-llahu i Madhërishëm nuk e detyron askënd të jetë në rrugën e të keqes e pastaj ta futë në xhehenem! Ai që mendon kështu, vërtet është indorant, mendjelehtë. Për fat të keq, ka shumë nga ne që mendojnë kështu dhe që mundohen ta arsyetojnë mendimin e tyre me gjepura që nuk thuhet. Në vijim do ta bëjmë të qartë qëndrimin e të humburve ashtu siç e përshkruan vetëm surja El-Mu’minun.

Jeta nuk është vetëm një çast i shkurtër. Ajo është një kohë e gjatë që di të sjellë të mira e të këqija. Jeta

<sup>72</sup> Jeta e varrit

<sup>73</sup> El-Mu’minun, 99-100

nuk është një skenë. Aty ndodhin shumë situata, nga të cilat disa gëzojnë e disa dëshpërojnë. Megjithatë me rëndësi është rezultati përfundimtar.

*“Kur të fryhet në Sur (Ditën e Ringjalljes), atëherë, midis tyre nuk do të ketë lidhje farefisnore dhe ata as që do të pyesin për njëri-tjetrin. Ata, që u rëndohet peshorja (e punëve të mira), janë të shpëtuar. Sa për ata që do të kenë peshore të lehta, mu ata do të jenë (njerëzit) që kanë humbur vetveten, duke qëndruar përherë në xhehenem. Zjarri do t’ua përcëllojë fytyrat dhe buzët (aq sa do t’u duken dhëmbët).”<sup>74</sup>*

Le ta shohim me vëmendje të plotë këtë polemikë që zhvillohet mes Zotit të botëve dhe të mjerëve fatkëqij të burgosur në xhehenem! Ai u thotë: *“Vallë, a nuk ju lexoreshin Shpalljet Tona dhe i quanit ato gënjeshtra?!”<sup>75</sup>*

Vallë, çfarë do të përgjigjeshin ata? Ata, pasi një herë kanë dështuar, kërkojnë një rast tjetër, një kthim të dytë në dynja, që pastaj të tregohen të suksesshëm!

*“Ata do të thonë: “O Zoti ynë, neve na mposhti e keqja (tekat dhe dëshira) jonë dhe ishim një popull i humbur. O Zoti ynë, nxirrna prej xhehenemit e, nëse kthehemi prapë tek e keqja, atëherë jemi keqbërës të vërtetë.”<sup>76</sup>*

Zoti i botëve do t’i dëgjojë fjalët e tyre! Në dynja pati vetëm punë, por jo edhe llogari. Ndërkaq tani ka llogari, e jo punë. Është vetëm një rast për të cilin kam treguar qartë dhe kam dërguar të dërguar që ju kanë nxitur ta shfrytëzoni atë periudhë për të bërë mirë. Megjithatë kriminelët u treguan mendjemëdhenj dhe përgënjeshtrian. Andaj All-llahu u thotë: *“Rrini aty të*

<sup>74</sup> El-Mu'minun, 101-104

<sup>75</sup> El-Mu'minun, 105

<sup>76</sup> El-Mu'minun, 106-107

përbuzur dhe mos më flisni asgjë! Mes robërve të Mi, ishte një grup i cili thoshte: "O Zoti ynë, ne kemi besuar, andaj na fal dhe na mëshiro! Ti je më i miri i mëshiruesve! Por ju (o jobesimtarë) i keni tallur ata (aq shumë), sa ju bënë të më harronit Mua së përmenduri, e përherë i përqeshnit ata."<sup>77</sup>

Është ky kujtimi i ditëve të para të padrejtësisë, bredhjes së verbër në humbje dhe mosbesim. Çastet e sulmit kundër besimtarëve të dobët e pandihmë bënë që ata ta shijojnë dënimin e dhembshëm e të turpshëm dhe përherë të jenë të përqeshur!

Por, ja që ditët kanë ndryshuar. Edhe situata nuk është më e njëjtë: e mira ia doli të dalë në skenë, erdhi dita që durimtarët t'i gëzohen përfundimit të durimit që e bënë dhe përfundimit të shpresës që e kishin.

All-llahu i Madhërishëm thotë: "Unë i kam shpërblyer ata sot për durimin e tyre e ata, me të vërtetë, janë shpëtuar."<sup>78</sup>

Vallë, a vëren në këtë polemikë ndonjë gjurmë të padrejtësisë që ia kanë bërë këtij që po dënohet? Mos vallë ndonjëri prej tyre morri guxim të shpifë për All-llahun gënjeshtër e t'i thotë: "O Zot, Ti ishe Ai që i ke shkruar këto që i ke shkruar, kurse tani po më merr në pyetje për gjërat që nuk kisha mundësi t'u ikja?".

Përshkrimi i kaderit ashtu siç është i paraqitur në disa transmetime është i paqëlluar. Ne nuk duhet ta lëmë Librin e Zotit tonë në mëshirën e mendjelehtësive dhe gjërave të pavërteta të përhapura të cilat i mohojnë shpirti i këtij Libri dhe teksti i tij i shenjtë.

<sup>77</sup> El-Mu'minun, 108-110

<sup>78</sup> El-Mu'minun, 111

Kur'ani sjell vendim të prerë se veprat e jobsimtarëve janë ato që i sollën këta aty ku janë dhe i bënë të jenë në vendin më të ulët: *“O ju, që nuk keni besuar! Mos u shfajësoni sot (në Ditën e Gjykimit), sepse, me të vërtetë, dënoheni vetëm për veprat që i keni bërë.”*<sup>79</sup>

Ai gjithashtu sjell vendim të prerë se veprat e besimtarëve janë ato që i bënë këta të shpëtojnë: *“Dhe një zë do t'i thërrasë: “Ky është xheneti që ju e keni merituar për atë që keni punuar.”*<sup>80</sup>

Mos u shfajësoni me kaderin; nuk ka vend të thoni se ishin të detyruar.

Ju që i keqkuptoni gjërat apo transmetimet, ju lutem, mos e ndotni kthjelltësinë e Islamit.

Derisa po e shkruaja këtë libër, në dorë më ra një fjali e bukur e shumë të nderuarit profesor Ahmed Behxhet e shkruar me titull *“Të shkujdesurit”*<sup>81</sup>, të cilën e pashë të udhës ta sjell këtu për një qëllim që do ta shpalosim pas pak:

Ka njerëz që e duan All-llahun dhe të tjerë që e urrejnë të vërtetën. Ka njerëz zemrat e të cilëve përulen para këshillave të All-llahut dhe njerëz zemrat e të cilëve neveriten kur shohin se çështja është e lidhur me të vërtetën.

Ka njerëz që e duan fenë, që duan të përhapet e mira në mesin e njerëzve, siç duan që mes tyre të përhapen edhe vlerat e larta, por ka edhe njerëz që e urrejnë fenë verbërisht; këta janë që duan e keqja dhe e shëmtuara të përhapet në mesin e njerëzve, siç duan

<sup>79</sup> Et-Tahrim, 7

<sup>80</sup> Et-A'raf, 43

<sup>81</sup> Në gjuhën arabe “Gafil”

që në mesin e tyre të përhapet lakuriqësia dhe sytë e tyre të uritur të ngopen me shikimin e mbrapshtë, ashtu siç bie miza përdhese në mishin e pambrojtur.

Përplasjet mes besimtarëve dhe jobesimtarëve janë pjesë e ligjit të jetës.

All-llahu i Madhërishëm ka krijuar njerëz të denjë për xhenet dhe ka krijuar të tjerë të denjë për xhehenem. Ata që do të hynë në xhenet, do të hynë me mëshirën dhe faljen e All-llahut, ndërsa ata që do të hynë në xhehenem, do të hynë për shkak të këmbënguljes dhe zgjidhjes së tyre, lirisë së tyre absolute. Askush nuk do të ketë mundësi të ketë justifikim ndaj All-llahut të Madhërishëm.

Argumentet e All-llahut janë të shtruara në mesin e njerëzve, në natyrën e tyre dhe në faktet e All-llahut në gjithësi. All-llahu nuk është i nevojshëm për krijesat e Tij, ndërkaq të gjitha krijesat janë të nevojshme për Të: *“O njerëz! Ju jeni të varfër e nevojtarë për All-llahun, kurse All-llahu s’ka nevojë për asgjë dhe është i Denjë për çdo lavd.”*<sup>82</sup>

Ne e dimë se adhurimi i adhuruesve nuk e shton fare Pushtetin e Tij, por edhe mosbesimi i jobesimtarëve dhe mohimi i mohuesve nuk e pakëson Pushtetin e Tij, i Lartëmadhëruar qoftë All-llahu. Feja është për të mirën e njerëzve, e jo për të mirën e All-llahut.

Ndjekja e fesë sjell të mira për njerëzit, pra jo për ndonjë tjetër. Pikërisht për këtë themi se të shkujdesurit zakonisht qëndrojnë në grupin e kundërshtarëve të fesë.

<sup>82</sup> El-Furkan, 15



Të shkujdesurit përshkruhen si njerëz që kanë sy, por nuk shohin, që kanë veshë, por nuk dëgjojnë dhe që kanë zemra, por nuk kuptojnë.<sup>83</sup>

Ata janë krahasuar me kafshët, ndërkaq Kur'ani famëlartë bën me dije se kafshët janë më të mira se këta: *"Ata janë si kafshët, madje edhe më të."*<sup>84</sup>

I Dërguari s.a.v.s. pikëllohej dhe ngushtohej kur njerëzit e kundërshtonin. Atë e befasonte armiqësia dhe ashpërsia e kacafytjes që e kishin krijuar me të. Por, All-llahu i Madhërishëm ia bëri me dije se nuk je ti (o Muhamed) ai që po e mohojnë ata, por keqbërësit po i mohojnë shpalljet e All-llahut.

Keqbërësi është një i shkujdesur i madh, ai vetë e blen zjarrin e xhehenemit, pra me dëshirë e zgjedh atë. Pas kësaj shkujdesjeje nuk mund të ketë shkujdesje tjetër.

Keqbërësi e fiton dynjanë, ndërsa e humbë Ahiretin. Kjo është shkujdesje e madhe.

Dynjaja, në krahasim me ahiretin, është e pavlerë ose vlen më pak se një krah mushkonje; e lusim All-llahun për shpëtim.....

Fjali e qëlluar, e mirë dhe e frytshme! I sollëm këto fjali me qëllim që pas tyre të sjellim të tjera të cilat ua shtojnë njerëzve sëmundjen. Ato i përmend një këshillues (ligjërues) me qëllim që t'i frikësojë njerëzit nga All-llahu, që ata t'i lënë gjynahet dhe të këqijat!

<sup>83</sup> *"Ne kemi paracaktuar për xhehenemin shumë xhinde dhe njerëz, sepse ata kanë zemra, por nuk kuptojnë, kanë sy, por nuk shohin dhe kanë veshë, por nuk dëgjojnë. Ata janë si bagëtitë, madje edhe më të. Përkundrazi këta janë të shkujdesurit."* El-A'raf, 179

<sup>84</sup> El-A'raf, 179

Vallë, si i frikësoi ai këta nga All-llahu? Ai tha: *“Ne, sado që të punojmë të mira, nuk mund ta dimë fatin tonë, ndoshta jemi banorë të xhehenemit, e ne nuk e dimë!!”*.

Pastaj mori dhe përmendi hadithe lidhur me kaderin që nuk i shërben kujt tjetër, veçse besimit të detyrimit. Bile, kujtoj se çështja është edhe më zi se kjo, ai bënë që gjynahqarët të vazhdojnë në rrugën e mbrapshtë deri në fund, sepse ata nuk e ndiejnë humbjen e vullnetit i cili i mbizotëron gjërat!

Ka shumë myslimanë që mashtrohen me këto mendime të marra. Ata e kanë kuptuar se shpërblimi dhe dënimi janë fat i padukshëm ose rastësi që nuk ka norma të caktuara.

Ndërkaq ne i lexojmë fjalët e All-llahut të Madhërishëm: *“Kush mund ta pengojë All-llahun, nëse Ai dëshiron ta zhdukë Mesihun, të birin e Merjemes dhe nënën e tij, si dhe gjithçka që gjendet në Tokë.”*<sup>85</sup> Mirëpo, All-llahu, i Fuqishmi, i Urti dhe i Drejti, thotë: *“Zoti juaj ia ka bërë detyrim Vetes mëshirën.”*<sup>86</sup>

All-llahu i Madhërishëm nuk krijon njerëz për xhehenem vetëm pse ua dëshiron dënimin!

Në vijim do t'i përmendim disa hadithe lidhur me kaderin.

<sup>85</sup> El-Maide, 17

<sup>86</sup> El-En'am, 54

### *Hadithe mbi Kaderin*

Lidhur ma kaderin janë transmetuar shumë hadithe. Që këtej, kujtojmë se ato kanë nevojë për studim serioz, që myslimanët t'u shmangen dështimeve shpirtërore dhe shoqërore që i kanë goditur në të kaluarën dhe tani.

Transmeton Ebu Davudi se Ubadete ibn es-Samit - All-llahu i Madhërishëm qoftë i kënaqur me të - në çastin e vdekjes i tha të birit që e kishte pranë: "O biri im! Kurrë nuk ke për ta shijuar ëmbëlsinë e besimit (imanit) derisa të dish se ajo që të ka ndodhur nuk mund të mos ndodhte dhe ajo që nuk të ka ndodhur nuk do të ndodhte. Se unë e kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s. duke thënë: "Të parën që e ka krijuar All-llahu është lapsi. Pastaj i ka thënë: "Shkruaj! Lapsi ka thënë: "E ç'të shkruaj? All-llahu ka thënë: "Shkruaj masat e të gjitha sendeve deri në Ditën e Kiametit." O biri im! Unë e kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut të thotë: "Kush vdes jashtë kësaj (këtij besimi) nuk është nga unë (radhët tona)!".<sup>89</sup> Hadithin në fjalë e mbështet edhe transmetimi i Tirmidhiut.

Dijetari shumë i nderuar Muhammed Hami del-Fekij dha një vërejtje lidhur me këtë hadith dhe transmetimet e tij duke vënë në theks se në senedin e hadithit është një transmetues i akuzuar për trillim (gënjeshtër dhe shpifje), i shpërfillur dhe mohues i hadithit!!

<sup>89</sup> Ebu Davudi, vëll. 4 fq. 225, numër: 4700 - Libri i Sunetit/ kapitulli mbi kaderin.

Edhe përkundër dobësisë së senedeve, ne kujtojmë se në tekstin e hadithit ka fjali të pranuar që përputhen me provat e Kur'anit, prej afër ose prej larg dhe ato janë në pajtim me besimin e saktë: se All-llahu përfshin gjithçka në diturinë e Tij dhe se neve do të na godasë vetëm ajo që na e ka caktuar All-llahu. Prandaj neve na mbetet të përpiqemi dhe të mundohemi ta krijojmë të ardhmen tonë në botën tjetër, pa u bërë mendjelehtë dhe të shkujdesur (gafil).

Problemi fshihet në hadithet e transmetuara me sened të saktë. Janë pra tekstet ato që na bëjnë të ngelim gojëmbyllur para tyre!

Merre p.sh. hadithin që e transmeton Aisha – All-llahu i Madhërishëm qoftë i kënaqur me të – e cila thotë: *“I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ishte thirrur të merrte pjesë në xhenazen e një djaloshi të familjes së ensarëve. Unë i thashë: “O i Dërguari i All-llahut, i lumi ai! Zog prej zogjve të xhenetit, nuk e ka parë të keqen dhe nuk e ka bërë!” Ai tha: “O Aishe, a ke për të thënë tjetër? All-llahu i Lartëmadhëruar ka krijuar njerëz për xhenet, i ka krijuar ende duke qenë ata në shtyllën kurrizore (të prindërve të tyre) dhe ka krijuar të tjerë për xhehenem, i ka krijuar ende duke qenë ata në shtyllën kurrizore (të prindërve të tyre)!”*<sup>98</sup>

Transmeton Sehl ibn Sa’d se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: *“Njeriu vazhdon të punojë punë të banorëve të xhenetit dhe kjo ashtu u duket edhe njerëzve, kurse ai është nga banorët e xhehenemit. Dhe njeriu vazh-*

<sup>98</sup> Muslimi, vëll. 4 fq. 2050, numër: 2662, Kaderi – Kuptimi i hadithit: “Çdo i porsalindur lind në natyrën e pastër” dhe dispozita lidhur me vdekjen e fëmijëve jobesimtarë dhe fëmijëve mysliman.

*don të punojë punë të banorëve të xhehenemit dhe kjo ashtu u duket edhe njerëzve, kurse ai është banor i xhenetit!*<sup>89</sup>

Transmeton Abdull-llah ibn Amër se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: *"All-llahu e ka krijuar krijesën e Tij në errësirë, e pastaj ia ka hedhur dritën e Tij! Është udhëzuar ai që e ka kapluar drita e Tij, ndërsa është humbur ai që nuk është përfshirë nga drita e Tij! Që këtej them: "Është tharë lapsi ndaj diturisë së All-llahut të Madhërishëm!" (Ka mbaruar gjithçka në lidhje me vendimin e All-llahut).*<sup>90</sup>

Ka shumë hadithe që kanë të bëjnë me këtë çështje; se njeriu është i krijuar me dëshirë të refuzuar, se i nënshtrohet caktimit paraprak të Librit, se munda i tij është kot, se ai nuk ndryshon gjë nga plani i caktuar në përjetësi (ezel).

Që këtej themi: Vallë, a është e vërtetë se munda dhe përpjekja e njeriut është kot? Po pse All-llahu i Madhërishëm thotë për Ditën e Llogarisë: "Ora (e Kiametit) do të vijë me siguri, por Unë e mbaj tepër të fshehur, që secili të shpërblehet për atë që ka bërë."<sup>91</sup>

Pse thotë: *"Se njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar. Se përpjekjet e tij do të shihen. Dhe se do të shpërblehet me shpërblim të plotë."*<sup>92</sup>

All-llahu i Madhërishëm kërkon prej njeriut të jetë i drejtë me vetveten dhe ta ruajë atë nga e keqja! Ai kërkon prej tij të pranojë se ka gabuar aty ku është

<sup>89</sup> Muslimi, vëll. 4 fq. 2042, numër: 2652. Kaderi - Mënyra e krijimit të njeriut në barkun e nënës së tij, caktimi i riskut, echelit dhe punës së tij.

<sup>90</sup> Ahmedi, vëll. 2 fq. 176

<sup>91</sup> Ta-Ha, 15

<sup>92</sup> En-Neshm, 39-41

dashur të mos gabojë dhe se ka bërë keq aty ku është dashur të bëjë mirë. Pikërisht për këtë All-llahu i Madhërishëm thotë: *"Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!"*<sup>93</sup>

Vallë, a i thuhet kësaj i detyruar dhe i paaftë? Apo i thuhet kësaj se është i lirë dhe zgjedh vetë?

Dijetarët islamë i refuzojnë të gjitha gjërat e transmetuara që na bëjnë t'i kuptojmë gjurmët e detyrimit. Para nesh janë dy gjëra, pra jo më shumë:

Që kuptimin e tyre të jashtëm t'ia nënshtrojmë interpretimit të përafërt dhe të pranueshëm; dhe

Paraqitja e këtyre transmetimeve se ato përmbajnë rrethana të papranueshme, që i përjashtojnë nga grupi i haditheve që janë në shkallë të saktësisë së tyre të plotë. Prandaj nuk lejohet përdorimi i këtyre haditheve në sferën e edukimit dhe arsimimit.

Ndoshta kam arritur që përmes një trajtimi logjik sado pak ta shmang dyshimin e krijuar rreth çështjes së detyrimit nga shumë transmetime, por nuk kam arritur t'i përmirësoj mendjet e atyre që duan ta predikojnë Islamin me hadithe të paqarta në të cilat duken qartë arsyet e refuzimit.

Për popujt të cilët u gjykuan me shkatërrim All-llahu i Madhërishëm thotë: *"Vallë, a nuk udhëtojnë nëpër botë e të shohin se si kanë përfunduar popujt e mëparshëm? Ata kanë qenë më të fortë se këta dhe tokën e kanë shfrytëzuar dhe punuar më mirë se sa e punojnë këta, e të dërguarit e tyre u kanë sjellë prova të qarta. Nuk ishte All-llahu që u bëri atyre padrejtësi, por ata i bënë vetvetes pa-*

<sup>93</sup> El-Isra', 14

*drejtësi. Pastaj përfundimi i atyre që punuan keq, ka qenë e keqja e madhe (xhehenemi), ngase mohonin shpalljet e Allahut dhe talleshin me to.”<sup>94</sup>*

All-llahu i dënon keqbërësit me të keqen më të madhe (xhehenemin). Kjo është drejtësia e Tij. Megjithatë sikur të donte, do t'i falte, sepse është e drejtë e Tij të bëjë gjithçka.

Megjithatë All-llahu i Madhërishëm nuk e dëmtton askënd asnjë grimë ...

Është për t'u çuditur se si është e mundur që Atij t'ia përshkruajmë “detyrimin”, e pastaj të themi se Ai nuk duhet pyetet për atë që e bën! Ata që nuk e kuptojnë dhe tregohen të padrejtë në gjykime, nuk duhet t'u lejohej që shtrembërimi i tyre mendorë (shpirtërorë dhe kulturorë) të arrijnë në fenë e Allahut.

Akideja e teuhidit nuk është parim teorik të cilin e stolis vetëm sinqeriteti, por është program i jetës gjithëpërfshirëse.

Më pëlqeu mendimi i dijetarëve tanë shumë të nderuar, që treguan se i Dërguari s.a.v.s. i falte dy rekatet e namazit të sabahut me suret “Thuaj: “O ju mosbesimtarë!”<sup>95</sup> dhe suren: “Thuaj: “Ai është All-llahu, Një dhe i Vetëm!”<sup>96</sup>

Ata thanë: “Surja e parë e lufton shirkun e punës, ndërsa e dyta lufton shirkun e besimit (akides).”

<sup>94</sup> Er-Rrum, 9-10

<sup>95</sup> El-Kafirun, 1-6

<sup>96</sup> El-Ihlas, 1-4

### *Kur'ani pastron doktrinat e besimit dhe sjelljet*

Kur'ani famëlartë e mori përsipër pastrimin e doktrinave të besimit nga njollat e shirkut dhe u angazhua për sjelljet e njeriut duke e bërë teuhidin thelb dhe qëllim të tij. Sjelljet do të mund të jenë të shëndosha vetëm atëherë kur brendia e njeriut do të jetë e shëndoshë.

Shpirti i njeriut që bëhet rob kurrë nuk do të mund ta shijojë lirinë në jetë. Shpirti është i lirë ose rob.

Kur'ani famëlartë e zgjeron sferën e teuhidit brenda njeriut (në shpirtin e tij), me qëllim që të mos kujtojë ai se ekzistojnë të tjerë, përveç All-llahut, që e krijojnë të ardhmen e tij dhe larg dëshirës së All-llahut: *"Kush është ai, që mund t'ju ndihmojë si një ushtri e tërë, përveç të Gjithëmëshirshmit? Mòhuesit janë pre e mashtrimit (të shejtanit). Kush janë ata, që do t'ju japin mjetet jetese, në qoftë se Ai jua ndalon ato? Por ata janë të zhytur në kryeneçësi e mendjemadhësi."*<sup>47</sup>

Teuhidi praktik që duket në këto ajete krijon në njeriun besim dhe mbështetje që e bëjnë atë të heqë dorë nga çdokush tjetër, përveç prej All-llahut. Pas kësaj, njeriu është i qetë dhe i rehatshëm. Kush është ai që mund t'i përmbushë nevojat e njerëzve? Pse ata përulen para të tjerëve duke menduar se ata janë që i përmbushin nevojat e tyre? Sikur besimi i tyre të ishte i sinqertë, me siguri ata do të kishin sjellje të tjera. Vetëm All-llahu është Ai që i përmbush nevojat e njerëzve, e askush tjetër.

<sup>47</sup> El-Mulk, 20-21



Pikërisht për këtë, i Dërguari s.a.v.s. pas çdo namazi thoshte: *"O Zoti im, s'ka kush e ndalon atë që Ti e jep, dhe s'ka kush e jep atë që Ti e ndalon; s'ka dobi i pasuri, pasuria e të cilit është prej Teje (por dobi bën besim dhe respekti Yt)."*

Fjalja e fundit na bën të kuptojmë se pasuria e gjerë, pushteti i gjerë dhe kënaqësitë e njeriut, që janë nga të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër, janë sprovë për njeriun dhe se qëndrimi i tij në vështirësi (skamje) dhe mirëqenie (pasuri) është ai i cili e cakton fatin e tij tek All-llahu, siç thotë i Dërguari s.a.v.s.: *"Mjerë për atë që në këtë botë është i veshur, ndërsa në botën tjetër do të jetë i zhveshur"*.

Besimtari mysliman është ai që shpresën dhe dëshpërimin e tij e lidh në përputhje me ligjin madhështor të Kur'anit famëlartë: *"Begatitë, që All-llahu ua jep njerëzve nga mëshira e Tij, nuk mund t'i pengojë askush, ndërsa atë, që Ai e pengon, askush nuk mund ta japë veç Atij; Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti."*<sup>98</sup>

Kur'ani famëlartë synon përmirësimin e brendisë së njeriut duke e shndërruar atë me dritën e teuhidit, sepse vetëm ndriçimi i brendshëm do të mund ta përmirësonte të jashtmen e tij dhe do ta bënte të jetë i përqendruar në rrugën e drejtë. Nisur nga ky parim madhështorë, besimtari mysliman është ai që çdoherë i pari u përgjigjet gjërave që i do All-llahu dhe që u shmanget atyre që nuk i do Ai.

All-llahu i Madhërishëm thotë: *"Vërtet, All-llahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij, të radhitur si të ishin një ndërtesë solide."*<sup>99</sup>

<sup>98</sup> El-Fatir, 2

<sup>99</sup> Es-Saff, 4

Ndërkaq i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. thotë: *"Vërtet, All-llahu nuk i shikon radhët e shtrembëta."*

Rregullimi i radhëve në pesë kohët e namazit në mënyrë solide, e detyron besimtarin mysliman që tërë ditën të lëvizë dhe të rroj me shpirtin e shoqërisë dhe ta harrojë vetveten. Besimtari mysliman është ai që krah për krah me të tjerët e ndihmon fjalën e All-llahut, me qëllim që vetëm ajo të jetë më e lartë, sikundër që me të tjerët bashkëpunon në përmbushjen e detyrave që i ka ndaj All-llahut.

Islami nuk e do njeriun i cili në këtë botë rron sipas dëshirave vetjake dhe që i shpërfillë rregullat solide të bashkësisë. Ujku e ha vetëm delen ose kafshën e cila është e larguar nga kopeja. Barinjtë dhe njerëzit primitivë janë ata që rrojnë me shpirtin vetjak, që rëndin pas pasurisë dhe shpëtimit. Në lëvizjet e tyre shihet vetëm dashuria e jetës, qoftë edhe nëse i shkulin të tjerët për të mos i lënë t'i arrijnë të mirat e jetës!

Vallë, a s'më thua se çfarë është duke dominuar sot në botën islame? Rregulli i radhëve që gjallëron me dashurinë e All-llahut apo sjelljet e vetjakut që rron me dashurinë e kësaj bote dhe e urren vdekjen?

All-llahu i Madhërishëm thotë: *".... por bëni të mira; se All-llahu me të vërtetë i do bamirësit."*<sup>100</sup>

Ndiej kënaqësi të veçantë kur lexoj që Zoti im i do bamirësit, veçmas kur lexoj se atë e ka bërë detyrim për çdo send, siç thotë i Dërguari fisnik s.a.v.s.! Këto ndjenja më bëjnë ta urrej çrregullimin, pështjellimin, pakujdesinë dhe paaftësinë, siç më bëjnë që çdo punë

<sup>100</sup> El-Bekare, 195

që e bëj, çfarëdo që të jetë, ta bëj me kujdes të madh dhe në të t'i lë gjurmët e bukurisë dhe përsosurisë.

All-llahu, të Cilin unë e adhuroj, e urren shtrembërimin, talljen dhe shëmtimin. Vërtet, Ai e ka përsosur çdo gjë që e ka krijuar ...

Unë në këtë jetë dua të jem shembull i rregullimit të gjërave, i krijimit të situatave solide dhe i përsosurisë së punës.

Për çudi, Umeti islam i cili pretendon lidhjen me All-llahun dhe dëshirën e përmbushjes së detyrave ndaj Tij, është bërë shembull në nivel botëror i gjërave të papërsosura dhe prodhimit të mallrave nën nivelin e tyre të duhur, veçmas i menaxhimit të punëve në mënyrë primitive dhe të tmerrshme.

Shërimi, para se të jetë në stërvitjen e duarve për të krijuar përsosurinë, është në ndriçimin e brendisë me dashurinë e All-llahut dhe me dashurinë e asaj që Ai e do! *"All-llahu i do bamirësit."*<sup>101</sup>

All-llahu i Madhërishëm thotë: *"Në të vërtetë, All-llahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburraveçë."*<sup>102</sup>

All-llahu i Lartëmadhëruar nuk e do vetëpëlqimin, lavdidashjen, namin e madh të njeriut dhe epërsinë ndaj të tjerëve. Unë e kam parë se këto sëmundje janë duke i shkatërruar bashkësitë e vogla dhe të mëdha, siç kam parë që këto bashkësi ngrihen dhe zhvillohen sipas traditave të punëve që bëhen sa për sy e faqe të botës dhe mendjemadhësisë, ndërsa në anën tjetër e përhapin dyfytërsinë shoqërore mbi të cilën njerëzit po i ndërtojnë zakonet dhe normat e tyre.

<sup>101</sup> Ali-Imran, 134

<sup>102</sup> En-Nisa', 36

Sinqeriteti është ai që i zhdukë këto anomali, është ky sinqeritet që e bën njeriun të dojë të jetë ushtar i panjohur në këtë botë, sinqeritet i cili e heq nga sytë tonë mbulesën e famës së dëshiruar ose të pasurisë së kërkuar!

Dyfytyrësia është shirk. Atë e kam parë se është bërë monedhë që shkëmbehet në shumë sfera të jetës. Sa dyfytyrësh që janë udhëheqësit dhe sunduesit! Këta sikur nuk e dinë se ç'është sinqeriteti?! Ata janë të gatshëm që në këtë botë të kenë një mijë fytyra të tjera.

Për çudi, sot ka ndodhur që traditat e dyfytyrësisë të zbresin nga shtresa e lartë dhe të shtrihen edhe në masat e gjera të popullit, aq sa njeriu ndodhë ta pyes vetveten: "Vallë, a e kanë harruar njerëzit Zotin e tyre?"

Islami së pari e mbolli teuhidin në zemrat e njerëzve, e pastaj bëri që ai të shtrihet në sferat e tjera të jetës pa ndonjë pengesë. Sheriatit islam, pas përfortimit të besimit, do ta luajë rolin e formimit të modeleve të punëve të mira dhe për përkufizimin e dispozitave të shpallura nga ana e All-llahut, gjegjësisht hallallin dhe haramin. Sheriati islam ndërtohet vetëm mbi bazat e shëndosha të besimit në All-llahun Një dhe të Vetëm.

All-llahu i Lartëmadhëruar është Sundues absolut i pushtetit të Tij të gjerë, Ai gjykon si të dojë dhe e gjykon cilin të dojë, fjala e Tij është e vërtetë, ndërsa vendimi i Tij është i drejtë, ne duhet vetëm të dëgjojmë dhe të respektojmë.

Jobesimtarët (kafirët) dhe ata që e mohojnë Atë nuk duan të dëgjojnë për mësimet e Tij, e as për urdhrat e Tij!

Politeistët (mushrikët) – çfarëdo lloj i shirkut të jetë – mbështeten në vendimet e të tjerëve dhe rrojnë sipas pasioneve të tyre.

Që të dyja këto grupe – jobesimtarë dhe mushrikë – që sot dominojnë në botë, këshillohen mes vete për zhvleftësimin e mësimave të All-llahut të vërtetuara në shpalljen e fundit. Jo vetëm kaq, por edhe disa ithtarë të Librit – hebrej dhe të krishterë – shtiren sikur i kanë harruar mësimet hyjnore të cilat ende i kanë pranë vetes e që ende nuk i ka kapluar shtrembërimi dhe moskujdesi.

Bota sot i miraton marrëdhëniet e paligjshme seksuale, përderisa për një akt të tillë pajtohen të dyja palët mëkatare!

Ajo gjithashtu i ka miratuar të gjitha llojet e kamatës dhe të alkoolit, ndërsa e ka anuluar dënimin me vdekje. Në vend të ligjeve të shpallura nga ana e All-llahut, janë vendosur ligje të cilat janë rezultat i mendjes së njeriut.

Sot gati është krim të kërkojmë zbatimin e ligjeve të All-llahut, andaj zëri i atyre që flasin për një gjë të tillë është i padëshiruar!

Kur'ani famëlartë na mëson se vetëm All-llahut i takon sundimi dhe gjykimi: "Thuaj: "Vallë, a të kërkoj tjetër gjykatës përveç All-llahut, kur është Ai që ju ka zbritur këtë Libër të hollësishëm?"<sup>103</sup>

*"Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjyqimit tënd dhe të të binden plotësisht."*<sup>104</sup>

<sup>103</sup> El-En'am, 114

<sup>104</sup> En-Nisa' 65

Teuhidi, siç e bëmë të qartë, është sistem i jetës, ndërsa lidhshmëria me All-llahun është ajo që i jep frytet e tij në çdo kohë dhe në çdo vend. Ai përfshin individin, shoqërinë dhe shtetin. Në xhami falemi, ndërsa jashtë ndërtojmë shkolla, universitete, gjykata dhe rrugë, e ndërtojmë shtetin dhe institucionet e tij, që të gjitha në përputhshmëri me dëshirën e All-llahut.<sup>105</sup>

Edukimi shpirtëror, ai shoqëror dhe ushtarak, janë gjërat për të cilat flet vetë i Dërguari i All-llahut s.a.v.s.! Ai thotë: *“Zjarri i xhehenemit nuk do ta prek syrin që ka qarë nga frika e All-llahut. Zjarri i xhehenemit nuk do t’i prek sytë që i janë shmangur shikimit të gjërave të palejuara. Dhe zjarri i xhehenemit nuk do ta prek syrin që ka ruajt për hir të All-llahut (në luftë).”*

Janë këto vepra që burojnë nga një burim i vetëm – nga burimi i besimit të teuhidit.

Është ky besim i cila në vete ndërfton gjithçka dhe me të nisat drejt All-llahut: *“Thuaj: “Në të vërtetë, nama-zi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm All-llahut, Zotit të botëve. Ai nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij.”*<sup>106</sup>

Unë me vëmendje të plotë e studiova rrëfimin e njeriut të mashtruar, të zotit e dy kopshteve, të cilin e kishte mashtruar bollëku, pasuria, mendjemadhësia dhe mosbesimi! Mirëpo All-llahu nuk e la të tillë, por shumë shpejt hoqi dorë nga ai dhe ia shkatërroi të dyja kopshtet që ishin plot vreshta. Vallë, ku mbeti pasuria? Shkoi në humbje. Edhe gjurmët më nuk du-

<sup>105</sup> Muhammed el-Gazali shkruan në një vend tjetër se ndërtimi i një fabrike është i barabartë me ndërtimin e një xhamie. (përkthyesi)

<sup>106</sup> El-En’am, 162-163

ken! Njeriu i mashtruar vajti në shkatërrim. Asgjë më nuk i bën dobi atij. Atij nuk i mbetet tjetër, pos të bërtasë me zë të lartë: *"Ah! Sikur të mos i kisha shoqëruar Zotit tim askënd! Kështu, ai nuk pati kurrfarë rrethi që ta ndihmonte kundër All-llahut dhe as që ishte në gjendje të mbronte vetveten."*<sup>107</sup>

Unë e pyeta veten time: "Cili ishte ai zot që ky njeri ia kishte shoqëruar All-llahut? Në rrëfimin për të nuk ka emër të ndonjë idhulli apo të ndonjë njeriu të pamposhtur me të cilin ai krenohet!

Së shpejti u përgjigja: "Ai e kishte marrë epshin e tij për zot, ndërsa për idhull vetveten!"

Nuk është e thënë që shirku të mbështetet me ndonjë idhull të gdhendur ose me ndonjë prijës farao-nik. Mjafton që zemra e njeriut të jetë e zbrazët nga All-llahu, koka e tij të jetë e zbrazët nga All-llahu dhe e mbushur vetëm me pasione, që ai ta kujtojë vetëm këtë botë dhe të mohojë botën tjetër, që në këtë botë të rrojë siç rrojnë egërsirat në xhungël, ta dëgjojë vetëm zërin e instinkteve të tij.

Nëse kësaj nuk i thonë mosbesim, atëherë ç'është mosbesimi (kufri)?

Zbulimet e shkencës moderne e bënë njeriun më largpamës dhe më inteligjent. Ai nuk do të duhej më t'i përkulej gurit ose drurit! Mirëpo, a thua këto zbulime e bënë njeriun ta njihte Zotin e tij, t'i nënshtrohej Atij, të lidhej me Të dhe të përgatitej për takimin me Të? Kurrsesi!

Në thellësitë e kësaj injorance u shfaq injoranca e racizmit dhe fanatizmit, injoranca e kolonializmit dhe robërisë, injoranca e despotizmit dhe shtypjes.

<sup>107</sup> El-Kehf, 42-43

Vetëm rizgjimi islam mund ta shpëtojë botën nga shkatërrimi. Është ky rizgim që do ta bëjë teuhidin filozofi të jetës, shpirt të Umetit dhe shembull të përparimit shpirtëror dhe material, që s'do të jetë vetëm slogan i thatë e as pretendim që i bënë keq të vërtetës.



## *Tema e dytë*

### *Gjithësia e dëshmon Krijuesin e saj*

Ne jetojmë në një kënd të vogël të kësaj gjithësie të gjerë. Megjithëkëtë, ky vend i yni i vogël nuk na ndan nga madhështia e pushtetit të madh dhe të gjerë të All-llahut të Madhërishëm, sepse Toka dhe gjithçka që është në të është fuqi e All-llahut, i Cili e ka përsosur çdo gjë.

Krijuesi ynë është i Plotfuqishëm, i Urtë dhe i Gjithëdijshtëm. Përsosuria e Tij nuk ka të mbaruar, siç nuk ka të mbaruar edhe mirënjohja ndaj Tij. Këtë e vërejmë kur e shikojmë vetveten dhe botën tonë të kufizuar!

Ka shumë krijesa që ne nuk i shohim fare dhe që nuk arrijmë dot t'i mësojmë e t'i njohim, ngase ato janë larg shqisave tona dhe larg mendjes sonë. Krejt kjo është si thotë All-llahu i Madhërishëm: *"Krijimi i qiejve dhe i Tokës është më i madh se krijimi i njerëzve, por shumica e njerëzve nuk e dinë."*<sup>108</sup>

Mirëpo, ajo që është dhe që mund ta vërejmë, është provë e qartë e cila flet për madhësinë e Krijuesit të Lartë, dëshmi se Atij i takojnë emrat e bukur dhe atributet e larta.

<sup>108</sup> *Cafir*, 57

Mjeti i shpikur nga ndonjë gjeni flet për mendjen e të zotit të tij dhe për përgatitjen e tij të jashtëzakonshme, që bën njeriun të thotë: “Gjurmët e duarve të këtij shpikësi të madh janë në mjetin që është para syve tanë, që na bën të krenohemi me të dhe t’i shprehim mirënjohje!”

Krijuesi i qiejve dhe i tokës është Ai që ka bërë që qelizat e trupave të gjallë dhe atomet e trupave të vdekur të flasin për diturinë, urtësinë dhe bekimin e Tij. Krijesa të panumërta, që çdoherë përtërihen dhe nuk humben fare, me zë të lartë i shprehin madhështi, mirënjohje e lëvdata këtij Krijuesi Madhështor. Ai thotë: *“Atij i përket gjithkush që gjendet në qiej dhe në Tokë. Ata që janë tek Ai, nuk ngurrojnë për të adhuruar Atë e nuk ndiejnë lodhje. Por e lavdërojnë (Atë) natën dhe ditën, paprerë.”*<sup>109</sup>

Gjithësia është burim i parë i besimit tonë, ajo është skena e parë e të menduarit tonë.

Shpërfillja e gjithësisë llogaritet lëshim (gabim) i madh njerëzor, mënjanim i ashpër nga All-llahu i Madhërishëm, dështim në realizimin e misionit për të cilin jemi krijuar dhe paaftësi e krijimit të harmonisë së plotë me porositë kur’anore të cilat përsëriten në më shumë se dhjetë sure!!

*“Me të vërtetë, në qiej dhe në Tokë ka shenja për ata që besojnë. Edhe në krijimin tuaj dhe të kafshëve të shpërndara nëpër Tokë, ka shenja për besimtarët e bindur. Edhe në ndërrimin e natës dhe të ditës, edhe në ujën që All-llahu e zbrit nga qielli, duke gjallëruar nëpërmjet tij tokën e shtretuar,*

<sup>109</sup> El-Enbija’, 19-20

*edhe në ndërrimin e crërave, ka shenja për njerëzit që mendojnë. Këto janë shpalljet e All-llahut, të cilat Ne t'i tregojmë ty me tërë të vëretën. Atëherë, në çfarë fjalësh të tjera do të besojnë ata, nëse mohojnë All-llahun dhe shenjat e Tij?!"<sup>130</sup>*

Këto ajete, që janë shpallur në Mekë, ndërsa janë vërtetuar në Medinë, janë për ta zgjuar mendjen e fjetur dhe për ta bërë atë t'i shohë dëshmitë dhe provat që gjenden në çdo send, të cilat në fakt dëshmojnë për All-llahun dhe i shpjegojnë atributet e Tij të larta.

Të menduarit është detyrë islame, siç thotë Akadi. Lëmi e parë e të menduarit tonë është materia e kësaj gjithësie, siç na bën të qartë Kur'ani famëlartë. Çudia jonë nuk mbaron e as që ndërpritet nga shpërfillja e të menduarit për këtë.

Kujtoj se befasitë që na kanë goditur neve janë rezultat i ndikimit të filozofisë greke dhe ndjekjes së iluzioneve (fantazmave) dhe hamendjeve të kësaj filozofie, duke filluar nga periudha e përkthimit e deri te dekadencia e fundit e arabëve.

Aristoteli dhe të tjerët e shohin materien si një gjë të pavlefshme, ndërsa krijesat në shkallë të ulët. Zoti i Aristotelit është më i lartë se të mendojë rreth gjithësisë ose që dituria e tij të merret me imtësi! Sipas tij, Zoti është Ai që e vëzhgon vetveten dhe nuk e di se çfarë ndodhë në botën e njerëzve! Dhe, sikur Ai ta dinte se çfarë ndodhë në Tokë, do të dihej se kjo është rezultat i asaj që ndodhë në qiell: rrotullimi i Hënës rreth Tokës, ngrohtësia dhe të ftohtit, zgjatja e hijes dhe tkurrja e saj, rrotullimi i Tokës rreth boshtit të vet

<sup>130</sup> El-Xhathije, 3-6

dhe rreth Diellit, si dhe lëvizja e planetëve në orbitë me një rend të përkryer, që të gjitha ndodhin me anë të ligjit të gravitacionit.

Parafytyrimi i Aristotelit për Zotin është i mangët dhe i pavlefshëm. All-llahu i vërtetë e shpalosi diturinë e Tij, duke e bërë të qartë se dituria e Tij përfshin gjithçka që është në gjithësi: *"Ai i ka çelësat e së padukshmes dhe vetëm Ai i njeh ato. Ai e di ç'ka në tokë dhe në det; asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh)."*<sup>111</sup>

Çështja nuk është vetëm temë e diturisë dhe shqyrtimit negativ, por është edhe çështje e krijimit dhe furnizimit, siç përmendëm më parë. Në çdo çast na dalin mijëra fjalë të cilat e orientojnë dhe drejtojnë ekzistencën sipas dëshirës së lartë të All-llahut: *"Sikur të gjithë drurët, që gjenden në Tokë, të ishin pena e deti bojë shkrimi e t'i shtohen atij edhe shtatë dete të tjera, nuk do të shtereshin fjalët e All-llahut. Pa dyshim, All-llahu është i Plotfuqishmi dhe i Urti."*<sup>112</sup>

Nga kjo na bëhet e qartë se shpërfillja e gjithësisë dhe e studimit të saj është dera drejt injorancës dhe devijimit! Islami e ndërton diturinë mbi bazën e vëzhgimit dhe studimit të thellë të gjithësisë dhe hulumtimit të pandërprerë në të, ndërkaq zhvillimi i diturisë larg kësaj rruge është devijim e assesi metodë islame. Ata që e ndoqën rrugën e devijimit të filozofisë greke, i bënë dëm Islamit dhe misionit të tij.

<sup>111</sup> El-En'am, 59

<sup>112</sup> Lukman, 27

Diku tjetër i kam qortuar disa myslimanë për mashtrimin e tyre me filozofinë greke dhe kontributin e tyre për përkthimin e saj, sidomos për atë se shumica e myslimanëve filluan të merreshin me atë, edhe pse e dinin se ajo përmbante shumë sherr e pak hair!!

Sidomos i kam qortuar për atë se nuk u angazhuan me përkthimin e filozofisë kur'anore; të njohurës, vlerave morale dhe mësimëve rreth marrëdhënieve ndërnjerëzore, veçmas që nuk u angazhuan në shpjegimin e Njëshmërisë së lartë me të cilën erdhi Kur'ani i madhërishëm.

Mungesa e tillë e dëmtoi universalizimin e misionit përfundimtar islam dhe e turbulloi pastërtinë e të menduarit tonë.

Të bëhemi të sinqertë, vëzhgimi dhe studimi i thellë i gjithësisë ishte faktor i zhvillimit të shpejtë të shkencës moderne. Sidomos i tillë ishte zbulimi i sekreteve dhe fuqive që gjenden në to. Më duhet të them se metoda e tillë është metodë kur'anore që del nga ajetet që nxisin studimin dhe vëzhgimin e gjithësisë. Nevoja e civilizimit modern për vlerat e larta dhe falimentimi i tij imanor janë ato që e kanë shndërruar suksesin shkencor në kërcënim për njerëzimin dhe humbje të ardhmërisë së tij.

Ne duam ta shfajësojmë vetveten, fenë tonë dhe trashëgiminë tonë të çmuar duke u mbështetur vetëm në tekstet e Librit tonë.

Gjithësia, sipas filozofisë kur'anore, është e çmueshme dhe e shtrenjtë te Krijuesi i saj! Jo sepse Ai ka dhënë mund për ta krijuar atë ose se ka paguar çmim për të! Assesi: *"Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t'i thotë asaj "Bëhu!" – dhe ajo bëhet."*<sup>113</sup>

<sup>113</sup> Ja Sin, 82

Shtrenjtësia e saj (vlëra e saj e lartë) i referohet faktit që e dëshmon Krijuesin e saj. Çdo tullë e saj është krijuar në bazë të së vërtetës dhe me të vërtetën, pjesët e saj janë të ndërtuara në bazë të ligjeve precize, aty shfaqet lavdia e All-llahut në formën më të ndritur dhe më të shkëlqyer. Libri i All-llahut thotë: *"Ne i kemi krijuar qiejt dhe Tokën dhe çfarë gjendet midis tyre me qëllim të plotë dhe me afat të caktuar."*<sup>114</sup>

Njeriu kurrë nuk do të jetë i aftë ta njohë All-llahun e Madhërishëm nëse para kësaj nuk i njeh ligjet e të vërtetës, andaj shpalljet e All-llahut kurrë nuk do t'i shërbejnë shpërfillësit të këtyre ligjeve! Është tejet brengosës fakti që shumica e myslimanëve sot janë duke i jetuar vitet e thata të jetës së tyre dhe janë bërë maskara në Tokë, ndërkaq All-llahu i Madhërishëm ia nënshtroi njeriut qiejt dhe Tokën dhe gjithçka midis tyre!!

Kur'ani famëlartë në shumë ajete të tij na e tërheq vëmendjen për madhësinë e Krijuesit në gjithësi, me qëllim që ne ta rrisim besimin tonë dhe t'i nënshtrohemi Atij. Vëru re fjalëve të All-llahut: *"Ne zbresim ujë nga qielli me masë të caktuar, pastaj e depozitojmë atë në Tokë. Por, nëse dëshirojmë, Ne jemi në gjendje ta heqim atë tërësisht."*<sup>115</sup>

Shkencëtarët thonë: "Tre të katërtat e Tokës janë të mbuluara me ujë. Planeti Tokë është i rrumbullakët sikur Hëna. Uji që shihet në sipërfaqen e Tokës rri i përqendruar në kozmos dhe nuk derdhet në të djathtë ose në të majtë. Ne mund ta parafytyrojmë se tre të

<sup>114</sup> El-Ahkaf, 3

<sup>115</sup> El-Mu'minun, 18

katërtat e ujit rrinë në formë të qarkut, e jo në formë të drejtë siç jemi mësuar ta shohim atë kur e kemi pranë nesh dhe kur e përdorim. Ndaj pyesim e themi: "Si është e mundur të bie kjo sasi e ujit dhe kush është ai që nuk lejon që sasia tjetër e këtij uji të mos bie?"

All-llahu është Ai që e ka vendosur në Tokë dhe Ai është që ka bërë që sasia tjetër e ujit të mos derdhet andej këndeje.

Qarkullimi i ujit midis gjallesave është gjë që e tërheq vëmendjen. Të gjithë pinë ujë: njerëzit, bagëtitë, kopshtet etj. Të gjithë pimë nga lumenjtë dhe burimet të cilat i sjellin retë e rënda me shi që vijnë nga çdo anë nga detet e mëdha. Pastaj ndodh që trupat dhe kopshtet të thahen (të eten), uji që ishte në brendinë e tyre të derdhet dhe kështu, duke i kaluar njëmijë rrugë, të kthehet nga ka ardhur, që përsëri të shndërrohet në re dhe shi, në burime dhe lumenj! Sa çudi, jeta vazhdon duke mos e çarë kokën për sasinë e ujit që gjithmonë është e mjaftueshme, as nuk pakësohet e as nuk shtohet.

Kur'ani famëlartë është ai që e thekson këtë qarkullim të përhershëm, dhe thotë: *"Nuk ka asnjë send që të mos gjenden tek Ne thesaret e tij; por prej tij Ne japim me masë të caktuar. Ne i dërgojmë erërat për pllenim dhe zbresim nga qielli ujë, prej të cilit ju japim të pini e të cilin nuk mund ta depozitoni dot. Në të vërtetë, vetëm Ne e japim jetën dhe e sjellim vdekjen dhe vetëm Ne jemi trashëgimtarët (e gjithçkaje)."*<sup>116</sup>

Ta kapërcejmë bisedën e ujit e të kalojmë te biseda e hijes dhe dritës! Rrëfimi kur'anor për këtë temë

<sup>116</sup> El-Hixhr, 21-23

më bën ta ndiej se vetë All-llahu i Lartëmadhëruar e di madhështinë dhe bukurinë e asaj që e ka krijuar, andaj vetë Ai na flet për të, që ne të mahnitemi, ta madhërojmë dhe t'i përkulemi vetëm Atij: *"A nuk e ke parë ti se si Zoti yt e ka zgjatur hijen?! Sikur të kishte dashur, do ta bënte të pandryshueshme? Pastaj Ne e kemi bërë Diellin udhëzues të saj. Pastaj e tërheqim atë (hijen), dalëngadalë pranë Vetes."*<sup>117</sup>

Pas bisedës rreth hijes, zgjatjes dhe tërheqjes së saj, rrëfimi kur'anor i referohet natës dhe ditës: *"Dhe është Ai që jua ka bërë natën mbulesë dhe gjumin pushim, kurse ditën jua ka bërë për të lëvizur."*<sup>118</sup>

Më ka ndodhur që shumë herë t'i shoh hijet e gjërave, sidomos gjatë uljes së aeroplanit, kur ende nuk ka zbritur në tokë. A thua hija ia kalon trupit apo trupi ia kalon hijes! Thashë më vete: ku ishte kjo hije derisa ne ishim në ajër? Pastaj i kam parë hijet e kodrave, hijet e reve që janë afër, por nuk i kam parë hijet e reve të larta. Siç duket, aty nuk ka gjëra që i pranojnë hijet e shpërndara në gjithësi!!

Mirëpo, hija e Tokës që noton në hapësirën e qiellit i gjen gjërat që e pranojnë atë, Hëna merr formë të ndryshme: hënë e re, hënë pesëmbëdhjetëshe, hënë e plotë (katërmëdhjetë), hënë e re etj., gjithë kjo varësisht se çfarë pranon nga këto hije.

Me vëmendje të plotë i lexova këto fjalë të All-llahut të Madhërishëm: *"A nuk e vërejnë ata se si të gjitha ato që i ka krijuar All-llahu, hija e tyre anon djathtas e majtas, duke iu falur All-llahut dhe duke iu përkulur?"*<sup>119</sup>

<sup>117</sup> El-Furkan, 45-46

<sup>118</sup> El-Furkan, 47

<sup>119</sup> En-Nahl, 48



Dhe fjalët e Tij: *"All-llahut i përulet në sexhde gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë, me hir a me pahir, si dhe hijet e tyre i përulet në mëngjes dhe në mbrëmje."*<sup>120</sup>

I Gjalli dhe i Përjetshmi (All-llahu) është Ai që çdo atomi në gjithësi ia falë ekzistencën, gjithçka është e nevojshme për Të, gjithçka i mbështetet Atij, gjithçka i nënshtrohet vetëm Atij, në mëngjes dhe në mbrëmje e respektojnë urdhrin e Tij, duke e deklaruar nënshttrimin e plotë ndaj pushtetit të Tij të lartë!

Vallë, a thua është e udhës të zhvleftësohet i Zoti i botëve dhe t'ia kthejmë shpinën bukurive të Tij dhe shenjave të Tij në gjithësi? Ata që nuk e njohin gjithësinë janë ata që e shpërfillin madhësitinë e All-llahut dhe rrojnë duke bredhur anembanë hapësirave që Ai i ka krijuar, njësoj siç që bredh bujku nëpër laboratorët kimikë, fabrikat e atomit dhe observatorët e vëzhgimit të planetëve.

Mund ta marr me mend që një adhurues i lopës ta shpërfillë gjithësinë dhe Krijuesin e saj, por kurrë nuk mund ta marr me mend që një ndjekës i Kur'anit të jetojë i paaftë dhe shpërfillës në mesin e fshehtësive të gjithësisë dhe fuqive të saj, si dhe gjërave që All-llahu i ka krijuar për të sjellë dobi dhe ndihmë! Si mund të ndodh kjo, kur në faqet e para të Librit të tyre thuhet: *"Është Ai që për ju ka krijuar çdo gjë që ka në Tokë."*<sup>121</sup>

Ky ajet vjen menjëherë pas thirrjes universale që i bëhet gjithë njerëzimit, që ta njohë Zotin e tij dhe gjërat që i krijoi për ta, të mirat dhe pasuritë e ndryshme.

<sup>120</sup> Er-Ra'd, 15

<sup>121</sup> El-Bekare, 29

*“O njerëz! Adhuroni Zotin tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat). I Cili e ka bërë për ju tokën shtresë dhe qiellin ndërtesë; i Cili prej së larti zbret ujë dhe nëpërmjet tij bën që të rriten fruta si ushqim për ju...”<sup>122</sup>*

Nuk kam për qëllim të kundërshtoj vetëm filozofinë greke për atë që sot e ka goditur logjikën (arsyen) islame nga shtrembërimi, ngase sot kemi të bëjmë me një lloj të përkushtimit artificial (të sajuar, të pararenduar) që mbështetet në ide absurde dhe koncepte joproduktive, përkushtim i cili jetën tjetër (ahiretin) e beson si urrejtje të vdekjes, ndërsa zuhdin në këtë botë e kupton shpërfillje të asaj ose rrojtje në margjinat e saj.

S’ka dyshim se kohëve të fundit është përhapur ky lloj i këtij përkushtimi artificial që e shëmtoi fenë dhe botën, ndërsa myslimanëve u solli disfata të tmerrshme në jetën reale dhe në jetën e ardhshme!

Çfarë mund të themi për njeriun i cili e pret dorën e vet për shkak se ka bërë gjynah?! Ai kurrë më nuk do të mund të punojë mirë me të. Transmeton Xhahidhi se një ditë e kishte takuar një njeri, të rraskapitur e thatanik dhe e kishte pyetur se çfarë i kishte ndodhur? Ai kishte thënë: “Kam menduar gjatë për të këqijat dhe humbjet që mund t’ia sjell njeriut epshi seksual, ndaj shkova dhe u trodha!” Sa i marrë që është ky njeri! Me këtë zgjidhje vetëm e ka humbur aftësinë për jetë! Disa të përkushtuar (që mbahen fetarë) e pëlqyen këtë veprim, ndaj edhe pranuan të jetojnë në një

<sup>122</sup> El-Bekare, 21-22

kënd të ngushtë të gjithësisë së gjerë, joshën rehatinë, shpëtimin, jetën larg trazirave (fitneve) dhe përgatitjen për jetën tjetër. Kështu i lanë të tjerët të bëjnë zhurmë në të gjitha fushat e jetës, t'i përhapin pasionet e tyre dhe t'i mbështesin ato.

Ky nuk është koncept i të menduarit islam edhe pse është shtrirë në mesin e shumë myslimanëve të cilët jetojnë të huaj dhe të dobët e të paaftë anembanë botës.

Rihapja e njeriut ndaj gjithësisë dhe të studiuarit e saj është porosi e vetme kur'anore e të gjitha doktrina-ve dhe porosive mbi të cilat ndërtohet feja.

Vallë, a thua ka krijesa të cilat i ka krijuar ndonjë zot tjetër, përveç All-llahut? A ka ndonjë zot tjetër, përveç All-llahut, që i ka krijuar kafshët, e një tjetër që i ka krijuar njerëzit? A thua Krijuesi i Diellit nuk është Krijuesi i Tokës? Uniteti i gjithësisë, rendi i saj i përkryer dhe qëllimi i saj provojnë qartë se Krijuesi është Një dhe i Vetëm. Pikërisht për këtë All-llahu i Madhërishëm thotë: *"Ai i ka krijuar qiejt pa shtylla të dukshme, ka vënë male të palëvizshme në Tokë, që ju të mos lëkundeni dhe ka shpërndarë në të gjithfarë gjallesash. Ne e zbresim ujin nga qielli dhe, nëpërmjet tij, kemi bërë të mbijë çdo lloj (bimë) i mirë. Ky është krijimi i All-llahut! Më tregoni çfarë kanë krijuar të tjerët pos Tij? Asgjë, por keqbërësit janë vërtet në humbje të plotë."*<sup>123</sup>

Është kjo logjika e lehtë dhe e përafërt e cila e konfirmon besimin si pjesë të shtyllave të fesë.

Kur skeptikët pyesin për mundësinë e ringjalljes pas vdekjes, Kur'ani sjell prova kozmike (të gjithësisë)

<sup>123</sup> Lukman, 10-11

të pakontestueshme: “A nuk e shohin ata qiellin që qëndron sipër tyre, si e kemi ndërtuar dhe zbukuruar, pa pasur kurrfarë plasaritje në të? Ndërsa Tokën e kemi shtruar dhe në të kemi shpërndarë male të palëvizshme dhe kemi bërë, që nga ajo, të mbijnë gjithfarëlloj bimësh të bukura, si mjet ndriçimi të mendjes dhe përkujtesë për çdo rob që i drejtohet Zotit të vet. Ne lëshojmë nga qielli ujë të bekuar dhe nëpërmjet tij krijojmë kopshte, drithëra që korren dhe palma hurme të larta me tufa frutash njëra mbi tjetrën, si ushqim për robërit Tanë; në këtë mënyrë Ne me shi e ringjallim tokën e vdekur. E kështu do të jetë edhe ringjallja.”<sup>124</sup> Po kështu do të jetë ringjallja dhe dalja nga varret për të qëndruar para Zotit! Ngjallja e dytë nuk është më e rëndë se ngjallja e parë që e shohim për çdo ditë!

Zgjimi i të shkujdesurve dhe njoftimi i tyre me mosmirënjohjen dhe refuzimin që e kanë, veçmas me frymëzimin e shpëtimit nga nuk e kujtojnë, arrihet përmes prezantimit të shpejtë dhe rrëmbyes të shenjave të All-llahut në krijesat e Tij: “Ne e kemi ndërtuar qiellin me fuqinë Tonë dhe Ne e zgjerojmë atë. Edhe Tokën e kemi shtruar! Sa shtrues të mrekullueshëm që jemi! Dhe nga çdo gjë, Ne kemi krijuar dy palë, në mënyrë që ju të vini veshin! Andaj, ikni (prej dënimit) drejt (shpërblimit të) All-llahut, se unë vërtet që jam dërguar te ju prej Tij, si paralajmërues i qartë.”<sup>125</sup>

Provat e gjithësisë nxisin në besim, në teuhid. Ato e orientojnë njeriun drejt pendimit dhe e shpëtojnë atë nga shkatërrimi e humbja. Por jo vetëm kaq. Kur’ani famëlartë e përgatit rrugën e shprehjes së mirënjohjes

<sup>124</sup> Kaf, 6-11

<sup>125</sup> Edh-Dharijat, 47-50

dhe lëvdatës ndaj All-llahut, duke e përmendur krijimin e Tij të mrekullueshëm të kontinenteve, jetën dhe gjallërinë që dominon gjithkund, nderimin e njeriut për nga forma dhe shpirti, gjithë kjo duket sikur Kur'ani shëtitë nëpër të gjitha anët e botës: "All-llahu është Ai që jua ka bërë Tokën vendbanim e qiellin kulm, ju ka dhënë formë e jua ka përsosur atë dhe ju ka furnizuar me ushqime të mira. Ja, ky është All-llahu, Zoti juaj. Qoftë i lartësuar All-llahu, Zoti i botëve! Ai është i Përjetshmi, s'ka zot tjetër përveç Atij. prandaj lutuni vetëm Atij, duke iu drejtuar me adhurim të sinqertë. Qoftë i lavdëruar All-llahu, Zoti i botëve!"<sup>126</sup>

Çfarë ndodhi pas asaj që besimi i humbi burimet e tij të gjithësisë dhe porositë e udhëzimet e tij kur'anore? Asgjë, vetëm që u shndërrua në një koncept të pakuptimtë, metafizik, të paqartë dhe dëshmi filozofike e teorike e vdekur.

Në fakt, të prapambeturit që sot e kanë vërshuar tokën islame janë ata që më shumë e mbështesin imitimën sesa që e mbështesin aktivitetin logjik të ndërtuar mbi bazat e vëzhgimit të gjithësisë dhe studimit të saj.

Sikur myslimanët të jenë të vetmit që banojnë në Tokë, e asnjë tjetër përveç tyre, atëherë mund të themi se shërr i shpërfilljes është meritë e tyre, siç është meritë e tyre për t'i gëlltitur gjynahet shpirtërore dhe morale! Mirëpo, Toka është vendbanim i shumë racave dhe feve të ndryshme, andaj nuk është e mundur që të tjerët të lëvizin, ndërsa myslimanët të pushojnë, siç nuk është e mundur që myslimanët të vetëmby-

<sup>126</sup> El-Gafir, 64-65

llen, ndërsa të tjerët të marrin hov e ta punojnë Tokën më mirë se sa që e punojnë ata! Në fund, Islami është ai që pëson prapambeturinë dhe të cilin e godasin disfatat e shëmtuara!

Kjo edhe ndodhi! Myslimanët u dhanë pas librave të vdekur që i shkroi përkushtimi i sajuar (artificial) dhe nuk lexuan asnjë vijë nga libri i hapur i gjithësisë! Këta i mbyllën veshët para thirrjeve të njëpasnjëshme të Kur'anit që nënkuptonin studimin e shenjave të All-llahut që gjenden në gjithësi, a ndaj edhe u ndalëm aty ku arritën të parët tanë të ndershëm. Ndërsa të tjerët vazhduan rrugën e zhvillimit dhe përparimit, andaj edhe na kaluan!!

Ndoshta thua: nëse është e vërtetë se të tjerët na kaluan dhe me shkathësi e studiuuan gjithësinë dhe atë e shfrytëzuan për ta mbështetur civilizimin e tyre, atëherë pse nuk besojnë në All-llahun, ndonëse i kanë parë shenjat e Tij në çdo gjë?

Studimi i doktrinave të mendimtarëve është gjë e çuditshme. Profesori Abbas el-Akkad pohon se studimi i doktrinave të mendimtarëve provon faktin se shumica e tyre janë besimtarë. Mirëpo, ky besim i përgjithshëm është ai që e përfshin besimin në All-llahun dhe madhësitinë e Tij, ndërkaq shndërrimi i këtij besimi në namaz, tesbih, agjërim, istigfar etj., kjo ndodh vetëm përmes studimit të shpalljes. E ku e kanë ata shpalljen dhe ku mund ta gjejnë atë?

*Muslimanët i bën të padrejtë fesë së tyre dy herë:*

Një herë që nuk e zbatuan atë në mënyrë të mirëfilltë dhe për së dyti që nuk qenë të aftë ta predikojnë atë në mënyrë të duhur.

Moszbatimi i mirëfilltë i fesë bëri që vetë ajo të ballafaqohet me akuza të ndryshme, sa që ata thanë: është kundër natyrës së njeriut, kundër lirisë dhe arsyes së shëndoshë.

Paaftësia e predikimit të fesë në mënyrë të duhur bëri që shumica e njerëzve, në Lindje dhe në Perëndim, të mos dinë fare për Islamin.

T'i kthehemi edhe njëherë bisedës kur'anore dhe porosive të tij të shpërfillura; All-llahu i Madhërishëm ua lejoi të gjithëve, besimtarë e jobesimtarë, përdorimin dhe shfrytëzimin e tokës, të ecin nëpër viset e saj dhe t'i nxjerrin thesaret e brendisë së saj.

Si do të jetë halli nëse jobesimtarët lëvizin dhe marrin hov, ndërsa besimtarët tregohen të paftë dhe dembelë? Si do të jetë halli nëse duart e të tjerëve tregohen të shkathtë në bujqësi, industri, tregti dhe administratë, ndërsa ne rrimë duarkryq dhe të palëvizshëm në këto fusha?

Vallë, a thua besimi do të ngadhënjejë me këtë paftësi mendore dhe vdekje materiale e kulturore? Apo atë do ta arrijë dështimi (dëshpërimi) në çdo vend? Ne duhet të heshtim, sepse realiteti i dhembshëm është ai që flet.

Sa më hidhëron ajo që të dërguarit e All-llahut të obligohen me përpunimin e hekurit, që atyre t'u kërkohet përpunimi i mjeteve luftarake, që të mirët e të vyeshtmit të mësojnë gjuajtjen dhe goditjen e caktit, që

ata të jenë ekspertë të ndërtimit të fortifikatave dhe kazermave ushtarake etj., ndërkaq që të mirët e të vyeshmit tanë të mos dinë asgjë nga këto gjëra.

Goditja e caqeve tokë-tokë, tokë-qiell ose det-tokë kërkon njohjen dhe aftësinë në çdo lëmë shkencore: shtresat e tokës, të qiellit, inxhinierinë, fizikën, kiminë, astronominë etj.

Vallë, a thua Davudi alejhi-selam tallej dhe humbte kohën kur atij iu tha: *“(Dhe i thamë): Puno pazmore të gjera. Thuri ato me maje të baraspeshuara dhe bëj vepra të mira.”*<sup>127</sup>

Dhul-Karnejni nuk tallej dhe nuk humbte kohë kur po i ndizte furrat dhe po i shkrinte xehet e po i vendoste muret e larta të fortifikatave!

Edhe Mehmeti II Fatihu nuk tallej dhe nuk humbte kohë kur urdhëroi që anijet të nisen nëpër rrugë të thara dhe kështu t’i rrethojë armiqtë e tij!

Ata që njohuritë e gjithësisë dhe jetës i llogarisin njohuri të kota për fenë e All-llahut dhe mendojnë se adhurim i vërtetë është bartja e tespiheve dhe lëvizja e kokrrave të tyre duke shqiptuar fjalë të thata, janë njerëz të verbër e të pavlerë.

*Janë të dobët e të vegjël, pa ëndrra,  
Të të mos mashtrojnë duart që bartin tespihe,  
Se, sikur Toka të dinte të fliste, do të dëshironte të ishte pa ta,  
Se askush nuk ka parë si ata, që janë vetëm hije.*

Myslimanët do të mund ta shohin rrugën vetëm atëherë kur do t’i kthehen filozofisë praktike të Kur’a-

<sup>127</sup> Es-Sebe’, 11



nit dhe t'i kuptojnë fjalët e All-llahut të Madhërishtëm:  
*"Ne i çuam të dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat dhe peshoren (e drejtësisë): që njerëzit të veprojnë drejt. Ne e zbritëm hekurin, në të cilin ka (material për) luftë të fuqishme dhe dobi (të tjera) për njerëzit, me qëllim që All-llahu të njohë ata që e ndihmojnë Atë dhe të dërguarit e Tij, pa e parë Atë. Me të vërtetë, All-llahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm."*<sup>128</sup>

Këto fjalë të All-llahut të Madhërishtëm mbarojnë me dy nga emrat e bukur të All-llahut, që e provojnë fuqinë dhe krenarinë. Aty ka shenjë për mendarët, për metodat të cilat sjellin ngadhënjimin dhe ngritjen lartë, siç ka një shenjë tjetër që shënon se e vërteta nuk ndihmohet me ambicie shpërfillëse. Ai që e ka humbur drejtësinë e parimit dhe përvojën e aftësisë, të mos e qortojë askënd tjetër, përveç vetvetes.

Kur'ani famëlartë flet për dhuntitë e All-llahut që i shfrytëzojnë banorët e Tokës, qoftë në shtëpitë e tyre ose në ushqimet e tyre, qoftë kur udhëtojnë nëpër Tokë ose kur janë në shtëpi. Po, janë këto dhunti të cilat i shfrytëzojnë dhe i gëzojnë të gjithë, besimtarë e jobesimtarë: *"Ne i mbështesim të gjithë me dhuratat e Zotit tënd: edhe këta, edhe ata. Dhuratat e Zotit tënd nuk i mohohen askujt."*<sup>129</sup>

Me vëmendje të plotë i vëzhgova këto të mira e dhurata të shtrenjta të Zotit tonë dhe pashë se prapambeturia shkencore dhe materiale është ajo që e ka pakësuar fatin e myslimanëve për t'i gëzuar ata, sikur që All-llahu e ka krijuar Tokën për të tjerët!!

<sup>128</sup> El-Hadid, 25

<sup>129</sup> El-Isra', 20

Eja së bashku t'i lexojmë fjalët e All-llahut të Madhërishëm: "All-llahu ju ka bërë shtëpi për të banuar dhe lëkurë kafshësh, që t'i përdorni si tenda, në mënyrë që t'i bartni lehtë, kur të udhëtoni dhe të zini vend. Ai ju ka dhënë edhe leshin, gëzofin e fijet që t'i përdorni për veshje dhe për shtrojë, deri në një kohë. Nga ajo që ka krijuar, Ai ka bërë për ju hije; ka bërë për ju streha nëpër male; ka bërë për ju rroba që t'ju mbrojnë nga nxehësia; ka bërë për ju veshje prej metali për t'ju mbrojtur në luftë. Kështu, Ai i përsos begatitë e Veta mbi ju, me qëllim që ju t'i bindeni vullnetit të Tij."<sup>130</sup>

Janë këto të mira që All-llahu i krijoi për të gjithë njerëzit, i bëri ata të jetojnë mirë dhe lehtë, si dhe të kenë banim të këndshëm në Tokë. Megjithëse jam duke e parë se myslimanët i shfrytëzojnë sasisë më të vogla të këtyre të mirave të shpërndara andej-këndeje, shoh se janë dorështrënguar ose të paaftë për t'i menaxhuar këto të mira!

Në Lindje dhe në Perëndim të Botës islame kam parë qytete, pallate, ura, rrugë, stacione dhe aeroporte, të cilat i kanë ndërtuar të huajt, ndërsa ne vetëm kemi vëzhguar dhe kemi pritur!

Kush është ai që sot prodhon rroba që mbrojnë nga nxehësia dhe veshje prej metali që mbrojnë në luftë?

Kush është ai që lëkurët e kafshëve i shndërron në çanta udhëtimi dhe shtëpi banimi?

Kush është ai që sot ndërton fabrika të mëdha për prodhim të leshit, gëzofit dhe fijeve dhe që ato i bartë me anije gjigante nëpër të gjitha vendet?

<sup>130</sup> En-Nahl, 80-81

Habitem kur nuk gjej njerëz që i kuptojnë ajetet e Kur'anit!

Studimi i gjithësisë është metodë e qartë kur'anore; së pari për ndërtimin e besimit, pastaj për mbështetjen dhe mbrojtjen e tij dhe, së treti, për dobinë e njerëzimit dhe jetës së tyre të mirë në Tokë. Megjithëkëtë, janë shumë gjenerata që i kanë mbyllë ndjenjat e tyre nga ky studim.

Disa herë më bëhet t'i dëgjoj fjalët e All-llahut të Madhërishëm: *"Vështroni frytet e tyre kur formohen dhe piqen. Sigurisht që në këto ka shenja për njerëzit që besojnë."*<sup>131</sup>

Dhe: *"Në Tokë ka vise që janë të lidhura njëri me tjetrin, ka kopshte të mbjella me hardhi, ka ara dhe palma me një pip ose me shumë pipa, të cilat ujiten me të njëjtin ujë, por disa nga frutet i bëjnë më të shijshme nga të tjerat. Pa dyshim, në këto ka shenja për njerëzit që kanë mend."*<sup>132</sup>

Është e vërtetë që sot e dëgjojmë jehonën e madhe të zërit që fton për politikën e zhvillimit dhe prosperitetit, rritjes dhe dyfishimit të prodhimit, si dhe shfrytëzimit të pasurive nacionale! Mirëpo, pas këtyre zërave nuk qëndron besimi (imani) i vërtetë! Është zëri që është pjesë e varfërisë dhe frikës nga pasojat e tij të tmerrshme. Varfëria do të mbetet edhe më tej, derisa shpirti të ngrihet në nivelin e duhur të besimit dhe të dijë të veprojë mirë me porositë e Kur'anit.

Evropianët dhe amerikanët janë më afër natyrës së shëndoshë. Ata ia dhanë mendjes vendin e duhur, e studiuuan gjithësinë dhe i shfrytëzuan dobitë e thesareve të saj dhe të mirave dhe fuqive që ishin në të.

<sup>131</sup> El-En'am, 90

<sup>132</sup> Er-Ra'd, 4

Ndërkaq ne, që u larguam nga kjo natyrë e shëndoshë, që në fakt është thelbi i fesë sonë, kuptohet se pastaj u morëm me filozofi të marra e të pavlera! Kur ne i dëgjuam disa të përkushtuar (fetarë) të ikur nga jeta dhe të dështuar në fushat e të menduarit, prodhimit dhe sjelljes, e dëmtuam Librit tonë dhe nuk arritëm t'i realizojmë qëllimet e tij të larta!

Imani – siç kuptohet nga Kur'ani – është fuqi për jetë, fuqi shkencore dhe fuqi materiale, të cilën e shoqëron nënshtrimi i çdo sendi për hir të kënaqësisë së All-llahut dhe për hir të Tij.

Këmbëzbathurit janë ata që sot me zë të lartë e kërkojnë zbatimin e Islamit në Tokë, ndërsa i lënë të tjerët t'i gjuajnë me predha nga qielli, këta janë memecë, mes tyre dhe Islamit ka distancë të madhe.

## Udhëtimi kontemplues\*

### *Shpirtërorja në Islam: e vërteta dhe horizontet*

Gjithësia, jeta në të dhe lidhshmëria e saj me All-lahun, i Cili e krijoi atë nga asgjëja, më bën të mendoj për një udhëtim shpirtëror dhe serioz rreth saj. Udhëtimi im vëzhgues do t'i bashkojë gjërat e kundërta që rrinë larg njëra-tjetrës dhe do të habisin me provat që i nënkuptojnë.

Në botën e distancave dhe të numrave kam parë që Hëna sillet rreth Tokës, ndërsa Toka sillet rreth Diellit, e Dielli dhe satelitët e tij lundrojnë në kozmosin e mbushur plot me galaktika të mbushura me mijëra trupa qiellorë (orbitë).

Horizontet e kozmosit të gjerë ende janë të pazbuluara, ndonëse ekziston një konsensus shkencor se gjithësia është shumë e madhe dhe e gjerë, që i kapërcen të gjitha mendimet që mund ta paramendojnë gjerësinë dhe saktësinë e saj!

Thashë më vete: Vallë, sa është Krijuesi i saj? Sa është madhështia e Tij? Nuk jam aq i marrë që të besoj se Toka është zot, kur e di se ajo është vetëm një grimcë e vogël dhe e kufizuar në ekzistencën absolu-

\* Veprim sipas fjalës arabe *tefekkür* që nënkupton meditim logjik dhe racional për madhësinë e All-llahut dhe gjithësisë.

te. Apo që dikë tjetër që është mbi Tokë ta llogaris për zot, kur e di se lindja dhe perëndimi i tij është e lidhur ngushtë me fuqinë e Lartë.

Më vonë i kujtova fjalët e All-llahut të Madhërishtëm: *"Në të vërtetë, Zoti juaj është All-llahu, që i krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë ditë e pastaj u ngrit mbi Fronin hyjnor (që mbisundon gjithësinë). Ai me errësirën e natës e mbulon ditën, e cila e ndjek atë; Dielli, Hëna dhe yjet i përkulen urdhrut të Tij. Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. Qoftë bekuar All-llahu, Zoti i botëve!"*<sup>123</sup>

Ajo që gjendet mbi ne dhe nën ne, është errësirë dhe dritë, lëvizje dhe pushim, ajo vazhdon të udhëtojë sipas urdhrut të All-llahut, nga i cili nuk del asnjëherë.

Mrekullitë e Fuqisë së Lartë më bënë të them më vete: kjo ka të bëjë me të tjerat, e si qëndron puna me ne?

Përgjigja ishte: Ai që vendos rregullin në horizontet e qiellit është Ai që në të njëjtën kohë e vendos rregullin e qarkullimit të gjakut nëpër damarët e më shumë se pesë miliardë njerëzve që banojnë në planetin tonë.

Është Ai që e rregullon rrjetin nervor në trupin tonë, që i përgjigjet urdhrave që dalin nga truri i njeriut, urdhra që ne i dimë dhe që nuk i dimë (instruksione të panjohura). Është Ai që e rregullon ekstraktin e jetës që qarkullon në çdo bimë që ka dalë mbi Tokë ose që është shtrirë mbi Tokë.

All-llahu, i Cili drejton trupat qiellorë dhe që nuk lejon një trup qiellor ta humb orientimin e tij ose të dalë nga rruga e caktuar për të, është All-llahu, i Cili

<sup>123</sup> El-A'raf, 54

në të njëjtën kohë i mbikëqyrë organet e jetës së çdo shpendi që fluturon me krahët e veta në qiell; është All-llahu i Cili i mbikëqyrë organet e çdo kafshe që ec me barkun e saj, kafshë që ec me dy këmbë dhe kafshë që ec me katër këmbë; është All-llahu që e di brendinë e çdo baktere që është e padukshme për syrin e njeriut, por që mund ta rrëzojë për tokë të mëdhenjtë për shkak të dëmit që e përmban!!

All-llahu i krijoi njerëzit për ta njohur Atë, por ata nuk e vlerësuan siç duhet All-llahun, ngase sikur ta vlerësonin siç duhet Atë, me siguri se do ta dinin se dëgjojnë dhe shohin vetëm falë organeve të vendosura në fytyrat e tyre, që jetojnë falë krijimit të All-llahut dhe që veprojnë me furnizimin e Tij: *"Sikur të donte All-llahu, do t'ua merrte dëgjimin dhe shikimin. Pa dyshim, All-llahu është i Fuqishëm për çdo gjë."*<sup>134</sup>

Civilizimit modern arriti të zbulojë fshehtësi të mëdha, por që u ndal aty nga ku duhej të nisej. Ky pra është turpi i tij!

Truri i njeriut është ai që i udhëheq organet e jetës në trupin e tij, ndërsa vijat e tij të përdredhura e të panjohura janë ato që e krijojnë shëndetin, sëmundjen, inteligjencën etj. Asnjë teknologji e zhvilluar nuk do të ishte e aftë që ta kryer detyrën e tij!

E pastaj? Çështja e trurit mbaron njësoj sikur të ishte ai një copë mishi të cilin e shet kasapi!

Pyetja e domosdoshme është: kush është Krijuesi i këtij organi të inteligjencës? Kush është ai që kujdeset për të, kur është në kafkën e fëmijës derisa të

<sup>134</sup> El-Bekare, 20

zhvillohet e të bëhet qenie gjeni dhe e frymëzuar? Ose, qenie e furrtarit që shet bukë? Sidoqoftë, ky është truri që e kryen rolin e mrekullueshëm në jetë!!

Materialistët nuk ia vënë veshin këtyre gjërave, sepse ata nuk interesohen për gjërat që i lidhin me All-llahun!

Mendarët janë që e refuzojnë këtë logjikë, ndërsa saktësia e trurit e provon madhështinë e Krijuesit dhe mrekullinë e krijesave që flasin për mrekullinë e Shpikësit të tyre.

Dituria e cila nuk shpie drejt All-llahut, është dituri që duhet të vendoset në kafazin e akuzimit, e lëre më që ajo dituri të jetë pengesë nga Zoti i botëve??

Libri ynë i madhërishtëm është ai që vëzhgimin në gjithësi e llogarit provë të besimit, provë të vështrimit të largët, të thellë dhe të sinqertë, i cili rezulton me njohjen e All-llahut. Burim i atyre që e njohin All-llahun janë shenjat e Tij në gjithësi dhe në njeriun: *“Ne do t’u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t’u bëhet plotësisht e qartë se ai (Kur’ani) është e vërteta.”*<sup>135</sup>

<sup>135</sup> Fussilet, 53



*Lidhshmëria e dhikrit dhe lutjes me dëshmitë  
e krijesave në tokë dhe në qiell*

Lidhshmërinë e dhikrit dhe lutjes me dëshmitë e krijesave në tokë dhe qiell, natën dhe ditën, e hasim në hadithet e të Dërguarit s.a.v.s.

Të shohim se çfarë na flet i Dërguari s.a.v.s. për këtë çështje. Transmetohet se kur i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. shkante në shtratin e tij, thoshte: "O All-llahu im, Zoti i të shtatë qiejve dhe i tokës, Zot i Arshit të Madh, Zoti ynë dhe Zot i çdo sendi, Zbërthyes i farës (i kokrrës së saj) dhe i bërthamës (së pemës), Ti je Ai i Cili e shpalle Tevratin, Inxhilin dhe Kur'anin. Kërkoj mbrojtjen Tënde nga sherri i çdo sendi, balli i të cilit është në dorën Tënde. O All-llah, Ti je i pari dhe para Teje nuk pati asgjë. Ti je i fundit dhe mbas Teje nuk mbetet asgjë. Ti je i Dukshmi dhe mbi Ty s'ka asgjë. Ti je i Padukshmi dhe nën Ty s'ka asgjë. Largoje nga ne borxhin dhe na mbroj prej varfërisë".<sup>136</sup> Sa lutje e bukur që është kjo!

Në vijim do të sjellim edhe një lutje tjetër pashoqe të të Dërguarit s.a.v.s., thënë më mirë, lutje që historia nuk njeh diç të ngjashme, lutje që shpreh adhurimin, përkushtimin dhe që i mbush tubimet me ndjenja të gjalla dhe aromë freskuese, lutje nga e cila dalin frymëmarrjet e pastra, ndërsa recitimi i saj është i lehtë dhe për mrekulli (mbinatyreshme)!

<sup>136</sup> Muslimi, 4/2084, numër: 2713, dhikri, duaaja, tevbeja, sitigfari/ çfarë thuhet para gjumit shtrirjes në shtrat. Ebu Davudi, 4/312, numër: 5051/ çfarë thuhet para gjumit.

I Dërguari s.a.v.s. thoshte: *"Falënderimi i takon All-llahut, i Cili më dha veshmbathje dhe më strehoi, më dha të ha dhe të pi, dhe i Cili më bëri me të mira dhe më nderoi (duke i bërë më të mirat) dhe i Cili më dha, dhe vërtet shumë më dha. Falënderimi i takon All-llahut për çdo gjendje."*

Ai gjithashtu thotë: *"O All-llahu im, Zot i çdo sendi dhe Pronar i tij, All-llahu i çdo sendi, kërkoj mbrojtjen Tënde nga zjarri."*<sup>127</sup>

Në një transmetim tjetër thuhet se kur i Dërguari i All-llahut zgjohej natën, thoshte: *"O Zoti im, kanë dalë yjet, sytë kanë pushuar, kurse Ti je i Gjalli dhe i Përhershmi, Ty nuk të fshihet nata e errët, e as qielli plot galaktika, po as Toka e shtruar si shtrat, Ti e di shikimin e përvojdhur të syrit dhe atë që fshihet zemra."*<sup>128</sup>

Feja jonë krijon lidhshmëri të pandarë mes gjithësisë dhe jetës, njeriut dhe sjelljes, diturisë dhe edukimit, dhikrit dhe duasë...!

Ndjenja e besimtarit mysliman se All-llahu i përfshinë të gjitha me dijen e Tij dhe se Ai të gjitha i sheh dhe është i njohur për gjithçka, se Ai është dëshmitar për çdo gjë, se Ai mbron, por prej Tij nuk mund të mbrohet askush, se Ai gjykon dhe askush nuk mund ta thyejë gjykimin e Tij etj., s'ka dyshim se lë gjurmë në fjalët e besimtarit, në punën e tij, kur është serioz dhe kur tallet, kur është i kënaqur dhe kur është i hidhëruar. Thënë shkurt, kjo ndjenjë ia trason rrugën e qartë të cilës duhet t'i përmbahet gjatë tërë jetës.

Kujtoj se këto fjalë kanë nevojë për një sqarim më të gjerë, sidomos kur kemi parasysh se në shpirtin

<sup>127</sup> Ebu Davudi, vëll. 4 fq. 313, numëri: 5058, edukata/ çfarë thuhet para gjumit.

<sup>128</sup> *El-edhikar li-en-Nevvi* fq. 123-124

tonë është e vendosur dashuria për gjërat e dëshiruara: për gratë, fëmijët, arin dhe argjendin e grumbulluar, kuajt e bukur, bagëtitë dhe arat e lëruara, dashuri kjo që i mbizotëron aktivitetet dhe punët tona.

Ai i cili është i përkufizuar vetëm në këto gjëra të dëshiruara, e ka harruar Zotin dhe ahiretin, ndërsa ai i cili di t'i rregullojë këto gjëra sipas vlerave të besimit dhe takimit me All-llahun, ai vërtet e ka qëlluar dhe është në rrugë të drejtë.

Shumë herë më bie të rri me disa të rinj, veçmas me tregtarë, dhe i dëgjoj bisedat që i zhvillojnë ata mes vete. Për fat të keq, në këto biseda gjej vetëm zhytjen e tyre në të ardhmen e afërt dhe kënaqësinë e shpejtë. Bisedë për çmimet, mallrat, lirimën ose shtrenjtimin e tyre ose bisedë për pagat mujore, avancimin dhe progresin. Pothuajse të gjithë janë të lidhur ngushtë me punët e kësaj bote dhe nuk ia vënë fare veshin asaj që është pas saj, e as që e kapërcejnë bisedën për të folur për Mbikëqyrësin e kësaj bote dhe Pronarin e saj.

M'u kujtuan fjalët e All-llahut të Madhërishëm: *"Andaj, ti (o Muhamed!) largohu prej atij, që i kthen kurri-zin Kur'anit dhe, që dëshiron vetëm jetën e kësaj bote! Kaq arrin gjithë dija e tyre! Në të vërtetë, Zoti yt i njeh më së miri ata që janë shmangur nga rruga e Tij dhe ata që ndjekin rrugën e drejtë."*<sup>139</sup>

Preokupimi me jetën e kësaj bote është i vërtetë kur ai është vetëm mjet për të kaluar në jetën e botës tjetër. Përndryshe, rendja pas dynjasë dhe shkujdesja nga çdo gjë tjetër, përveç asaj, është humbje e qartë.

<sup>139</sup> En-Nexhm, 29-30

Lidhja jonë me All-llahun do të jetë e saktë dhe e pranuar vetëm atëherë kur të jetë e fuqishme për t'i mbizotëruar instinktët e shqetësuar (ndezura) dhe shkujdesjen e pavlerë!

Gjithësia e dëshmon Krijuesin e saj. Këtë duhet ta mendojmë çdoherë që e shikojmë atë. Bota moderne – Lindja dhe Perëndimi – është e vendosur për t'i shpalosur vetëm shkaqet, ndërsa e ul perden para Zotit të këtyre shkaqeve, sikur Ai nuk ekziston fare ose nuk ka punë me to. Madje, sikur këto shkaqe të jenë faktor i vërtetë, ndërsa çdo gjë përveç tyre është hamendje! S'ka dyshim se një bindje e tillë është humbje e madhe dhe devijim i qartë!

Ligji i kauzalitetit e ka respektin e duhur, njerëzit mbjellin për të korrë, martohen për të krijuar pasardhës, ndonëse këto mjete janë çelësa në duart e Fuqisë së Lartë (All-llahut) ose mbulesa nën të cilat vepron Fuqia e Lartë.

Imam Neveviu thotë: *"Në përmbledhjet e haditheve sahih kemi transmetuar se Zejd in Halid el-Xuheni ka thënë: "I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. e fali namazin e sabahut me ne, ndërsa qielli ishte ende i errët - me re dhe shira. Pasí përfundoi, u kthye kah njerëzit dhe tha: "A e dini se çfarë ka thënë Zoti juaj?" All-llahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më së miri, u përgjigjën të pranishmit. Ai tha: "(Zoti juaj) ka thënë: "Nga robërit e Mi ka që janë gdhirë besimtarë dhe jobesimtarë! Ai që është që më beson Mua dhe nuk u beson yjeve. Ndërsa ai që thotë: "Na ra shi me këtë e këtë yll (që paralajmëron shiun), ky është që nuk më beson Mua, ndërsa u beson yjeve.""<sup>140</sup>*

<sup>140</sup> Muslimi, vëll. I-rë, fq. 83, numër: 125 Imani/ ka bërë kufër ai që thotë se shiu ka ra falë këtij ylli.

Kujtoj se është e udhës ta shpjegojmë qëllimin e këtij hadithi; të shkujdesurit nga All-llahu, që mohojnë se Ai është që i lëvizë erërat dhe retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës, thonë: *"Shiu na erdhi falë lëvizjes së këtyre erërave dhe ndryshimeve klimatike! Këta nuk kanë besim!"*

Ata që e besojnë All-llahun janë ata që erërat dhe retë i shohin si shenja të fuqisë së All-llahut dhe si prova të vullnetit të Tij. Këta nuk bëjnë kufër kur thonë: *"Qielli e lëshoi shiun në tokë; pranvera sjell fruta të ëmbla; ngrohtësia i poqi pemët etj."*

Me rëndësi është që ne ta njohim faktorin e vërtetë (All-llahun), që vetëm Atij t'i drejtohem me mirënjohje dhe falënderim kur na jep të mira, që para Tij të qëndrojmë të përkushtuar kur shpresojmë dhe kur sprovohemi.

Është e vërtetë se sot botën e ka vërshuar thatësia shpirtërore dhe habia e madhe. Vallë, cili do të jetë qëndrimi i atyre që e duan All-llahun kundrejt kësaj thatësie dhe habie?

Disa, të habitur nga fakti që shumë njerëz janë larguar nga All-llahu dhe kanë rënë në gjynahe që nxisin zemërimin e Tij, kanë vendosur ta shpëtojnë vetveten dhe kështu të izolojnë tërësisht, duke menduar se qëndrimi pasiv është më i dobishëm. Këta, me gjithë të mirat që i kanë, u shëmbëllojnë atyre që nuk i pëlqejnë vendet e pirjes së duhanit, ndaj edhe largohen prej tyre, duke i lënë të tjerët ta ndotin ajrin e të djegin shëndetin dhe pasurinë.

Por, jo vetëm kaq, çështja merr përmasa edhe më të gjera! Nuk është kjo ikje nga një ambient i ndotur

në një ambient tjetër më të pastër, por është kjo ikje duke marrë fenë dhe nderin me vete, nga vendi ku njolloset feja dhe nderi!

Vallë, ku do të jetë vendi i besimtarit në mesin e njerëzve, në trupin e të cilit veprojnë urrejtjet dhe punët e pavlera e të turpshme? Njëri e mashtron, ndërsa tjetri e tradhton! Sikur ai bindet me fjalët e poetit i cili thotë se gjallesat më të vyeshme janë egërsirat, sepse i vërsulen njëri-tjetrit para syve dhe nuk fshihen nga askush!

Ku do ta gjejë besimtari vendin e tij në tubimet plot fjalë të kota dhe gjynahe, ku bisedat janë sekrete dhe zhvillohen me zë të ulët e të ëmbël, ndërsa aty nuk dëgjon tjetër, veçse përgojim dhe njollosje të nderit të njerëzve, biseda që kanë për qëllim avancimin e të vegjëlve dhe zhvleftësimin e të mëdhenjve?!

Ku do ta gjejë besimtari vendin e tij në mesin e traditave që dominojnë, të cilat e imponojnë miklimin dhe dyfytirësinë para pushtetarëve dhe e imponojnë nënçmimin dhe përqeshjen e të dobëtëve dhe të varfërve?

Ku do ta gjejë besimtari vendin e tij në mesin e njerëzve që shumë pak e kujtojnë All-llahun, që llomotisin me fjalë që shprehin falënderimin ndaj All-llahut për dhuntitë e Tij ndaj krijesave, e sa shumë që janë të tillë, kur i godet ndonjë mërzi, fillojnë të bërtasin si gratë e mjera dhe desh shkatërrohen nga pezmatimi!

Është fakt se sot shumë pak flitet për takimin me All-llahun! Dënimi dhe shpërblimi i Tij janë biseda që shumë pak përmenden, ndërkaq ato janë të domosdoshme!

### *A është zgjidhja izolimi i besimtarit?*

Për besimtarin mysliman është më mirë të ikë me fenë e tij, të tërhiqet tërësisht dhe të izolohet nga të gjitha këto grupe ...

Nëse në besimin e tij ka ende dritë qiriu, për të është më mirë ta ruajë atë, që të mos e fikin errësitat që dominojnë ...

Unë them: Asnjë nga këto gjëra nuk e lejojnë apo arsyetojnë izolimin. Dijetarët thonë: "E vërteta është se drita e qiriut kurrë nuk mund të fiket, qoftë edhe nëse të gjitha errësitat e Botës mëtojnë ta bëjnë këtë. Prandaj, të mirët e të vyeshmit nuk duhet ta mbështesin ikjen, nëse e keqja është përfshirë gjithkund.

Njeriu i mirë e i vyeshëm, që sot preferon ikjen, është ai që e përgatitë për nesër gëlltitjen e të keqe. Madje nëse i shpëton asaj, me siguri se ajo ka për t'i gëlltitur fëmijët e tij nesër ose pasnesër...

Islami nuk e lejon ikjen ose tërheqjen nga fushëbeteja, atë e lejon vetëm nëse tërheqja e tillë është përgatitje e rifillimit të përplasjes dhe përforcimit të pozitive për sulm: "Cilido që ua kthen shpinën atë ditë, përveç atij që tërhiqet me qëllim që të sulmojë përsëri ose për t'u bashkuar me një grup tjetër, do të shkaktojë zemërimin e All-llahut dhe do të ketë si strehë xehenemin. Eh, sa fund i keq është ky!"

Ne e arsyetojmë izolimin e përkohshëm me qëllim që njeriu ta forcojë vetveten dhe t'i mbyllë rrugët nga mund të depërtojë armiku i tij, që pas këtij përforcimi dhe përgatitjeje të mund ta fillojë luftën kundër armikut dhe ta fitojë atë, ta ngrejë lart fjalën e të vërtetës.

Ne në asnjë mënyrë nuk mund ta arsyetojmë ikjen e besimtarit mysliman nga detyra e tij e shenjtë dhe shmangia pa ndonjë arsye, siç nuk mund të lejojmë që disa grupe të myslimanëve të vendosin të bëjnë vetëm zhurmë ose të vendosin të mblidhen në grupe për të kryer rite të posaçme dhe asgjë tjetër.

Ndodh që njeriu të koncentrohet dhe të përgatitet për ta rifilluar punën! Ndërkaq, të japë dorëheqje nga puna, kjo është çështje tjetër.

Ndodh që besimtari i izoluar të arsyetohet e të thotë se do të jetë më i qetë, më i freskët dhe më i pushuar, do të jetë në gjendje që më shumë ta përmendë All-llahun, por ky arsyetim është i papranuar, sepse njoftimi i të paditurve me Zotin e tyre dhe përkujtimi i njerëzve për Mbikëqyrësin dhe Kujdestarin e punëve dhe begative të tyre, është më i dobishëm se sa pastrimi i shpirtit dhe rehatia e kokës.

Doemos duhet ta njohim të vërtetën e fesë së cilës i përkasim; përkujtimi i njerëzve për All-llahun është maja e dhikrit që kërkohet nga besimtari. Njoftimi i tyre me dispozitat e All-llahut, detyrat që i kanë ndaj Tij, si dhe udhëheqja e tyre në bazë të Shpalljes së Tij, ky është zëri i lartë që shqipton dhikrin e Tij. Ka shumë njerëz që kënaqen vetëm me kontemplim pasiv dhe pastërti ose ndriçim të brendshëm. Kujtoj se çështja në fjalë meriton një sqarim më të gjerë. Shkatërrimi i feve të mëhershme u bë nga njerëz që preferuan jetën në margjinat e shoqërisë dhe që mbështetjen e të vërtetës e llogaritën barrë të rëndë që ata kurrë nuk mund ta mbanin, veçmas nëse kemi parasysh frikën e tyre të madhe ndaj rezistimit të njerëzve të prishur,



duke thënë se është më mirë t'i lëmë ata në humbje dhe devijim e ne të kënaqemi me udhëzimin që na është dhënë!!

Ky lloj i njerëzve është ai që u thoshte atyre që urdhëronin për të mirë dhe ndalonin nga e keqja: *"Përse këshilloni një popull, kur e dini se All-llahu do ta zhdukë ose ndëshkojë me ndëshkim të ashpër?"*<sup>141</sup>

Ky lloj i njerëzve bën një pyetje të çuditshme, që nuk e dimë a është rezultat i budallallëkut ose i humbjes së shpresave?! Sido që të jetë, fati i këtij grupi të njerëzve nuk jep shenja të mira që të na bëjnë të rrimë të qetë, ndaj edhe frikohemi nga ky fat, veçmas kur i lexojmë fjalët e All-llahut të Madhërishëm: *"A ka pasur njerëz të mençur te popujt para jush, të cilët të pengonin ngatërresat në Tokë, përveç disave prej tyre që i shpëtuan Ne?! Ata që bënë të këqija, jepeshin pas kënaqësive dhe ishin gjynahqarë."*<sup>142</sup>

Kuptimi i këtij ajeti e vërteton kuptimin e mësuar nga ajeti tjetër që thotë: *"Por, kur e harruan atë për të cilën ishin paralajmëruar, Ne i shpëtuan ata që i këshillonin, kurse i ndëshkuam ashpër keqbërësit, për shkak të mosbindjes së tyre."*<sup>143</sup>

Vetëm All-llahu i di fshehtësitë e atyre që heshtin ndaj mbështetjes së të vërtetës dhe rezistencës kundër të pavërtetës: se a është ky pasivitet që shpreh dobësi dhe mposhtje? Ndonëse All-llahu e njih refuzimin e tyre të brendshëm? Apo është ky mosinteresim dhe vlerësim i gabuar i pasojave?

<sup>141</sup> El-A'raf, 164

<sup>142</sup> Hud, 116

<sup>143</sup> El-A'raf, 165

Sido që të jetë, shpërfillja e devijimit duke e lënë atë ta mbisundojë jetën e përditshme, pa dyshim që sjell goditjen e pashmangshme të kaderit<sup>144</sup> që nuk lë gjë dhe nuk kursen asgjë: *“Zotë yt kurrë nuk do t’i shkatërronte qytetet padrejtësisht, nëse banorët e tyre do të ishin të ndershëm.”*<sup>145</sup>

Le ta shqyrtojmë me vëmendje të plotë fjalinë e fundit!! All-llahu thotë: *“...nëse banorët e tyre do të ishin të ndershëm (përmirësues)”*, e nuk thotë: *“...nëse banorët e tyre ishin të mirë (të vjeshëm)”*! Kjo është është, sepse ndershmëria ose mirësia individuale e fshehur diku larg nuk pikëllohet për besimin e dobët, e as që çan kokë për dështimin e së mirës, është ndershmëri dhe mirësi e pavlerë dhe e padobishme! Bëhu i mirë, mirëbërës, përmirësues, i udhëzuar dhe udhëzues.

Nuk është e udhës që të rrih larg e të presësh se çfarë do të ndodhë, t’i nënshtrohesh gjendjes reale e të mos ...!!

Ne nuk pranojmë që Islami të cilësohet se është fe e materies ose e shpirtit, janë këto terme të cilat janë formuar pas shpalljes së Kur’anit.

All-llahu i Madhërishëm është Krijuesi i botës, Mbi-këqyrësi dhe Vëzhguesi i ekzistimit të tij. Ai është Drejtuesi i gjërave në të! Ekzistimi i çdo sendi varet nga All-llahu, i Cili është i Pari dhe i Mbrami, i Dukshmi dhe i Padukshmi, i Vërteti që nuk ka dyshim në Atë.

Besimi se jeta në këtë botë është kalimtare e jo e përhershme, se takimi me All-llahun është i pash-

<sup>144</sup> Caktimit të All-llahut të Madhërishëm

<sup>145</sup> Hud, 117 - Kujtoj se përkthimi më adekuat do të ishte:.....*nëse banorët e tyre do të ishin përmirësues.*

mangshëm, se përgatitja për këtë takim është e kërkuar, të gjitha këto nuk nënkuptojnë asketizmin në këtë botë dhe mospreokupimin me pjesën e caktuar në të për ne!

Ata që janë të penguar t'i shohin shenjat e All-llahut në hapësirë dhe në vetvete, janë shembull i keq për Islamin dhe sprovë për të tjerët (meqë i largojnë nga Islami), edhe nëse vazhdojnë të lexojnë dhe t'i lëvizin buzët!

Murgu dyfytirësh, që shtiret i vdekur në tollovinë e jetës së përditshme, që rri indiferent në luftën e saj të madhe, është njeri i sëmurë. Begatia e shëndetit nuk ia lejon që ky ta gëzojë fatin e përkushtimit apo bindjes (nuk ua falë këtë që e bëjnë).

Nuk është njësoj i verbëri dhe ai që sheh, as errësira dhe drita, as freskia dhe vapa. Po ashtu, nuk janë kurrë të barabartë të gjallët dhe të vdekurit, siç thotë All-llahu i Madhërishëm: *"Nuk janë, kurrsesi, njësoj i verbëri dhe ai që sheh. As errësira dhe drita. As freskia (e hijes) dhe vapa. Po ashtu, nuk janë kurrë të barabartë të gjallët dhe të vdekurit."*<sup>146</sup>

Është çudi që Islamit t'i përkasin njerëz që nuk kanë dritë me të cilën do të ecin në jetë, që nuk kanë dritë të mendjes zbuluese ose bindje frymëzuese. E tërë ajo që i lidh ata me Islamin është një lexim që nuk e kuptojnë dhe adhurim (iradet) të cilit i mungon puna. Ata që janë larg Islamit arritën ta pushtojnë hapësirën dhe i vunë këmbët e tyre në Hënë. Ndërkaq ne (myslimanët) u bëmë viktimitë e mendjes së paaftë,

<sup>146</sup> Fahir, 19-22

viktimë e paaftësisë morale, pretendimeve boshe, vetëkënaqësisë dhe akuzimit të të tjerëve. Vallë, a thua Islami do të ketë sukses nga përhapja e kësaj gjendjeje? Kurrsesi! Ne e nxjerrim gjuhën duke vrapuar pas një sasi të vogël të diturisë, mjeteve dhe mallrave për prodhimin e të cilave u shquan të tjerët.

Dora që rri lartë është më e dobishme se dora që rri poshtë. Të prapambeturit, shpirtërisht dhe ekonomikisht, që e shtrijnë dorën vetëm për të marrë, nuk duhet të presin që të tjerët t'i shikojnë me sy të mirë ose të hynë në fenë e tyre!

Si është e mundur që i përparuari të trembet nga i prapambeturi, e të shndërrohet në pasues të tij?

### *Shpirtërorja e ashtuquajtur*

Vallë, a thua përpjekjet për ta bërë Umetin të ngrihet në fushat e industrisë kulturore dhe ushtarake do të realizoheshin në llogari të çiltërsisë shpirtërore dhe ngjalljes së ndjenjave të dashurisë Hyjnore? Është krejt absurde!

Ata që e kuptojnë shpirtëroren si një lloj shtangimi psikologjik dhe pavetëdije mendore, janë njerëz që nuk e njohin Islamin, bile janë kundërshtarë të tij.

Më afër All-Ilahut dhe Librit të Tij janë njerëzit me duar dhe ballë të pluhurosur nga dheu i arave, tymi i fabrikave apo rendja në treg, e të cilët pas gjithë kësaj thonë se e duan Zotin e tyre me dashuri të madhe. Këta janë njerëzit që lëvizjet dhe aktivitete e

tyre të përhershme i bëjnë vetëm për ta ngritur lart fjalën e All-llahut, mur mbrojtës të ligjit të Tij dhe zahire me të cilën do ta takojnë Atë në Ditën e Llogarisë.

Shpirtërorja e ashtuquajtur, që i shmang njerëzit nga ky qëllim, është e papranuar, bile atë duhet dëbuar nga lëmi i shkencës dhe edukimit.

Një ditë në programin e radios dëgjova se Egjipti do të pranonte nga Gjermania Perëndimore ndihma për ndërtimin e drenazheve; dëgjova edhe se vëllezërit tanë në Jemen do të pranonin ndihma nga Kina për ndërtimin e rrugëve.

Nuk u habita, sepse lënda e bukës të cilën e ha unë është e importuar nga jashtë, e të mos flasim për veturën që e ngas. Prandaj thashë me vete: ku jemi ne në këtë botë?

A është e vërtetë se shpirtërorja është ajo e cila na e shkaktoi këtë paaftësi? E vërteta thotë: "Kjo shpirtërore është një lloj paralizimi i aftësive dhe shtrembërim i veçorive njerëzore!".

Më duhet të them se Islami është krejt tjetër. Siç duket, ne jemi në një anë, e ai në anën tjetër. Ndonëse feja jonë është vetëm ajo që është në Librin e Zotit tonë dhe në Sunetin e të Dërguarit tonë.

Sikur të parët tanë të ishin sot, do të ishin krejt ndryshe, ata do t'i shihnim duke lundruar nëpër oqeane, duke vëzhguar me nëndetëse apo duke qenë në bartëse të aeroplanëve.

Të parët tanë ishin ata që me punë i bënë sexhde Atij, me emrin e të Cilit lëvizin valët e detit, që e lejojnë të lejuarën dhe ndalojnë të ndaluarën, që e shpresojnë shpërblimin e Tij dhe që i frikësohen ndëshkimit të Tij.

Kjo është shpirtërorja të cilën e njih feja jonë. Tjetër nuk ka.

Civilizimi modern e vuri në spikamë njohjen e gjithësisë, mirëpo e harroi Zotin e saj ose e mohoi Atë! Vallë, a do të dimë ne t'i bëjmë ballë civilizimit modern në kohën kur nuk e njohim gjithësinë, kur e harrojmë Zotin e saj dhe kur i shpërfillim porositë e Tij?

Pse të mos e njohim gjithësinë sikur që e njohin të tjerët apo edhe më mirë, e të tjerët të na shohin me sy habie e askush të mos marrë guxim të na sulmojë apo nënçmojë!? Pse të mos u flasim për All-llahun Një dhe të Vetëm?! Pse të mos ua tërheqim vëmendjen e plotë dhe t'i bëjmë ta vlerësojnë bisedën tonë për All-llahun e Madhërishëm e të mendojnë mirë për këtë!? E kur ata të na shohin të përpiktë e të vendosur se ne nuk i ndjekim pasionet tona dhe nuk bëjmë parregullsi, se ne e përmendim Zotin tonë në mëngjes e në mbrëmje, me siguri që nuk do të ketë prej tyre që do të thotë: "Janë këto njohuri metafizike të botës së tretë, që i kanë zhvleftësuar dhe që e kanë penguar zhvillimin e tij!"

Islami - në tokën e tij të mposhtur - është fe e plagosur rëndë! Puna e tij shfaqet aty ku duhet, e jo diku tjetër! Ndodh që për ritet islame të kujdesemi në xhami, por normat e tij ligjore mbeten të shpërfillura ose të larguara në të gjitha fushat tjera! Përkatësia islame është bërë çështje individuale, e jo shoqërore. Ajo ka mbetur vetëm në përmasa të kufizuara që nuk duhet të kapërcehen!

Thirrja islame kudo në Botë është joproductive, jofunksionale dhe e paqartë, sepse kultura islame është shtrembëruar, ndërsa politika islame e devijuar!

Koha që ne e jetojmë sot nuk e pranon ndarjen e besimit nga ligji që del nga ai ose ndarjen mes besimit dhe platformës së të drejtave të njeriut që e lidhin me të.

Kujtoj se prapambeturia e myslimanëve në fushën e civilizimit e politikës ndërkombëtare, si dhe gjendja e tyre e keqe, janë shkak i mosfunksionimit ose ngecjes së misionit të Tij ose gjërat që ia hedhin hijen e zezë këtij Umeti. Pikërisht për këtë kujtoj se shpirtërorja islame në moral dhe sjellje është e përafërt me asgjënë, bota nuk pati ndonjë dobi nga ajo.

Është fakt se dhjetë milionë hebrenj, që u shpërndanë nëpër Evropë dhe Amerikë dhe e planifikuan kthimin në Palestinë, ishin më aktiv dhe më të suksesshëm se një miliardë myslimanë të cilët u treguan të pasuksesshëm në përhapjen e ideve të tyre dhe në ndikimin te popujt te të cilët depërtuan.

*Pakica punëtore është gjithmonë më e rëndësishme se shumica e papunë!*

Pyesim: Cilat janë bazat e mendimit hebraik dhe të veprimtarisë së tij aktive? Cili është ndikimi i tij në gdhendjen e karakterit dhe mbështetjes së vlerave të larta? Para se të përgjigjemi ne, do të ishte e udhës që t'i përkujtojmë ata që kanë arsye të shëndoshë dhe zemër të ndritur me disa fakte historike që vijnë nga thelbi i Dhiatës së Vjetër.

Jakobi (Jakubi) e mashtroi dhe e tradhtoi vëllain e tij më të madh dhe kështu ia vodhi peygamberllëkun!

Dhiata e Vjetër pohon se Zoti kishte luftuar tërë natën kundër Jakobit (Jakubit) dhe nuk e kishte lënë të largohet përderisa nuk e kishte quajtur me emrin Israil, sepse Jakobi (Jakubi) kishte dalë fitues!

Jeta që ndërtohet mbi këto parime nënkupton se ekzistenca i takon mashtruesit, tradhtarit dhe të fuqishmit, ndërsa humbja i takon të vërtetës së dobët dhe naive.

Dhiata e Vjetër rrëfen ngjashëm edhe për Davudin, mbretin e madh, se ai e kishte grabitur gruan e një komandanti të ushtrisë së tij të cilën e kishte pëlqyer dhe pastaj e kishte planifikuar vrasjen e tij për këtë qëllim.

Çfarë madhështie dhe çfarë fuqie është kjo? Është madhështia dhe fuqia e grabitqarëve të ashpër dhe logjika e egërsirave që jetojnë në xhungël!

Pikërisht për këtë ne nuk besojmë në ekzistimin e shpirtërores hebraike; është e vërtetë se në shpirtat e disave edhe më tej janë të pranishme vlerat e dhjetë porosive të shenjta që i gdhendin disa gjëra të besimit dhe të mirës. Ne besojmë se disa njerëz janë të krijuar që ta respektojnë të vërtetën dhe të drejtën, siç thotë All-llahu i Madhërishëm: *“Te populli i Musait ka pasur disa njerëz që udhëhiqnin dhe zbatonin të drejtën nën dritën e së vërtetës.”*<sup>147</sup>

Mirëpo, zbatimi i këtyre vlerave është i rrënuar dhe i shtrembër, gjurmët e së cilit janë të rrënjosura thellë në sjelljet e hebrenjve dhe që i shoqërojnë ato gjatë gjithë kohës. Asnjë hebre nuk ndien keqardhje

<sup>147</sup> El-A'raf, 159



nëse e imiton babanë e tij për të grabitur tjetrin me tradhti dhe mashtrim ose nëse i bën padrejtësi me forcë.

Kjo është fshehtësia e urrejtjes së kamotshme ndaj hebrenjve. Këtë urrejtje nuk e lehtëson fare ngadhënjimi i tyre ndaj arabëve. Është e vërtetë se arabët sot janë në fatkeqësi, ndonëse më parë nuk kanë qenë, qoftë në xhahilijet ose në Islam, sepse përkushtimi i sajuar (i shtirur) mund të jetë më i dhembshëm dhe më fatkeq për popujt sesa ateizmi i zhurmëmadh.

Myslimanët sot ballafaqohen me dy armiq në një front: me hebrenjtë dhe të krishterët; të drejtat e mysli-manëve janë të nëpërkëmbura duke i bërë të mendojnë ata se nuk ia vlejnë ta jetojnë jetën, edhe pse ekziston një dallim mes sjelljes së hebrenjve e karakterizuar si e ashpër dhe sjelljes me të cilën dëshiron të ekspozohet kisha e krishtere para njerëzve. Murgëria edhe më tej është sistem shpirtëror dhe shoqëror, që i përkushtohet fesë dhe që e mbizotëron dynjanë, që e deklaron mëshirën dhe vetëmohimin!

Sistemi i murgërisë nuk vlen vetëm për të krishterët. Ai është prezent edhe te budistët. Gjëja më e bukur që haset te ky sistem – për dallim nga doktrinat – është përkushtimi i tij i plotë për t'i shërbyer gjërave që i përqafon dhe shpërfillja e pasioneve të cilat i mbizotërojnë të tjerët. Budistët murgë u treguan të gatshëm për t'u flijuar (duke u djegur) për hir të drejtimit të tyre dhe të gatshëm për t'u ballafaquar me armikun.

Ditëve tona kemi rastin të shohim grupe murgjish të krishterë të cilët veprojnë në Afrikë dhe Azi në kushte jashtëzakonisht të vështira duke e përhapur doktrinën e trinisë. Qëllimi i tyre është zgjerimi i terri-

torit të mbisundimit të krishterë. S'ka dyshim se mundësitë e jashtëzakonshme janë ato që ua mundësojnë atyre këtë veprim të tyre të palodhshëm, veçmas shërbimet që ua ofrojnë popujve ku veprojnë: shërbime kulturore, shëndetësore dhe shoqërore. Janë këto metoda për përfitimin e zemrave të atyre që i ftojnë dhe mbjelljen e aftësive dhe fesë.

Doktrinat, qofshin ato tokësore ose qiellore, nuk mund ta mposhtin logjikën njerëzore e as ta mbisundojnë përgjithmonë natyrën e shëndoshë.

Përparimi i civilizimit dhe ndikimi i diturisë sollën tërheqjen e mendimit devijues dhe çlirimin e botës nga besëtytnitë e shumta. Megjithëkëtë, njerëzit e fesë – teologët anembanë botës – nuk u dëshpëruan. Shumica e tyre iu bashkëngjitën civilizimit aktual që ishte dominues duke u brë shërbëtorë të tij, e jo të shërbyer. Kolonializmi dhe sionizmi arritën të rekrutojnë mijëra priftërinj për realizimin e interesave të tyre. Siç duket, urrejtja e kamotshme e kishte bërë punën e saj në shpirtin e murgjve dhe priftërinjve, andaj edhe ata nuk e çanë kokën që në Perëndim dhe Lindje ishte e pranishme çoroditja racore dhe kufri publik. Këta iu vërsulën tokës islame me qëllim të shkatërrimit të saj dhe dorëzimit të vendeve islame në duart e atyre që e donin jetën e kësaj bote.

Fatkeqësia e cila nuk duhet shpërfillur është ajo që kolonializmi u tregua mjaft i mprehtë, plot pasione dhe plot urrejtje e zili, ndërkaq myslimanët u treguan mjaft injorant për fenë e tyre, të paaftë për t'u ngritur në nivelin e tij dhe të shkujdesur se çfarë përgatitej kundër tyre. Ngadhënjimi i kolonializmit kulturor dhe të

atij politik përhapri shumë shtrembërime dhe devijime që kishin të bëjnë me natyrën e fesë (Islamit) dhe të mësimëve të rrugës së drejtë. Në vijim do të përpiqemi t'i shtrojmë disa nga këto gjëra që ndodhën.

### *Gabimet dhe devijimet*

Bota moderne nuk çan kokë për ahiretin dhe nuk përgatitet për këtë Ditë të Madhe të Llogarisë së vësh-tirë. Ajo është e preokupuar vetëm me tokësoren, ajo mbetet e lidhur ngushtë me të mirat dhe pasuritë e saj. Fjalët, që ndoshta ndonjëherë i dëgjon për jetën e përjetshme, nuk e tërheqin vëmendjen e saj. Ndodh që ajo shumë shpejt t'i harrojë e t'i kthçhet përpjekje-ve të jetës, të mirave të saj kalimtare dhe shpërblimit të shpejtë.

Të gjithë të dërguarit pohuan se jeta e kësaj bote është parathënie e shkurtër e Librit të gjatë, se njerëzit të cilët në këtë botë rrojnë me ligjin e kohës, do të përcillen në jetën tjetër ku nuk vlen ligji i kohës njësoj si kur humbet pesha në jetën e astronautëve sot!

Ahireti e nënkupton përjetshmërinë e pafundmë. Njerëzit duhet ta përgatisin veten me pastërti dhe ngritje, që të jenë të denjë ta meritojnë këtë jetë të re të përjetshme.

Është për t'u çuditur nga fakti se Dhiata e Vjetër nuk e përmend fare takimin me All-llahun e as përshkrimin e xhenetit dhe xhehenemit, madje as përgatitjen për atë jetë të përjetshme e të vërtetë!

Kjo shkujdesje e shëmtuar për një të vërtetë që asnjë shpallje nuk e la pa e përmendur, llogaritet ndër format më të këqija të devijimit që i ndodhi Tevratit!

Ne myslimanët pohojmë se faqet e mbrojtura të Kur'anit janë ato të cilat na njoftojnë me misionin e Musait, pra jo shkrimet që iu nënshtruan epsheve të ndryshme, që i lejuan vetes ta shënojnë atë që duan dhe ta heqin atë që nuk e duan.

Përshkrimin e misionit të Musait e gjejmë në këto rreshta të Kur'anit: *"O Musa! Në të vërtetë, Unë jam Zoti yt! Prandaj, hiqi nallanet, sepse ndodhesh në luginën e shenjtë të Tuvasë. Unë të kam zgjedhur ty, prandaj dëgjo atë që po të shpallet! Me të vërtetë, Unë jam All-llahu, s'ka zot tjetër përveç Meje, prandaj, vetë Mua më adhuro dhe kryej faljen për të më kujtuar Mua! Ora (e Kiametit) do të vijë me siguri, por Unë e mbaj tepër të fshehur, që secili të shpërblehet për atë që ka bërë. Prandaj, mos e lër atë që nuk beson në të (Ditën e Kiametit) dhe që jepet pas epsheve të veta, të të nxjerrë (nga rruga e drejtë), përndryshe do të humbisje."*<sup>148</sup>

Çfarë pasojash solli ky shtrembërim? Izraelitët (Beni Israilët) u bënë shpërfillësit më të mëdhenj të Ditës së Gjykimit, pengues të besimit në të dhe u bënë – duke pasur parasysh se i zunë postet më të rëndësishme në qendrat e informimit dhe orientimit në Botë – thirrës për adhurim të trupit dhe të jetës së dynjasë. Ata nuk çanë kokë që ta përmendin All-llahun në çështje serioze, e as t'ua përkujtojnë të tjerëve takimin me të, ditën e natën.

Ngjashëm vepruan edhe ithtarët e feve pagane, të cilët i djegin kufomat e të vdekurve, ndërsa pluhurin

<sup>148</sup> Ta-Ha, 11-16

e hedhin në ajër, e pastaj harrojnë se kush ishte dhe çfarë ishte ai! Këtyre u përngjajnë ateistët e Lindjes komuniste dhe shekullarët e Perëndimit, të cilët vetëm emri i lidh me disa doktrina fetare, ndërsa sytë e tyre kurrë nuk e kanë parë qiellin. Besimi në ringjalljen dhe llogarinë është vazhdimësi e besimit në Allahun Një.

Dëshira e madhe e përhapur në kohën moderne për të mos e kujtuar Ditën e Gjykimit i kthehet lëkundjes së këtij besimi ose zbrazjes së zemrave nga ky besim. Islami e vë në spikamë lidhshmërinë e sjelljeve të përditshme me besimin i cili Ditën e Gjykimit e bën plotësim të jetës në këtë botë.

Ndodh që ti ta harxhosh pasurinë që e ke për shkak se dëshiron të njihesh si dhënës, por ndodh ta harxhosh atë për përmbushjen e nevojave të të varfërve, siç ndodh që nga harxhimi i saj të përfitosh sa më shumë pasues ose ta harxhosh për t'i shlyer borxhet që i ke.

Mirëpo, Kur'ani famëlartë na e tërheq vëmendjen për një shkak tjetër të harxhimit të pasurisë, që është i pranuar te All-llahu i Madhërishëm: *"Ata që nga dashuria i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë rob, duke thënë: "Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim! Ne i frikësohemi Zotit tonë në një Ditë të ashpër, që do t'i bëjë fytyrat të jenë të vrenjtura." Por All-llahu do t'i ruajë ata nga tmerret e asaj Dite e do t'u japë shkëlqim dhe gëzim."*<sup>149</sup>

Ndodh të kërkosh post të veçantë, si plotësim për autoritetin tënd shoqëror ose ndoshta e kërkon sepse

<sup>149</sup> El-Insan, 8-11

– sipas mendimit tënd – e meriton të jesh prijës ose udhëheqës, por ndodh ta kërkohsh postin për shkak se të tjerët të kanë propozuar për atë post, siç ndodh ta kërkohsh për shkak të përfitimeve të ndryshme dhe pasurive të shumta që i sjell. Këto shkaqe janë krejt ndryshe nga shkaqet tjera që e vënë në spikamë kërkimin e postit për ta bërë të vërtetën ngadhënjyese dhe për ta zhdukur të pavërtetën, për ta ngritur lart fjalën e All-llahut dhe për ta vendosur drejtësinë mes robërve të Tij.

S'ka dyshim se udhëheqësi në këtë rast është sikur imami në namaz, që u prinë njerëzve, ndërsa puna e tij llogaritet ibadet, sikur puna e imamit e cila bëhet për hir të All-llahut.

Janë shumë shkaqe psikologjike të cilat veprojnë pas marrjes së guximit për vetëveprim dhe heqjes dorë nga ai, pas aktivitetit dhe flakjes së tij, pas heshtjes dhe bisedës dhe pas kënaqësisë dhe zemërimit! Puna nuk ka peshë nëse pas saj nuk qëndron besimi i vërtetë!

All-llahu i Madhërishëm thotë: *"Atyre që duan jetën e kësaj bote dhe bukurinë e saj, Ne do t'ua shpërblejmë krejtësisht punën e tyre dhe në të nuk do t'u lihet gjë mangët. Këta janë ata për të cilët në botën tjetër nuk do të ketë kurrgjë, përveç zjarrit. Do t'u shembet çdo gjë që kanë bërë në këtë jetë dhe do t'u zhvlerësohet ajo që kanë bërë."*<sup>150</sup>

Civilizimi modern është civilizim tokësor dhe njerëzor, që beson se asgjë nuk ka zbritur nga qielli, se vetëm njeriu është zotëri i kësaj gjithësie, se e tashmja

<sup>150</sup> Hud, 15-16

është ajo që duhet dhe meriton të shijohet, se vdekja është gjë e dhembshme, por çfarë të bëjmë? Ta shfrytëzojmë atë që është para vdekjes, e të mos çajmë kokë për atë që është pas saj. Ajo që është pas saj, nuk na intereson fare!

Ne nuk mohojmë se ekziston një ndikim i vogël i feve të cilin ende disa e trashëgojnë! Mirëpo, cila është dobia e këtij ndikimi? Ky ndikim i përngjan tymit të disa fabrikave që e ndryshojnë ajrin, por erërat vijnë me shpejtësi dhe e shpartallojnë atë.

Unë një kohë të gjatë e kam kaluar me pleq e të rinj, mësues e nxënës, udhëheqës e njerëz, ushtarë e civil dhe nuk më ka rënë të dëgjoj – pos disa herë – që ata të flasin për takimin me All-llahun dhe për jetën në botën e ardhme.

Njerëzit janë të burgosur brenda interesave të tyre personale dhe nuk duan që të dalin prej aty ku janë e ta shohin jetën e ardhme! Këta i refuzojnë ngushëllimet që u vijnë nga të tjerët që ua duan shpëtimin dhe që duan t'ua lehtësojnë dhembjet dhe vuajtjet.

Si është e mundur që njerëzit të mendojnë se nuk është gjë e keqe nëse nëpunësi e shtrin dorën për të marrë rryshfet që ta kënaqë vetveten, ndërsa për atë që tregohet i ndershëm dhe i përmbajtur për hir të All-llahut, duke shpresuar në shpërblimin e Tij dhe duke e kryer punën me nder, të mendojnë se është i marrë!!

Analogjia e tillë ka të bëjë edhe me pasuritë e njerëzve, gjakun dhe nderin e tyre. Sot ka shumë që e shtrijnë dorën e tyre në pasurinë, gjakun dhe nderin e njerëzve. Ato nuk i pengon kujtimi i xhenetit dhe i xhehenemit. Sikur xheneti dhe xhehenemi janë

fjalë prapambetëse që kanë të bëjnë me njerëz të prapambetur!

Kështu ndodhi ngadhënjimi i botës së dukshme ndaj botës së padukshme, botës fizike ndaj botës shpirtërore. Unë nuk mendoj se ateizmi është risi që u paraqit në kohën moderne. Ai i ka rrënjët e thella në historinë e njerëzimit. Megjithatë, ateizmi e shfrytëzoi përparimin shkencor që ta shpartallojë besimin, ta çrrënjosë atë nga lëmi i edukimit dhe ta pezullojë ndikimin e tij në vepra dhe moral.

Dua që t'ua tërheq vëmendjen njerëzve për të vërtetën rreth natyrës së përplasjes mes të mirës dhe të keqes; ditën që e mira do të jetë vetëm ide, që vetëm do ta ngacmojë ose mashtrojë shpirtin e njeriut, ndërsa e keqja të jetë stuhi e fuqishme dhe e mençur, atë ditë do të mposhtet e mira. Ditën që e vërteta bëhet që nuk i dëgjohe fare zëri, ndërsa e pavërteta merr guxim për ta ngritë zërin lart, atë ditë do të mposhtet e vërteta.

Pikërisht për këtë ritet islame janë energji shoqërore. Ato kryhen në shoqëri, me qëllim që fuqitë e shumta të ndihmohen mes vete...namazi është një treg që punon ditë e natë, ai asnjëherë nuk mbaron! Ky namaz bëhet me përkushtim të plotë, që fillon me deklarin e njëshmërisë së All-llahut (All-llahu ekber), zë i lartë që largon djallin nga faqja e dheut, dhe zëri i tij nuk dëgjohe më askund! Zëri i teuhidit vazhdon të jehojë në çdo vend, ai vazhdimisht ripërtërihet! Namazi krijon mjedis të kthjellët dhe ambient të pastër, aty nuk mund të jetojnë bakteret e epsheve!

Epshtet marrin hov dhe dominojnë vetëm atëherë kur namazi braktiset dhe kur shpirtërorja e tij zvetëno-



het. All-llahu i Madhërishëm i përshkruan brezat e rrënuar e të dështuar, dhe thotë: *"Pas atyre erdhën breznit, që e braktisën faljen e namazit dhe ndoqën epshet e veta. Ata do të pësojnë dënimin e madh. Përveç atyre që pendohen, që besojnë dhe bëjnë punë të mirë. Këta do të hyjnë në xhenet dhe nuk do t'u bëhet kurrfarë padrejtësie."*<sup>151</sup>

Më ka ra të shoh se si kolonializmi që e urren Islamit të godasë e të shpartallojë çdo tubim të besimit, të bojkotojë çdonjërin nga i cili pritet të formojë grupe të besimtarëve ose t'i mbështetë ato. Kjo ndodhte sepse besimtarët individë janë mbeturinë e qenies, tullat e së cilës janë rrënuar dhe ajo gati sa nuk është rrëzuar përtokë. Ata janë të vdekur, pa dyshim. Nëse jo sot, atëherë me siguri nesër. Kjo u ndodhi myslimanëve në Azi dhe Afrikë.

Bile unë mërzimet shumë për myslimanët që udhëtojnë drejt Evropës dhe Amerikës, siç mërzitem shumë edhe për ata që All-llahu i udhëzon në rrugën e Islamit në këto dy kontinente, sepse mjedisi jetësor në këto vende e gëlltitë shumicën, e çrregullon natyrën që më herët ka qenë e shëndoshë dhe i shkatërron bimët që mund të lulëzojnë e të japin fryte.

Bota moderne tani është duke i dëgjuar astronautët dhe pushtuesit e kozmosit, që nëse ndonjëri prej tyre pa dashje thotë: "Unë kërkova në qiell, por nuk e gjeta Zotin!" – këtij i beson një i ngratë e i mjerë, që e ka mendjen e vyshkur dhe është me ambicie të ulët! Megjithatë ateizmi po përhapet.

<sup>151</sup> Merjem, 59-60

Më ra të mendoj gjatë për këtë çështje dhe thashë më vete: "Si u bë që errësira t'i zaptojë këto vende të mëdha të Botës? Si u bë që t'i devijojë masat e gjera e t'i bëjë të jetojnë larg Zotit të tyre ose ta mohojnë Atë?"

Më vonë m'u bë e qartë se kufri i ka dy shkaqe që i përngjajnë njëra-tjetrës dhe janë të njëjta për nga ndikimi dhe rreziku.

E para: disa njerëz nuk e respektuan Përkujdesësin e begatave të mëdha. Ata e mohuan Atë, andaj edhe i kapërcyen kufijtë e porosive dhe udhëzimeve të Tij.

E dyta: Prezantimi i fesë (Islamit) në mënyrë që nxit neveritje dhe zemërim.

S'ka dyshim se prezantimi fesë në shekujt e mesëm ishte ai që e nxiti këtë neveritje dhe zemërim. Atëkohë, njerëzit besonin se feja është kundër shkencës, se është armike e jetës së drejtë e të barabartë! Njerëzit nuk mund ta dallonin prezantimin e vërtetë nga ai i pavërtetë. Prandaj, ndodhi që shkenca të refuzonte besimin në Zot, e me të edhe civilizimi modern ta bënte të njëjtën.

Për fat të keq, bota nuk arriti ta gjente atë i cili do ta merrte për dore dhe do ta udhëhiqte atë drejt rrugës së drejtë. Civilizimi mendjemprehtë filloi ta përdorte mençurinë e saj në gjërat që vinin pas.

Kujtoj se dy shkaqet e lartpërmendura edhe më tej janë së bashku që të krijojnë kushte për të jetuar ateizmi dhe shthurja. Pasi edhe unë jam nga thirrësit myslimanë, më duhet të pranoj se Islami nuk gjen sot njeri që do ta merrte përsipër predikimin e të vërtetave të tij. Shumë thirrës sot flasin fjalë me të cilat çuditen mendarët, saqë u përhap bindja se Islami është fe e një grupi të

sundimtarëve që jetojnë në luks, e që rrojnë në mesin e njerëzve që rëndin pas ushqimit! Këta njerëz nuk e njohin lirinë dhe nderin, e as mendjen dhe shpikjen.

Feja na detyron ta zaptojmë dynjanë dhe ta vëmë atë në shërbim të qëllimeve të larta, ndërkaq ne thamë: Jo, nuk duam të kemi lidhje me dynjanë!

Feja na urdhëron të kujdesemi për trupin dhe shëndetin, me qëllim që ta stërvitim e që ai të na shërbejë për realizimin e planeve dhe shpresave tona, ndërkaq ne thamë: Feja na bën të kënaqemi me urinë, dobësinë, errësirën, mosnjohjen dhe zbavitjen.

Feja na urdhëron të jemi mendjemprehtë, syhapur, mendjegjerë, ndërsa ne bëhemi mendjehumbur, duke u kënaqur vetëm me disa lexime dhe pjesë të dhikrit pa i kuptuar dhe studiuar fare ato.

Islamit nuk i bëjnë dobi natyra e shtrembër dhe mendja e humbur. Është për t'u çuditur se ata të cilët zemërohen nga realiteti i hidhur dhe e pohojnë pendimin, janë ata që e ndjekin po atë rrugë që e ndoqën ata që më parë na udhëhoqën drejt disfatës....rrugën e shkatërrimit të dynjasë, shpërfilljes së saj dhe mbetjes larg saj!

Megjithatë nuk ishin kështu të parët tanë të mëdhenj. Ata arritën të dinë se feja është dynjaja, e vendosur mes dy harqeve, të besimit dhe përmbajtjes së udhëzimeve të tij dhe adhurimeve që e pastrojnë dhe e edukojnë shpirtin dhe trupin, që janë të dobishme për dynjanë dhe ahiretin.

Feja nuk na thotë: Braktiseni Tokën dhe shkoni të jetoni në një planet tjetër! Sepse, All-llahu i Madhërishtëm na thotë: *"Është Ai që për ju ka krijuar çdo gjë që ka në Tokë."*<sup>152</sup>

<sup>152</sup> El-Bekare, 29

Feja nuk na thotë: Bëhuni asketë dhe mos i shijoni të mirat e Tokës, braktisni ato që të jeni më afër engjëjve!

Feja na thotë: *“O besimtarë! Hani nga ushqimet e lejuara që ju kemi dhënë dhe, nëse jeni adhurues të All-llahut, falënderojeni Atë!”*<sup>153</sup>

All-llahu e di se ka njerëz që do të shkatërrohen dhe do të ngarkohen me gjëra që nuk i dinë, se këta do të mëtojnë t’i mësojnë të tjerët për këto gjëra, duke u thënë se janë më të përshtatshme. Prandaj, All-llahu u thotë: *“Çfarë mendoni ju për ushqimin që jua ka zbritur All-llahu, një pjesë të të cilit e bëni të ndaluar e një pjesë tjetër të lejuar?” Thuaj: “A ju ka lejuar All-llahu për këtë apo po shpifni gënjeshtër për All-llahun?”*<sup>154</sup>

All-llahu gjithashtu e di se në Tokë do të rrojnë një pakicë që do të besojë, ndërsa shumica do të jenë që nuk do të besojnë, se zotërimi i të mirave të Tokës do të jetë forcë e të zotëve të cilët do të arrijnë ta përvetësojnë atë dhe mbështetje e parimeve të tyre, andaj si do të jetë halli nëse jobesimtarët i zotërojnë ato, e jo besimtarët?

Si do të mund të triumfojë e vërteta? Si do të mund të dalë fitimtare dhe ta mposhtë të pavërtetën? Pikërisht për këtë All-llahu i Madhërishëm lidhur me përshkrimin e hekurit thotë: *“Ne e zbritëm hekurin, në të cilin ka (material për) luftë të fuqishme dhe dobi (të tjera) për njerëzit, me qëllim që All-llahu të njohë ata që e ndihmojnë Atë dhe të dërguarit e Tij, pa e parë Atë. Me të vërtetë, All-llahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm.”*<sup>155</sup>

<sup>153</sup> El-Bekare, 172

<sup>154</sup> Junus, 59

<sup>155</sup> El-Hadid, 25

Do të ishte e udhës – në çastin e dëgjimit të zërit që thotë: “Kush janë ndihmuesit e mi në rrugën e All-llahut” – që burrat e të së vërtetës të rrokin në dorë armët e prodhuara dhe t’i bëjnë ballë armikut dhe ta mposhtin tiraninë.

Me siguri do të ishte turp i madh dhe fatkeqësi e mjerueshme për imanin dhe pasuesit e tij që besimtarët t’i shohim të paastë dhe të dobët, të marrë dhe të papunë, në kohën kur jobesimtarët për kufrin e tyre i kanë përgatitur tanket dhe predhat!

Pikërisht për këtë themi: “Feja është vetë dynjaja, e orientuar me faktorët e besimit dhe qëllimet e tij.”

Mirëpo, ndër myslimanët është përhapur shpirtërorja e rrejshme, të cilën e refuzon çdokush që e lexon me vëmendje Kur’anin dhe që është i edukuar me vlerat e tij morale! Kjo bëri që myslimanët të mbeten të hutuar, të ecin mbi burimet e naftës, minierat e hekurit dhe të arit, e të mos dinë asgjë për ato, derisa erdhën zotërinjtë dhe bënë që nga këto burime dhe miniera t’i nxjerrin mineralet e tyre të shtrenjta. Prej këtyre vendeve i nxorën begatitë e All-llahut dhe çdo gjë e shfrytëzuan për ta përforcuar fenë dhe kombin e tyre, vetveten dhe fëmijët e tyre.

Ndërkaq myslimanët e ngushëlluan njëri-tjetrin duke thënë: “Ne jemi të huaj në dynja, por qëndrojmë thellë në fe!”

Këta rrejtën, sepse puna dhe gjendja e tyre ishte vërtet e huaj dhe larg Librit të All-llahut dhe Sunetit të të Dërguarit të Tij, si dhe larg rrugës së të parëve të mëdhenj!

Myslimanët ishin të huaj në fe dhe në dynja.

Është zullumqar ai që e nxjerr arin për t'i nënshtruar zezakët, siç ndodh sot në Afrikën Jugore; është i mbrapshtë (gjynahqar) ai që atë e nxjerr për të prodhuar byzylykë që do t'i vë në dorë ose si zinxhirë në qafë; i mençur është ai që atë e nxjerr për ta përforcuar pozitën e tij materiale dhe letrat me vlerë; indorant është ai që nuk di ta nxjerrë fare atë; ndërsa mendjelehtë është ai që shkon në treg për ta blerë atë për ndonjë vajzë ose për kënaqësi personale!!

Muslimanët bien në dy kategoritë e fundit. Kohëve të fundit mund të hasim në të tillë që polemizojnë për lejimin e arit për femrat! Këta e harrojnë qëndrimin e Islamit lidhur me këtë çështje, andaj edhe diskutimi i tyre ngjall një të qeshur të hidhur, sepse muslimanët nuk janë të aftë ta nxjerrin atë nga minierat e tokës, e as ta përpunojnë atë, ndërsa janë shumë të nevojshëm për të!

Prapambeturia nënçmuese, e cila e ka goditur botën Islame, ka bërë që disa nga bijtë e saj t'i shqyrtojnë me vëmendje idetë e huaja, eposhorët morën guxim të bëjnë thirrje që epsheet dhe emocionet të përmbushen haptazi. Nëse thirrësit islamë edhe më tej mbeten viktimë e mësimëve të sajua dhe e shpirtërores së rrejshme, sidomos nëse mbeten të dhënë në mënyrë të flaktë pas imitimit të kohërave të dekadencës politike dhe kulturore gjatë historisë së gjatë, si dhe të përqendruar në çështje sekondare e dispozita të hershme dhe forma të vdekura, ata të tjerët do ta vazhdojnë rrugën e tyre!

## *Tema e tretë*

### *Rrëfimet kur'anore*

Tema e rrëfimeve kur'anore është tema më e gjerë në Kur'anin familartë. Andaj shqyrtimi ynë ka të bëjë vetëm me një aspekt të kufizuar të saj: A janë rrëfimet të cilat na i transmeton Kur'ani familartë të tilla që i ngjasojnë njëra-tjetrës në kontekstin e tyre, në përshkrimin e ndodhive dhe në përcjelljen e porosive të tyre? Dua të them: A janë ato një lloj përsëritjeje e cila nuk bën dobi? Përgjigja është negative. Sepse çdo rrëfim është në vendin e duhur, i transmetuar me qëllim të caktuar dhe me ndikim të ndryshëm. Dëgjuesi ndien nevojë për të gjitha këto rrëfime, të cilat do t'i ndihmojnë ta kompletojë të vërtetën historike dhe elementet e saj edukative. Kujtoj se këtu jemi të detyruar për një shpjegim më të gjerë të kësaj çështjeje dhe për një argumentim sa më bindës! Të shkojmë te rrëfimi për Ademin alejhis-selam i cili përsëritet shtatë herë<sup>156</sup> në Kur'anin familartë e kështu të nxjerrim shembuj për ta provuar këtë që e themi.

Janë një grup orientalistësh ata të cilët na shtynë të merremi me këtë çështje, ngase ata mendojnë se

<sup>156</sup> Mund të jetë e përsëritur tetë herë, nëse sureve: El-Bekare, El-A'raf, El-Hixhr, El-Isra', Ta-Ha, El-Kehf dhe Sad, ia bashkëngjasim suren Es-Sexhde.

rrëfimet kur'anore janë kontradiktore me njëra-tjetrën. S'ka dyshim se pretendimi tyre është i pasaktë dhe rezultat i mosnjohjes së gjërave siç duhet, ndonëse nuk përmban tendenca armiqësore.

Dua të theksoj se profesori Abas el-Akad thotë: "Fotografite për një vend që merren nga disa kënde të ndryshme dallojnë mes vete. Kështu fotografia e Kajros nga ajri nuk është e njëjtë me fotografinë e cila merret nga bregu Maktam<sup>137</sup>, ndërsa fotografia e saj nga lumi Nil është krejt ndryshe nga fotografia e saj nga piramidat." Kajroja është Kajro, por dallon vetëm këndi i shfaqjes së saj.

E njëjta ndodhë edhe kur e lexojmë rrëfimin të cillin na e transmeton kur'anKur'ani familartë për Adem-in alejhis-selam. Rrëfimi për të është përmendur në suren e parë e cila u shpall pas shpërnguljes së të Dërguarit s.a.v.s., andaj është gabim ta konsiderojmë këtë rrëfim se është i pari që ka të bëjë me Ademin alejhis-selam, edhe pse është i pari i theksuar në Mus'haf. Gjatë shqyrtimit të thellë mësojmë se rrëfimi për Adem-in alejhis-selam i përmendur në suren El-Bekare është rrëfimi i fundit i shpallur për të!! Aty vihet në spikamë gabimi i Ademit, bartja e përgjegjësisë për daljen nga xheneti, përshtkrimi i tij se është rob që nuk e zbatoi urdhrin e All-llahut, andaj meritoi dënimin, se All-llahu – nga mëshira që pati për robin e dobët – ia mësoi dhe ia frymëzoi pendimin, ndërsa kur u pendua, e zbriti në Tokë që të fillonte jetë të mundimshme, pas së cilës do të kthehet në xhenet, natyrisht nëse tregohet i mirë dhe bën punë të mira.

<sup>137</sup> Breg në lindje të Kajros.



Cila është fshehtësia e këtij prezantimi? S'ka dyshim se fshehtësia e tij qëndron në sqarimin e të së vërtetës dhe përgënjeshttrimin e hamendjeve që hebrenjtë i sajuan për Ademin, siç përmend Dhiata e Vjetër.

Të shohim se çfarë thotë Dhiata e Vjetër lidhur me Ademin. Në Librin e zanafillës, kapitulli i tretë, thuhet: "Pastaj e dëboi njeriun nga kopshti i Edenit duke thënë me vete: "Tani njeriu u bë si çdonjëri prej nesh, sepse është i lirë të bëjë gjithçka. Ai nuk duhet lejuar të hajë edhe frutat nga pema që jep jetë (të përjetshme), përndryshe do të jetojë përgjithmonë. Le ta punojë tokën nga e cila edhe u krijua." Perëndia e ruante hyrjen e kopshtit të Edenit me engjëjt rojtarë dhe me shpatën e zjarrtë. Askush nuk lejohej t'i afrohej pemës që jep jetë (të përjetshme).!"

Nga këtu mësojmë se pema nga e cila hëngri Ademi dhe që e meritoi zemërimin e Zotit është pema që jep jetë (njohuri)! Çfarë jete (njohurie)? Njohjen e të mirës dhe të keqes!! Sikur All-llahu dëshiron që Ademi të mbetet injorant (i paditur), të mos dijë se çfarë është e mira dhe çfarë është e keqja?

Kur'ani na mëson se All-llahu i Madhërishëm ia mësoi Ademit emrat e çdo gjëje, e dalloi me dituri të gjerë, andaj është e pamundur që ta krijonte kafshë që nuk do ta dallonte të mirën nga e keqja. Është qesharake që All-llahu – siç pretendon Dhiata e Vjetër – të jetë frikësuar se Ademi do të ngrihej në shkallë të lartë të njohurive nëse do të hante nga pema që jep jetë e kështu do të bëhej i përjetshëm, kuptohet pasi të ishte bërë i ditur!

Shprehja e Dhiatës së Vjetër: "Tani njeriu u bë si çdonjëri prej nesh....", nënkupton se çështja është e

frikshme! Njëri prej cilëve? Bota nuk është sektor publik të cilin e udhëheq drejtorja e zgjedhur ose e caktuar! "All-llahu është vetëm një Zot – qoftë lavdëruar Ai."<sup>158</sup>

Shprehja "Tani njeriu u bë si çdonjëri prej nesh..." është fjali që del nga zëdhënësi i cili flet në emër të zotave të Olimpmit dhe në emër të familjes pagane të cilën e ngërtheu kultura greke.

Këtë e thotë Dhiata e Vjetër dhe e bën shkak të largimit të njeriut nga xheneti dhe shkak të zbritjes së tij në tokë!

Siç duket, rrëfimi në fjalë kërkon sqarim të mëtejshëm. Këtu ekziston frika nga kthimi i ndonjërit në xhenet për të ngrënë nga pema e jetës së përjetshme e për t'u shpallë luftë zotave! Atëherë çfarë duhet bërë? Këtu e kemi: "Perëndia e ruante hyrjen e kopshtit të Edenit me engjëjt rojtarë dhe me shpatën e zjarrtë. Askush nuk lejohet t'i afrohej pemës që jep jetë (të përjetshme).!"

Kush do të sulmojë? Prej cilit e presin sulmin? Pse të angazhohen rojtarë? Siç duket Dhiata e Vjetër nuk di gjë për lavditë Hyjnore, e as për madhështinë e Krijuesit të Madh! Njerëzit, xhindet dhe engjëjt janë të nevojshëm për çdo moment të jetës së tyre që atë ta marrin nga All-llahu i Lartëmadhëruar. S'ka asnjë gjallesë që të mos jetë nën pushtetin e Tij, andaj cili është ai që do të dëshironte ta çante rrugën e t'i afrohej pemës së ashtuquajtur "që jep jetë të përjetshme" kur All-llahu është Ai që ndërhyr midis njeriut dhe zemrës së tij dhe përnjëherë ia mbyll duart dhe gojën! Çfarë mund të bëj krijesa me Krijuesin e saj?

<sup>158</sup> En-Nisa', 171

Njeriu thotë më vete dhe qeshet: çfarë është kjo pemë, frutat e së cilës i ha njeriu për të fituar jetën e përjetshme? E të hyjë në radhët e zotave? T'ia kenë frikë se mos vallë ngjitet në qiell e të bëjë ndonjë revolucion, qoftë i suksesshëm apo i dështuar?!

Tevrati na rrëfen mënyrën se si All-llahu e zbuloi gabimin e Ademit, që ne të çuditemi dhe të heshtim nga habia. Ademi dhe Hava, pasi e thyen urdhrin hyjnor, e ndien të keqen që e kishin bërë dhe filluan të mendojnë për situatën që u gjetën: ".....ata dëgjuan Zotin Perëndi që po kalonte përmes kopshtit. U fshehën midis pemëve, por Perëndia e thirri njeriu dhe i tha: "Ku je?"

Para se ta përmbyllim rrëfimin, duhet ta theksojmë habinë që na kaplon kur dëgjojmë që Zoti ecën përmes kopshtit sikur të jetë rojë e natës, që nuk di se çfarë ndodhë në kopshtin që e ruan! Habia na merr edhe kur e shohim pamjen e Ademit dhe të gruas së tij, kur ata fshihen midis pemëve që Perëndia të mos i shohë. Pastaj, Zoti Perëndi e pyet Ademin: "Ku je?" Njeriu iu përgjigj: "Dëgjova që po afroheshe përmes kopshtit; kisha frikë dhe u fsheha nga ti, sepse jam lakuriq." Po kush të tregoi se je lakuriq? – e pyeti Zoti Perëndi. Mos ke ngrënë nga frutat e ndaluara?"

Është ky Zoti Perëndi që nuk e di se çfarë ndodhë në pushtetin e Tij!!

"Njeriu u përgjigj: "Gruaja që ma ke dhënë si shoqe më dha një frutë dhe unë e hëngra. Atëherë Zoti Perëndi e pyeti gruan: "Përse e bërë këtë?" Gruaja iu përgjigj: "Gjarpri është fajtor, ai më shtyu ta haj frutën."

Kështu fillon rrëfimi me të cilin fillon njerëzimi!! Është ky rrëfim që lexuesit i duket se autori i tij është i specializuar në lëmin e rrëfimeve për fëmijë.

Ne nuk duam që fjalët e tilla të ngelin pa ndonjë shpjegim nga ana jonë, pa atë që është e domosdoshme për t'i larguar të thënat e kota për All-llahun e Madhërishëm. Prandaj, atyre që këto llomotitje i llogarisin të shenjta, hebrenj e të krishterë, u themi: "All-llahu është më i Madh dhe më i Lartë se çmendoni ju dhe si e përshkruani."

Kur'ani famëlartë u flet mendarëve për All-llahun, andaj edhe thotë: "(Për Aië) njëlloj është: si ai prej jush që flet me vete edhe ai që flet me zë të lartë, si ai që fshihet natën edhe ai që ecën ditën."<sup>159</sup>

"...asnjë gjeth nuk bie, pa e ditur Ai dhe nuk ekziston asnjë kokërr në errësirën e tokës, as e njomë, as e thatë, të të mos jetë shënuar në Librin e qartë (Leuhi Mahfudh)."<sup>160</sup>

"A nuk i shohin shpendët mbi kokat e tyre, se si i hapin dhe i mbledhin krahët? Askush nuk i mban ata, përveç të Gjithëmëshirshmit; Ai, me të vërtetë, sheh çdo gjë."<sup>161</sup>

Është e dhembshme dhe fatkeqe mosnjohja e All-llahut të Madhërishëm, veçanërisht është i dhembshëm përshkrimi i tij që haset te hebrenjtë dhe të krishterët. Pikërisht për këtë, Kur'ani famëlartë u bën thirrje ithtarëve të Librit (hebrenjve dhe të krishterëve) dhe thotë: "O ithtarët e Librit! Juve ju erdhi i Dërguari Ynë, i cili ju shpjegon gjëra nga ato që i keni fshehur ju prej Librave (Teuratit dhe Ungjillit) dhe ju fal shumë. Juve

<sup>159</sup> Er-Ra'd, 10

<sup>160</sup> El-En'am, 59

<sup>161</sup> El-Mulk, 19

*ju erdhi prej All-llahut dritë (i Dërguari) dhe Libër i qarië (Kur'ani). Me të cilin All-llahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësira në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në rrugën e drejtë.”<sup>162</sup>*

Ta shohim se çfarë na thonë suret e Kur'anit famëlartë të cilat e sjellin rrëfimin për Ademin alejhis-selam, gjegjësisht surja El-Bekare dhe El-A'raf. Ademi në këto dy sure përmendet pasi këto dy sure e përshkruajnë gjithë misionin njerëzor në Tokë dhe aftësitë të cilat All-llahu ua dha bijve të Ademit të cilët pastaj do ta realizojnë këtë mision.

Në suren e parë i lexojmë fjalët e All-llahut të Madhërishëm: *“Është Ai që për ju ka krijuar çdo gjë që ka në Tokë.”*<sup>163</sup>

Ndërsa në suren e dytë i lexojmë këto fjalë të All-llahut: *“Ne ju kemi vendosur në tokë dhe aty ju kemi dhënë çfarë ju nevojitet për jetesë.”*<sup>164</sup>

Njeriu është krijesë të cilën në mënyrë të veçantë e krijoi kujdesi i lartë hyjnor, për të caktoi provim të veçantë dhe e detyroi me një lloj të veçantë të punës dhe mundimit në këtë botë. Ai do të mund të tregohet i suksesshëm dhe i pasuksesshëm, ndërsa dëshira e tij për shpëtim është ajo që vendos për këtë.

Në suren e parë shohim se njeriut iu dha dituri të cilën nuk e dinin as engjëjt, dituri për të cilën engjëjt nuk kishin dëgjuar më parë dhe dituri që nuk ishte e njohur për ta. Prandaj, ata pranuan se janë të paaftë

<sup>162</sup> El-Maide, 15-16

<sup>163</sup> El-Bekare, 29

<sup>164</sup> El-A'raf, 10

për t'i ditur emrat e gjërave të cilat i dinte Ademi, andaj edhe thanë: *"Qofsh i lavdëruar! – thanë ata – Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti."*<sup>165</sup>

Ndërkaq surja e dytë na mëson se Ademin – këtë të diturin dhe të mençurin, që ua kaloi engjëjve – e goditi ajo e cila e bëri djallin të jetë edhe më i ashpër dhe më i guximshëm ndaj tij, lakmues pas tij, shpend të cilin shumë lehtë do ta gjuante! Ai është krijesë inteligjente, mirëpo lehtë mashtrohet, ndërsa e ardhmja e tij shumë lehtë njolloset.

Pikërisht për këtë djalli për Ademin dhe pasardhësit e tij tha: *"Do t'u qasem atyre nga përpara dhe nga mbropa, nga e djathta dhe nga e majta, e kështu Ti do të vëshesh se shumica e tyre nuk të janë mirënjohës!"*<sup>166</sup>

Konteksti i sures El-A'raf na mëson se si bie përtokë njeriu i mençur, si ndodh mashtrimi i tij, si bëhet që ata të qeshin me të, si ndodh shkatërrimi i të ardhmes së tij dhe i të ardhmes së gruas së tij, sepse edhe asaj iu ndalua të hajë nga pema dhe ja, tani djalli u thotë të dyve: *"Zoti juaj jua ka ndaluar pemën, vetëm që të mos bëheni engjëj ose të pavdekshëm."*<sup>167</sup>

Ademi mund të thoshte: *"Si të lakmoj të bëhem engjëll kur unë jam ai që engjëjt mu përkulën? Zotëriu nuk shpreson të bëhet rob??"*

Mirëpo, njeriu i mençur ra në grackë, u besoi fjalëve që e këshillonin rrejshëm, madje u tregua edhe më i shkujdesur kur djalli u betua në Zotin se për

<sup>165</sup> El-Bekare, 32

<sup>166</sup> El-A'raf, 17

<sup>167</sup> El-A'raf, 20

Ademin dhe gruan e tij ishte këshillues i sinqertë: *"Dhe iu betua atyre (duke u thënë): "Vërtet, Unë jam për ju këshillues i sinqertë."*<sup>168</sup> Kështu Ademi u largua nga xheneti dhe kështu ndodhi mashtrimi i bijve të tij deri në Ditën e Ringjalljes!

Është ky mashtrim (dinakëri, dredhi) për bijtë e Ademit në të cilin nuk ka mençuri . S'ka dyshim se mashtrimi i tillë e arriti qëllimin – të dështonte viktimat, e të mos mund të vinte në vete, ta kuptonte realitetin dhe të përgatitej për të nesërmen. Vallë, a thua bijtë e Ademit po e përsërisin fatkeqësinë e njëjtë?

All-llahu është i Gjithëmëshirshëm e i Dashur, ai e frymëzon robin e Tij gjynahqarx duke e mësuar si të kërkojë falej e të pendohet për gabimin e bërë. E nëse ai pendohet, atëherë Ai gëzohet dhe shpejton për ta takuar atë, bën që çdo e mirë të vrapojë me shpejtësi te ai! Pikërisht për këtë All-llahu nuk e la Ademin të vetëm të ballafaqohet me pasojat e mosdëgjimit të tij, por e mësoi se si të kthehej tek Zoti i tij dhe të shpëtojë nga gjynahu që e kishte bërë: *"Ademi mësoi disa fjalë (se si të kërkonte falje) nga Zoti i tij, kështu që Ai ia pranoi pendimin. Sigurisht, Ai i pranon shumë pendimet, Ai është Mëshirëploti."*<sup>169</sup>

Kam vërejtur se All-llahu i Madhërishëm ia pranon pendimin njeriut. E kur t'ia falë, atëherë ia përgatitë rrugën e kthimit të mirë tek Ai. Mëshira e All-llahut të Lartëmadhëruar i paraprin zemërimit të Tij. Sikur njerëzit të liheshin në mëshirë të ndjenjave të tyre, me siguri që gjynahet e tyre do t'i shkatërronin. Mos-

<sup>168</sup> El-A'raf, 21

<sup>169</sup> El-Bekare, 37

bindja ndaj All-llahut nuk është çështje e lehtë, ajo është dera e zemërimit dhe vuajtjes. Kur All-llahu ia dëshiron të mirën ndonjë gjynahqari, atij ia jep një shkëndijë nga drita me të cilën ai do ta shohë rrugën e pendimit. E nëse bën të ndiejë keqardhje për gjynahun që e ka bërë dhe e dëshiron kthimin e tij te Zoti i tij (duke shprehur dashurinë për Të), atëherë para tij do të ndizet drita jeshile e cila nënkupton se atij i lejohet kalimi.

Çfarë bëri Ademi dhe gruaja e tij në çastin kur e dëshironin pendimin dhe kthimin te Zoti i tyre? I përsëritën së bashku fjalët: *“O Zoti ynë! Ne e kemi futur veten në gjynah, prandaj, nëse Ti nuk na falë dhe nuk na mëshiron, ne vërtet që do të jemi nga të humburit. All-llahu tha: “Zbritni! Ju do të jeni armiq me njëri-tjetrin. Në Tokë do të banoni dhe do të jetoni deri në një kohë të caktuar. Aty do të jetoni, aty do të vdisni dhe prej saj do të ringjallenit.”*<sup>170</sup>

Surja El-A'raf sjell hollësi për gjërat që surja El-Bekare i sqaron në mënyrë të përgjithshme. Pas këtyre hollësive të shtruara në këto dy sure, pasojnë katër thirrje për bijtë e Ademit që i mësojnë ata se si të jetojnë në faqe të dheut, duke ua tërhequr vërejtjen nga shkujdesi i cili i përmbysi prindërit e tyre dhe i bëri t'i shijojnë vuajtjet e ndryshme. Këto katër thirrje e ngërthejnë në vete thelbin e asaj që i duhet njerëzimit, ndriçim për mendjen dhe mbrojtje.

Pas rrëfimit për Ademin alejhis-selam, surja El-Bekare iu drejtohet izraelitëve, bartësve të shpalljes së mëhershme. Këta u treguan të padëgjueshëm ndaj

<sup>170</sup> El-A'raf, 23-25



porosive qiellore, të etur pas devijimit dhe shtrembërimit të tyre, andaj All-llahu deshi që bartësve të rinj të shpalljes t'u rrëfejë për atë se çfarë bënë të parët dhe çfarë bëri Zoti me ta. S'ka dyshim se biseda kur'anore lidhur me izraelitët nënkupton që myslimanët duhet të përqendrohen mirë në rrugën e Zotit dhe ta ruajnë të ardhmen e botës e cila është e lidhur ngushtë me Kur'anin e tyre.

Mirëpo, myslimanët – sidomos myslimanët e kohës bashkëkohore – nuk arritën të marrin mësim. Errësira e cila po i kërcënon bijtë e Ademit në shumë vende të botës është rezultat i tradhtive të mëdha të cilat i bënë myslimanët që i shpërfillën porosinë e shpalljes së tyre dhe mbulesës të cilën e qëndisën dhe e vunë përmbi mësimet e fesë.

Dekadenca e myslimanëve bëri që civilizimi njerëzor të pësojë humbje të mëdha. Dekadenca e tyre bëri që elementet e kaosit dhe devijimit ta arrijnë qëllimin e tyre pa u penguar fare. Nuk dyshoj se llogaria e myslimanëve do të jetë e vështirë nëse ata vazhdojnë të veprojnë në këtë mënyrë.

Ata – sidomos në këtë kohë – nuk janë duke bërë më pak seç bënë hebrenjtë në të kaluarën - shpërfilljen e shpalljes, braktisjen e vlerave hyjnore, kërkimin e lëvdatave në tendencat racore dhe ngritjen lartë në emisionet laike të cilat i refuzojnë mësimet e Muhamedit s.a.v.s.

### *Rrëfimet kur'anore – mjete për edukim*

Rrëfimet e Kur'anit familartë lidhur me popujt e mëhershëm paraqesin mjet për edukim, janë burim i udhëzimit të mirëfilltë dhe këshillë që e ndihmon individin dhe shoqërinë. Rrëfimet kur'anore janë fragmente nga e kaluara të cilat Shpallja e Lartë i rikthen për qëllime të larta, për mësim dhe këshillë.

Shumë herë më ndodhë të kem nevojë që ta dëgjoj zërin tim të incizuar më herët në shirit magnetofoni. Këtë e bëj disa herë dhe nuk mërzitem fare. Shkenca arriti ta ruajë zërin dhe ta përsërisë atë sa herë që është e nevojshme.

Edhe rrëfimet kur'anore përmbajnë gjallëri të jashtëzakonshme, të duket sikur janë ngjallur shekujt e vdekur qëmoti, sikur janë gjarpërinj që lëvizin, sikur e dëgjojmë zhurmën e luftës që zhvillohet mes të mirëve dhe të këqijve, shiriti i ngjarjeve lëviz për t'i rikthyer kështu periudhat e historisë së botës.

Ne sot jemi në këtë botë dhe bëjmë çfarë të duam, por a thua gjithë këtë e humbë koha? Assesi! Ajo mbetet e ruajtur, Zoti i botëve do të na e rikthejë kur të dojë Ai, ngase Ai në Librin e Tij të fundit në transmetime të sinqerta na prezanton shembuj që kanë të bëjnë me këtë çështje, që ne të shohim se çfarë pësuan ata që jetuan para nesh, ata që u treguan të padëgjueshëm dhe ata që u treguan të dëgjueshëm, të udhëzuar e të devijuar, të drejtë e mburravec, të shpëtuar e të humbur. Janë këto transmetime që e rrëfejnë realitetin e ndodhur e assesí imagjinatë: *"Kështu pra, Ne po*

*të tregojmë ty (o Muhamcd) disa histori të së kaluarës. Ky (Kur'an) që të kemi dhënë, është një këshillë nga ana Jonë. Kush shmanget nga ia, në Ditën e Kiametit do të mbartë ngarkesë të rëndë. Që do t'u mbetet përherë. Sa barrë e keqe që do të jetë ajo në Ditën e Kiametit.”<sup>171</sup>*

Ne nuk kemi për qëllim që këtu të shkruajmë hollësisht për rrëfimet kur'anore. Qëllimi ynë është të hulumtojmë për disa ilaçe hyjnore të vlefshme për sëmundjet njerëzore. Pikërisht për këtë ne i hulumtojmë dhe studiojmë historitë e të kaluarës dhe bredhjet e tyre nëpër botë derisa një ditë u gjetën nëntokë.

Ne e dimë se njeriu është njeri, se ai shumë herë nuk është i njëjtë, sepse ndodhë që ai të jetojë në qytet ose fshat, të jetë i arsimuar dhe analfabet, mirëpo ky ndryshim hetohet në qëllimet dhe metodat e tij, ndërsa ndjenjat dhe emocionet e tij janë ato që shumë pak ndryshojnë.

Edhe përkundër përparimit të shkencës, zjarri i ndezur i epsheve në Holivud nuk është më i vogël se zjarri i epsheve para dhjetë shekujve që ndizej në tregun e shitjes së robërve dhe në vendet e kurvërisë! Poshtërimet e kolonializmit nuk janë fare më të vogla se të ato që u ushtruan atë në kohën e faraonëve dhe të shfrenuarve mendjelehtë!

Është gabim të llogaritet feja si fiksion i jetës në formë primitive; se njeriu i paarsimuar është më afër All-llahut se njeriu i arsimuar dhe i mençur?! Thelbi i fesë është brendia e pastër dhe mendja e ndritur. Kështu na mëson Libri ynë. Njeriu që banon në pallat

<sup>171</sup> Ta-Ha, 99-101

dhe është shpirtmirë dhe i moralshëm, është më i dashur për All-llahun se ai që banon në kasolle ose në shkretëtirë e që rend pas epsheve!

Karakteri i civilizimit modern të bën të çuditësh. Ai arriti të shohë se çfarë ka në Hënë, por mbeti i verbër për gjërat në Tokë. Më pëlqeu shkrimi i profesorit Ahmed Behxhet lidhur me raportin e Kombeve të Bashkuara për shëndetin e fëmijëve në botë. Ai thotë: "Vetëm vitin e kaluar kanë vdekur 14 milionë fëmijë! Dehidrimi i fëmijëve (për shkak të diarresës) ishte shkak i vdekjes së 70% të rasteve, ndërsa shkak i vdekjes së të tjerëve është lia, malaria, kollitja e rëndë etj".

Ky numër i madh i vdekjeve është turp për botën e cila arriti ta pushtojë kozmosin dhe të thur programe për t'i luftuar planetët! Numri i atyre që pësuan vdekje gjatë dy ditëve, si shkak i dehidrimit dhe jashtëqitjes, e tejkalon numrin e atyre që pësuan vdekje nga sëmundja e AIDS-sit gjatë dy vjetëve! Vallë, a do t'ia kushtojë bota vëmendjen e saj sëmundjeve të fëmijëve, ashtu sikur është duke vepruar me sëmundjen AIDS?

Bota është duke hulumtuar për "vaksinën" të cilën do ta merrte i sëmurë për të mbetur i shëndoshë në trup, ndërsa i sëmurë në shpirt dhe moral dhe njëherazi praktikues i epsheve seksuale dhe anomalive çnjerëzore!

Bota nuk është duke menduar për shërimin e sëmundjeve nga burimi, e t'i mënjanojë ose kundërshtojë epshet e ndaluara! Ajo është duke u krijuar rrugë këtyre epsheve të ndaluara. Ajo ka përpiluar ligje që do t'i mbronin ato, e pastaj është treguar e kujdesshme për lirinë e devijimit. Në anën tjetër i nxit shkencëtarët të hulumtojnë e të zbulojnë ilaçe që do t'i mbrojnë devijuesit.

Ne pohojmë se përparimi shkencor nuk vlen aspak nëse mungon ngritja shpirtërore. Në këtë rast përparimi shkencor do të kontribuojë në dyfishimin e mjeteve të caktuara që çojnë drejt rënies morale dhe shkatërrimit mendor.

Kur'ani famëlartë na rrëfen për civilizimet e mëhershme që u ngritën mbi bazat e përparimit të mrekullueshëm shkencor. Popujt e përparuar i mahniti dituria që e patën dhe superioriteti i arritur, andaj i kapërcyen kufijtë e çdo sendi dhe u bënë padrejtësi të tjerëve. Veshët e tyre u bënë të shurdhër për ta dëgjuar zërin e njerëzve të mirë që i këshillonin për të marrë rrugën e mbarë. A thua çfarë u ndodhi atyre?

All-llahu i Madhërishëm thotë: *"Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë, për të parë se si ka qenë fundi i atyre, që kanë jetuar më parë? Ata kanë qenë më të shumtë, më të fortë dhe kanë lënë më shumë gjurmë në Tokë, por nuk u ka bërë aspak dobi ajo që kishin fituar. Kur të dërguarit e tyre iu sollën prova të qarta, ata u mburrën me diturinë që zotëronin vetë, por shumë shpejt i goditi ajo, me të cilën talleshin. Dhe, kur panë dënimin Tonë, ata thanë: "Tani ne nuk besojmë në askënd tjetër veç All-llahut dhe i mohojmë idhujt që ia shoqëronim Atij (në adhurim)". Por besimi i tyre nuk u sollë kurrfarë dobie, kur panë dënimin Tonë. I tillë është ligji i All-llahut, që ka vepruar gjithmonë midis robërve të Tij. Të humbur kanë qenë jobesimtarët."*<sup>172</sup>

Civilizimi aktual ka shënuar përparim të jashtëzakonshëm në të gjitha fushat e shkencave. Fitimet e tij materiale në tokë, det dhe qiell, pa dyshim se janë dy-

<sup>172</sup> El-Gafir, 82-85

fishuar, por gjithashtu s'ka dyshim se ai ka mbetur me lidhje të dobët me All-llahun, i papërgatitur për takimin me Të, andaj siç duket, mosinteresimi i tij për fenë është për shkak të teologëve (hoxhallarëve) të cilët nuk merituan të pasohen dhe nga shkakut se mendimi islam nuk posedon prezantues të besueshëm e as pasues të sinqertë!

Pikërisht për këtë civilizimi perëndimor u nis i vetëm për t'iu përkushtuar racave të cilat i kishte me vete, ta nxiste mendjemadhësinë, guximin dhe kapardisjen e tyre në Tokë.

Unë i kam shqyrtuar me vëmendje të plotë sëmundjet (anomalitë) që u përhapën ndër ata që jetuan më parë dhe që i bënë të shkatërrohen. Kujtoj se po ato sëmundje (anomali) janë të përhapura në mesin e civilizimit aktual dhe të shtrira në normat e ndryshme ligjore, qofshin ato kapitaliste ose socialiste.

Populli Ad, njerëz që ishin trupmëdhenj, thoshin: "Kush është më i fuqishëm se ne?" Fuqia e tyre u manifestua në ndërtimin e godinave të larta, pallateve gjigante e të larta, si dhe të përsosura me artin dhe zbukurimin e tyre!

Më herët thamë se All-llahu i Madhërishëm ua nënshtroi besimtarëve Tokën dhe gjithçka që është në të, andaj nuk ka asgjë të keqe që ata të ndërtojnë në të çfarë të duan, pra të ndërtojnë edhe pallate e godina të larta sa të duan. Me rëndësi është që ata t'i ndërtojnë me devotshmërinë e All-llahut, të mos jenë këto pallate e godina të larta shfryrje e ndjenjave të kryelartësisë dhe shastisjes, vetëm adhurim i jetës së kësaj bote.

Është e vërtetë se shumë prej atyre që sot ndërtojnë godina e pallate të larta pasurinë e kanë të grumbulluar nga plaçkitja e mundit të punëtorëve të mjerë, nga tregtia me lëndë narkotike (drogës) dhe nga tregtia me njerëz! Kolonializmi botëror ka arritur të ndërtojë qytete të mëdha me djersën e zezakëve dhe pasuritë e plaçkitura nga banorët e Afrikës dhe Azisë. Pastaj, këto qytete u mbushën me njerëz që nuk e njohin Zotin dhe të drejtat që i kanë ndaj Tij, madje as që e përmendin Atë për të mirë! Vallë, çfarë thua kur i shikon të gjitha këto godina dhe pallate të bukura? A nuk i kujton fjalët e Kur'anit famëlartë për popullin Ad: *"A mos vallë në çdo kodrinë po ngrini përmendore, për t'u tallur, dhe ngrini pallate, sikur do të jeni përgjithmonë? Edhe kur të përdorni forcën, e shfrytëzoni atë si tiranë!"*<sup>173</sup>

Sëmundjet e njerëzve janë të ngjashme mes vete, kurse ilaçi i tyre është një. Përshkrimi i këtij ilaçi të vjetër vihet në spikamë në këshillimin e të Dërguarit Hud drejtuar popullit të tij. I Dërguari Hud nuk i detyroi ata të heqin dorë nga begatitë që i gëzonin dhe me të cilat dëfreheshin. Assesi! Ai gëzohej që populli i tij i gëzonte këto të mira, vendbanimet e bukura dhe kopshtet e lulëzuara. Por, ai kërkonte prej tyre që këtyre të mirave t'ua bashkëngjisin vetëm një gjë: *"Andaj, frikësojuni All-llahut dhe bindmuni mua! Frikësojuni Atij, i Cili ju ka dhuruar ato që i dini; ju dhuroi juve bagëti dhe fëmijë, edhe kopshte, edhe burime. Unë, me të vërtetë, i trembem për ju dënimit të një Dite të madhe."*<sup>174</sup>

<sup>173</sup> Esh-Shuara', 128-130

<sup>174</sup> Esh-Shuara', 131-135

A tyre që pendohen All-llahu i Madhërishëm u premtoi jetë të lumtur, e jo jetë të privuar nga të mirat e as varfëri. Ai thotë: *"Sikur banorët e qyteteve të besonin dhe të ruheshin prej gjynaheve, Ne do t'u dërgonim bekime nga qielli dhe toka...."*<sup>175</sup>

All-llahu i Madhërishëm bëri që populli Ad ta zëvendësonte në Tokë popullin e Nuhut alejhis-selam, të cilin All-llahu e shkatërroi me vërshimin e madh (tufanin). Populli Ad u tregua i padëgjueshëm. Sa të ligë që u bënë! Është me rëndësi të përmendim se populli i Hudit alejhis-selam banonte në jug të Gadishullit Arab, ndërsa populli i Nuhut alejhis-selam banonte në veri të Gadishullit, në brigjet e Eufratit, andaj pyesim se si u bë që të përcillen farat e së keqes nga lart poshtë? Si u bë që këto veçori të kalojnë në vende të tjera, qofshin ato afër apo larg?! All-llahu i Madhërishëm thotë: *"Kështu, sa herë që një i dërguar vinte te popujt para tyre (mekasve) ata thoshin: "Është magjistari" ose "Është i çmendur!" Vallë, a mos ia kanë pasuar këtë njëri-tjetrit? Jo, por ata vetë janë popull që e kanë tepruar. Prandaj shumangu prej atyre; ti nuk do të qortohesh për këtë."*<sup>176</sup>

Ne vërejmë se popujt e humbur nuk i hulumtojnë çështjet hyjnore, çështjen e ringjalljes, të udhëzimit dhe të edukatës. Çështjet në fjalë nuk e meritojnë preokupimin dhe kujdesin e duhur të tyre. Siç duket, ata janë të preokupuar me gjëra të tjera, ndërsa bakteri i çrregullimit edhe më tej vazhdon të veprojë në kohën tonë.

Çfarë kërkoi Nuhu nga populli i tij, përveç që u tha: *"Vallë, a nuk i frikësoheni ju All-llahut? Në të vërtetë,*

<sup>175</sup> El-A'raf, 86

<sup>176</sup> Edh-Dharijat, 52-54



*unë jam një i dërguar i besuar për ju. Andaj, frikësojuni All-llahut dhe bindmuni mua!*<sup>177</sup>

Pastaj filloi t'ua përshkruante All-llahun, i Cili i fton në adhurimin e Tij: *"A nuk e shihni se si All-llahu i ka krijuar shtatë qiejt njëri mbi tjetrin, dhe në ta e ka bërë Hënë të dritë, kurse Diellin e ka bërë fener? All-llahu ju ka krijuar nga toka, ashtu si bimët, pastaj ju kthen tek ajo dhe prej saj sërish do t'ju nxjerrë."*<sup>178</sup>

Mirëpo, populli i Nuhut nuk mendoi për këtë Zot, për madhësinë dhe të drejtat e Tij! Ata menduan për vetveten, për pozitën e tyre, për pasurinë dhe famën. Ata menduan se thirrja e re do ta bënte Nuhun të parin e tyre, ndërsa pasuesit e tij do të ishin me vlerë më të lartë se këta!

I marri mendon se mençuria është sfidë për të, andaj e kundërshton çdo gjë nga frika se mos i lëkundet pozita!

Të shohim se çfarë i tha populli Nuhut alejhis-selam: *"Por, paria e popullit të tij, e cila nuk besoi, tha: "Ne shohim se ti je thjesht njeri si ne dhe, shohim, që ty të shkojnë pas vetëm më të pavlerët nga ne, pa menduar fare. Ne nuk shohim se ti ke diçka më të mirë se ne, madje ju quajmë gënjeshtarë."*<sup>179</sup>

Fjalët e tyre e nënkuptojnë mohimin e asaj me të cilën Nuhu dallohej nga të tjerët, zhvleftësimin e atyre që i besuan duke i llogaritur të pavlerë në shoqëri dhe njollosjen e besimit dhe sinqeritetit të tyre, se nuk janë

<sup>177</sup> Esh-Shuara', 106-108

<sup>178</sup> Nuh, 15-18

<sup>179</sup> Hud, 27

më tepër se rebelë dhe të padëgjueshëm, të tillë që duan ta ndryshojnë gjendjen në të cilën duhet të mbesin. Është interesant fakti se këto akuza përsëriten në çdo kohë dhe në çdo vend. Me këto akuza u ballafaqua edhe i Dërguari i fundit, Muhammedi s.a.v.s., ndërsa me të njëjtat vazhdojnë të ballafaqohen edhe thirrësit dhe reformatoret.

Njerëzit kanë prirje të çuditshme për të ashtuquajturin "sistemi i klasave", për zhvleftësimin e grupeve të njerëzve për shkak të ngjyrës ose të statusit social që e kanë (varfërisë)! Populli i Nuhut kërkoi që ky t'i dëbonte të pavlerët nga mesi i tij, sepse e kishin mëri të rrinin me ta. Mirëpo përgjigja e Nuhut alejhis-selam ishte: *"Unë nuk mund t'i dëboj ata që besojnë. Ata do të takohen me Zotin e tyre. Mirëpo, unë shoh se fatkeqësisht, ju jeni popull, që nuk dini. O populli im, kush do të më mbrojë nga All-llahu, nëse unë i dëboj (besimtarët)? A nuk doni të merrni këshillë?"*<sup>180</sup>

Kërkesa e tillë iu drejtua edhe të Dërguarit Muhammed, të zotit të Shpalljes së fundit, të cilit All-llahu i shpalli: *"Mos i dëbo ata që i lutën Zotit të vet në mëngjes e mbrëmje, duke e dëshiruar Fytyrën (mirësinë) e Tij!"*<sup>181</sup>

Klasifikimi i njerëzve është besëtytni që e shfaq veten te brahmanët,<sup>182</sup> të cilët disa njerëz i llogaritën të krijuar nga truri i zotit, e disa të tjerë nga këmba e tij! Këta të fundit janë të pavlerët!

Mos mendo se besëtytnia e tillë ka humbur. Ajo shfaqet në civilizimin modern, në shumë vendime

<sup>180</sup> Hud, 29-30

<sup>181</sup> El-En'am, 52

<sup>182</sup> Ihtarë të fesë brahmane.

politike, shoqërore dhe morale. Edhe pse dokumenti i të drejtave të njeriut e refuzoi atë, sjelljet e evropianëve dhe amerikanëve sikur e përmbajnë dhe e mbështesin atë.

E metë e Hitlerit ishte ajo që ai haptazi e favorizonte gjakun e racës ariane ndaj gjakut të racave të tjera, por është fakt se popujt perëndimorë e fshehin këtë doktrinë në vetvete, ndërsa herë pas here e shfaqin atë në sjellje dhe veprime.

Hebrenjtë pretendojnë se janë popull i zgjedhur, se vërtet All-llahu e ka krijuar gjithë këtë botë për hir të tyre dhe për hir të shërbimit të tyre! Hebrenjtë e shfrytëzuan këtë legjendë të tyre për të bërë zhurmë në botë. Është fakt se një legjendë e tillë bëri që arabët të mposhten në mënyrë të turpshme para hebrenjve, siç është fakt se legjenda e tillë i bëri hebrenjtë të vendosen mbi kurrizin e amerikanëve dhe të bëjnë çfarë të duan.

Është mrekulli që njeriu të lind madhështor për shkak se lëkura e tij është e bardhë, për shkak se babai i tij është i pasur ose nga shkaku se prejardhja e tij është e lashtë dhe fisnore.... madhështia e trashëguar e bën atë ta heqë nga vetja barrën e ngjitjes në shkallët e ngritjes shoqërore dhe i krijon atij një vetëbesim që nuk kundërshtohet!!

Populli i Nuhut ishte i pari që e shpiki këtë risi, e cila pas tyre u përhapë në popujt e tjerë: *"Sa e sa brezni Ne i kemi shkatërruar pas Nuhut! Mjafton që Zoti yt i di dhe i sheh gjynahet e robërve të Tij!"*<sup>183</sup>

<sup>183</sup> El-Isra', 17

Historia e shoqërisë njerëzore nuk shënon raporte të mira me Zotin. Nëse ndodhë që një fletë të jetë e bardhë me punë të mira, s'ka dyshim se shumë fletë të tjera janë të zeza e me punë të fëlliqura.

Bijtë e Ademit janë bërë të duken si të pavlerë, ata nxitojnë pas punëve të këqija më shumë se që nxitojnë pas punëve të mira. Te ata thirrjet e epshit i kanë mbizotëruar thirrjet e mendjes, por edhe dashuria e jetës së kësaj bote e ka mbizotëruar dashurinë e jetës së botës së ardhme.

Mirëpo kaderi i All-llahut është gjithmonë i zgjuar dhe asnjëherë nuk hesht. All-llahu i Madhërishtëm na rrëfen për atë se çfarë u ndodhi keqbërësve që e merituan ndëshkimin e Tij. Rrëfimet kur'anore sjellin hollësi të asaj që i goditi të padëgjueshmët ndaj All-llahut dhe kundërshtarët e të dërguarve të Tij: *"Ne të gjithë i dënuam për gjynahun e vet; disave u dërguam furtunë, disa syresh i goditi një zë i tmerrshëm, disa prej tyre i gëlltiti toka dhe të tjerët i përmbyti uji. All-llahu nuk u bëri atyre padrejtësi, por ata i bënë padrejtësi vetvetes."*<sup>184</sup>

S'ka dyshim se gabimet e të parëve po përsëriten edhe në civilizimin që sot dominon në botë dhe që është duke i imponuar metodat e tij në jetë!

Fëlliqësira e dëfrimit, padrejtësisë, mohimit dhe e egoizmit e kanë përfshirë botën e parë, ndërsa fëlliqësira e faraonizmit, përuļjes, poshtërimin dhe shpërfilljes kulturore dhe shpirtërore e ka përfshirë botën e tretë.

<sup>184</sup> El-Ankebut, 40

Banorët e Sodomës u shkatërruan nga një ciklon, fisi Themud u godit nga një zë i tmerrshëm, Karuni u gëlltiti nga toka, ndërsa populli i Nuhut dhe njerëzit e Faraonit u mbytën në ujë.

Shkujdesi ndaj All-llahut i ka përfshirë të gjithë, siç i ka përfshirë të gjithë dëshira për jetë të përhershme në këtë botë dhe dëfrim të përjetshëm me të mirat e saj. S'ka dyshim se për fenë e Zotit shumë pak interesohen, madje edhe nëse interesohen shumë të tjerë, interesimi i tyre do ta prek të jashtmen, e assesi thelbin.

Fjalët që i pashkolluari Rebi' ibën Amir ia kishte thënë komandantit të ushtrisë persiane atë kohë: "Kemi ardhur që t'i nxjerrim njerëzit nga adhurimi i robërve në adhurimin e All-llahut, nga ngushtësia e kësaj bote në gjerësinë e saj dhe nga padrejtësia e feve në drejtësinë e Islamit" – janë fjalë të shkurtra që e nënkuptojnë thelbin e dokumenteve të të drejtave të njeriut dhe të drejtave të popujve që sot nuk mund t'i thonë qartë as politikanët më të mëdhenj në botë. Këto fjalë të ndritshme e të shtrenjta, që i shqiptoi goja e një njeriu të pashkolluar, janë fjalë që nuk mund t'i kuptojnë dhe t'i deklarojnë njerëzit profesional të fesë, siç nuk mund të ngrihen në nivelin e tyre pushtetarët që hanë popullin e tyre, biografia e të cilëve – ekonomike dhe politike – është konkretizim i karakteristikave pagane të politikës e cila e largoi botën e përparuar nga përmbushja e detyrave që i kishte ndaj popullit.

Vendet e botës së parë dëshmuan se feja në këto vende është futur në pajtim me epshet që i kanë ato, bile ajo është mposhtur (dorëzuar) para ashpërsisë së tyre dhe i ka larguar pengesat nga rruga.

Nuk mund të mos habitem me qëndrimin e kishës evangjeliste në Angli e cila pajtohet me lejimin e homoseksualizmit me kushte, siç nuk mund të mos habitem edhe me konfirmimin e saj të ligjeve të cilat

kanë dalë nga Kuvendi i Përgjithshëm dhe ai i Lordëve! Habitem meqë këta njerëz e dinë shumë mirë se All-llahu i Madhërishëm e shkatërroi popullin e Lutit dhe qytetërimin e tyre duke e kthyer vendin e tyre përmbys dhe duke lëshuar mbi ata shi gurësh prej dheut të pjekur pikërisht për shkak të homoseksualizmit të cilin e bënin.

Habia ime do të bëhet edhe më e madhe kur dëgjova se Papa i Vatikanit ishte nisur për në Afrikë, që ta sulmojë martesën me më shumë se një grua, që Islami e lejon, ndonëse ai e di se vajzat në Perëndim e humbin virgjërinë qysh në moshë të re para se ta arrijnë moshën e martesës. Kjo gjë nuk e brengos Papën, sepse ai më shumë lodhet me përparimin e Islamit në Afrikë! Prandaj, doemos duhet të krijohen metoda për ta penguar atë!

S'ka dyshim se myslimanët janë përgjegjës për vazhdimin e këtij çrregullimi (fesadi) që vazhdon të mbetet në tokën e tyre! Është e vërtetë se myslimanët besojnë që zinaja (kurvëria) është e ndaluar, është kjo gjë e mirë, por këta e kanë vështirësuar çështjen e martesës duke caktuar për të harxhime marramendëse! Por, jo vetëm kaq, burgosja e gruas brenda katër mureve të shtëpisë dhe largimi i saj nga pjesëmarrja në jetën publike ku do të kontribuonte, u bë bazë e etikës së përgjithshme të ata! Islami ka sistem të shëndoshë shoqëror dhe natyror (shpirtëror), ndërsa mësimet islame janë të lehta dhe praktike. Është absurde që Islamit ta kuptojnë dhe ta praktikojnë ata që luftojnë për të vërtetuar se fytyra dhe zëri i gruas janë auret (pjesë e turpshme), se mosshkollimi i saj është rit islam.

### *Kuptimi i fesë*

A thua ç'kuptim ka feja në jetën e njeriut? S'ka dyshim se feja mbështetet në dy të vërteta kryesore:

E para: Njohjen e All-llahut dhe besimin se fillimi dhe mbarimi i jetës sonë dhe i çdo krijese është në duart e All-llahut (tek Ai do të kthehen të gjitha).

E dyta: Ndjekja e udhëzimit të Tij, nënshtrimi i plotë ndaj urdhrave dhe ndalesave të Tij dhe kapja fort për besën e dhënë All-llahut, se do t'i dëgjojmë dhe respektojmë gjërat e shpallura nga Ai.

Ky është kuptimi i Islamit. Është kjo feja e All-llahut, që nga fillimi e deri në mbarim, është feja të cilën e predikuan të gjithë të dërguarit dhe me të i udhëhoqën popujt në jetë. Islami ishte feja e Ademit, qysh ditën që All-llahu e krijoi, e urdhëroi dhe e ndaloi. E kur ai i shpërfilli ato, u ndëshkua! Islami ishte feja e Nuhut ditën që e thirri popullin e tij ta besonte All-llahun Një dhe të Vetëm, të kërkonte falje (istigfar), të krijonte raporte vëllazërie mes vete dhe të pajisej me vlera të larta morale: *"Kërkoni falje nga Zoti juaj, i Cili është Falës i madh, që Ai t'ju dërgojë shi të bollshëm, t'ju shtojë pasurinë dhe fëmijët tuaj dhe të bëjë për ju kopshte e lumenj!"*<sup>185</sup> E kur atyre iu bë e rëndë prania e tij midis tyre dhe ia kthyen shpinën, ai u tha: *"Por, nëse ktheni shpinën, unë prej jush nuk kërkoj kurrfarë shpërblimi. Shpërblimi im është vetëm tek All-llahu. Mua më është urdhëruar të jem në anën e myslimanëve."*<sup>186</sup>

<sup>185</sup> Nuh, 10-12

<sup>186</sup> Junus, 72

Islami ishte feja e Ibrahimit, ditën që i shpalli luftë idhujtarisë dhe atyre që ishin të ashpër, ditën që për hir të All-llahut hoqi dorë nga vetvetja dhe djali i tij: *"Kur Zoti i tij i tha: "Përrulul!" – ai u përgjigj: "Iu përula Zotit të gjithësisë".*<sup>187</sup>

Islami ishte feja e Jakubit – që sot shteti izraelit pretendon se i takon atij – një pretendim që pa dyshim është i trilluar – ditën që u tha bijve të tij: "O bijtë e mi! Pa dyshim, All-llahu ka zgjedhur për ju fenë e vërtetë, prandaj mos vdisni ndryshe veçse duke qenë myslimanë të nënshtruar ndaj Atij."<sup>188</sup>

Jusufi i drejtë dhe besnik krenohej me përkatësinë islame dhe vendosjen nën flamurin e tij ditën që po i lutej Zotit të tij: *"O Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, Ti je Mbrojtësi im edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër! Bëj që të vdes si mysliman dhe më shoqëro me punëmirët (në botën tjetër)."*<sup>189</sup>

Sulejmani, i Dërguar dhe mbret në Tokë, ftonte në rrugë të All-llahut dhe e shpjegonte fenë e tij ditën që po i shkruante Mbretëreshës së Shebës: *"Ajo është nga Sulejmani dhe është: "Me emrin e All-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit" mos u madhështoni para meje dhe e jani të përrulur si besimtarë!"*<sup>190</sup>

Edhe Musai e ftonte popullin e tij t'i përmbahej fesë së vërtetë, i nxiste në luftë kundër shtypjes së Faraonit dhe mundimeve që i duronin, i ftonte të qëndronin besnik në besimin e All-llahut, Një dhe të Vetëm: *"O Populli im! Nëse besoni All-llahun, mbështetuni tek Ai, nëse jeni myslimanë!"*<sup>191</sup>

<sup>187</sup> El-Bekare, 131

<sup>188</sup> El-Bekare, 132

<sup>189</sup> Jusuf, 101

<sup>190</sup> En-Neml, 3031

<sup>191</sup> Junus, 84



Edhe Isai ftonte në Islam ditën që kërkoi nga havarijunët (nxënësit e tij) të mblihdeshin përreth tij dhe flamurit që ky e kishte në dorë për t'i bërë ballë kështu armiqësisë së hebrenjve: *"Kur Isai vuri re mosbesimin e tyre, tha: "Kush janë ndihmuesit e mi në rrugën e All-llahut?" Nxënësit (e tij) u përgjigjën: "Ne jemi ndihmuesit e (fesë së) All-llahut. Ne e besojmë All-llahun e ti (Isa) dëshmo se ne (i) jemi nënshtruar (Atij). Zoti ynë! Ne besojmë atë që na ke shpallur dhe pasojmë të Dërguarin (Isain). Na shkruaj pra, bashkë me dëshmitarët!"<sup>192</sup>*

Pastaj erdhi Muhammedi, i Dërguari më i madh dhe i fundit, me qëllim që ta largonte pluhurin nga besimi të cilit iu ishte bërë e padrejtë, t'i largonte nga ai dyshimet e ithtarëve të Librit (të krishterëve dhe hebrenjve), t'i largonte trillimet e tyre për trupëzimin dhe besimin në shumë zota dhe t'i vinte në spikamë lavditë hyjnore dhe t'i shfaqte ato me një veshje që, nga madhështia dhe bukuria, asnjëherë nuk vjetrohet e kështu t'u thotë njerëzve: *"All-llahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirrni Atë (lutjuni Atij) me to dhe largohuni nga ata që i shtrembërojnë emrat e Tij. Ata do të ndëshkohen për çfarë kanë vepruar."<sup>193</sup>*

Ky i Dërguar filloi ta ndërtonte Umetin, i cili do ta përcjellë misionin e tij te të gjithë njerëzit duke ndjekur jetën e tij, ibadetin e tij të ndritshëm e të bukur, luftën e tij të palodhshme dhe moralin e tij të përkryer. Ishte ky i dërguari që me zë të lartë u thotë njerëzve: *"Në të vërtetë, namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm All-llahut, Zotit të botëve. Ai*

<sup>192</sup> Ali-Imran, 52-53

<sup>193</sup> El-A'raf, 180

*nuk ka asnjë ortak. Kështu jam urdhëruar dhe unë jam i pari që i nënshtrohem Atij.*"<sup>194</sup>

Njerëzimi e arriti kulmin e përsosmërisë së tij në personalitetin e Muhammedit s.a.v.s., në metodat me të cilat ai e ndërtoi Umetin, në elementet që e garantojnë përjetshmërinë e misionit të fundit të shpallur nga All-llahu, se ky mision asnjëherë nuk do të vjetrohët sa të ketë ditë dhe natë.

Islami është feja e All-llahut. Asgjë tjetër, përveç Islamit. Nuk është e njohur që ndonjë i Dërguar të ftonte në fe tjetër, përveç Islamit!

Asnjëherë nuk ka ndodhur që Shpallja të thotë: *"Zoti ka fëmijë, se ky fëmijë do ta sakrifikojë jetën dhe me gjakun e tij do t'i shpagojë gabimet e njerëzve! Ndërkaq, ajo që iu shpall të Dërguarit të cilit i përkasin të gjithë ithtarët e Librit, është krejt tjetër: "Vallë, a nuk ka dëgjuar ai për atë që thuhet në Shkrimet e Musait dhe të Ibrahimit – i cili i plotësoi detyrimet: se askush nuk do t'i mbartë gjynahet e tjetrit dhe se njeriu do të ketë vetëm atë për të cilën ka punuar; dhe se përpjekjet e tij do të shihen dhe se do të shpërblehet me shpërblim të plotë!"*<sup>195</sup>

Tevrati i Musait e pohon atë që e përmendëm për të vërtetën e Islamit dhe natyrën e tij: *"Ne e kemi shpallur Tevratin, në të cilin janë udhëzimet dhe drita. Sipas tij, profetët që ia kishin dorëzuar veten All-llahut, i gjykonin hebrejtë; por edhe të diturit dhe rabinët kështu vepronin, sepse atyre iu qe besuar mbrojtja e Librit të All-llahut, për të cilin ata dëshmonin....."*<sup>196</sup>

<sup>194</sup> El-En'am, 161-162

<sup>195</sup> En-Nexhûn, 36-41

<sup>196</sup> El-Maide, 44

Isai është vetëm i Dërguar i All-llahut, i cili nga vëllezërit e tij të dërguar dallohet me durimin e gjatë dhe luftën e hidhur, gjë që e bën atë të jetë njëri nga të dërguarit e vendosur fort (ulu-l-azm).

Bota sot është duke parë skenën nga e cila rrëqethet lëkura; myslimanët çdo ditë janë të rrethuar me disfata të turpshme, ndërsa hebrenjtë, të stolitur me kryelartësi të paparë dhe pasuri, arrijnë të ngadhënjëjnë, kuptohet të ndihmuar dhe të mbështetur nga krisherizmi botëror që dominon në Lindje dhe Perëndim.

Vallë, a mendon se e vërteta do të humbet në këtë luftë të pakuptimë e të verbër? A do të bie përtokë flamuri i teuhidit? A do të shndërrohet Mesxhidu Aksaja në tempull ku do të banojë "Zoti i Izraelit" për ta sunduar botën dhe i ndihmuar me bijtë e popullit të zgjedhur, siç supozojnë ata?

S'ka dyshim se edhe të parët tanë kaluan nëpër këto sprova dhe fatkeqësi dhe pas tyre dolën më të fortë dhe më të pasur, por vetëm pasi e rregulluan çështjen e tyre personale dhe krijuan raporte të drejta me All-llahun! A thua ne do të marrim mësim prej tyre e ta ndjekim rrugën e tyre?

E vërteta asnjëherë nuk zhvleftësohet për shkak të disa ditëve të thata që kalojnë pranë saj. Thelbi i saj asnjëherë nuk humbet për shkak të disa sëmundjeve të përkohshme që i kaplojnë pasuesit e saj.

E pavërteta nuk e humb të vërtetën për shkak se një ditë koha i erdhi në ndihmë, i dha fuqi dhe e ndihmoi ta ndërtonte shtetin e saj! Asnjëherë nuk ka ndodhur që krimet e Faraonit të shndërrohen në vlera, se një ditë ai arriti ta vendoste pushtetin në tokë, të ur-

dhëronte dhe ndalonte, t'i vriste fëmijët meshkuj, ndërsa femrat t'i linte gjallë.

Ne i vlerësojmë masat e gjera të popullit dhe udhëheqësit me të vërtetën dhe të pavërtetën, pra sa janë ata afër njëres dhe sa janë larg tjetrës.

Lidhja e ithtarëve të Librit me të dërguarit e tyre u tregua e dobët, ndërsa Shpallja që e kishin ata pranë, nuk u bëri dobi, qoftë në sjellje ose në marrëdhëniet e tyre me të tjerët. Pikërisht për këtë, pyesim: nëse hebrenjtë nuk i zbatojnë mësimet e Teuratit të Musait, ndërkohë që edhe të krishterët nuk janë duke i zbatuar mësimet e Ungjillit të Isait, atëherë cilat mësimet janë duke i zbatuar? Në çka ftojnë ata? Pikërisht për këtë Kur'ani famëlartë thotë: *"Thuaj (o Muhammed): "O ithtarët e Librit! Nuk do të keni asgjë në vijë, derisa t'i përmbaheni Teuratit e Ungjillit dhe asaj që ju është shpallur nga Zoti juaj (Kur'ani)."*<sup>197</sup>

Myslimanët i respektojnë mësimet e ithtarëve të Librit dhe u treguan të kujdesshëm në krijimin e raporteve të mirëfillta me ta, por pushtetarët, politikanët, priftërinjtë dhe epshorët, ishin ata që e kundërshtuan Islamin, e penguan rrugën e tij dhe në zemrat e tyre e fshehën urrejtjen ndaj pasuesve të tij. Një gjë e tillë ndodhi më herët dhe për fat të keq është duke ndodhur edhe tani në forma të poshtra dhe të shëmtuara.

Kur'ani famëlartë shumë herë e përsërit tërheqjen e vërejtjes nga këto ndjenja të shëmtuara. All-llahu i Madhërishëm thotë: *"Shumë nga ithtarët e Librit, prej zilisë që kanë në vete, dëshirojnë që t'ju kthejnë nga besimi në mosbesim...."*<sup>198</sup>

<sup>197</sup> El-Maide, 68

<sup>198</sup> El-Bekare, 109

*"A nuk i sheh ti (o Muhammed) ata që iu është dhënë një pjesë prej Librit? Ata e ndërrojnë të mirën me të keqen dhe dëshirojnë që edhe ju të humbisni rrugën e drejtë." <sup>199</sup>*

*".....me siguri që shumicës prej tyre do t'ua shtojë mosbindjen dhe mohimin." <sup>200</sup>*

*"O besimtarë! Nëse i bindeni një grupi nga ata që u është dhënë Libri, ata do t'ju kthejnë në jobesimtarë, pasi patët besuar." <sup>201</sup>*

Unë me vëmendje të plotë e kam analizuar politikën botërore që zhvillohet kundër Islamit dhe kam vërejtur se udhëheqësit e saj – që sot janë të njohur – janë të kujdesshëm ndaj disa gjërave: refuzimi i përkatësisë islame – nga vetë popujt që deklarohen se janë myslimanë – dhe avancimi i përkatësisë shekullariste (laïke); mospranimi i dispozitave të qiellit dhe mbizotërimi i ligjit njerëzor; shtrembërimi i gjërave derisa muslimanët të mposhten në çdo sferë.

Çfarë mund të ndodhë me një popull që i tërhiqet vëmendja nga përkatësia fetare, gjykimi sipas dispozitave të qiellit dhe kujdesit ndaj riteve fetare?! S'ka dyshim se një ose dy breza do të vazhdojnë t'u mbesin

All-llahu i Lartmadhëruar u tërheq vëmendjen myslimanëve të jenë vigjilentë në lidhje me armiqësinë që pjesëtarë të traditave të mëparshme fetare do ta kenë kundër atyre që do t'i ndjekin mësimet e Muhammedit (s.a.v.s.). Duhet të jetë e qartë se kjo nuk është një armiqësi që vjen thjesht për arsye shpirtërore, por vetëm për arsye të pushtetit. Islami, me rreptësinë e tij morale e tradicionalisht të konsoliduar, imponohet edhe sot si e vetmja shpresë për çlirim të njeriut nga të gjitha format e sundimit njerëzor. Kur pranohet të qenit rob i All-llahut, atëherë nuk mund të jesh më skllav i njeriut, i ideologjive, i pasurisë, i pasioneve dhe i iluzioneve të tij.

<sup>199</sup> En-Nisa', 44

<sup>200</sup> El-Maide, 64

<sup>201</sup> Ali-Imran, 100

besnik parimeve të tyre, por që shumë shpejt do të ndodhë që brezat e tjerë të humben dhe të vendosen në grupin e të hutuarve, ndërsa bashkimin e tyre ta shndërronë në grupe të cilat më pas do t'i gjuajnë një nga një.

Është për t'u habitur nga qëndrimi i ithtarëve të Librit, të cilët me zemërgjerësi dhe me shpirtbujari i mirëpresin idhujtarët! Vallë, a thua çfarë besimi është ky?

Dijetarët shumë të nderuar pohojnë se rrëfimet kur'anore, para se ta nënkuptojnë historikun e personave dhe ndodhive, janë shfaqje e doktrinave, vlerave morale, riteve adhuruese dhe politikave udhëheqëse.

Rrëfimi, si element edukativ dhe shenjë orientuese, e përsëritur apo e papërsëritur, që pa dyshim se është e shoqëruar me një urtësi të madhe, në vete përmban urtësi të mëdha të cilat dinë të shfaqen gjatë një komentit tematik të Kur'anit familartë.

Kujtoj se është e udhës që shqyrtimin tonë ta përmbyllim me atë që All-llahu i Madhërishëm e përshkruan në Librin e Tij se është "i qartë", por që me të e përshkruan edhe detyrën e të dërguarve dhe thotë: *"Nëse ju nuk më besoni, dijeni se edhe popujt e mëparshëm i kanë quajtur gënjeshtarë (të dërguarit) dhe se i Dërguari ka për detyrë vetëm që të shpallë (kumtoj) qartazi."*<sup>202</sup>

Qartësia e Librit nuk lë vend për arsyetim tjetër dhe e shpalos çdo dyshim. Vallë, a thua Umeti ynë i ka përmbushë detyrimet e këtij kumtimi të qartë? A thua Umeti ynë ka arritur që të tjerëve t'ua kumtojë Shpalljen e cila në vete e përmban të vërtetën dhe mëshirën?

<sup>202</sup> El-Ankebut, 18

Umeti ynë – që për fat të keq jemi të detyruar ta themi – nuk e përmbushi detyrën që e kishte ndaj Shpalljes së qartë: kumtimin e saj në mënyrë të duhur. Ai as që e kumtoi atë! Më duket se edhe për këtë Umet vlen të kallëzohet rrëfimi që u tregua për popujt e mëparshëm!

Në vijim do ta shqyrtojmë qëndrimin e myslimanëve ndaj misionit të tyre, me shpresë që ky përshkrim të jetë mësim për brezat e ardhshëm – të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi.

### *Qëndrimi i myslimanëve ndaj misionit të tyre*

Siç dihet, historia është kujtesa e një populli, magazina e përvojave dhe njohurive të tij, ajo është mendja e tij, e dukshme dhe e padukshme! Është thesari i vlerave të tij dhe thesari i veprave të lavdishme, si dhe bazë e personalitetit (identitetit) të tij.

Kur njerëzit thonë: filani e ka humbur kujtesën (memorien), mësojmë se ai është afër pragut të çmendurisë. Trullosja për gjërat që kanë qenë e nënkuptojnë paaftësinë e tij për t'u ballafaquar me gjërat që do të vijnë.

Dhe, kur njerëzit thonë: filani nuk ka shtrat të përgatitur për të ndërtuar, as tradita me të cilat do të ringjallet dhe do ta nisë rrugën e përparimit dhe zhbi-limit, madje as thesar kulturor nga i cili do të furnizohet, atëherë mësojmë se ai është kopil, ai e improvizon biografinë dhe sjelljen e tij pa ndonjë bazë dhe kriter.

Poeti i madh Shevki thotë: “Një popull që e harron historinë e tij është sikur endacaku që rri i brengosur në lagje dhe nuk e di prejardhjen e tij, andaj vetëm llototit fjalë të pakuptimta për ta treguar atë.”

Ne myslimanët jemi bijtë e një historie të gjerë e të gjatë, që fillon me misionin tonë, ose me ardhjen e të Dërguarit më të madh, Muhammedit s.a.v.s.! Është ky i Dërguar, i cili e bëri të qartë se Islami është misioni i të gjithë të dërguarve, edhe pse shumë njerëz nuk iu bindën këtij të Dërguari dhe devijuan, edhe pse në tokë u formuan shtete të frikshme që i adhuronin besëtytnitë dhe pushtetin dhe i zhvleftësonin veçoritë e larta njerëzore duke qëndruar para një idhulli të ndërtuar nga guri ose para ndonjë idhulli të gjallë (njeri) me emrin Faraon, Mbret ose me emra të tjerë mashtrues.

Muhammedi, i Dërguari i All-llahut, që u rrit jetim, është njeriu i vetëm i cili e rrëmbeu dhe e hoqi mbulesën e të pavërtetës, është i vetmi që i orientoi njerëzit drejt njohjes së All-llahut Një dhe që e shpëtoi njerëzimin nga tirania dhe çnderimi i fuqive të këqija.

Dimensionet e thella të jetës së Muhammedit s.a.v.s. mbeten ende të pazbuluara, ndërsa Umeti i tij ka një histori të pasur e të çuditshme, andaj nuk e di se pse është trajtuar nga ky Umet në këtë mënyrë? Kujtoj se historia e Umetit islam është e panjohur dhe me plot fshehtësi thesaresh. Unë nuk mendoj se ka ndonjë popull që është i nevojshëm për ta mësuar historinë e tij, siç është Umeti ynë islam!!

Në faqet që vijojnë do të përpiqem të sjellim një vështrim të shpejtë të historisë së këtij Umeti, nga fillimi e deri më sot. Janë fjalët e All-llahut të Madhëri-



shëm ato që na shtyjnë ta sjellim këtë shqyrtim: "A nuk është e qartë për ata që trashëguan tokën e banorëve të mëparshëm të saj, se, nëse ne dëshirojmë, i dënojmë për gjynahet e tyre dhe ua vulosim zemrat, që të mos dëgjojnë?!"<sup>203</sup>; "A nuk e kanë të qartë ata, se sa popuj i kemi shkatërruar ne para tyre; nëpër vendbanimet e të cilëve ecin? Me të vërtetë, në këto ka shenja paralajmëruese, por ata nuk po vënë vesh."<sup>204</sup>

Ajo që ndodhi dhe nuk vlen vetëm për ata! Prandaj medoemos do t'i vëmë vesh asaj që ndodhi, të marrim mësim dhe të kemi dobi, të gjykojmë dhe të krahasojmë, se në të kundërtën do ta paguajmë çmimin e shpërfilljes sonë me gjakun tonë dhe sigurinë tonë.

Kur'ani famëlartë e bën të qartë se ka mendje që formohet nga përvoja, nga ecja nëpër tokë dhe nga udhëtimi nëpër të kaluarën! Ai gjithashtu e bën të qartë se njeriu, dituria e të cilit krijohet nga leximet e shpejta dhe shqyrtimet teorike, është më i dobët se njeriu i cili në këtë botë ka përpjekje dhe përvoja me njerëzit.

Kur'ani famëlartë flet për mendjen që lind nga studimi i përhershëm dhe përpjekjet e palodhshme, prandaj edhe thotë: "Vallë, a nuk kanë udhëtuar ata nëpër botë, që zemrat e tyre të mendojnë dhe veshët të dëgjojnë? Në të vërtetë, atyre nuk u janë verbëruar sytë (në këto gjëra), por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor."<sup>205</sup>

Kur'ani famëlartë ua tërheq vërejtjen atyre që kalojnë pranë gjurmëve të atyre që jetuan më parë dhe u shkatërruan për shkak të gjynaheve që i bënë dhe

<sup>203</sup> El-A'raf, 100

<sup>204</sup> Es-Sexhde, 26

<sup>205</sup> El-Haxhë, 46

thotë: *“Ata me kohë kanë kaluar pranë vendbanimit që e shkatërroi shiu i tmerrshëm, e vallë, a nuk e kanë parë atë? Jo, ata nuk prisnin të ringjallehin.”*<sup>206</sup>

Pikërisht për këtë themi se studimi i historisë është detyrim fetar. Kuptohet që studimi i tillë është edhe detyrim njerëzor, bile unë – pas një kontemplimi të thellë në historinë e myslimanëve – konsideroj se studimi i historisë është domosdoshmëri e ekzistimit dhe mur mbrojtës i jetës sonë dhe i misionit tonë, natyrisht nëse ne jemi të kujdesshëm që ta ruajmë jetën tonë dhe ta kumtojmë misionin tonë.

Edhe më tej më kujtohen masakrat e Antakisë dhe të Bejtu-l-Makdisit gjatë sulmit të parë të kryqëzatave nën udhëheqjen e kryqtarëve! Dhjetëra mijë njerëz të vrarë e të lënë nëpër rrugë!

Vallë, a ishin kryqtarët të denjë për ta merituar këtë fitore të pavlerë apo të aftë ta arrinin këtë sukses? Assesi! Assesi! Ishin rojet e myslimanëve ata që e kishin lëshuar vendin e tyre dhe ishin bërë shënjestër e goditjeve të panumërta të armikut!!

Historia thotë: “Kur ndodhi kjo fatkeqësi, asnjë vend islam, në Lindje e në Perëndim, nuk lëvizi fare. Myslimanët ishin në gjendje të tmerrshme; grindje e përçarje mes vete, kaos të vërtetë, të preokupuar e të zhytur në dëfrimet dhe kënaqësitë e kësaj bote. Sikur një ushtri e grave me fshesa në dorë të kishte lëvizur, me siguri se do t’i mposhtnin kryqtarët! Ata ishin të lodhur dhe binin përtokë (lexo: kryqtarët) nga uria që i kishte kapluar i hanin cofëtinat që i gjenin nëpër rrugë e s’ishin të aftë për asgjë me rëndësi...!

<sup>206</sup> El-Furkan, 40

Të mjerët myslimanë, lejuan të bëhen të hutuar e t'i gjej armiku në gaflet, të pandihmë, të rrethuar nga çdo anë me tradhti, të përçarë e të grindur mes vete, prandaj kryqtarët bënë çka nuk bënë me ta... Studimi i kësaj fatkeqësie meriton seancë akademike, seancë të juristëve, thirrje në çdo xhami që ta tërheqë vëmendjen e njerëzve, bisedë e secilit udhëtar...

Mirëpo myslimanët, pas kthimit të tokave të tyre që i kishin humbur, nuk e studiuuan historinë. Tërë atë që kishte ndodhur e konsideruan temë të thjeshtë, andaj nuk kaluan dy shekuj e gjysmë e Bagdadin e goditi ajo që e goditi – hilafeti abasid kishte filluar të rrënohet, e tërë bota digjej flakë, çdo send u gjet nën këmbët e Tatarëve!

All-llahu i Madhërishëm deshi që turqit të rimëkëmben dhe ta marrin në dorë hilafetin që tanimë ishte larg arabëve. Turqit arritën të përparojnë e të depërtojnë deri në Lindje të Evropës, në kohën kur në Spanjë flamuri islam rrëzohej përtokë. Karvanët e teuhidit dhe civilizimit islam, të nënçmuar e të pikëlluar, tërhiqeshin drejt brigjeve të detit nga ku tetë shekuj më parë ishte nisur Tarik ibn Zijadi.

Si u bë që këto ndodhi të tmerrshme të kalonin në heshtje? Cila është ajo logjikë e cila e pranon këtë heshtje? Pse nuk bënë zë njerëzit që ishin në xhami? Pse nuk u preokupuan ata me këto gjëra? Pse nuk bënë thirrje mendarët për studimin e tyre? Pse nuk ishin këto fatkeqësi e vuajtje gjërat më primare për studim?

Kujtoj se shkenca e historisë e cila ka arritur te ne është e mangët në distancë hapësinore, e shpërfillur

në citimin e ndodhive dhe lidhshmërinë mes shkaqeve dhe pasojave, andaj nuk zë vend të merituar në mesin e shkencave të tjera.

Për nga distanca hapësinore ne nuk dimë mjaft për vëllezërit tanë nga besimi në Lindje të Azisë, në Veri, në Jug dhe në mes, sikur islamit t'i përkasin vetëm arabët, persët dhe turqit.

Sa më vjen keq dhe sa i brengosur jam që sot e shoh Shqipërinë të cilën në heshtje është duke e ngrënë komunizmi, ndërkaq shumica e popullit të saj janë myslimanë! Askush nuk i përmendi e as çau kokë për ta, asnjëri nuk e studioi çështjen e tyre, asnjë ligjërues nuk foli për ta. Me siguri ishte i brengosur për atë se a duhet të ngrihen duart në namaz ose jo!!!

Çështja e Shqipërisë myslimane është vetëm një shembull i dhjetëra shteteve të tjera që sot shtrihen në Evropë dhe Azi, derisa thashë më vete: a mendojnë arabët se islami është vetëm i tyre? Se është çështje specifike që i karakterizon dhe i dallon nga të tjerët? Pra a është islami vetëm karakteristikë kombëtare?

S'ka dyshim se mungesa e vetëdijes së shëndoshë për mësimet islame dhe gjendja e misionit të tij bëri që Umeti islam ta pranojë rënien e Spanjës me disa vargje të poezisë që e bëjnë njeriun të qajë e që më vonë të gjithë të brengosurit heshtën dhe kështu çështja të mbarojë.

Ngjashëm ndodhi edhe me rënien e disa vendeve të pasura të Bashkimit Sovjetik (me popullatë myslimane). Carët ishin ata që vunë dorë mbi këto vende të bukura e plot pasuri, sikur asgjë të mos kishte ndodhur! Sikur në kulturën tonë nuk ka shkencë të histo-

risë që i regjistron fitoret dhe humbjet, që u rrëfen brezave të ardhshëm për atë që kishte ndodhur!

Kujtoj se është e domosdoshme që Umetit islam t'ia them të vërtetën duke ia kujtuar shpërfilljen ndaj një aspekti të rëndësishëm të kulturës sonë dhe të jem dëshmitar kundër këtij Umeti para All-llahut, sepse ky Umet e shpërfilli studimin e të kaluarës dhe nuk arriti të ballafaqohet me sukses me të tashmen!

Më kujtohet koha kur unë isha në shkollë fillore. Atëherë i kisha vetëm dymbëdhjetë vjet, ndërsa me shokët e mi e mësonim historinë e shtetit osman. Unë kujtoj se është i domosdoshëm mësimi i historisë së shtetit osman, siç kujtoj se është i domosdoshëm edhe studimi i historisë së indonezianëve në Jug të Azisë, i nigerianëve në Perëndim të Afrikës dhe studimi i gjithë tokave islame, si në shkollë të mesme ashtu edhe në universitete.

Unë jam i sigurt se 90% e të arsimuarve tanë nuk dinë për historinë e Islamit në Filipine dhe se si është larguar Islami tash nga ishujt Mindanao, Sulu etj. Ata nuk dinë se si është bërë që myslimanët e këtyre vendeve të jenë vetëm 20%, ndërkaq që më herët kanë qenë shumicë e tyre?!

Botën islame sot e ka përfshirë një paqartësi e madhe (ngatërrim, karakter enigmatik), kolonializmi modern arriti ta copëtojë atë në Afrikë dhe Azi e të krijojë shtete të vogla të udhëhequra me bindje fisnore dhe grupe fetare që ishin prodhim i misionit botëror të krishterë!!

Unë i thashë vetes sime: Unë jam egjiptian, ndërsa Islami është ai që më ka bërë të jem arab. Me Gadi-

shullin Arab nuk më lidhin lidhjet farefisnore dhe nuk çaj kokë që të jem pikërisht nga kurejshët, se ajo që më intereson është vetëm feja ime. Gjuha arabe ka përparësi për mua, sepse ajo është gjuha e Shpalljes.

Islami nuk është lidhje farefisnore: arabët, indianët dhe zezakët, të gjithë janë të barabartë. Është normale që atë ta udhëheqë arabishtja, dua të them arabishtja e gjuhës, e jo arabishtja e prindërve, sepse myslimani i huaj (që nuk është arab) mund të jetë më i lartë dhe më i çmuar tek All-llahu dhe njerëzit se disa arabë të lashtë të cilët nuk i sollën gjë Islamit dhe nuk e shtrinë dorën e ndihmës dhe të fitores.

Më duket se jam i detyruar që në këtë kontekst të bëj një sqarim për përkatësinë time të fesë sime, të interesimit tim për historinë e tij, që të mos mendoj dikush se unë jam njeri fanatik, që di diçka dhe e tepron në atë, që i shtyn të tjerët të mendojnë si ai, ndërsa shumëçka tjetër nuk di.

Në faqet që vijojnë do të kritikoj shumë udhëheqës të mëparshëm myslimanë, sidomos do ta them mendimin tim për sjelljet e tyre të atëhershme dhe këtë do ta bëj duke u mbështetur vetëm në burimet e mbrojtura islame.

Qëllimi im është të mos lejoj që Islami t'i bart barrët e disave që flasin në emër të tij, ose të disa udhëheqësve tiranë që e kanë marrë në dorë drejtimin e tij..... Islami nuk merret me gjendjen e pasuesve të tij, përveç të atyre që ishin të njohur me udhëheqjen korrekte e të drejtë (katër halifët e drejtë – hulefai rashidun).

### *Përmasat shpirtërore dhe shoqërore të Islamit*

Tashmë është e domosdoshme njohja e përmasave shpirtërore dhe shoqërore të Islamit. Islami përbëhet nga shtatëdhjetë e më shumë degë, të cilat në vete ngërthejnë tokën dhe qiellin, ato e përkufizojnë raportin e njeriut me Zotin e tij, me vetveten, familjen dhe shoqërinë, ato flasin për doktrinat e besimit, vlerat morale, marrëdhëniet ndërnjerëzore, si dhe dispozitat me të cilat detyrohet dhe ritet të cilat duhet t'i kryejë secili mysliman.

Islami nuk është program i një partie politike që e merr pushtetin në dorë, e pastaj dështon ose edhe ka sukses! Islami, para së gjithash, është fe që mbështetet në baza të shëndosha e të qarta, është rrugë në të cilën ec njeriu që di se si të krijojë marrëdhënie të mirëfillta me të afërmit dhe ata që janë më larg, me armikun dhe me mikun.

Degët e besimit (imanit) që janë më shumë se shtatëdhjetë, janë përmbledhje të tëra, ndërsa secila prej tyre e ka boshtin rreth të cilit silllet. S'ka dyshim se pjesët e suksesit që i takojnë çdonjëres përmbledhje nuk janë të barabarta; veçoritë e besimit shkëlqejnë me rrezet e teuhidit. Po kështu janë edhe përmbledhjet e ibadeteve dhe vlerave të tjera fetare. Ndodhë që këto t'i godasin disa risi ose shtrembërime që nuk e prekin thelbin...

Kufijtë e hallalit dhe haramit janë të pandryshuara. Myslimanët i refuzojnë vlerat e ulëta morale dhe të këqijat, ndërkohë që lthtarët e Librit (të krishterët dhe he-

brenjtë) e lejuan kumatën, kurvërinë, homoseksualizmin dhe mëkatet e tjera të njohura. Ne edhe më tej gjejmë njerëz që urdhërojnë për të mirë dhe që ndalojnë nga të këqijat, njerëz që të tjerëve ua kujtojnë All-llahun dhe Ditën e Fundit, ndërkohë që çrregullimet në politikën udhëheqëse, dominimi i shpirtit egoist dhe çrregullimet në politikën financiare që kanë kontribuar në shtrembërimin e jetës së njerëzve janë evidente!

Bazat e besimit nuk janë dobësuar fare. Përkundrazi, me kalimin e kohës ato janë përforcuar edhe më shumë; burimet e shariatit islam janë të mbrojtura, sa të jetë edhe vetë Kur'ani, edhe pse zbatimi i tij në disa aspekte të rëndësishme është pezulluar.

Nuk është çudi që përpjekjet e njerëzve të shënojnë edhe dominimin e pasioneve, ndërsa kjo të ndikojë dukshëm edhe në qenien e shtetit islam, t'i sjellë atij humbje të mëdha. Mirëpo, edhe përkundër kësaj, Islami mbeti në rrugën e tij, të përparojë në Lindje dhe në Perëndim. Ai mbeti i plotfuqishëm dhe nuk la gjëra të padrejtë pa mos e humbur nga faqja e dheut idhujtarinë dhe boshtin e saj. Islami u tregua i plotfuqishëm edhe në ballafaqimin me Ithtarët e Librit, në mposhtjen e komplotëve të tyre dhe në largimin e pengesave të cilat ata i kishin vendosur në rrugën e tij.

Njeriu trupmadh që ndien dhembje në kokë apo është i sëmurë nuk e pengon që t'i rrëzoj përtokë të vegjlit të cilët përpiqen ta mbysin, ai shumë herë del fitues.

Historiani anglez Arnold Toynbee flet për ditët e rënies dhe dekadencës që e kishin goditur qeverinë islame. Ai përmend se kjo nuk e kishte penguar islamin të përhapej dhe zgjerohej anembanë botës. Ai thotë: "Islami, përkundër dobësimit të shtetit të tij në pjesët



e Azisë së mesme, nuk ngeci. Përkundrazi, ai u përhap edhe më shumë. Gjatë sundimit të halifit El-Muktedir (980-932), kur hilafeti abasid ishte më i dobët se kurdoherë, bullgarët e Vollgës (popull turq që banonin atë kohë në ato vende) i dërguan letër halifit nga i cili kërkonin t'u dërgonte dijetarë të cilët do t'ua mësonin fenë islame. Në vitin 922 halifi El-Muktedir e dërgoi një delegacion të dijetarëve.

Karлакët (popull turk) e përqaftuan Islamin nga fqinjët e tyre që jetonin në Transoksiani (Ma veraen-nehr) – këta ishin samanidët. Karлакët u shtrinë deri në lumin Tarim duke e bartur me vete islamin. Kështu, përderisa shteti islam copëtohej, njerëzit hynin në islam grupe-grupe, më shumë se që e kishin përqaftuar atë kur ai ishte shtet i bashkuar dhe i fuqishëm.<sup>207</sup>

Ai thotë: "Ajo që duhet përmendur është se Islami u përhap në jug-lindje të Azisë falë asaj se sunduesit lokalë e përqaftonin atë me dëshirë, e jo me fuqinë e shpatës. Islamin e pranuan edhe indonezianët të cilët e ruajtën kulturën indiane, rrënjët e së cilës kishin mbetur tek ata gati njëmijë vjet."

Ai gjithashtu thotë: "Në shekullin e XII dhe XIII Islami arriti t'i tejkalonte vështirësitë e mëdha që e kishin rrethuar nga çdo anë si rezultat i sulmeve të rënda e dërrmuese të kryqëzatave, por jo vetëm kaq – ai vazhdoi të përhapej edhe më tej. S'ka dyshim se kjo ishte një arritje e mrekullueshme nëse e marrim parasysh se bota islame në atë kohë ishte e copëtuar politikisht."

<sup>207</sup> Toynbee, *Muzhiz dirnetu et-tarikh*, 2/110. Këto fjalë ua kushtojmë shpifësve të cilët supozojnë se Islami është përhapur me shpatë.

Islami si fe hyjnore edhe më tej është duke shënuar përparim të dukshëm. Edhe pse si shtet është në gjendje të vështirë dhe i rrethuar me humbje të mëdha. Këtë më së miri e hetoi Toynbee!

Ne jemi të detyruar që me dhembje të pyesim: "A e hetuan historianët tanë këtë? A thua e identifikuan bakterin e sëmundjes? Apo retë e zeza e të tmerrshme që i kishin kapluar myslimanët, si rezultat i teprimit të "sulltanëve" të tyre, nuk gjetën asnjë që do të fliste për to dhe do t'ua tërhiqte vëmendjen prej tyre? Prandaj koha moderne e gjeti Umetin islam në verbëri! E ardhmja e tij ishte nën kërcënimin e stuhive të mëdha që frynin nga çdo anë!!

Tomas Arnoldi në librin e tij "Thirrja në Islam"<sup>208</sup> përmend shumëçka rreth kalimit të të krishterëve në Islam. Ai thotë: "Mësohet se morali i Salahudinit dhe jeta e tij burrërore në kokat e të krishterëve në kohën e tij kishin krijuar ndikim magjik, derisa disa kalorës të njohur të krishterë, të mahnitur me të, e kishin braktisur fenë e tyre të krishtere dhe popullin e tyre dhe ishin bashkëngjitur me myslimanët."

Në vitin 1185 krishterizmin e braktisi edhe kalorësi anglez nga radhët e kalorësve të tempullit i njohur me emrin Robert of Sant Bans. Ky e përqafoi islamën dhe u martua me njërin nga mbesat e Salahudinit. Pas dy vjetëve në betejën e Hitinit, Salahudini e arriti fitoren e madhe – e çliroi Palestinën, ndërsa e mposhti ushtrinë e krishtere duke i sjellë dëme të mëdha. Në mesin e atyre që u zunë robër ishte edhe

<sup>208</sup> Ky libër në gjuhën shqipe mban titullin: Thomas W. Arnold, Historia e përhapjes së Islamit, Prishtinë, 2004 – redaksia.

mbreti i Bejtu-l-Makdisit, i njohur me emrin Xho. Para fillimit të luftës (në mbrëmje) kishte ndodhur që gjashtë kalorës ta kishin braktisur mbretin, ngase shpirti i keq kishte hyrë në ta?! Këta ikën dhe iu bashkëngjitën ushtrisë së Salahudinit dhe me dëshirën e tyre e përqafuan Islamin.”<sup>209</sup>

Pas prezantimit të rasteve të kalimit të të krishterëve në islam, Tomas Arnold përmend disa shembuj prej tyre, të cilat i komenton me fjalët e tij dhe thotë: “S’ka dyshim se këto lajme të ndërlikuara janë provë se kalimi i të krishterëve në islam – për çka ne nuk kemi asnjë informacion – ishte bërë në masë të gjerë. Thuhet se në fundin e shekullit XV në qytetin e Kajros ishin njëzet e pesë mijë të krishterë që kishin kaluar në islam.

S’ka dyshim se numri i atyre që kishin kaluar në Islam ishte edhe më i madh, sidomos përreth vendeve të shenjta. Siç duket, myslimanët të cilët u morën me historikun e kësaj periudhe ishin të preokupuar thellë me shënimin e veprave të lavdishme të udhëheqësve myslimanë! Pikërisht për këtë, ata nuk u preokupuan dhe nuk u interesuan për ndryshimet fetare që kishin ndodhur në jetën e individëve të panjohur.

Ky shqyrtim na mëson se myslimanët ishin shumë pak të interesuar që t’i përcjellin lajmet e hyrjes së të krishterëve në islam!

Prandaj ne pyesim duke thënë: “Pse sot interesimi i tyre të jetë kaq i vogël dhe pse të mos interesohen për këto ndryshime që kishin ndodhur atë kohë? A

<sup>209</sup> Pse historianët tanë nuk i shkruan këto gjëra që kishin ndodhur? A nuk meritonin këto gjëra vëmendje dhe studim?

thua kalimi i të krishterëve në islam nuk ishte gjë e rëndësishme, që meriton studimin, përhapjen dhe mburrjen? Gjithsesi! Mirëpo historianët tanë – All-llahu i faltë – shumë pak u interesuan dhe nuk çan kokë për çështjet e thirrjes islame, kulturës dhe civilizimit. Historianët tanë i shohim që lajmet e parëndësishme i shkruajnë me shkronja të mëdha! Këta i fshijnë (nuk i evidentojnë) informacionet për popujt dhe shtetet për të cilat ne shumë pak dimë. Ndoshta i shënojnë gabimet që kanë ndodhur pa mos i korrigjuar dhe pa mos i shqyrtuar siç duhet. Sot e kësaj dite vërej gabime të cilat mbulohen me dhé, ndërkaq që historia do të duhej t'i përhapte. Megjithatë kuptohet se tmerri i pushetit ua ka mbyllë gojët!!

Sot e kësaj dite i vërej mrekullitë e imanit të gjallë, të thirrësve syçelë e mendjemprehtë dhe të muxhahidëve durimtarë dhe të drejtë, që përmbi to të hidhet pluhuri i dheut, sikur vetëm nënçmimi i njerëzve është ai që kërkohet!!

Misioni islam u ballafaqua me disfata të tmerrshme. Ishin ato ditë të tmerrshme për të dhe myslimanët, por megjithatë ato ditë shënuan rezistencën burrërore të myslimanëve që i mposhtën komplotet e mëdha dhe arritën ta ngrenë fenë nga ajo që ishte rrëzuar përtokë ose ta shpëtojnë nga shpërfillja e bartësve të tij! Megjithatë heronjtë e rezistencës, dijetarë dhe ushtarë, shkuan tek All-llahu ndonëse shumë pak njerëz dinë për ta.

Tani dëgjojmë se mijëra evropianë kanë hyrë në islam, se mijëra zezak në Afrikë, Indi dhe Azi e përqa-

fuan fenë islame, se të gjithë këta i dhanë përparësi islamit ndaj thirrjeve të tjera të misionarëve dominues!

Ajo që na habit është fakti se tërë këtë e ka kapluar heshtja, bile shumë myslimanë të arsimuar nuk e dinë numrin e saktë të myslimanëve që jetojnë në vendin a tyre, e lëre më ta dinë numrin e myslimanëve në botë!

Pikërisht për këtë unë them: "Medoemos duhet të mësohet historia dhe filozofia e historisë! Medoemos duhet ta kuptojmë aktivitetin njerëzor duke e ballafaquar atë me tekstet qiellore, me emrin e të cilit kanë funksionuar (përparuar)! Medoemos duhet t'i fshijmë gabimet të cilat i janë veshur atij, ndonëse ai është i pafajshëm dhe i pastër prej tyre."

Sot jemi shumë të nevojshëm për dallimin e të vërtetës nga e pavërteta, të mirës nga e keqja, sidomos kur e kemi parasysh se jemi në betejë me drejtimit dhe idetë moderne që na rrethojnë nga çdo anë. Koha nuk i fshin vetvetiu gabimet që kanë ndodhur e as që ofron arsye për ato. Shpalljen e All-llahut nuk bën ta njollosin pasionet e mbretërve dhe djallëzitë e djajve.

Islami arriti t'i duronte gabimet dhe padrejtësitë me të cilat u ballafaqua në fillim. Ai arriti t'i tejkalonte ato dhe t'u shpëtonte rreziqeve të tyre, mirëpo bota islame në shekullin XV është duke u ballafaquar me një grumbull mbeturinash të devijimeve nga e kaluara.

Unë nuk mendoj se disfatat ushtarake janë problemi që i ka bërë disa myslimanë të anojnë kah blloku Lindor e disa të tjerë kah blloku Perëndimor. Unë mendoj se problemi më i madh është shndërrimi i kë-

tyre disfatave ushtarake në disfata kulturore. Moskujdesi i myslimanëve ndaj trashëgimisë së tyre të shtrenjtë e të pastër, paaftësia për ta mbikëqyrë shtrembërimin shkencor dhe lajthitjen që ka depërtuar në mendjet dhe sjelljet e tyre gjatë prezantimit të konceptit islam para të tjerëve, shohim që myslimanët – për t'u mbrojtur nga lufta kulturore – shumë herë mbështeten në hamendje.

Autokracia është regjimi i tyre shtypës (despotik)!

Pasuria qarkullon vetëm në duart e të pasurve!

Aktiviteti kulturor është i shpërfillur dhe i vetmuar!

Gruaja është peng i burgut të saj të tmerrshëm ku nuk ka dituri e as përmirësim!

Dituria islame fshihet pas mureve të disa ibadeteve individuale!

Thirrja islame është e vdekur në fushën e prezantimit të lirë njerëzor!

Thirrja islame është e vdekur në fushën e mbrojtjes së fuqishme ushtarake, ngase bartësit e saj (hoxhallarët) e kanë humbur aftësinë për jetë!

I paafti në fushën e jetës nuk mund ta mbështetë e as ta ndihmojë besimin. Ai as që mund të gëzojë respekt personal dhe nuk shikohet me sy respekti!!

Me vëmendje të plotë e kam shqyrtuar gjendjen e myslimanëve gjatë ditëve të fundit të qëndrimit të tyre në Spanjë dhe erdha në përfundim se largimi i tyre nga ai vend ka qenë vendim i drejtë dhe ligj civilizues që nuk mund të shmanget!!

Çfarë mund të presim prej atyre në mesin e të cilëve janë përhapur gjynahet e mëdha, që shihen kudo

dhe për të cilat ata nuk çajnë kokë se do të dalin para All-llahut?

Në disa libra letrare i lexova këto gjëra: Kordoba dhe alkooli! Kordoba dhe tubimet muzikore! Amoraliteti! Magjia dhe komploti! Aty gjeta shumëçka që më tronditi; burimet kordobiane shënojnë shumë dukuri të pirjes së alkoolit dhe të shpirtligësive. Ahengjet mëkatore atje nuk përkufizoheshin vetëm në raste të veçanta. Banorët e Kordobës jepeshin pas dëfrimeve si në festat e myslimanëve, ashtu edhe në festat e të krishterëve.

Vallë, a thua se për këtë All-llahu i solli arabët në Spanjë?

Autori i librit që e kam pranë thotë: "Mbretërit ishin ata që më shumë interesoheshin për këto ahengje marramendëse, për to kishin caktuar shtëpi të veçanta në shëtitorët dhe pallatet e tyre. Njëjtë vepronin edhe shtresa aristokrate e përbërë nga ministrat, udhëheqësit dhe gjykatësit. Shtëpitë e tyre ishin përballë pallatit El-Hamra' duke pasur parasysht pozitën e mirë dhe ajrin e pastër aty!

Autori flet për një periudhë të errët të asaj kohe: amoralitetin, homoseksualizmin, këngët erotike, si dhe për fëlliqësira të tjera! A thua e tërë kjo do të kalonte pa ndëshkim? Ku mbeten fjalët e All-llahut të Madhërishëm: "*All-llahu, me siguri që do ta prishë punën e ngatërrestarëve. All-llahu, me fjalën e Tij e forcon të Vërtetën, edhe sikur ta urrejnë keqbërësit këtë!*"<sup>230</sup>

<sup>230</sup> Junus, 81-82

Humbi Spanja dhe arabët u përzunë duke hequr të zinj të ullirit. Sa e tmerrshme ishte ajo ditë! Siç shihet, aty nuk pritej gjë tjetër, përveç që kaderi i All-llahut ta kryente punën e vet!

S'ka dyshim se këto janë disa fryte të hidhura të gabimeve të mëdha që e përfshinë një periudhë fatkeqe të historisë. Unë them: këto gabime s'ishin tjetër, veçse grimca pluhuri në ditën kur frynë erë e madhe, sepse shtatëdhjetë degët e islamit vazhduan ta ripërtërijnë dhe rindërtojnë jetën njerëzore, edhe përkundrajt asaj se degët politike dhe administrative ishin shkatërruar. Mirëpo kjo nuk nënkuptonte se degët e tjera nuk e luanin rolin e tyre të duhur dhe nuk i zbusnin dëmet, siç nuk nënkupton se këto degë nuk e furnizonin trupin e Umetit me fuqi për ta vazhduar rrugën. Mirëpo, deri kur? Dhe, në cilën gjendje?

Historia e imametit të madh më bën t'i shoh elementet e caktuara të cilat e kishin ndotur postin e lartë shekuj me radhë. Prandaj, çfarë të them? Islami nuk i largoi carët, mbretërit dhe faraonët, që në vend të tyre të vijë sundimtari i cili do të qeverisë në emër të tyre, që do të quhej Halife, por që do të jetë faraon i maskuar; hilafeti është rezultat i një marrëveshje (besëlidhje) të lirë ose rezultat i zgjedhjeve të shëndosha. Hilafeti nuk është meritë e një gjaku të veçantë ose meritë e një prejardhjeje të një njeriu me fat. Kështu na mëson feja e All-llahut!

Më duhet të them se disa sundues myslimanë i bënë dobi të konsideruar fesë së All-llahut dhe shërbim të madh. Ata jetuan jetë të mirë dhe ishin të njohur me moral të lartë, të drejtë, korrekt ndaj Umetit.



Ata e deshën ahiretin dhe luftuan deri në fund të jetës për hir të All-llahut.

Gjithashtu më duhet të them se shumica e tyre arritën ta sigurojnë postin e tyre udhëheqës duke e deklaruar besimin në Islam, punën për hir të tij dhe sundimin në emër të tij, edhe pse në post kishin ardhur me metoda të pavlefshme. Deklarimi i qëllimeve fetare dhe kryerja e riteve fetare disa herë haptazi, ishin metoda më efikase për të qëndruar në post. Ne nuk themi që ata hoqën dorë nga islami, por në një mënyrë këta bënë pajtim mes të vërtetave islame dhe pasioneve të tyre. S'ka dyshim se pajtimi i tillë gjatë kohë shkoi në dëm të vetë fesë. Islami nuk përparoi, e as kundërshtarët nuk u mposhtën!

Gjërat që e kundërshtojnë islamin duhet të indorohen e assesi të vërtetohen. Vallë, a thua lejohet nëpërkëmbja e të drejtave të popullit mysliman dhe kështu të grabitet posti i lartë? Islami është mëshirë për të gjithë botët. Shpallja e Lartë nuk erdhi që në emër të saj të sundojnë njerëz pa meritë dhe të paaftë dhe njerëz që i cenojnë të gjitha të drejtat e Umetit. Mirëpo, kështu humbet parimi i këshillimit mes myslimanëve për punët e tyre, kështu përmbysen liritë e ndershme, ndërsa çështja bëhet pjesë që i takon dinakërisë dhe njeriut dhelparak.

Është e vërtetë se një numër i myslimanëve të mëdhenj e panë të udhës ngushtimin e veprimtë fitnes, bile edhe Husejni i biri i Aliut pranoi të dërgohej në fushëbetejë për të luftuar kundër forcave romake, edhe pse do të ishte nën flamurin e udhëheqjes shtypëse! Siç është e vërtetë se një numër i madh i njerëz-

ve të gjeneratave të para (selefu salih) e falën namazin pas imamëve të padrejtë dhe zullumqarë. Këta e shihnin të udhës t'i shërbenin islamit duke qenë larg luftërave të pakuptimta që mund të ndodhnin, ngase shërbimin ndaj islamit e shihnin një amanet të shenjtë.

Është e udhës të përmendim se islami mund të ngulfatet nën sundimin autokrat dhe në komplotet e tij të trashëguara. E metë e sundimit autokrat është se paratë grumbullohen nga çdo anë, pa mos çarë kokë se a është hallall apo haram. Mendarët u çuditën me atë që kishte ndodhur në kohën e sundimit të emevitëve rreth krijimit të marrëdhënieve të tyre me vendet e çliruara. Banorët e Horasanit e kishin pranuar Islam-in dhe hynë në fenë e All-llahut grupe-grupe. Situatë e njëjtë mbretëronte edhe në Egjipt, ku numri i atyre që e pranonin islam-in bëhej shumë i madh. Megjithatë përveç disa guvernatorë aty-këtu, ata nuk i liron njerëzit e këtillë nga pagesa e xhizjes! Vallë, kjo mënyrë e veprimit është e thirrësve apo e plaçkitësve?

Me ardhjen e halifit të drejtë Omer ibn Abdu-l-Aziz situata ndryshoi dhe u anulua politika e tillë e udhëheqjes.

Sunduesi despot është më xheloz se femra që është e dashuruar fort. Ai i urren njerëzit e mëdhenj, qofshin ata udhëheqës, politikanë, dijetarë ose shkrimtarë.

Kjo është fshehtësia që ri pas vrasjes së luftëtarëve dhe udhëheqësve të mëdhenj, të cilët e çliruan Lindjen dhe Perëndimin, sepse sunduesi despot nuk dëshiron që pranë tij të jetojnë njerëz plot lavdi dhe vepra krenare me të cilat ndoshta lazdohen.

Në këtë mjedis ndodhi edhe ndarja e diturisë nga sundimi: mes dijetarëve dhe politikanëve u krijua urrejtje e ashpër. Atë kohë mësojmë se Imam Ebu Hanifja dhe Imam Maliku – All-llahu i Madhërishëm qoftë i kënaqur me ta – ishin në anën e kryengritësve dhe rebelëve. Ebu Hanifja nuk pranoi të bashkëpunonte me shtetin dhe qëndrimi i tillë i tij e bëri që ai të vdiste në burg.

Ndërkaq Imam Maliku në mënyrë më të butë u largua nga çrregullimet e krijuara atëkohë. Ai e pa të udhës që t'i shërbente islamit duke u vendosur midis masës së gjerë të popullit pa u ngatërruar me pushtetarët. Fetvaja që e kishte dhënë ai atëbotë lidhur me pavlefshmërinë e përbetimeve të pushtetarëve, i kushtoi disa të goditura që i shkaktuan thyerje të brinjëve. Halifja i kishte kërkuar falje për këtë që kishte ndodhur!

Në vijim do të merremi me shqyrtimin e ndarjes mes diturisë dhe pushtetit, që pa dyshim se ka lënë gjurmë të thella në historinë tonë kulturore dhe politike. Tani do ta shqyrtojmë çështjen e disa familjeve sunduese të njohura për nga fanatizmi ndaj arabëve!

### *Fanatizmi ndaj arabëve*

Arabët duhet ta dinë se do të çmohen vetëm atëherë kur do të çmohet Islami; se kjo fe erdhi në gjuhën e tyre, se i Dërguari i fundit është nga mesi i tyre dhe se kibleja e namazeve është në tokën e tyre! A nuk

është kjo begati e madhe? A nuk duhet ta falënderojnë All-llahun për të? A nuk duhet që kjo begati t'i bëjë ta harrojnë vetveten dhe të shkrihen në përhapjen e fesë së tyre? Përderisa Kur'ani është në gjuhën e tyre dhe dituria nga trashëgimia e tyre, atëherë ata janë udhëheqës të njerëzve!

Atyre askush nuk ua konteston këtë të mirë dhe këtë meritë, përveç atij i cili është më me meritë në këtë fushë.

Megjithatë duket se disa familje arabe që sunduan dhe arabë të tjerë, menduan se Islami është një tren që i bartë dhe i shpie drejt interesave të tyre, i bën të jenë më të vlefshëm se të tjerët, bile sot disa arabë mendojnë se edhe pa islamit ata do të jenë me vlerë dhe peshë! S'ka dyshim se kjo është rezultat i mosnjohjes së islamit, rezultat i dhënies së tyre pas fanatizmave të injorancës dhe rezultat i paaftësisë për t'i marrë përsipër barrët e përparimit dhe detyrat burrërore!

Sa i shëmtuar është njeriu i cili dëshiron që raca ose gjaku i bardhë të përparojë e të udhëheqë! Më duhet të them se kam parë që udhëheqësit e misionit ungjillor – që pa dyshim se i zbukurojnë hamendjet dhe iluzionet e tyre – i caktojnë disa zezakë për kardinal dhe ipeshkëv. Këta bëhen përgjegjës për masat e popullit. Andaj pse nuk turpërohen bartësit e të së Vërtetës nga fakti se ua imponojnë të tjerëve racën e tyre dhe i avancojnë njerëzit e tyre pa kurrfarë shkakut?

### *Rrëfimi i diturisë dhe i sundimit në historinë tonë*

S'ka dyshim se udhëheqësi i drejtë është i pari i cili do të vendoset nën hijen e Arshit të All-llahut ditën kur nuk do të ketë hije tjetër, përveç hijes së Arshit të All-llahut. Gjithashtu s'ka dyshim se një ditë e udhëheqësit të drejtë është më e vlefshme se dhjetë vjet të jetës së një njeriu që jeton në vetmi dhe e adhuron All-llahun. Posti i halifes në vete e përmban ibadetin, da'vetin, xhihadin dhe kujdesin për çështjet e dynjasë dhe ahiretit.

Udhëheqësi i mirë di të krijojë të mira të pakufishme. Mençuria e tij është roje e të së vërtetës, ndërsa ai di ta mposhtë të pavërtetën, të jetë korrekt dhe i drejtë me njerëzit dhe t'i realizojë idealet e larta.

Udhëheqësit mysliman i mjafton të dijë nga dituritë islame aq sa për ta plotësuar besimin e tij, të dijë aq sa ibadeti i tij të jetë i saktë, të shquhet me vlera morale dhe të jetë i drejtë në marrëdhëniet me njerëzit, e pastaj le të jetë çfarë të dojë: mjek, kimist, inxhinier, shkrimtar etj. Me rëndësi është që ai të kërkojë ndihmë nga çdo i ditur dhe për çdo lëmë, të mbledh përreth tij këshilltarë të cilët do t'ia shpjegojnë të paqartat dhe do ta udhëzojnë drejt interesit të përgjithshëm. Halifi, kushdo që të jetë, jeton në një mjedis ku mbretëron këshillimi i sigurt dhe mendjempërtë. Ai ndien se pozita e tij tek All-llahu dhe te njerëzit është në varësi nga besnikëria e tij ndaj rregullave të sundimit dhe amanetit të njerëzve!!

Këto gjëra ndoshta nuk i plotëson ai të cilin në postin udhëheqës e sjell babai ose nëna! Ai që i ka humbur aftësitë udhëheqëse nuk meriton të jetë në atë post, pa marrë parasysh prejardhjen e tij fisnike, e sidomos afërsinë ndaj të Dërguarit s.a.v.s.. Islami nuk pranon që Abasi të jetë bazë e shtetit abasit, e as Fatimja të jetë bazë e shtetit fatimit. Gjithë kjo është pjellë e pasioneve të njerëzve dhe e pasioneve të atyre që shpifin për Allahun! I mençuri nuk mashtrohet me realitetin e dyshimtë edhe nëse ai dominon gjatë kohë.

All-llahu i Madhërishtëm thotë: *"Thuaj: "Nuk barazohet e keqja me të mirën, edhe sikur të të habisë bollëku i së keqes."*<sup>211</sup>

Ka qenë e mundur që Umeti islam ta kryente amanetin e misionit të tij në mënyrë më të ndershme dhe më të dobishme seç ishte bërë, mirëpo humbja e amanetit të udhëheqjes, politika e hegjemonizmit dhe përhapja e injorancës në mesin e atyre që i mermin përsipër postet udhëheqëse ishte ajo që i bërë dëm të madh Umetit tonë.

Dikur Ahnefiu thoshte: *"Është fatkeqësi që propozimi të dalë nga ai që e ka në dorë atë, e jo nga ai i cili e kupton dhe e njeh."*

Në vijim do t'i shqyrtojmë disa nga devijimet që ndodhën gjatë periudhës së hilafetit abasit.

1 – Gjatë kësaj periudhe ishte formuar sektori i përkthimit. Ishte kjo gjë e natyrshme, ngase misioni islam është universal dhe duhet të jetë i hapur për të gjitha vendet e botës. Valë, a thua ky sektor u shfrytë-

<sup>211</sup> El-Maide, 100

zua për përhapjen e mësimave islame? Assesi! Sektori në fjalë u shfrytëzua për përcjelljen e njohurive që i kishin popujt e tjerë te ne!

Kështu, në vend se t'ua mësojmë të tjerëve atë që ne e kishim, filluam t'i mësojmë gjërat që të tjerët i kishin.

Siç duket, përkthyesit e çuan veten në tundim me gjërat që i përkthenin, andaj edhe filluan të krijojnë përputhshmëri mes gjërave të përkthyerave dhe gjërave që i kishin me vete. Mjedisi kulturor filloi të mbushet me mjegulla që i kishin errësuar horizontet. Nga larg shihej se vinin çrregullime të panumërta.

Boshtin mendor që e kishte krijuar Islami në atë kohë bazohej në studimin e gjithësisë, gjithësinë që e krijoi Krijuesi i Lartëmadhëruar, i Cili pastaj u betua në qiellin dhe tokën, në natën dhe ditën, në yjet dhe erërat, në prindin dhe fëmijën. Betimet vazhduan edhe më tej të shtrihen derisa e përfshinë kohën dhe vendin, duke i përshkruar horizontet e bukurisë që shfaqen në dritë dhe në errësirë! Shih se çfarë thotë All-llahu i Madhërishëm: *"Beto hem në kuqërrimin e muzgut. Në natën e në gjithçka që ajo kaplon me errësirën e saj, si dhe në hënën e plotë, se ju, me siguri, do të kaloni nga e keqja te më e keqja! Çfarë kanë ata që nuk duan të besojnë?!"*<sup>212</sup>

<sup>212</sup> El-Inshikak, 16-20

Më duhet të them se përkthimi i pjesës së ajetit ku thuhet: "...do të kaloni nga e keqja te më e keqja", nuk përshatet me domethënien e saktë të ajeteve në komentet e Kur'anit famëlartë. Kujtoj se kuptimi i saktë do të ishte se: "ju do të kaloni nga një gjendje në një gjendje tjetër", nga gjendja e fuqisë në dobësi, nga jeta në vdekje, nga vdekja në ringjallje etj. Si do të ishte që ne ta kuptonim jetën kalim nga një e keqe në më të keqe?! A nuk është e palogjikshme? A thua All-llahu na krijoi për ta përjetuar vetëm të ke-

Ky bosht kur'anor e ndërton imanin mbi bazën e kontemplimit material dhe shpirtëror, si dhe që t'i realizojë dobitë e njeriut në këtë botë dhe në botën tjetër. Filozofia greke është filozofi abstrakte. Ajo i shpjegon gjërat e dukshme (të prekshme) me anë të përfytyrimeve imagjinare (hipotetike). S'ka dyshim se bota mori rrugë përpara vetëm atëherë kur ia ktheu shpinën kësaj filozofie, kurse natyrën e saj të shëndoshë e orientoi drejt logjikës shkencore dhe praktike të Kur'anit.

Është e vërtetë se unë dua që të njihem me të gjitha ato që i kanë të tjerët, qofshin ato të vërteta apo iluzione, por ndiej keqardhje se periudha e përkthimit na dëmtoi shumë dhe nuk na bëri dobi. Më duhet të them se në vend se të merremi me udhëzimin e banorëve të Tokës me shpalljen e All-llahut me të cilën Ai na nderoi, ne u preokupam me përcjelljen e iluzioneve në vendet tona duke u dhënë leje atyre të jenë afër të vërtetave të çmuara të fesë sonë (t'u bëhen rival).

2 – Gjatë periudhës së hilafetit abasit vërejmë studimin e hollësishëm të diturive fetare dhe letrare. Në këtë periudhë vërejmë se tregjet ishin të mbushura përplot me libra të llojeve të ndryshme të diturive dhe të arteve, si nëpër qytete ashtu edhe nëpër fshatra. Doemos duhet të theksojmë se shumica e kësaj literature ishte popullore, ndërsa një numër i vogël i tyre ishte zyrtare. Sepse, dijetarët e fikhut, tefsirit, hadithit dhe gjuhës jetonin në mesin e masave të gjera të po-

qen? A nuk është e vërtetë se Ai na krijoi nga dashuria që kishte për ne dhe për të qenë të lumtur, e sidomos kur e kemi parasysh se Ai na krijoi për të qenë banorë të shenetit e jo të xhehenemi! (Përkthyesi – S.T.)



pullit. Një numër i madh i këtyre dijetarëve ishte trajtuar në mënyrë të pandershme nga shteti. Ai që bëhej i afërt me pushtetarët dihej se e kishte rrezikuar fenë, përveç atij që e ruante All-llahu.

Ishte e natyrshme ndarja e diturisë nga pushteti, sepse shumica e pushtetarëve e kishin trashëguar pushtetin, edhe pse nuk kishin kurrfarë merita për të. Asnjëri nuk thoshte që All-llahu e ka bërë mençurinë në pasardhës të veçantë.

Edhe pse kjo ndarje ishte një fatkeqësi e madhe, megjithatë fatkeqësia më e madhe ishte ndarja mes diturisë dhe edukatës (terbijes) ose ndarja mes diturive fetare dhe tesavuffit (mistikës islame).

Zemra dhe mendja janë dy gjëra që e bëjnë njeriun të përsosur. Mençuria është e padobishme kur pranë saj është natyra e fëlliqur, ndërsa zemra është e padobishme kur pranë saj është padituria dhe shkujdesi. Arsimimi i shëndoshë dhe i përsosur është ai që përnjëherë e gdhend mendjen dhe zemrën.

Diku tjetër kam thënë se shkëputja e të kuptuarit të thellë nga tesavufi (mistika islame) ka bërë që mjedisin e tij ta mbushin hamendjet dhe të pavërtetat e kështu Umeti të çrregullohet! Natyrisht që edhe largimi i sinqeritetit me All-llahun dhe besimi i fortë në Të nga të kuptuarit e thellë bën që mjedisin e tij ta përfshijnë sajimi, lakmia e dynjasë dhe mënjanimi i suksesit të All-llahut të Madhërishtëm.

Hilafeti abasid nuk arriti të përparonte aq shumë e të shkonte përtej kufijve ku kishin arritur emevitët, siç nuk arriti ta përhapë thirrjen universale islame në Lindje dhe në Perëndim. Kaosi që mbretëronte atëko-

hë i joshi armiqtë që ta sulmonin. Në këtë periudhë mësojmë për luftërat e para të kryqëzatave dhe për disfatat e mëdha të cilat i përjetuan myslimanët. Ishin këto disfata të cilat sot e kësaj dite i joshin armiqtë tanë që të marrin guxim për të na sulmuar.

Ç'të them për shtetin fatimitë, përveç se ishte një shtet plot sherr. Aty nuk kishte asgjë të mirë ose kishte shumë pak të mirë!!

### *Hilafeti Osman*

Kujtoj se është e udhës që para se të flasim për hilafetin osman t'i themi dy tri fjalë që do të na e bëjnë të qartë rolin e misionit universal islam.

I Gjithëmëshirshmi, i Cili e krijoi njeriun dhe ia mësoi të folurit e qartë, bëri që njerëzit të identifikohen para të tjerëve duke u shërbyer me metodat e ndryshme të të folurit të tyre dhe të merren vesh mes vete me llojlloj metodash: *"Ndërmjet shenjave të Tij janë krijimi i qiejve e i Tokës dhe shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e ngjyrave (raceve) tuaja. Pa dyshim, në këtë ka shenja për ata që dinë."*<sup>213</sup>

All-llahu deshi që Shpallja e Tij e fundit të jetë në gjuhën arabe. Prandaj ai që e dëshiron njohjen e saj, të kuptuarit e saj dhe zbatimin e saj, nuk i mbetet tjetër, pos t'i qaset gjuhës së Shpalljes, ta njohë mirë atë dhe prej saj të marrë udhëzim.

Nuk është çudi që të huajt të jenë më të afërt me All-llahun se arabët të cilët e shpërfillën Shpalljen dhe nuk pranuan të identifikohen me të.

<sup>213</sup> Er-Rum, 22

Historia jonë kulturore flet se një numër i madh i të huajve u shquan me shkathësi të veçanta në dituritë fetare. Këta bile ishin edhe më të dashuruar në stilitikën e gjuhës arabe dhe në letërsinë e saj, se sa që ishin bijtë e Gadishullit Arab.

Prej tyre pati që zunë poste të rëndësishme, madje edhe postin më të lartë të udhëheqjes (imametin). Pas tyre shkuan popuj dhe shoqëri, bile nuk është e njohur që ndonjë i mençur ta kishte kritikuar (fyer) udhëheqjen e tyre njerëzore dhe morale.

Dua që në këtë kontekst ta përsëris atë që e thashë më parë: unë jam egjiptian, por islami është ai që më ka bërë të arab. Me Gadishullin Arab nuk më lidhin lidhjet farefisnore dhe nuk çaj kokë që të jem pikërisht nga kurejshët, se ajo që më intereson është vetëm feja ime. Unë nuk çaj kokë për Adnanin, Kahtanin dhe Ken'anin.<sup>214</sup> Mua më intereson vetëm Islami dhe shkallët e mirësisë!

Dua të them se me këtë të menduar të lehtë e kam pranuar themelimin e hilafetit osman, i cili erdhi pas rënies së hilafetit abasid, duke lënë pas vetes mjegull e tym, veçmas kujtime trishtuese.

Autori i krishterë Filip Hiti në librin e tij "Historia e arabëve" thotë se rënia e hilafetit abasid e nënkuptonte rënien dhe fundin e pushtetit arab. Kujtoj se këto fjalë kanë nevojë për një shpjegim më të gjerë: dua të them se arabët sunduan në emër të Islamit, në emër të civilizimit të cilin e kishte krijuar islami. Ata arritën të përparonin dhe ta merrnin vendin e lavdishëm duke dalë në ballë të njerëzimit.

<sup>214</sup> Fise të shquara arabe.

Sikur arabët ta përmbushnin amanetin e shenjtë me besnikëri, t'i përulëshin All-llahut dhe të identifikoheshin me mësimet e Tij, me siguri se flamuri i tyre nuk do të binte përtokë e as që do t'i sulmonte ata armiku! Arabët shumë shpejt i veshën mësimet islame me petkun e traditave të injorancës, andaj edhe i ngatërruan punët e mira dhe të këqija.

Pse të kenë pasardhësit e Abasit dhe pasardhësit e Fatimes<sup>215</sup> të drejtë fetare të krenohet me islamin të cilin e bartin? A thua shpallja thotë se imani shoqërohet me individët e këtyre dy familjeve? S'ka dyshim se pas këtyre pretendimeve injorante qëndrojnë udhëheqjet dominuese!

Gjithashtu s'ka dyshim se tekstet fetare pohojnë këshillimin midis myslimanëve, ashtu siç funksiononte gjatë hilafetit të drejtë (hilafe er-rashide). Nuk është e mundur që islamin ta udhëheqë njeriu i paaftë dhe i pavlerë, sidomos në kohën e përplasjeve të mëdha që janë duke ndodhur në jetë, edhe nëse pretendon se e ka të veshur pelerinën e të Dërguarit s.a.v.s!

Kryeqendra islame, atëkohë e hutuar, u sulmua ashpër dhe u shkatërruar nga Holaku dhe bashkëshortja e tij e krishterë, nga Evropa e krishterë dhe nga ushtritë mongole që vinin nga Lindja. Brezat e mëvonshëm të emevive u detyruan të hidhen në det, sepse ishin të sulmuar ashpër nga Ferdinandi dhe Izabella, Vatikani dhe Evropa.

Ky ishte fundi i dhembshëm i historisë që shënonte plot çrregullime dhe plëngprishje, histori që ve-

<sup>215</sup> Ekziston një dyshim i madh rreth asaj se a është e vërtetë që fatimijë thirren në prejardhjen e tyre në Fatimen (radijallahu anha)?

tëm e mbante emrin e islamit, por jo edhe thelbin e tij! Ishte histori për hir të individëve i varrosi aftësitë njerëzore dhe mësimet islame, për hir të individëve që i shqetësonte trashëgimia farefisnore, lavdërimi dhe armiqësia, si dhe përshtatja e fesë ndaj pasioneve.

S'ka dyshim se masa e gjerë e myslimanëve ishte ajo që e pagoi çmimin e tërë kësaj që po ndodhte: mijëra myslimanë të vrarë, mijëra të tjerë të zënë robër, librari që u bënë hi e pluhur, e disa herë i gëlltitën valët e detit.

Për çudi, arabët sot e kësaj dite i duan me gjithë shpirt fanatizmat e tyre, mburren me racën e tyre dhe lavdërohen me kombin e tyre! Do të ishte më e udhës që ata të edukohen me Librin e Zotit të tyre dhe me Sunetin e të Dërguarit të tyre, t'u referohen këtyre dy burimeve nëse duan ta rikthejnë lavdinë e dikurshme dhe ta ndërtojnë atë që dikur u shkatërrua.

Tani është koha të flasim për udhëheqjen e hilafetit osman të islamit dhe Umetit të tij.

Jeta primitive e turqve të parë ishte më e dobishme për islamit se jeta dëfryese e arabëve dhe qytetërimi i tyre i sajuar. Besimi i thjeshtë në zemrat e turqve ishte më i vlefshëm se besimi teorik e i thelluar i lidhur ngushtë me logjikën e Aristotelit dhe me polemikat e kelamistëve.

Turqit arritën ta ndalin hovin e sulmeve të tatarëve dhe kryqtarëve dhe kështu të krijojnë epërsi në anën tonë. Ushtria turke u ballafaqua me armiqtë e ashpër dhe kështu arriti ta shuajë urrejtjen e tyre të madhe. Mendoj se turqit janë të shquar më shumë me aftësi luftarake se që janë të shquar me aftësi shkenco-

re dhe politike. Dashuria e tyre e flaktë për islamin dhe udhëheqjen e tij ishte ajo që qëndronte pas tyre.

Më kujtohet rasti i një ushtari turk, i cili ishte zgjuar nga shtrati i trembur e i trishtuar, sepse kishte hetuar se këmbët e tij kishin qenë të shtrira në drejtim të dritares ku kishte qenë i vendosur Mus'hafi i ndershëm. Ai e nxori shpatën dhe tërë natën nuk vuri sy në gjumë, por vazhdoi të thoshte: Ah Mus'hafi i ndershëm!!

Unë ndjeva respekt dhe dashuri për ushtarin i cili e qorton veten dhe e edukon. Me sytë e mi e kam parë këtë respekt dhe këtë edukatë të lartë. Një ditë isha në zyrën e profesorit Muhammed Ferid Vexhdi. Rinim dhe bisedonim për shumëçka. E pashë se ai po shkruante me dy lapsa, një herë me njërin e një herë me tjetrin! Unë i thashë: Çfarë po bën kështu? Ai tha: "Nuk i shkruaj ajetet e Kur'anit familartë me lapsin me të cilin i shkruaj artikujt e mi. Për ajetet e Kur'anit të çmuar kam laps të posaçëm!!".

S'ka dyshim se këto ndjenja janë të çmuara dhe kanë peshë të lartë, sidomos te njeriu i cili ka origjinë turke (mendohet për profesorin Muhammed Ferid Vexhdi). Turqit – por bile edhe të gjithë të tjerët – i organizon dashamirësia e ngrohtë dhe dashuria e madhe që kanë për All-llahun dhe të Dërguarin e Tij.

Xhelozia ndaj islamit dhe hidhërimi i tyre ndaj asaj se çfarë i bën armiq të Umetit islam, ishin faktorët që rrinin pas rrjedhës së fuqishme që i shtyri masat e gjera të lëshohen kundër bakterit të armiqësisë në Konstantinopojë dhe ta largojnë praninë e të krishterëve në të. Kjo do të shënonte edhe hakmarrjen e myslimanëve

për shkatërrimin e Bagdadit, zhvendosjen luftës nga tokat islame në territoret e Evropës dhe vonimin e kolonializmit evropian për disa shekuj të tokave arabe. Këtë e pohon edhe historian anglez Toynbee!

Njerëzit nuk do të luftonin sikur evropianët të ishin më të drejtë dhe më të matur!

Mirëpo, drejtësia dhe matura tek evropianët ka një shpjegim tjetër! Nëse një i krishterë e vret ndonjë arab (lexo mysliman) ose ndonjë banorë të vendeve islame, atëherë nuk lejohet përndjekja e tij me ligj për këtë që e ka bërë..... Por, nëse myslimani del në mbrojtje të Palestinës dhe lufton kundër okupatorit, atëherë ai është terrorist dhe përndjekja e tij kërkohet me ligj ndërkombëtar. Këtë akt do ta dënonte ashpër krishterizmi i fuqishëm!

Si të ballafaqohemi me këtë logjikë? Si të flasim me ta? T'i përmbahesh fesë është fundamentalizëm, kur ajo fe është islami i cili dëshiron të mbijetojë! Ndërkaq t'u përmbahesh feve të tjera, kjo është gjë që i përket lirisë së mendjes dhe ndërgjegjes dhe nuk duhet të pyesim për të!

Turqit arritën ta çrrënjosin dhe ta shtypin këtë kryelartësi të tyre të rrejshme dhe i edukuan fort mirë të tjerët. Mirëpo, turqit – edhe përkundër rolit të tyre të madh që e patën në histori – shumë shpejt filluan të shkojnë pas hapave (t'i imitojnë) të abasidëve dhe të tjerëve. Kjo ndodhi në shekullin e fundit të sundimit të tyre. Kështu, aftësitë e jashtëzakonshme udhëheqëse që u shfaqën më herët, filluan të humben tek ata që erdhën më vonë.

Çdo e metë që dikur kishte qenë në mesin e abasidëve dhe fatimitëve u gjet edhe në mesin e osmanlinjve. Sikur të kishte qenë e shkruar që islami të sprovohet me një grup të pretenduesve, që marrin në dorë udhëheqjen e tij dhe i preokupojnë njerëzit me racën e tyre bujare dhe lavditë e tyre të imagjinuara.

Tani pyesim? Çfarë bënin arabët pas rënies së hilafetit të tyre në shekullin VII?

Ata e dinin se Islami nuk e njih fanatizmin racor dhe nuk është çudi që atë ta udhëheqin njerëz që janë të aftë e të prirë, pa marrë parasysh se nga janë dhe ku jetojnë. Pikërisht për këtë arabët qysh ditën e parë që turqit e morën flamurin në dorë shkuan pas tyre. Më duhet të them se është e pamundur që pushteti i shëndoshë e i gjerë i botës islame të jetë i shkëputur nga arabishtja. Le të jetë ai nga Etiopia, siç ishte Bilali ose nga Persia, siç ishte Selmani, ose nga Bizanti, siç ishte Suhejbi, por këta të gjithë u bënë arabë me mësimin e arabishtes, pra me shijen e ëmbël të Librit dhe Sunetit.

Sikur turqit të shkonin pas hapave të Sulltan Mehmet II Fatihut dhe ta zbatonin porosinë e tij, me siguri se do t'i shërbenin islamit dhe vetvetes.

E vërteta është se sëmundjet e vdekjes filluan dalëngadalë të depërtojnë në tërë qenien islame, ndërsa simptomat e dobësisë e nënkuptonin përshpejtimin e fundit të tij!

Vallë, a thua arabët kishin mundësi të bënin diçka? Them: ata ishin të aftë për të bërë shumëçka, por u bënë shpërfillës (të painteresuar, të panështruar dhe dembelë)!



Nga të metat e para të arabëve është dashuria e tyre për udhëheqje dhe lufta për pushtet. S'ka dyshim se kjo e metë u përçoll me humbje të mëdha materiale dhe shpirtërore. Ne nuk e mohojmë atë se njerëzit lakmojnë për pushtet dhe sundim, mirëpo a thua vetëm ajo është rrugë për përmirësim dhe për të bërë mirë?!

Dominimi tregtar ishte ai i cili i mundësoi Anglisë ta sundonte Indinë. Historia e kolonializmit anglez në këto vende të gjera flet se anglezët nuk e derdhën gjakun e tyre kur i pushtuan tokat indiane dhe i kapën për hunde indianët e mjerë, që do të thotë se dominimi tregtar ishte faktori kryesor që i bëri ata ta udhëheqin popullin.

Çfarë duhej të bënin arabët pasi e humbën fuqinë politike? Do të ishte e udhës që arabët ta përvetësonin fuqinë shkencore (dominimin shkencor) dhe ta ndihmojnë fenë e tyre me laps dhe gjuhë, me mendje dhe civilizim, me vetëdije dhe edukim, t'i përvetësonin zemrat dhe mendjet e njerëzve, pikërisht në kohën kur turqit i mbanin në dorë çelësat e të urdhëruarit dhe të ndaluarit në rezidencat e qeverisë!

Sikur ta bënin këtë, me siguri se do t'i plotësonin mangësitë e sundimit osman, do ta përhapnin gjuhën e tyre në të gjitha vendet e Ballkanit dhe nga kultura arabe do të krijonin një mbështetje të fortë shpirtërore dhe shkencore për pushtetin në shtet (osmanlinjtë). S'ka dyshim se nga kjo do të kishte dobi islami, si në aspektin material, ashtu edhe në atë shpirtëror, qoftë në Azi, Evropë ose Afrikë.

Oh sa të shëmtuara që janë sëmundjet e zemrave!! Lakmia për pushtet disa herë është më e madhe se

lakmia “për dashuri”. Çudi, dashuria e disa njerëzve për pushtet duket disa herë më e madhe se dashuria e Mexhnunit për Lejlën!

Pas kësaj tokat e harruara islame i vërshuan kryqtarët e rinj. Ushtritë okupatore vallëzonin mbi tokën e nënshtruar: *“Sa shumë aytete u treguan kokëforta para urdhrave të Zotit të vet dhe të dërguarve të Tij! Ne u kërkuan llogari të rreptë dhe i ndëshkuam me dënim të ashpër. Ata i provuan pasojat e veprave të veta dhe fundi i tyre qe shkatërrim.”*<sup>216</sup>

Studimi i historisë nuk është vepër vullnetare. Studimi i historisë është domosdoshmëri fetare dhe shoqërore me të cilën ngrihen popujt e gjallë. Çfarë mund të ndodhë nëse një kompani tregtare i shpërfillim llogaritë e fitimit dhe të humbjes dhe punohet paushall, duke shpërfillë të kaluarën dhe eksperiencën? Natyrisht që kompania do t’i mbyllë dyert dhe do të tërhiqet nga fusha e tregut për të mbetur kështu vetëm në kujtim.

Vetëdija e dobët ndaj historisë politike është e barbartë me vetëdijen e dobët ndaj historisë shkencore dhe kulturore.

Myslimanët nuk i ruajnë shënimet e historisë së shkencave që u zhvilluan në tokat e tyre. Pothuajse askush nuk i jep rëndësi atyre që u shquan në shkencën e astronomisë, optikës, matematikës dhe kimisë! Ndoshta për ta më i rëndësishëm do të ishte një poet anormal ose ndonjë autor që merret me shkrimet e teksteve lidhur me abdesin dhe pastrimin!

<sup>216</sup> Et-Talak, 8-9

Ngecja, që kishte arritur ta pushtonte kulturën shkencore dhe t'i varfëronte fushat e saj, pati ndikim të madh në shkatërrimin e Umetit tonë në shekujt e fundit. Pikërisht për këtë themi se rënia e pushtetit osman nuk është e njëjtë me rënien e pushtetit abasid.

Në kohën e abasidëve myslimanët ishin më të arsimuar dhe në nivel më të lartë kulturor se që ishin armiqtë e tyre tatarë në kohën që i sulmuan dhe arritën të dominojnë në tokat e tyre. Pikërisht për këtë nuk kaloi kohë e gjatë dhe ngadhënjimtarët u shkrinë në ata që ishin të mundur: tatarët hynë në islam!

Pas kësaj ndodhi që shumë shpejt të okupohen tokat islame dhe ato t'i copëtojnë myslimanët. Në Evropë myslimanët u bënë pakica që nuk kishin në dorë asgjë. Atyre iu morr pushteti dhe nderi, ndërsa në Azi dhe në Afrikë u shndërruan në etnitete të pashpresa dhe të poshtëruara që nuk dinë përkatësi e as miqësi.

Studimi i historisë është shtyllë e rëndësishme në formimin e mendjes njerëzore dhe shtyllë e rëndësishme e mbijetesës së misionëve të larta. Unë kujtoj se ka ardhur koha të zgjohemi dhe të shohim.

\* \* \*

Dua të them se "Islami është trashëgimia më e madhe në Botë, Libri i tij, që: *"Ky është Libri në të cilin nuk ka dyshim"*, - është mburoja më e fortë e tërë Shpalljes Hyjnore, nga fillimi i historisë e deri në Ditën e Ringjalljes. Umeti islam, me besnikërinë ndaj tij dhe punën për hir të tij, është populli më i mirë i dalë për

njerëzimin; se kjo fe është drejtim i shkruar në faqe të dheut, është ngadhënjimtar i të fuqishmëve që orvaten t'ia zënë rrugën; në rrugën e tij ai vazhdoi të jetë i ashpër dhe i fuqishëm, andaj edhe më tej ai është i pari i mundshëm për të vazhduar drejt qëllimit të tij...”

Nuk i shkrova të gjitha këto gjëra për ta vajtuar historinë, e as që i shkrova për t'i zmadhuar të këqijat që kanë kaluar dhe të zotët e tyre!! Unë vetëm desha ta shpalos një aspekt të ndotur të shkarjeve të pasuesve dhe gabimeve të sundimtarëve!!

Unë së pari desha: të jem i drejtë dhe korrekt ndaj Islamit dhe ta shfajësoj atë nga dyshimet që përpiqen t'ia veshin armiqtë e tij.

Së dyti desha: Tërheqjen e vërejtjes drejt asaj se gabimet fillojnë si të mundshme (me gjasa), por që dita-ditës rriten dhe bëhen të papërmirësueshme.

Unë njoh shumë mundës që kanë fituar ndeshje të vështira dhe i nënshtruan disa sëmundje që ishin në trupin e tyre, por me kalimin e kohës sëmundjet filluan të rriten dhe ndodhi që heronjtë e së djeshmes të tërhiqen nga mejdani, ngase nuk arritën t'i shëronin simptomat e paraqitura më parë.

Islami është fe që në qenien e tij e bart farën e përjetshmërisë dhe çdoherë që ndodhë që të hyjë në ndonjë ambient të ndotur, është Kur'ani nga i cili e merr erën freskuese. Pikërisht për këtë kemi mbijetuar dhe do të mbijetojmë deri në ditën kur All-llahu do ta trashëgojë tokën dhe gjithçka që është në të.

Shkaqet e mbijetesës sonë fshihen në lidhjen e fortë me Kur'anin famëlartë dhe kthimin e përhershëm tek ai çdoherë që nga ai na largon ndonjë stuhi e ashpër.

Më mbetet të them diçka lidhur me një gabim në historinë tonë; ajo se disa që flasin në emër të islamit, ndërsa shumë pak dinë, janë ata që nuk bëjnë dallim mes mësimëve islame dhe sjelljeve të sunduesve që në emër të tij sundojnë ose të atyre që preokupohen me dituritë e tij.

Degët e besimit në fenë tonë e kanë mundësinë e kompensimit të njëra-tjetrës. Në rast se njëra prej tyre nuk ka mundësi të realizohet, mirëpo vetëm për një kohë...

Në kohën kur qeveria e shpërfillë zbatimin e drejtësisë shoqërore, ndodh që ndjenjat e vëllazërisë të vijnë në gjendje që ta shtrijnë dorën e sadakasë dhe të ndihmës ose për të siguruar vende pune për të papunët që janë të aftë për punë. Mirëpo, a thua kjo bën dobi në çdo vend dhe në çdo kohë?

Ndodh që thirrësit dhe vaizxhinjtë ta marrin mbi vete barrën e të urdhëruarit për të mirë dhe të ndaluarit nga e keqja, por a do të thotë kjo se nuk ka nevojë për themelimin e institucioneve që do të ndryshojnë dhe do të sjellin vendime?

Shumë herë ua hedh shikimin degëve të besimit ashtu siç i shikon Ibn Rumi fëmijët e tij dhe thotë:

*Fëmijët tanë janë sikur ndjenjat tona,  
Cilindo që e humbim na dhimbset shumë,  
A thua dëgjimi pa sy është i njëjtë sikur të jesh me sy?  
Apo syri pa dëgjimin të udhëzon siç duhet?*

Rrëfimi i Umetit tonë me misionin e tij le të jetë mësim për rizgjim bashkëkohor islam, me qëllim që myslimanët të dinë të ecin dhe të përparojnë më mirë.



## *Tema e katërt*

### *Ringjallja, llogaria dhe shpërblimi*

All-llahu i Madhërishëm nuk i krijoi njerëzit për të jetuar në tokë disa vite, e që pastaj të zhduken e të mbeten vetëm në kujtime ose fare të mos mbeten! Assesi, Ai i krijoi për të qenë të përjetshëm!

Vdekja me të cilën njerëzit ballafaqohen në jetën e kësaj bote është vetëm një ëndërr (periudhë mes vdekjes dhe ringjalljes) e përkohshme ose pikë ndarëse mes jetës së parë dhe jetës së dytë, e para për mbjellje, ndërsa e dyta për korrije.

Dhe, gjatë rraskapitjeve të njerëzve në fushat e jetës dhe heshtjes së të vdekurve nëntokë (në varre), do të ndodhë Ndodhia e Madhe (kiameti) me përmasa të gjera, të cilin All-llahu i Madhërishëm përshkruan me këto fjalë: *"Dhe, kur fryhet në Sur, ata do të dalin nga varret dhe do të nxitojnë drejt Zotit të tyre, duke thënë: "Mjerë ne! Kush na ngriti prej varreve tona?" (Do t'u thuhet): "Ja, kjo është ajo që ka premtuar i Gjithëmëshirshmi; të dërguarit e thanë të vërtetën!" Do të jetë ai vetëm një zë i tmerrshëm e ata të gjithë do të paraqiten para Nesh."*<sup>217</sup>

Ata të cilët punuan mirë dhe u përgatitën për takim me All-llahun e Lartëmadhëruar, ata do të thonë:

<sup>217</sup> Ja Sin, 51-53

*"(Banorët e xhenetit do të thonë): "A nuk do të vdesim më, përveç vdekjes së parë? Dhe as nuk do të dënohemi?" Vërtet, kjo është fitorja më e madhe!"<sup>218</sup>*

Ndërkaq, ata që e menduan jetën periudhë që fillon me lindjen e njeriut dhe mbaron me vdekjen dhe vendosjen e tij në varr dhe që mohuan gjithçka që është pas vdekjes, ata do ta vuajnë dënimin e tmerrshëm: *"Kurse për ata, që e mohojnë Zotin e tyre, dënimi është xehenemi; ç, sa i shëmtuar është ai vendbanim! Kur të hidhen aty, do të dëgjojnë ulërimën e tij, ndërkohë që ai vlon, gati për të shpërthyer me furi."<sup>219</sup>*

Shumë herë më bie të udhëtoj jashtë vendit tim, të jem larg atdheut tim, disa herë më gjatë e disa herë më shkurtë, disa herë më merr malli shumë e disa herë jo aq, por gjithnjë gjatë këtyre udhëtimeve unë planifikoj mirë çdo gjë, bile edhe kthimin, saktë e di se nga kam ardhur dhe ku do të kthehem! Qëndrimi im në hotel më bëri të ndiej se jam veçse një kalimtar, se pas meje në dhomën time do të vendoset dikush tjetër, sikur që unë u vendosa pas dikujt tjetër!

S'ka dyshim se dëshira për qëndrim të përhershëm është marrëzi! Kështu ndodhë me ne në jetën e kësaj bote, ajo është kalimtare, jo e përhershme! Kjo e bëri Ibn Kajim el-Xhevzijen t'i thoshte besimtarit të mirë:

*Eja në xhenetet e adenit (kopshtet aden),  
Se ato janë vendet e tua të para dhe në to janë  
vendpushimet!*

<sup>218</sup> Es-Saffat, 58-60

<sup>219</sup> El-Mulk, 6-8



Ndërkaq kjo e frymëzoi poetin që të flet me gjuhën e banorëve të varreve, që ai të thonë:

*O ju që ecni mbi tokë,  
Sikur që ju jeni tani, ne kemi qenë më parë!*

Kur'ani famëlartë flet gjerë e gjatë për botën e ahiretit, llogarisë së saktë, begative të përhershme dhe të panumërta dhe dënimit të përhershëm e të tmerrshëm; ai pohon se jeta e njerëzve në këtë botë është një kohë e shkurtër, se teprimi i tyre në gëzime dhe brenga është mashtrim i madh, se veprimi i vetëm i drejtë është besimi në All-llahun dhe Ditën e Fundit.

Jeta e të dërguarve të All-llahut na mëson për polemikën e ashpër që ndodhë mes tyre dhe kundërshtarëve të tyre. Mirëpo, sa herë që kjo polemikë ashpërsohet, shpallen fjalët e All-llahut: *"Sigurisht që ti (Muhamed) do të vdesësh një ditë e, sigurisht që edhe ata do të vdesin. Pastaj, në Ditën e Gjykimit, ju do të grindeni para Zotit tuaj!"*<sup>220</sup>

Grindja e tyre e nënkupton fillimin e ri të polemikës midis besimtarëve dhe jobesimtarëve që grinden për Zotin e tyre, ndonëse ky fillim i ri për disa do të jetë dëshpërim, e për disa të tjerë gëzim!

Luftërat e lapsit sot e kanë zhurmën që i shëmbëllen vringëllimës së armëve në luftërat e ashpra! Në jetën time kam parë revista e libra të mbushura përplot me të zeza dhe shpifje kundër All-llahut dhe të dërguarit e Tij. Unë mendoj se vendtubimi i madh i

<sup>220</sup> Ez-Zumet, 30-31

Ditës së Gjykimit do t'i mbledhë të gjithë këta, besimtarë e jobesimtarë, të dërguar dhe kundërshtar të tyre, që të gjithë do të qëndrojnë në vendin e llogarisë. Vallë, a thua pse vepron kështu Zoti ynë me ne?

*"Që t'u tregojë atë, për të cilën nuk pajtohen dhe që mohuesit ta kuptojnë se kanë qenë gënjeshhtarë....."*<sup>221</sup>

A thua grumbullimi tyre në një vend kërkon mund të madh? Assesi: *"Nëse dëshirojmë të bëhet diçka, mjafton që të themi: "Bëhu!" dhe ajo bëhet."*<sup>222</sup>

Rruga e jetës vazhdon pandërprerë, ndërsa besimi se vdekja është zhdukje e përhershme është ndjenjë e rrejshme! Besimtari është i bindur se vdekja nuk e ndërpret lidhjen e jetës, sepse një lidhje të tillë nuk është në gjendje ta ndërpresë askush. Vdekja është pika e transferimit nga një jetë në një jetë tjetër. Shumë njerëz nuk bëhen gati për takim me All-llahun. Ata vazhdojnë të rëndin pa qëllim pas interesave të tyre, mbyllen brenda tyre dhe nuk shohin asgjë: *"Por njeriu dëshiron të gabojë sa të jetë gjallë dhe pyet: "Kur do të jetë Dita e Kiametit?"*<sup>223</sup>

Pikërisht për këtë është përsëritur biseda për ringjalljen, llogarinë dhe shpërblimin në Librin e All-llahut. Pothuajse asnjë sure nuk e lë pa e përmendur atë.

Në suren e parë të Kur'anit familartë, pas fjalëve të para që fillojnë me falënderimin e All-llahut, Zotit të botëve, i lexojmë fjalët që na e kujtojnë Ditën e Ringjalljes: *"Sunduesit të Ditës së Gjykimit"*, Ditës së Llogarisë. Është kjo sure të cilën besimtari mysliman e lexon dhjetëra herë në ditë.

<sup>221</sup> En-Nahl, 39

<sup>222</sup> En-Nahl, 40

<sup>223</sup> El-Kijame, 5-6

Për çudi, Dhiata e Vjetër nuk e përmend fare Ditën e Gjykimit apo Llogarinë, ajo nuk e përmend as xhenetin e xhehenemin (dëshirën për njëri dhe frikën nga tjetra), sikur autori i librit "Kapitali" të jetë ai që e ka shkruar Tevratin! Si është e mundur që një fe të mos ua tërheqë vërejtjen të tjerëve për takimin me All-llahun? Si është e mundur që të mos e përmend fare botën e ardhme?!

Shkujdesi i tillë i bëri hebrenjtë të besojnë se janë të përjetshëm në Tokë. Kjo është pakujdesi e tillë e cila e krijoi të menduarit e tyre materialist, duke besuar se xheneti dhe xhehenemi i tyre është vetëm në këtë botë!

Megjithëse kohëve të fundit i gjejmë disa shkrime të shenjta të Dhiatës së Vjetër që e tërheqin vëmendjen për ekzistimin e xhenetit dhe xhehenemit, megjithatë kjo nuk ndikoi në zbutjen e pangopësisë së hebrenjve për jetën e kësaj bote dhe lidhshmërinë e tyre vetëm me të, sepse ata besojnë se – edhe nëse ka jetë të ardhme – ata do të jenë trashëgues të saj, ashtu siç thuhet në Kur'an: *"Unë nuk besoj se do të vijë Ora (e Kiametit), por, edhe nëse kthehem te Zoti im, sigurisht që Ai do të më japë shpërblimin më të mirë."*<sup>224</sup>

Njeriu që e vëzhgon jetën e hebrenjve, si në të kaluarën ashtu edhe sot, vëren se ata e kanë rregulluar atë në bazë të asaj se bota është e vërtetë, ndërsa ahireti është iluzion, se xheneti dhe xhehenemi janë këtu! Pikërisht për këtë Kur'ani famëlartë u drejtohet atyre me këtë sfidë dhe u thotë: *"Thuaju: "Nëse Shtëpia e jetës*

<sup>224</sup> Fussilet, 50

së përtejme (Ahireti) tek All-lahu është vetëm për ju e jo për njerëzit e tjerë, atëherë kërkon vdekjen, nëse ajo që thoni është e vërtetë. Por ata kurrsesi nuk e dëshirojnë vdekjen për shkak të të këqijave që kanë bërë! All-llahu i njeh mirë keqpërsësit. Dhe, vërtet, do t'i gjesë ata më lakmues për të jetuar sesa njerëzit e tjerë, madje, edhe se paganët. Secili nga ata dëshiron të jetojë një mijë vjet; por edhe nëse jeton aq, nuk do të mund t'i ikë dënimit! All-llahu i sheh punët e tyre të këqija."<sup>225</sup>

Kujtoj se prirjet materialiste që e mbisundojnë civilizimin modern janë pjellë e zhytjes së hebrenjve në to dhe e mosrezistencës së tyre. Musai është i pastër nga ky devijim. Ne vërejmë se në takimin e tij të parë me Zotin e tij, ai i dëgjoji dhe i pranoi këto mësimet të qarta: "Me të vërtetë, Unë jam All-llahu, s'ka zot tjetër përveç Meje, prandaj, vetëm Mua më adhuro dhe kryej faljen për të më kujtuar Mua! Ora (e Kiametit) do të vijë me siguri, por Unë e mbaj tepër të fshehur, që secili të shpërblehet për atë që ka bërë. Prandaj, mos e lër atë që nuk beson në të (Ditën e Kiametit) dhe që jepet pas epsheve të veta, të të nxjerr (nga rruga e drejtë), përndryshe do të humbisje."<sup>226</sup>

Ne kuptojmë se Kur'ani është përmbushës i Librave të mëparshme dhe mbrojtës i tyre, veçmas për mirësues i gabimeve të tyre.

Jeta jonë e shkurtër na mëson që të mos e anashkalojmë jetën e botës së ardhme, që do të jetë e përjetshme dhe kurrë nuk do të përfundojë. Kur'ani na mëson se shkujdesi i të ardhmes është tradhti, ndërsa shpërfillja e përgatitjes për të është humbje!

<sup>225</sup> El-Bekare, 94-96

<sup>226</sup> Ta-Ha, 14-16

S'ka dyshim se besimi në ahiret i ndihmon njeriut në zbutjen e vështirësive dhe i ndihmon atij që dëshiron të ngrihet lart dhe çlirohet nga barrët e pastrimit shpirtëror. Kur gratë e të Dërguarit s.a.v.s. u zemëruan me të për shkak të mënjanimit të tyre nga jeta luksoze<sup>227</sup> dhe të mirat që i kishin të tjerët, ai u tha: *"Mbahuni fort, nëse jeni që e kërkonit dhe e dëshironi jetën e ahiretit: "Nëse e dëshironi jetën e kësaj bote dhe shkëlqimin e saj, e jani, unë do t'ju lë të kënaqeni për ca kohë dhe do t'ju lëshojë si është më mirë. Por, nëse dëshironi All-llahun, të Dërguarin e Tij dhe botën tjetër, dijeni se All-llahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato prej jush që bëjnë vepra të mira."*<sup>228</sup>

Ne duam t'i fitojmë të mirat e dynjasë dhe të ahiretit! Mirëpo, çfarë ndodhë kur njeriu e zgjedh vetëm

<sup>227</sup> Shtëpia e Pejgamberit nuk është shtëpi mbreti ose sunduesi. Ajo është shtëpi e cila mjaftohet me pajisjet më të pakta. Në të nuk ka vend për lakmi, dëfrime e pasione të ndryshme të cilat përmbushen pandërprerë. Ndryshe nga shtëpitë e mbretërve, i Dërguari ishte tejet modest, i denjë, i përshtatshëm, i respektueshëm, njeri tejet i turpshëm. Sidoqoftë, i Dërguari kishte vendosur që të jetonte jashtë suazave të jetës së bukur. Atë nuk e preokuponin ushqimet e ndryshme, në jetën e tij nuk kishte vend për grumbullimin e sasive të mëdha të ushqimeve të ndryshme për jetë luksoze. Mirëpo, bashkëshortet e tij vinin nga familjet e pasura dhe fisnike, ato ishin rritur me jetë komfore dhe me të gjitha të mirat. Nuk do të kalojë shumë kohë e së shpejti të gjitha ato do të bashkohen kundër tij duke kërkuar shpenzime më të mëdha dhe jetë më luksoze!!

Sidoqoftë, shpallja e All-llahut erdhi që ta rregullonte dhe stabilizonte këtë situatë faktike të tyre. Shpallja kur'anore do të vë në dukje se shtëpia e Pejgamberit është shtëpi së cilës i mjaftojnë sasitë e vogla të ushqimit (edhe buka e thatë), edhe pse i zoti i shtëpisë (Pejgamberi) është i pari i gjithë Gadishullit Arabik dhe prijësi i gjithë njerëzve! Shpallja gjithashtu bëri të ditur se bashkëshortet e Pejgamberit janë të detyruara ta mbajnë barrën e postit të tij të rëndësishëm, të preokupohen me namaz, xhihad dhe kërkim të ahiretit.

<sup>228</sup> El-Ahzab, 28-29

njërën prej tyre dhe detyrohet që në këtë botë të jetojë me sasi të pakta të të mirave, me qëllim që kështu t'i fitojë të mirat e përhershme dhe të mëdha të ahiretit?

Muxhahidët (luftëtarët islamë) dhe familjet e tyre janë të parët që trajtohen me këtë ligj, edhe pse prej tyre pati që i shijuan të mirat e kësaj bote dhe të mirat e botës tjetër. Transmeton Hababi dhe thotë: *"U shpërngulëm me të Dërguarin e All-llahut me qëllim që ta arrijmë kënaqësinë e All-llahut, andaj edhe u shpërblyem nga All-llahu. Prej nesh kishte të tillë që kishin vdekur më herët dhe nuk i shijuan shpërblimet e tyre! Por, pati edhe të tillë, fryti i të cilëve u poq dhe ai i voli dhe u kënaq me to."*<sup>229</sup>

Shtëpia e Pejgamberit është shtëpi e cila mjaftohet me pajisjet më të pakta, në të nuk ka vend për lakmi, dëfrime e pasione të ndryshme të cilat përmbushen pandërprerë. Ndryshe nga shtëpitë e tjera, i Dërguari ishte tejet modest, i denjë, i përshtatshëm, i respektueshëm, njeri tejet i turpshëm, ai ishte i preokupuar me namaz, ibadet dhe xhihad. Transmeton Ummu Seleme se i Dërguari s.a.v.s. u ngrit një natë nga gjumi, dhe tha: *"I Lartëmadhëruar qoftë All-llahu! Çfarë trazira (fitne) kanë zbritur sonte? Çfarë thesaresh janë hapur? Kush do t'i zgjojë ata që janë në dhoma (do të thotë: gratë e tij)? Mjerë ai që në këtë botë ka qenë i veshur, kurse në Ditën e Kiametit do të jetë i zhveshur (lakuriq)."*<sup>230</sup>

Namazi i natës është më i bukur dhe më i frytshëm se gjumi i natës në shtrat. Nuk ka dobi në stolitë e kësaj bote nëse ato janë të dëmshme në botën tjetër.

<sup>229</sup> Fet'hu-l-Bari, II, fq. 142, numër: 1276

<sup>230</sup> Fet'hu-l-Bari, I, fq. 210, numër: 115/ Dituria.

Mendarët e llogarisin vlerë të madhe morale përgatitjen e njerëzve për të ardhmen. Dallimi qëndron në përkufizimin e të ardhmes; disa njerëz atë e mendojnë të nesërmen e deri në momentin e vdekjes! Shumë njerëz sot mendojnë kështu. Këta e njohin të ardhmen vetëm brenda këtyre suazave të ngushta! Nëse ndonjëri thotë: "Unë mendoj për të ardhmen!", ai e ka për qëllim të nesërmen e afërt dhe pleqërinë që i vjen.

Njerëzit sot shumë pak mendojnë për botën e ardhme (jetën e ahiretit) dhe përgatitjet për atë jetë, edhe përkundër asaj se në çdo moment hasim qindra njerëz që vdesin dhe qindra qortime që vijnë nga çdo anë: *"Po u afrohet njerëzve dita për të dhënë llogari, por ata vazhdojnë të jenë të shkujdesur e të shmangur (nga e vërteta). Sa herë që atyre u vjen nga Zoti i tyre ndonjë paralajmërim i ri, ata e dëgjojnë, duke u tallur me të."*<sup>231</sup>

Besimtarët e denjë e të vetëdijshëm e dinë se e ardhmja e vërtetë e përfshin tokën dhe qiellin, se ajo i përfshin pak vite të numëruara të jetës në këtë botë, edhe nëse ato janë me dhjetëra, se jeta e vërtetë, e përjetshme dhe e pambaruar është jeta e ahiretit, pra pasi të shkojmë nga kjo botë. Kjo na bën ta kthejmë vëmendjen drejt Kur'anit famëlartë i cili e përshkruan ahiretin me "nesër". All-llahu i Madhërishëm thotë: *"O besimtarë, frikësojuni All-llahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë All-llahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju! Mos u bëni si ata që e harruan All-llahun, kështu që Ai i bëri të harronin vetveten!"*<sup>232</sup>

<sup>231</sup> El-Enbiya', 1-3

<sup>232</sup> El-Hashr, 18-19

Kjo e bëri poetin e mençur të thoshte:

*Për njeriun nuk ka shtëpi tjetër që do të banonte,  
Përveç asaj të cilën para vdekjes e pati ndërtuar*

*Morali i atyre që e dëshirojnë  
dhe e kërkojnë ahiretin*

Ndërtimi i Ahiretit kërkon vlera të veçanta morale! Ai që i dëshiron kënaqësitë e mëdha të epshit, merr ryshfet, uzurpon të drejtën e tjetrit dhe e hanë haramin. Vendi i tij do të jetë vend i shëmtuar, plot dëshpërim dhe mundim. I Dërguari s.a.v.s. thotë: *"Xhehenemi do të jetë më afër atij, mishi i të cilit është rritur me haram."*<sup>233</sup>

Shumica e njerëzve më duken sikur të çmendur nga prekja e djallit, ndaj rendin në tokë sikur egërsira: çdo gjë që bie në kthetrat e tyre, e gëlltisnin me shpejtësi. Këta janë ata që e vjedhin pasurinë dhe famën dhe përnjëherë i gëlltisnin gjërat që u dalin përpara, pa frikë se mos ndoshta janë të ndaluara ose ta kenë për qëllim vetëm të lejuarën. Këta nuk i dallon asgjë nga egërsirat e malit! Këta nuk e besojnë All-llahun e as Ditën e Ahiretit, andaj është e pamundur që ata t'i ndryshojnë sjelljet e tyre, ngase vetëm besimi i shëndoshë është ai që i ndryshon këta dhe sjelljet e tyre.

<sup>233</sup> *Et-Tergîb ve'l-Terkîb*, II, fq. 547



Ndërkaq ata që besojnë në All-llahun dhe në Ditën e Ahiretit, ata janë të ndryshëm. Ata u frikësohen gjërave të dyshimta, e duan pastërtinë e fesë dhe të nderit, janë të preokupuar me botën e ardhme më shumë se që janë të preokupuar me jetën e dynjasë, i kuptojnë thellë fjalët e All-llahut të Madhërishtëm: *"Jeta e kësaj bote, nuk është gjë tjetër, veçse argëtim dhe lojë. Ndërsa jeta e botës tjetër, pikërisht ajo është jeta e vërtetë. Veç sikur ta dinin!"*<sup>224</sup>

Ibn Is'haku, gjatë përshkrimit të myslimanëve në Luftën e Uhudit, thotë: "Ebu Dexeane ishte burrë trim dhe arrogant (kryelartë) para fillimit të luftës; ai kishite një fashë të kuqe me të cilën kur lidhej, bënte me dije se do të luftonte deri në vdekje."

Si mund të tregohet arrogant njeriu i cili përgatitet për luftë me armikun dhe e pret vdekjen nga kjo luftë? Në shpirtin e këtij njeriu nuk ka vend për frikë. Në të sikur kanë humbur ndjenjat e frikës. Ai e sheh vdekjen si një transferim që do ta shpinte atë në librin e Il-lijunëve (emrat e të cilëve janë të shkruara diku lart)!

Le të ecë kryelartë mbi tokë, se ndoshta prej saj do të dalë që të niset drejt Firdeusit më të lartë (kopshtit më të bukur në xhenet), pikërisht në çastin kur ai bie shëhid!

Të parët tanë u bënë shëmbull i lartë për atë se si duhet të kujdesemi për jetën e ahiretit dhe për guximin në vdekje!

S'ka dyshim se brezat që erdhën pas tyre, që sot e kanë mbushur tokën, treguan shëmbull të keq në dashurinë e jetës së kësaj bote dhe në urrejtjen e vdekjes.

<sup>224</sup> El-Ankebut, 64

Disa myslimanë besojnë se për dynjanë vlejnë punë që nuk janë të njëjta me punët e ahiretit, se punët e dynjasë janë zanatet e ndryshme, ushqimi etj., ndërsa punët e ahiretit janë namazi, leximi i Kur'anit etj., se për njërën vlen një kohë, ndërsa për tjetrën një kohë tjetër!

Kjo ndarje duhet të shqyrtohet, sepse është një ndarje formale dhe e parëndësishme. Rruga e jetës është një dhe koha e saj është një! E mira dhe e keqja i referohet lëvizjes së zemrës dhe qëllimit të saj; ai i cili ushqehet për të qenë i fuqishëm në kryerjen e detyrave që i ka ndaj All-llahut, është i mirë, ndërkaq ai që falet për të fituar pozitë në mesin e njerëzve, është i keq. Veprat formale nuk kanë vlerë dhe janë të parëndësishme, sidomos nëse nuk e kanë thelbin e tyre. Vlera e tyre duket në lëvizjet e jetës dhe boshtit rreth të cilit sillet jeta.

Janë fjalët e All-llahut të Madhërishëm ato që na mësojnë për këtë: *"Ne i çojmë të dërguarit vetëm si sjellës të lajmeve të mira dhe qortues. Pra kushdo që i beson ata dhe bën mirë, nuk do të frikësohet e as nuk do të pikëllohet. Kurse ata që mohojnë shpalljet tona, do t'i godasë dënimi për shkak të mohimit."*<sup>235</sup>

Hadithet autentike të Dërguarit s.a.v.s. na mësojnë se të parët që do t'i prekë zjarri i xhehenemit do të jenë ata që duan vetëm të duken kur e falin namazin, kur lexojnë dhe kur luftojnë. Gjithashtu këto hadithe na bëjnë me dije se përmirësimi i marrëdhënieve bashkëshortore është një lloj afrimi tek

<sup>235</sup> El-En'am, 48-49

All-llahu i Madhërishëm. Në Ditën e Llogarisë do të shpëtojë ai që jetën dhe punën e ka vetëm për hir të All-llahut, që është i orientuar vetëm kah Ai dhe që është përgatitur me ndjenja, fuqi dhe aftësi për takim me All-llahun.

Krijimi i dallimit mes çështjeve të dynjasë dhe çështjeve të ahiretit, duke e shpërfillur lëvizjen e zemrës, ishte pasoja që qëndroi pas ngeçjes së turpshme e cila e goditi Umetin tonë dhe e bëri të paaftë në përhapjen e misionit të tij, bile të paaftë edhe për ta ndihmuar vendin e tij.

Kur'ani famëlartë flet për dynjanë dhe për ahiretin si dy gjëra të pandara. Cila është ajo dynja për të cilën na flet pra Kur'ani famëlartë? Është dynjaja që rri e shkëputur nga All-llahu, edhe në qoftë se njerëzit duan vetëm të duken në emër të Tij dhe të bëjnë tregti me fenë e Tij; mosnjohja e duhur, ashpërsia e zemrës dhe qëllimi i keq, janë sëmundje që i shkatërrojnë ibadetet dhe e pengojnë ngritjen e tyre në qiell.

Ndoshta gjynahu i atyre që sot rrinë larg All-llahut është mbi shpinën e atyre që nuk dinë ta sjellin fjalën e All-llahut te zemrat e tyre dhe nuk janë të aftë ta bartin barrën e predikimit.

Në Kur'anin famëlartë gjejmë kërcënime që vlejnë për të gjithë ithtarët e Librit. Në mesin e tyre janë edhe myslimanët që nuk iu frikësuan All-llahut. Le t'i shqyrtojmë me vëmendje fjalët e All-llahut: "E All-llahut është gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Ne i kemi porositur ata që u është shpallur Libri para jush dhe juve: *"Frikësojuni All-llahu! Nëse mohoni, dijeni se All-llahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë.*

*All-llahu është i Vetëmjaftueshëm dhe i Denjë për çdo lavdërim.*<sup>226</sup>

Pas këtyre fjalëve vjen përsëri kërcënimi tjetër për hebrejtë, të krishterët dhe myslimanët, se nëse nuk bëjnë mirë në tokë, All-llahu do t'i dëbojë dhe në vend të tyre do të sjellë të tjerë: *"Nëse do, Ai ju dëbon or njerëz dhe sjell të tjerë. All-llahu ka fuqi ta bëjë këtë."*<sup>227</sup>

Kërcënimi me zhdukjen (dëbimin) e brezave të dështuar dhe zëvendësimi me të tejrë që do të jenë më të mirë dhe të denjë për çdo lavdërim është i përsëritur në shumë vende të Kur'anit famëlartë.

Pas kësaj All-llahu i Madhërishëm thotë: *"Kush dëshiron shpërblimin e kësaj bote, (le ta dijë) tek All-llahu janë shpërblimi i kësaj dhe i botës tjetër. All-llahu dëgjon dhe vështron çdo gjë."*<sup>228</sup>

Kuptimi i kësaj është ky: Le të mbetet i rrëzuar përtokë ai, ambiciet e të cilit nuk i kapërcejnë kufijtë e dheut dhe të pluhurit të tokës, ndërkaq ai që i kërkon horizontet e larta, (le ta dijë) All-llahu nuk ka për t'ia humbur punën, Ai e dëgjon fjalën e tij dhe e vështron punën e tij.

Këto fjalë i shëmbëlajnë shpjegimit të All-llahut të Madhërishëm për Luftën e Uhudit dhe sjelljes së atyre që e deshën durrues dhe të atyre që e deshën ahiretin: *"Çdo shpirt vdes vetëm me vendimin e All-llahut, në kohë të caktuar. Kush dëshiron mirësitë e kësaj bote, Ne do t'i japim atij prej saj, ndërsa kush dëshiron shpërblimin e botës tjetër, Ne do t'i japim atij prej saj. Ne do t'i shpërblejmë mirënjohësit."*<sup>229</sup>

<sup>226</sup> En-Nisa', 131

<sup>227</sup> En-Nisa', 133

<sup>228</sup> En-Nisa', 134

<sup>229</sup> Ali-Imran, 145

Rreth fjalëve të All-llahut të Madhërishëm që i nënkuptojnë ata që i dëshirojnë mirësitë e kësaj bote dhe ata që i dëshirojnë mirësitë e botës tjetër, është i nevojshëm një shpjegim më i gjerë. Janë fjalët e All-llahut në Kur'an që e japin këtë shpjegim: *"Atyre që duan jetën e kësaj bote dhe bukuritë e saj, Ne do t'ua shpërblejmë krejtësisht punët e tyre dhe në të nuk do t'u lihet gjë mangët. Këta janë ata për të cilët në botën tjetër nuk do të ketë kurrgjë, përveç zjarrit. Do t'u shembet çdo gjë që e kanë bërë në këtë jetë dhe do t'u zhvlerësohet ajo që kanë punuar."*<sup>240</sup>

Ajetet e cituara nënkuptojnë se individë dhe popuj janë ata që do të jetojnë vetëm për mirësitë e kësaj bote. Atyre nuk do t'u interesojë fare ajo që është pas kësaj jete, sepse do t'i harxhojnë fuqitë dhe aftësitë e tyre për arritjen e të mirave të kësaj jete, për dëfrimin me to, pa e falënderuar Krijuesin e tyre ose pa e njohur Atë siç duhet.

All-llahu i Madhërishëm na e bën të qartë se Ai ua dha atyre të gjitha ato që ata i kërkuan dhe se asgjë atyre nuk do t'u lihet mangët nga këto gjëra! Por, këta nuk do të kenë hise në të mirat e botës tjetër, sepse nuk çanë kokë për të dhe nuk treguan interesim për të. Ata mbetet që në botën tjetër ta marrin shpërblimin e plotë të mohimit të tyre dhe harresën e Zotit të tyre; qëndrimin e përjetshëm në xhehenem!

Vallë, a thua çdo mohues jeton i lumtur në këtë botë? Megjithëse rraskapitet duke rendur pas dynjasë dhe i duke i synuar të mirat e saj, mohuesit të All-lla-

<sup>240</sup> Hud, 15-16

hut nuk i takon e drejta që duhet ta përmbushë All-llahu, andaj edhe puna e tij në këtë botë nuk ka çmim të caktuar që Ai duhet t'ia paguajë! Sunduesin e robërve të Vet nuk mund ta sfidojë asnjëri. Pikërisht për këtë Ai i sjell ajetet e tjera që e bëjnë edhe më të qartë këtë çështje: *"Sa për atë që e dëshiron këtë botë, ne shpejtojmë që t'i japim çfarë të dëshirojmë atij që duam. Pastaj ia caktojmë atij xhehenemin, në të cilin ai do të përvëlohet, duke qenë i turpëruar dhe i dëbuar. Sa për atë që dëshiron botën tjetër dhe përpiqet për të me gjithë shpirt e duke qenë besimtar, përpjekja e tij do të shpërblehet."*<sup>241</sup>

Të gjallët lëvizin brenda një sferë (kufijve) të përkryer të bërë nga vullneti i lartë i All-llahut të Madhërishëm; pasuria, varfëria, lumturia, dëshpërimi etj., të gjitha janë nga ky vullnet.

All-llahu i Madhërishëm nuk ia jep çdo mohuesi (jobesimtari) atë që ai e dëshiron në jetën e kësaj bote. Ai dikujt i jep, e dikujt jo. Por, edhe nëse dikujt i jep, atëherë nuk i jep çdo gjë që ai e dëshiron, por i jep aq sa dëshiron All-llahu nga mirësitë e kësaj bote!

Dallimi i njerëzve në furnizime (risk) është i lidhur ngushtë me sprovën hyjnore për ta. All-llahu është Ai që mes njerëzve e shpërndan fitimin (bukën e gojës) dhe pasurinë në këtë jetë, gjithë kjo në përputhshmëri me principet dhe caktimet të cilat i di vetëm Ai. S' do mend se në këto gjëra nuk duhet parë mënjanimin e ndonjërit ose privilegjin e tjetrit. All-llahu është Ai i cili sprovon me pasuri dhe varfëri. Pasuria e ndonjërit nuk është shenjë e kënaqësisë së Tij, por as varfëria e

<sup>241</sup> El-Isra', 18-19

ndonjërit nuk është shenjë e hidhërimit të Tij: *“Ne i mbështesim të gjithë me dhuratat e Zotit tënd: edhe këta, edhe ata. Dhuratat e Zotit tënd nuk i mohohen askujt.”*<sup>242</sup>

Ne nuk kemi frikë se mund të ndodhë ndonjë e padrejtë nga Zoti ynë, sepse Ai nuk e dëmton askënd asnjë grimë! Ne e kemi frikë vetëm zvogëlimin e mirësisë së lartë të All-Ilahut (që na jepet).

Askush nuk mund t'i kontrollojë mirësitë e larta të Tij. Ai ua jep ato vetëm atyre që i përgjigjen plotësisht dhe që i shprehin dhuratat e Sunduesit të Plotfuqishëm. Tërë çështja i takon vetëm Atij, vetëm Ai përgjigjet dhe ngritë: *“Shiko, si Ne i parapëlqejmë disa ndaj të tjerëve. Kurse bota tjetër, në të vërtetë, do të ketë shkallëzime më të mëdha dhe parapëlqime më të theksuara.”*<sup>243</sup>

Në vijim do t'i sjellim disa hollësi të përmendura në Kur'anin familjar dhe në Sunetin e pastër të të Dërguarit s.a.v.s. që flasin për gjendjen e njerëzve në Ditën e Llogarisë.

Njerëzit, para se të ndodhë ringjallja, do t'i kaplojë frika dhe befasia, do t'i pushtojë heshtja të cilën herë pas here do ta ndërpresë pyetja e habitshme: *“Ditën kur do të fryhet në Sur, pikërisht atë Ditë do t'i tubojmë të ligjtë me sy të zgurdulluar. Duke i pëshpëritur njëri-tjetrit: “Ju keni qëndruar (në dynja) vetëm dhjetë ditë.”*<sup>244</sup>

*“Atë ditë, ata do të shkojnë pas thirrësit, pa iu shmangur dot atij dhe do t'i ulin zërat para të Gjithëmëshirshmit. Ti nuk do të dëgjosh tjetër, veç pëshpëritjes.”*<sup>245</sup>

<sup>242</sup> El-Isra', 20

<sup>243</sup> El-Isra', 21

<sup>244</sup> Ta Ha, 101-102

<sup>245</sup> Ta Ha, 108

Llogaria hyjnore do t'i përfshijë të gjitha krijesat. Transmeton Adijj ibn Hatim se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: "Nuk do të ketë askush, të cilit Zoti i tij nuk do t'i flasë në Ditën e Kiametit. Mes Tij dhe robit nuk do të ketë ndërmjetësues (përkthyes)<sup>246</sup>. Njeriu do të shikojë në të djathtë dhe nuk do të shohë tjetër, veçse atë që e ka punuar (që e ka sjellë me vete). Pastaj do të shikojë në të majtë dhe nuk do të shohë tjetër, veçse atë që e ka punuar (që e ka sjellë me vete). Pastaj do të shikojë përpara dhe nuk do të shohë tjetër, veçse xhehenemit që ndodhet para syve të tij. Andaj ruajuni xhehenemit, qoftë edhe me një kokërr hurme (që e jepni sadaka)."<sup>247</sup>

Duket se disa do ta kenë fatin e llogarisë së lehtë dhe nuk do t'u merren parasysh shumë e shumë gjërat që i kanë bërë. Këta duket se do të shpëtojnë me mirësinë e All-llahut të Madhërishëm. Transmetohet se i Dërguari s.a.v.s. ka thënë: "Do të ndodhë që ndonjëri prej jush të jetë shumë afër Zotit të tij, sa që Zoti do t'ia vë dorën mbi shpatullë dhe do t'i thotë: "A e ke bërë këtë e këtë? Po, do të thotë ai! Ai do t'i thotë: "A e ke bërë këtë e këtë? - Po, do të përgjigjet ai! - duke i vërtetuar gjynahet që i ka bërë. Pastaj All-llahu do të thotë: "Unë t'i kam mbuluar ato në dynja, kurse ja sot Unë t'i fali...!"<sup>248</sup> Pastaj atij i jepet libri i të mirave. Ndërsa jobesimtarët do të thirren nga një vend i lartë, prej ku do të shihen nga të

<sup>246</sup> All-llahu i di të gjitha gjuhët. Ai do të flet me arabët dhe të tjerët pa ndërmjetësues.

<sup>247</sup> Ibn Maxhe, vëll. 1-të fq. 590, numër: 1843

<sup>248</sup> Fet'hu-l-Bari, XIII, fq. 483, hadithi numër 7514. *Kitabu Et-Tevid* Kapitulli: Biseda e Zotit të Madhërishëm në Ditën e Kiametit me të dërguarit dhe të tjerët.



gjithë: "Këta janë ata që kanë gënjer për Zotin e tyre. Mallkimi i All-llahut qoftë mbi të padrejtët."<sup>249</sup>

Për çudi disa gjynahqarë do t'i kundërshtojnë gjërat që i kanë bërë, do të mëtojnë t'i mohojnë dhe të betohen se janë të pafajshëm! All-llahu i Madhërishëm thotë: "Atë ditë kur do t'i tubojmë të gjithë, Ne do t'u themi idhujtarëve: "Ku janë idhujt tuaj, për të cilët thoshit se ishin ortakë të All-llahut!" Ata nuk do të mund të shfaqësohen ndryshe, veçse duke thënë: "Betohemi në All-llahun, Zotin tonë, nuk kemi qenë idhujtarë!"<sup>250</sup>

Duket se sajimi i shpifjeve dhe trillimeve me të cilat jetuan disa njerëz në dynja do të mbeten me ta deri në çastin e fundit, duke mëtuar të krijojnë zhurmë dhe kështu t'i shpëtojnë llogarisë! All-llahu i Madhërishëm thotë: "Ditën, kur All-llahu t'i ringjallë të gjithë, ata do t'i betohen Atij, ashtu siç të betohen ty tani, duke menduar se kjo do t'ju sjellë dobi. Në të vërtetë, pikërisht ata janë gënjeshtarët."<sup>251</sup>

Hadithet e të Dërguarit s.a.v.s. na bëjnë me dije se në Ditën e Kiametit do të pyetet dyfytirëshi për atë se çfarë ka bërë? Ndërsa ai, duke dashtë ta mbrojë vetveten, i thotë All-llahut: "O Zot, të besova ty, e besova Librin Tënd dhe të dërguarit e Tu, u fala, agjërova dhe kam

<sup>249</sup> Hud, 18

Disa besimtarë që në jetë kanë gabuar dhe gjatë kohë nuk janë penduar, ata do të ballafaqohen me mëshirën e All-llahut. S'ka dyshim se punët e tij i di vetëm All-llahu, andaj Ai nga mëshira e Tij e madhe dhe falja e Tij e gjerë do t'ia mbulojë ato në Ditën e Kiametit, ashtu sikur i ka mbuluar në dynja. Ndërkaq, të humburit dhe projektuesit e devijimit do të ballafaqohen me llogari tjetër.

<sup>250</sup> El-En'am, 22-23

<sup>251</sup> El-Muxhadele, 18

*dhënë sadaka; ai e lavdëron sa mundet!! Atëherë All-llahu i thotë: "Eja pra këtu, do të thotë, eja të dëgjosh se çfarë do të bëhet me ty. Pastaj i thotë: "Tani do të sjellim një dëshmitar që do të dëshmojë kundër teje. Ai do të mendojë në vete se cili mund të jetë ai dëshmitar që do të dëshmonte kundër meje? Atëherë All-llahu ia mbyll gojën dhe i thotë këmbës së tij, mishit dhe eshtrave të tij: Flitni! Dhe flet këmba e tij, mishi dhe eshtrat, të gjitha do të flasin për punët që i kanë bërë! Që të mos mendojë se e meriton të shpëtojë. Ky është dyfytirëshi me të cilin All-llahu i Madhërishëm është i zemëruar."<sup>252</sup>*

Jobsimtarët do të përpiqen t'i diskutojnë dhe t'u ikin disa vendeve, por do të detyrohen të pranojnë se në shumë vende të tjera ishin gjynahqarë. All-llahu i Madhërishëm thotë: "Kush është më keqbërës se ai që trillon gënjeshtër kundër All-llahut ose që mohon shpalljet e Tij? Atyre do t'u jepet çfarë u është caktuar (në Levhi Mahfudh). E, kur t'u vijnë të dërguarit Tanë (engjëjt), për t'ua marrë shpirtin, do t'u thonë: "Ku janë idhujt që i adhuroni në vend të All-llahut?" Ata do të thonë: "Na braktisën." Kështu ata dëshmojnë kundër vetes, që kanë qenë mohues."<sup>253</sup>

Vrasësi që është nisur për t'u ekzekutuar me varje nuk pyet e as nuk flet. Kështu ndodh me kriminelët në Ditën e Gjykimit: "Atë Ditë njerëzit dhe xhindet nuk do të pyeten për gjynahet e tyre."<sup>254</sup>

<sup>252</sup> Muslimi, vëll. IV, fq. 2280, numër: 2968

<sup>253</sup> El-A'raf, 37

<sup>254</sup> Er-Rahman, 39

Sepse atë ditë besimtarët dhe keqbërësit do të njihen nga shenjat e tyre.

Mirëpo, gjatë verifikimit, ai do të pyetet për punën e tij, pra për atë që ka bërë. All-llahu i Madhërishtëm thotë: *"Ndalni ata, se do të pyeten."*<sup>255</sup>

Njerëzit do të llogariten në vende të ndryshme dhe me metoda të ndryshme. Çdo tekst kur'anor do të përshtatet sipas vendit dhe metodës.

Dita e Llogarisë së pritur është ditë e rëndë! Vallë, çfarë thua për ditën në të cilën do të pyeten të gjithë njerëzit, duke filluar nga krijesa e parë e deri në mbarimin e rraskapitjes mbi këtë tokë?

All-llahu i Madhërishtëm thotë: *"Ajo është Dita në të cilën do të tubohen të gjithë njerëzit, dhe ajo është Ditë e dëshmuar. Dhe ne e shtyjmë atë vetëm gjer në afatën e caktuar. Kur të vijë ajo ditë, njeriu mund të flasë vetëm me lejen e Tij. Disa prej tyre do të jenë fatkëqij e disa fatlumë."*<sup>256</sup>

Pyetjet e rënda do t'u drejtohen individëve dhe popujve. Individu do të përgjigjet për veten e tij, për t'i treguar se çfarë ka punuar për të nesërmen e tij? I Dërguari s.a.v.s. thotë: *"Në Ditën e Kiametit do ta sjellin të birin e Ademit që do të jetë sikur një qengj – i porsalindur dhe i dobët – e do të ndalet para All-llahut, i Cili do t'i thotë: "Të dhashë, të pasurova dhe t'i dhurova të gjitha të mirat, andaj çfarë bëre ti me to? Ai do të thotë: "O Zot, e grumbullova dhe e rrita, e bëra më shumë se që ishte, më kthe (në dynja) të ta sjellë!! All-llahu do t'i thotë: "Më trego se çfarë ke sjellë...! Ai do të thotë: "O Zot, e grumbullova dhe e rrita, e bëra më shumë se që ishte, më kthe (në dynja) të ta sjellë!! Në fund do të dalë se rob i nuk ka asnjë*

<sup>255</sup> Es-Saffat, 24

<sup>256</sup> Hud, 103-105

*të mirë për ta treguar dhe kështu urdhërohet të vazhdojë drejt xhehenemit.*"<sup>257</sup>

Në Ditën e Gjykimit do të llogariten individët, shoqëritë, civilizimet dhe popujt se a e ndihmuan njëri-tjetrin në punë të mira apo e mbështetën njëri-tjetrin në punë të këqija.

All-llahu i Madhërishëm thotë: *"I All-llahut është pushteti i qiejve dhe i Tokës! E kur të arrijë Ora (e Kiametit), atë ditë mohuesit do të humbasin. Atëherë të gjithë popujt do t'i shohësh të gjunjëzuar. Çdo popull do të thirret me Librin e vet (do t'i thuhet): "Sot do të shpërbleheni për atë që keni bërë."*<sup>258</sup>

Historia e njeriut në këtë botë është e mbushur përplot me padrejtësi. Pak më parë dëgjova se kishin kaluar 200 vjet nga zbulimi i Australisë. Vallë, çfarë ndodhi me banorët autoktonë? Biseda për këta njerëz mbetet vetëm pëshpëritje e disa zërave që mezi dëgjohehen. Dëbimi i tyre u bë në heshtje të plotë, askush nuk morri vesh se çfarë u ndodhi. Për dëbimin e tyre u përdorën metodat më çnjerëzore, ndërsa raca e bardhë okupuese e trashëgoi tokën për ta përpunuar dhe për t'u treguar kryelartë mbi të. Kështu harroi se ç'ka bërë me duart e saj më parë!

E njëjta ndodhi edhe me Amerikën. Banorët autoktonë të këtyre vendeve i ndoqi vdekja deri në zhdukje. Andaj mos ia vë veshin pretendimeve të njerëzve që e ngritin lart kryqin, ndërsa nën hijet e tij i fshehin instinktet e egërsirave!! Shumë njerëz u mashtruan me këto pretendime, por Dita e Kiametit

<sup>257</sup> Tirmidhiu, vëll. IV, fq. 534, numër: 2427/ Përsëritimi i Kiametit

<sup>258</sup> El-Xhathije, 27-28

do t'i demaskojë kriminelët keqbërës, qofshin individë ose shoqëri.

All-llahu i Madhërishëm na mëson se Ai do ta vendosë drejtësinë në atë ditë dhe do t'u hakmerret zullumqarëve. Ai thotë: *"Ai është zotëruar i cilësive më të larta dhe Zot i Fronit. Ai e dërgon Shpalljen me urdhrin e Tij tek ata, që ka zgjedhur prej robërve të Vet, për t'i paralajmëruar për Ditën e Takimit me Atë; për Ditën, kur ata do të paraqiten të zbuluar, kur asgjë e tyre nuk do të jetë e fshehtë për All-llahun. Kujt i përket pushteti i asaj dite? All-llahut, të Vetmit, Ngadhënjimtarit! Atë ditë, çdo njeri do të shpërblehet sipas asaj që ka punuar; atë ditë nuk ka padrejtësi! All-llahu, me të vërtetë, është i shpejtë në llogari."*<sup>259</sup>

Jeta e kësaj bote është mejdan i sprovës, e jo vendtakim i shpalljes së rezultateve dhe i zbatimit të drejtësisë! Jeta e kësaj bote është provim i ndërlikuar dhe i rëndë. Ndodhë që në këtë jetë të mbyten të dërguar dhe të bien shchidë, të përhapen shpifje e trillime se kinse janë të vërteta, të mësohet për gjëra të sajara e të pavërteta e të thuhet se janë dituri e dobishme, por patjetër do të ndodhë dita kur do të ndodhë rregullimi i këtyre kriterëve të kundërta dhe do të përmirësohen gjendjet e gabuara! Doemos të ndodhë Dita e Kiametit: *"Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre: kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë."*<sup>260</sup>

Për fat të keq, shumë njerëz qëndrojnë larg kësaj të vërtete! A thua Iblisi (djalli) ishte i mençur kur pa-

<sup>259</sup> El-Gafir, 15-17

<sup>260</sup> Ez-Zelzele, 6-8

ralajmëroi se bijtë e Ademit do të preokupohen me jetën e kësaj bote dhe do ta lënë anash jetën e botës tjetër? Ai e priste këtë prej tyre. All-llahu i Madhërishëm thotë: *“Me të vërtetë, hamendja e Iblisit për ata u vërtetua; ata shkuan pas tij, përveç një grupi besimtarësh të vërtetë. Por ai (Iblisi) nuk ka pasur kurrfarë pushteti mbi ta. Ne vetëm kemi dashur të zbulojmë se kush beson në jetën tjetër e kush dyshon në të. Zoti yt është Mbikëqyrës i çdo gjëje.”*<sup>261</sup>

Sa kohë do të zgjasë llogaria e njerëzve dhe si do të përfundojë ajo? Ne nuk e dimë saktë këtë, Kur’ani i përmend vetëm përmbajtjet kryesore dhe më të rëndësishme të cilat duhet t’i dinë besimtarët!

Një njeri e kishte pyetur Ali ibn Ebi Talibin (All-llahu i Madhërishëm qoftë i kënaqur me të): Si do t’i llogaritë All-llahu njerëzit përnjëherë, ngase ata janë shumë? Ai ishte përgjigjur: “Sikur që i ushqen përnjëherë, edhe pse janë shumë.”

S’ka dyshim se All-llahu i njëh bijtë e Ademit, qysh kur ata ishin familje e vogël, e deri sa u bënë familje e madhe e u shtrinë nëpër qytete e fshatra dhe u bënë numër që s’numërohen dot! Çdo njeri që do të jetë në këtë grumbull të madh të njerëzve do ta ndiejë se ballafaqohet me punët që i ka bërë dhe do të marrë shpërblimin e asaj që e kanë vjelë duart e tij. Atë ditë nuk ka padrejtësi e as harresë!

Në këtë Ditë të Madhe do të dëgjoen dy zëra të kundërt: njëri prej tyre sjell lajmin e gëzimit, kurse tjetri lajmin e mjerimit! Zëri i parë do të jetë për besimtarin, të lumtur dhe fytyrëqeshur, që thotë: *“Ja, le-*

<sup>261</sup> Es-Sebe’, 20-21

*xoni librin tim! Vërtet, unë kam qenë i bindur se do të jepja llogari." Kështu, ai do të ketë jetë të lumtur, në një kopsht të lartë, frutat e të cilët do t'i kapë lehtë."<sup>262</sup> Ndërkaq zëri i dytë do të jetë për jobesimtarin, të penduar, fytyrëzë dhe të brengosur, që thotë: "Ah, sikur të mos më ishte dhënë libri im. Dhe të mos e kisha ditur llogarinë time! Ah, të kisha qenë i vdekur (e të mos isha ringjallur)! Pasuria ime nuk më sollí dobi dhe më la fuqia ime!"<sup>263</sup>*

Kujtoj se është e udhës që në vijim të sjellim një koment tematik të sures El-Vakia (Ndodhia e Kiametit) ku do të hasim në shumë hollësi që kanë të bëjnë me ato që i përmendëm më herët.

### *Koment tematik i sures El-Vakia (Ngjarja e Kiametit)*

El-Vakia është një nga emrat e shumtë të Ditës së Kiametit (Ringjalljes), krahas shumë emrave të tjerë që hasen në Kur'anin famëlar të e që kanë të bëjnë me këtë ditë, si p.sh.: El-Hakka (Çasti i katastrofës së madhe), El-Kariatu (Krisma e kiametit), Es-Saatu (Çasti i ndodhisë së kiametit) etj. Veçoritë kryesore të kësaj sureje janë shumë të qarta. Ajo fillon me një bisedë të shkurtër rreth mbarimit të jetës së kësaj bote dhe fillimit të llogarisë në botën tjetër. Surja vazhdon më tutje dhe sjell tri kategori të njerëzve të cilët do të

<sup>262</sup> El-Hakka, 19-23

<sup>263</sup> El-Hakka, 25-29

dallohen në Ditën e Ringjalljes: ata janë të përparmit (njerëz të cilët e pranuan besimin në All-llahun duke mos bërë asnjë pyetje ose duke mos kërkuar sqarime të mëtejshme), njerëz me fat dhe njerëz të pa fat.

Në vazhdim, surja El-Vakia sjell pesë argumente valide të cilat argumentojnë se ringjallja vërtet do të ndodhë, ndërsa mohimi i asaj konsiderohet çmenduri. Surja e përfundon shtjellimin e këtyre pesë argumenteve me përshkrimin e udhëtimit të fundit njerëzve nga kjo botë – vdekjen dhe veçoritë dalluese të cilat i përshkruajnë të tri kategoritë e njerëzve: të përparmit, të atyre me fat dhe atyre të pa fat.

Është fakt se shumica e njerëzve jetojnë me preokupimet e jetës (preokupimet e rëndomta të jetës, ushqimit dhe pijes), presionin e pasioneve dhe lakmive të ndryshme dhe nën agoninë e civilizimit modern. Këta mendojnë vetëm për jetën e tyre të tanishme dhe materien prezente të çuditshme. Njëri prej tyre thotë: “Nuk besoj se do të ndodhë kiameti apo Dita e Gjykimit”, kurse tjetri pohon duke thënë: “Nuk ka tjetër, vetëm se kjo jetë jona në këtë botë, po vdesim dhe po lindemi dhe asgjë nuk na shkatërron tjetër pos kohës!”

Ndodh që edhe të përбетohen me këto fjalë të thjeshta dhe pa kurrfarë turpi duke pohuar se nuk ka jetë tjetër pas vdekjes: “Idhujtarët betohen solemnisht për All-llahun, se Ai kurrë nuk do t’i ngjallë të vdekurit.”

E ti pastaj sheh sesi ai i cili do të vdesë nesër, e përcjell atë që ka vdekur sot, e ky ende vazhdon t’i flasë shokut të tij për shpresat të cilat edhe më tutje synon t’i realizojë me mish e me shpirt. Porosinë dhe mësimin e vdekjes së parë ia mbulojnë lakmitë e pa-



dobishme! Ditët kalojnë dhe shumë njerëz vdesin, shumë prej tyre i mbulon dheu i tokës, kurse për fat të keq mohuesit e ringjalljes vazhdojnë të shtohen, numri i tyre nuk po zvogëlohet, zëri i kufrit (mosbesimit) është i lartë, në Lindje dhe në Perëndim.

Mirëpo, papritmas ndodh Dita e Kiametit, zëri i mosbesimit shuhet, jehona dhe buçima e zërit të kufrit humbet tërësisht: "Kur të ndodhë Ngjarja (Kiameti), ardhjen e saj askush nuk do ta mohojë."

Njeriu për nga natyra është tejet polemizues, kokëfortë, mirëpo ç'mund të thotë kur tashmë ka ndodhur tmerri? Gjuha e atyre që e mohuan ndodhinë e kësaj dite është tharë, ata nuk kanë mundësi të thonë edhe më tutje gjëra të kota!

*"Disa do t'i ulë e disa do t'i lartësojë."*

Në këtë ditë do të ketë shumë mbretër dhe të parë të cilët do të ringjallen të varfër dhe të mjerë, sepse këta nuk bënë kurrfarë përgatitje për këtë ditë! Do të ketë edhe shumë të tjerë të panjohur, të harruar, që në Ditën e Kiametit do të jenë në majë!

Pejgamberi s.a.v.s thotë: "Mjerë ai që në këtë botë ka qenë i veshur, kurse në Ditën e Kiametit do të jetë i zhveshur (lakuriq)." (Buhariu)

Vërtet është ditë e të korrigjuarit të pozitave dhe përmirësimit të tyre, është ditë e mbarimit të gënjeshtreve dhe ndriçimit të së vërtetës!

Disa komentues të Kur'anit janë të mendimit se "rrëzimi" dhe "ngritja" kanë të bëjnë me jetën në sipërfaqen e kësaj toke, siç përmendet në hadith:

*"Njerëzit në Ditën e Kiametit do të ringjallen në një tokë të bardhë, të shkëlqyer, sikur të jetë një pllakë e rrum-*

*bullakët e shkëlqyer, në të nuk do të ketë shenjë dalluese për asnjërin.*"<sup>264</sup>

Që të gjithë do të jenë lakuriq e këmbëzbathur, do të qëndrojnë para Zotit të botëve: *"Kur të pyesin ty (o Muhamed) për malet, thuaj: "Ato do t'i bëjë hi e pluhur Zoti im, ndërsa toka do të bëhet fushë e shkretë, nuk do të shohësh në të as lugina, as brigje."*<sup>265</sup>

Që të dyja këto komente e plotësojnë njëra-tjetrën, pa ndonjë kontradiktë. Në këtë ditë do të ndodhë një dridhje e fortë shoqërore e cila do të lëkundë dhe rrënojë çdo gjë që njerëzit e kanë shpikur, do të rrënojë çdo llagap apo pozitë të cilët vetë ata e kanë përcaktuar. Këtu kemi të bëjmë edhe me një dridhje të sferës materiale, përshkrimi i së cilës fillon me fjalët e Allahut të Madhëruar: *"(ajo ndodh) Kur toka tundet me dridhje të forta. E kodrat shkapërderdhën e bëhen copë e thermi. E bëhen pluhur i shpërndarë."*

Në Ditën e Kiametit do të ndodhë një dridhje e fortë e cila do të lëkundë çdo gjë, ndërsa shkëmbinjtë e fortë do të bëhen pluhur, ashtu sikundër thërmijat që lundrojnë në rrezet e diellit që e shndrisin dhomën!

*"Ditën, kur Toka do të ndërrohet me tokë tjetër, por edhe qiejt, të gjithë do të dalin para të Vetmit dhe Ngadhënjësit All-llah."*<sup>266</sup>

Nuk e dimë se sa do të qëndrojmë këtu para se të ndryshohet toka në tokë tjetër! Dhjetëra apo qindra shekuj? Përcaktimi i periudhës kohore nuk është me

<sup>264</sup> Fet'hu-lBari, pjesa e 11, fq 372, kapitulli "Er-Rekaik", numri 6521

<sup>265</sup> Ta Ha, 105-107

<sup>266</sup> Ibrahim, 48

rëndësi, me rëndësi është përfundimi i suksesshëm i mbjelljes së të mirave gjatë tërë kësaj kohe të gjatë.

All-llahu i Madhëruar bën të qartë se në Ditën e Kiametit bijtë e Ademit do të shpërndahen në tri grupe: *"Ju (o njerëz) do të ndaheni në tri grupe: njerëzit e së djathtës – sa të nderuar do të jenë fatlumët! Njerëzit e së majtës – sa të poshtërtuar do të jenë fatkeqët! Dhe ata që kanë prirë (në besim) e që do të prijnë (edhe në xhenet). Ata janë të afërtit (tek All-llahu), në kopshtet e kënaqësisë."*

Le ta shqyrtojmë me vëmendje të plotë rrëfimin për botën tjetër dhe supozimin se ajo ndodh vetëm shpirtërisht (se vetëm shpirti ringjallet e jo trupi)!

Njeriu është i formuar nga trupi dhe shpirti. Por, a thua është e vërtetë se ngritja e dëshiruar e njeriut arrihet vetëm me anë të shkatërrimit të trupit (dënim të tij) dhe mohimit të kërkesave të tij? Nuk kam hasur në Kur'anin famëlar të apo në sunetin e Pejgamberit s.a.v.s. të ketë diçka që do ta vërtetonte këtë, se dënimi i trupit dhe mohimi i kërkesave dhe nevojave të tij është pjesë që do ta vërtetonte këtë pohim!

Islami rekomandon agjërimin si obligim për çdo të moshuar, proces ky i cili bën që njeriu të ballafaqohet me uri dhe etje. Pastaj, Islami rekomandon faljen e namazit, ndodh që sexhdeja dhe qëndrimi në të të jenë të gjata dhe këmbët të lodhen! Duke u marrë me punët e përditshme njeriu mund të lodhet e të derdhë djersë, madje mund ta humbë dhe jetën në rrugën e All-llahut. Të gjitha këto janë një lloj sprove Hyjnore në të cilën vihet njeriu si qenie e gjallë e përbërë nga shpirti dhe trupi. Fati i shpirtit në këtë rast është sa fati i trupit, bile roli i trupit është rol ndërmjetësues, ai

vetëm e përcjell atë që e dirigjon mendja dhe me anë të saj e orienton dëshirën drejt kënaqësisë së All-llahut.

Po të ishte ndalur dhembja vetëm në të ashtuquajturën "Bang", kurse njeriu të mos kishte ndier asgjë deri në vdekje, ai nuk do ta kishte shpërblimin e duhur!

Njeriu është krijesë që shquhet nga shumë karakteristika dhe veçori të ndryshme. Atë e krijoi All-llahu me duart e tij, atë nuk e krijoi All-llahu në formën më të bukur që burri apo gruaja të thotë: "Trupi është send i fëlliqur, ai duhet të nënçmohet, përulet dhe dënohet!"

Kur All-llahu e krijoi Ademin, i tha: *"O Adem, jeto ti dhe gruaja jote në xhenet dhe aty hani sa të doni e kur të doni, por mos iu afroni kësaj peme, se ndryshe do të bëheni të padrejtë."*<sup>287</sup>

Ku shihet pra dënimi apo mundimi i trupit në këtë ajet i cili i lejon të gjitha gjërat!?

Pastaj, All-llahu i krijoi të dërguarit, i bëri të jenë krijesat më të zgjedhura në mesin e të gjitha krijesave të tjera, e u tha: *"O të dërguar! Hani nga të lejuarat dhe bëni vepra të mira! Vërtet, Unë e di mirë se çfarë bëni ju!"*<sup>288</sup>

Ku janë pra gjurmët e të ndaluarës në këtë rekomandim për t'i ngrënë të gjitha gjërat e lejuara?!

All-llahu i Madhërishëm e bëri të mundshme që besimtarët e Tij të jenë të furnizuar me ushqime të pastra e të bukura. Ai kërkoi prej tyre vetëm mirënjohje dhe falënderim për tërë këto dhunti që Ai ua dhuroi: *"O besimtarë! Hani nga ushqimet e lejuara që ju*

<sup>287</sup> El-Bekare, 35

<sup>288</sup> El-Mu'minun, 51

*kemi dhënë dhe, nëse jeni adhurues të All-llahut, falënderojeni Atë!*<sup>269</sup>

A thua kjo do të thotë luftë kundër trupit, kërkesave dhe nevojave të tij, nënçmim dhe dënim i tij?

Më pas All-llahu i Madhërishëm bën të qartë se bijtë e Ademit, pas udhëtimit të tyre të gjatë në këtë botë dhe pas ndërrimit të popujve dhe civilizimeve, do të kthehen për herë të dytë tek All-llahu i Madhërishëm: *"Ashtu siç e filluam krijimin e parë, do ta përsërisim atë. Ky është premtimi Ynë. Ne do ta bëjmë këtë me të vërtetë."*<sup>270</sup>

Njerëzit do të jenë gjithmonë njerëz. Ata do të ringjallen me të gjitha gjymtyrët e tyre, me tërë ndjenjat dhe emocionet që i kanë pasur në jetën e kësaj bote. Thënë më mirë, me të gjitha gjymtyrët dhe ndjenjat me të cilat i kanë bërë mëkatet dhe e kanë shfaqur respektin e duhur ndaj Zotit të tyre. Vetë trupi i tyre do të jetë dëshmitar kundër tyre. Në momentin kur ata të cilët nuk e kanë pranuar nënshtrimin dhe përlujen para All-llahut, do të përpiqen ta mohojnë atë që e kanë bërë. All-llahu i Madhëruar do t'i urdhërojë gjymtyrët e tyre të flasin dhe të dëshmojnë kundër tyre dhe ta përgënjeshtrojnë atë që ata e thonë: *"E derisa i afrohen atij, kundër tyre dëshmojnë: të dëgjuarit e tyre, të parët e tyre dhe lëkurat e tyre për çdo gjë që ata kanë punuar. Lëkurave të tyre ata u thonë: "Përse dëshmuat kundër nesh?" Ato thonë: "All-llahu që çdo sendi i ka dhënë të folur na dha edhe neve, e Ai është që u krijoi ju herën e parë dhe vetëm te Ai do të ktheheni."*<sup>271</sup>

<sup>269</sup> El-Bekare, 172

<sup>270</sup> El-Enbiya', 104

<sup>271</sup> Fussilet, 20-21

Njeriu i cili në këtë botë ka sakrifikuar dhe është flijuar, do të shpërblehet me jetë të lumtur në botën tjetër.

Taberaniu transmeton se i Dërguari s.a.v.s. ka thënë që gratë e besimtarëve në xhenetet e ahiretit do të jenë më të mira (më të bukura, më të vyeshme ose do të kenë status më të lartë) se hyritë symëdha! Bashkëshortja e tij Ummu Seleme e pyeti: Pse, o i Dërguari i All-llahut, do të jenë më të mira se këto në xhenet? Pejgamberi s.a.v.s. tha: *"Me namazin e tyre, me agjërimin e tyre dhe me përkushtimin (ibadetin) e tyre ndaj All-llahut!"*

Më pas, po në këtë hadith, transmetohet se gratë e besimtarëve do të thonë: *"Ne jemi të përjetshme, nuk vdesim asnjëherë; ne do të jemi të këndshme dhe nuk do të shëmtohem kurrë. Si të zëmë vend, s`do të shkulemi kurrë prej aty. Do të jemi të lumtura dhe s`do të hidhërohem asnjëherë. Lum ata që do të na kenë dhe lum ai që do të jetë yni!"*

Ata të ciët në këtë botë flijuan dhe sakrifikuan më të shtrenjtën (bënë xhihad të shenjtë), në botën e ahiretit do të jenë të qetë dhe të pushuar. Thënie se trupi i njeriut humbet dhe se ai asnjëherë nuk kthehet (nuk ringjallet), se bota e ahiretit është vetëm një teatër ku do të jenë të vendosur vetëm shpirtrat, se shpërblimi dhe ndëshkimi i tyre janë vetëm dy koncepte spirituale të cilat i përngjajnë qortimit të ndërgjegjes apo qetësimit të ndërgjegjes, janë thënie të pavërteta dhe pa bazë.

Siç duket, këto thënie janë përcjellë në fenë e krishtere nga shumë fe të tjera tokësore të devijuara. Sa shumë fe pagane i kanë sulmuar me të ashpër fetë e tjera duke i rrënuar tiparet themelore të besimeve qiellore dhe në to kanë futur shumë legjenda dhe mite!

Është për t'u çuditur se ata të cilët e mbështetën dhe përkrahën filozofinë e asketizmit (murgërisë) dhe shtypjen e kërkesave fizike, janë po të njëjtit të cilët në civilizimin modern paraqesin elementin e dështimit dhe disfatës së plotë, ndonëse civilizimi modern është duke i tejkaluar gjitha normat e shuarjes së etjes së ndjenjave dhe dëshirave seksuale fizike (emocioneve), duke krijuar mundësi kënaqësish të tilla të cilat nuk janë parë as në oborret e mbretërive të mëparshme! Siç dihet, gabimet e tilla çojnë drejt mëkateve dhe formave të paturpshme të sjelljes, drejt mëkateve dhe gabimeve më të mëdha!

Në kohën moderne i shohim arritjet e mëdha shkencore, disa prej të cilave meritojnë shpërblimin më të madh, të njohur me emrin çmimi "Nobel", shpërblim të cilin pothuajse e dëshiron çdo shkencëtar i botës! Vërtet, ai është një dhuratë që ta kënaqë shpirtin! Mirëpo, duhet pasur parasysh se vlerësimi i tillë i lartë shkencor nuk e shuan urinë dhe nuk jep siguri.

Le të vazhdojmë me rrëfimin i cili ka të bëjë me shpërblimin në Ditën e Ahiretë të të themi: Vërtet kërkesat e trupit janë të kufizuara, përmbushja e tyre nuk kushton aq shumë, kuptohet, nëse e lëmë anash jetën luksoze. Por, a ka kjo vlerë më të madhe sesa shpërblimi ose përmbushja morale?

Besimtarët e vërtetë i preokupon adhurimi i sinqertë i All-llahut, thënë më mire, madhështitë e Tij në gjithësi dhe në dhuntitë e shumta. Besimtarët e tillë jetojnë me to duke qenë gjithmonë të kënaqur e të gëzuar. Ata mbeten të kënaqur përgjithmonë, pa marrë parasysh se çfarë u jep Zoti i tyre, varfëri apo pasuri,

në të dyja rastet ata e shohin vetëm Zotin e tyre, asgjë tjetër.

Sidoqoftë, si njerëz dhe besimtarë të sinqertë, ne duhet medoemos t'i përjetojmë shpërblimet e All-llahut, e assesi të shtiremi se nuk jemi të preokupuar me dhuntitë materiale të xhenetit, por e tërë ajo që duam është vetëm kënaqësia e All-llahut dhe të kënaqurit me madhështinë dhe shoqërinë e Tij!

Kur All-llahu i Madhërishtëm thotë: *"Kushdo që shpëton nga zjarri i xhenemit dhe hyn në xhenet, ai ka fituar (gjithçka që mund të dëshirohet)."*<sup>272</sup> - asnjërit nuk i lejohet të thotë: "Ç'janë xheneti dhe dhuntitë e tij? Unë e dua vetëm kënaqësinë e All-llahut, asgjë tjetër! Një thënie e tillë me siguri është e pakuptimtë dhe pavend.

A thua dëshiron kënaqësinë e All-llahut duke qenë nën hijen e pemës Zekum? Nëse ajo bën hije?? All-llahu i Madhëruar do të shfaqet para robërve të Tij me kënaqësinë e Tij të përhershme, kur këta do të jenë të veshur me petkat e xhenetit dhe kur do të jenë duke ecur nën hijet e tij të përhershme.

Natyrisht, besimtarët do të jenë të privilegjuar me pamjen e All-llahut të Madhëruar, mirëpo, krahas kësaj, do t'i shijojnë dhuntitë dhe mirësitë e xhenetit.

Mbi komentin e ajetit famëlartë: *"Besimtarëve dhe besimtareve All-llahu u premtoi xhenete nën të cilat rrjedhin lumenj, në to do të jenë përgjithmonë, dhe (u premtoi) vendbanime të bukura në xhenetin e Adnit, edhe një disponim nga All-llahu që është mbi të gjitha. Ky, pra është ai shpëtimi i madh."* – kemi thenë: Kënaqësia dhe dispo-

<sup>272</sup> Ali-Imran, 185



nimi i All-llahut do të jetë dhuntia më e lartë Hyjnore, gjëja më e shtrenjtë e cila do ta kënaqë syrin e besimtarit, gjëja më e ëmbël në xhenet, por ne i flakim sjelljet e pahijshme kundrejt fjalëve të Zotit të Urtë e të Mëshirshëm!

Të gjithë dijetarët janë të mendimit se shpërblimi dhe ndëshkimi i Botës së Ahiretit janë të natyrës fizike dhe shpirtërore, se kemi një numër të madh ajetesh dhe hadithesh pejgamberike të cilat e konfirmojnë një pohim të tillë.

Mund të ndodhë që disa njerëz të mirë të gabojnë dhe të nxjerrin mbi bazën e përvojës së tyre një normë apo dispozitë të përgjithshme e të pakuptimtë e cila do të vlejë për gjithë njerëzit e tjerë. Kujtoj se kështu nuk duhet vepruar!

Ne e dimë se Isai dhe Jahja (i biri i Zekerijait) nuk kanë qenë të martuar. Mirëpo, që të dy këta pejgamberë nuk morën guxim që t'i shpallin luftë martesës, e as që i hapën rrugën jetës së ashpër e të pakëndshme askete, sepse këta nuk ishin dërguar për ta rrënuar jetën! Mosmarta e tyre ndodhi për shkaqe dhe rrethana të cilat i dinë vetëm këta dy të dërguar! Misioni i tyre nuk kishte për qëllim ta shkatërronte jetën njerëzore, por ta rindërtonte atë. Dijetarët e mirënjohur Ibn Tejmije dhe Xhemaluddin el-Afgani bënë jetë beqari (të pamartuar), por kurrë ndonjëri prej tyre nuk bëri thirrje për një jetë të tillë!

Ka shumë njerëz të cilët janë të njohur si vegjetarianë dhe nuk hanë ushqime mishi. Këtyre u mjaftojnë ushqimet që dalin nga toka. Mirëpo, le të mbetet kjo natyrë dhe ky kriter i tyre përcaktim personal. Ngrënia

e mishit nuk është obligim fetar. Asnjëri nuk ka të drejtë që një gjë të tillë ta paraqesë si kriter apo parim fetar.

Disa shkrimtarë bashkëkohorë tentuan të pohojnë se xheneti nuk është “treg i gjelbërimeve”, duke dashur të mohojnë shpërblimin dhe dënimin material në Ahi-ret. Në historinë tonë moderne kishte njerëz të cilët u ndikuan me konceptet e tilla të të menduarit, ato i quajtën gjëra të cilat sot njihen si tejet sublime dhe të ngri-tura lart, po në fakt janë gjëra absurde dhe të panjohura.

Në historinë islame ekzistojnë figura legjendare të cilat asnjëherë nuk vdesin, për të cilat flitet se kanë shijuar dhe përjetuar gjëra të jashtëzakonshme. Trans-metohet se Enes ibn Nadër ishte njëri prej këtyre figu-rave që pohonin se e kishin parë Zotin, se i kishin parë shpërblimet dhe dhuntitë e Tij të premtuara e të përgatitura për besimtarët! Në Luftën e Uhudit, ky ishte njëri ndër ata të cilët nuk e pëlqyen qëndrimin e atyre që deshën të largoheshin nga fushëbeteja, ishte i vetmi i cili u vu kundër mushrikëve, duke i duruar në trup sulmet me shpatë dhe duke thenë: “Vërtet jam duke e nuhatur (jam duke e parandjer) aromën e xhe-netit e cila është pas kodrës së Uhudit.”

A thua ky besimtar madhështor është një ëndë-rrues? Ky, për të cilin Zoti i botëve kishte thënë: “*Mi-dis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbrojtur besëlidhtjen me All-llahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre.*”<sup>275</sup>

E ç’ të themi për Xha’fer ibn Ebi Talibin, njeriun ma-dhështor i cili e mbante në dorë flamurin islam në

<sup>275</sup> El-Ahzab, 23

fushëbetejë dhe nuk e lëshoi deri kur iu këputën të dy duart? Pas tij erdhi heroi tjetër i cili barti këtë flamur të shtrenjtë.

Kishte dëshirë të flaktë të vdiste si shehid dhe thoshte: "Po sa i këndshëm që është xheneti dhe sa afër që është! Ai është i mrekullueshëm, kurse uji i tij është shumë i freskët dhe i ftohtë!"

A thua dëshira e flaktë për xhenetin dhe pushimin nën hijet e tij është një vegim dhe iluzion i rastit? A thua kjo dëshirë mund të quhet dobësi e të menduarit? Ashtu mendojnë vetëm maskarenjtë.

Intelektualët dhe fetarët e drejtë dhe objektiv, të cilët flasin për Islamin duke qëndruar larg Kur'anit dhe Sunetit të Pejgamberit s.a.v.s., do të duhej ta mbyllnin gojën dhe të turpëroheshin.

Nëpër shkrimet e disa priftërinjve të krishterë kam hasur të përqeshen me konceptin islam të xhehenemit dhe xhenetit si dhe me realitetin e tyre fizik (objekti i talljes së tyre është xheneti i artë dhe xhehenemi i zjarrtë)! Me siguri këta njerëz janë të ndikuar nga shumë koncepte, mendime njerëzore dhe filozofi të cilat nuk kanë të bëjnë aspak me shpalljen Hyjnore. Por, le të shohim çfarë të mire dhe dobie i sollën njerëzisë me këto fjalë dhe thënie? Vallë kanë shkuar përpara shpirtërisht me civilizimin modern dhe vallë e zbutën vrazhdësinë e tij? A thua arritën t'i shndërronin njerëzit e rëndomtë dhe ata të veçantë në njerëz spiritualë të cilët do t'i shtypin kërkesat e trupit dhe ndjenjat seksuale e do të ngrihen lart në qiell? Kujtoj se këta gabuan në përpjekjet për ta shëruar shpirtin dhe jetën njerëzore. Këta nuk arritën ta njohin çelësin

me të cilin do ta hapnin shpirtin e njeriut! E vërteta është se koka dhe zemra e tyre është e ngjeshur me mori të pavërtetash dhe trillimesh, gjë që i largoi njerëzit e arsyes dhe të logjikës së shëndoshë nga feja dhe i bëri të qëndrojnë larg saj, shkak i cili nuk lejoi që këta ta përqafojnë fenë ashtu siç duhet dhe t'i respektojnë porositë dhe mësimet e saj.

Njeriu është qenie e përbërë prej materies dhe shpirtit, ndaj ai mund të jetë i kënaqur dhe i lumtur vetëm nëse i ndjek porositë dhe mësimet të cilat e pranojnë aspektin e tij fizik dhe shpirtëror. Një gjë e tillë ishte esenca e mësimëve dhe porosive të të gjithë pejgamberëve të All-llahut, ndër ta edhe e Musait i cili duke u lutur për hir të popullit të tij (duke kërkuar falje prej All-llahut për popullin e tij), thotë:

*"Ti je Mbrojtësi ynë, andaj falna dhe mëshirona! Ti je më i miri i mëshiruesve! Na cakto të mira në këtë botë dhe në tjetrën, sepse veç tek Ti ne kthehemi."*<sup>274</sup>

Para tij, Ibrahim i a.s. e kishte bërë këtë lutje drejtuar Zotit të Tij:

*"O Zoti im, më dhuro dituri dhe më radhit me të mirët! Bëj që të përmendem për të mirë te breznitë e ardhshme. Dhe më bëj një nga trashëgimtarët e xhenetit të begatë! Fale babanë tim, sepse ai është njëri nga të humburit, dhe mos më turpëro në Ditën, kur do të ringjallen njerëzit, në Ditën, kur askujt nuk do t'i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek All-llahu!" atë Ditë xheneti do t'u afrohet besimtarëve të devotshëm, ndërsa xehenemi do t'u tregohet atyre që kishin humbur."*<sup>275</sup>

<sup>274</sup> El-A'raf, 155-156

<sup>275</sup> Esh-Shuara', 83-91

### *Koment i hollësishëm i sures El-Vakia*

Në këtë sure e hasim ndarjen e atyre që ishin fatlum në dy grupe:

Ata që kanë prirë në besim dhe vepra të mira dhe që do të prijnë edhe në xhenet, dhe

Të shpëtuarit përmes vlerësimit të veprave të tyre të mira.

Ndërkaq, ata të cilët mbesin, janë fatkeqit (banorët e xhehenemit). Disa nga komentuesit e Kur'anit gabuan kur pohuan se këto tri grupe janë ato që përmenden në fjalët e All-llahut të Madhërishëm në suren Fatir: *"Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes (duke bërë vepra të ndaluara), disa janë në rrugë të mesme (duke kryer detyrimet dhe duke shmangur të ndaluarat), ndërsa disa, me lejen e All-llahut, shkojnë përpara me të mira (përtej detyrimeve); kjo është dhuntia e madhe."*<sup>276</sup>

Surja El-Vakia flet për të gjithë njerëzit: besimtarë dhe jobesimtarë, ndërkaq, ajeti i sures Fatir flet vetëm për besimtarët myslimanë! Fillimi i ajetit na udhëzon në këtë drejtim: *"Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të zgjedhur (nga ndjekësit e Muhamedit a.s.)."*<sup>277</sup> Surja El-Vakia i përshkruan të parët se ata janë: *"Shumë prej të hershmëve. E janë pak prej të mëconshmëve."* (El-Vakia, 13-14)

Disa janë të mendimit se "shumë prej të hershmëve" nënkupton shokët e të dërguarve të cilët me shpalljet e tyre i paraprinë Muhamedit s.a.v.s., kur-

<sup>276</sup> Fatir, 32

<sup>277</sup> Fatir, 32

se: "pak prej të mëvonshmëve", janë myslimanët! Këta janë të mendimit se një konstatim i tillë është i natyrshëm duke e marrë parasysh numrin e madh të pejgamberëve dhe popujve të tyre që ishin para të Dërguarit Muhammed s.a.v.s.!

Sipas mendimit tim, ajeti i sures El-Vakia e shtjellon vetëm çështjen e Umetit të Muhammedit dhe se ata të hershmit janë sahabët dhe selefi ynë i mirënjohur, ata të cilët me diturinë dhe veprën e tyre e përhapën këtë fe në të katër anët e botës, kurse ata të mëvonshmit, do të jenë të huajt (el-gurebau), njerëzit e shquar me devotshmëri të jashtëzakonshme, në një mjedis kundërshtar dhe armiqësor.

Ndërkaq, për sa u përket të dërguarve të mëherëshëm, misioni i tyre ishte me karakter të përkufizuar, si nga aspekti i kohës ashtu edhe nga aspekti i vendit, mision i cili përfundoi brenda disa vjetësh dhe i cili vlente vetëm për disa vendbanime të caktuara.

Ne në veçanti i respektojmë shokët e Musait të cilët besuan në Tevrat, siç respektojmë edhe shokët e Isait të cilët besuan në Inxhil. Por ku mbetën ata gjatë këtyre shekujve që kaluan?! U zhdukën ata dhe udhëzimi i tyre, kurse vendin e tyre e zunë ata që s'kanë të bëjnë fare me Qiellin (hebrenjtë dhe të krishterët).

Në suren El-Vakia vërejmë se përshkrimi i parë ka të bëjë me të përparmit (sabikun), apo thënë më mirë, veçoria e parë të cilën e fitojnë këta është afrimi i tyre pranë All-llahut të Lartmadhëruar, apo kënaqësia e Tij e lartë. Mu për këtë All-llahu i Madhëruar thotë: *"Dhe ata që kanë prirë (në besim) e që do të prijnë (edhe në xhenet). Ata janë të afërtit tek All-llahu, në kopshtet e kënaqësisë."*

Le ta shqyrtojmë me vëmendje çështjen e atyre të cilët merituan të jenë në këto xhenete apo vendbanime të begatshme.

Vërtet besimi në gjërat e padukshme (gajbin), të cilat i kishin të njohura në këtë botë, bëri që para tyre në botën tjetër të shfaqen të dukshme! Madhërinë e Allahut të cilën në këtë botë (ditëve të mëhershme) e kishin besuar sinqerisht dhe teoretikisht, në botën tjetër (në ditët e sotme) e shohin me sytë që i kanë në ballë! Mu për këtë, këta me gjithë zemër do të shprehin falënderimin dhe mirënjohjen e tyre ndaj All-llahut, do të shprehin Lavdërimin dhe Madhështinë e Tij! Shprehja e falënderimit dhe mirënjohjes së tyre ndodh pandërprerë dhe pa ndonjë lodhje apo bezdisje, ajo del nga zemra e tyre ashtu sikundër del ajri nga mushkëritë tona!

*"Dhe lutja e tyre aty do të jetë: „Qofsh i lavdëruar, o Zot!“ përshëndetja e tyre do të jetë „Selam“ dhe lutja e tyre e fundit „Falënderuar qoftë All-llahu, Zoti i botëve“.*<sup>278</sup>

Këta i shoqërojnë dhe u bashkëngjiten engjëjve të cilët shprehin vazhdimisht madhërimin ndaj All-llahut duke mos ndier aspak lodhje apo bezdisje: *"Por e lavdërojnë (Atë) natën dhe ditën, paprerë."*<sup>279</sup>

Nëse ndodh që në mesin e tyre të ketë ndonjë që në këtë botë me përpikëri e ka lexuar Kur'anin, e ka kumtuar atë dhe e ka mbrojtur, në ditën e Ahiretit, siç përmendet në hadith, i thuhet:

*"Lexuesit të Kur'anit në Ditën e Kiametit do t'i thuhet: Lexo dhe hip lart, lexoje ashtu si e ke lexuar në dynja. Vendi yt do të jetë te ajeti i fundit të cilin do ta lexosh."*

<sup>278</sup> Junus, 10

<sup>279</sup> El-Enbija', 20

Po, ky vërtet ishte nga ata që i shoqëronin engjëjt fisnikë me këtë zotësi dhe çiltërsi.

Banorët e xhenetit ndiejnë kënaqësi nga përmen-dja e veprave të tyre të mira (bakijatu salihat). Këta me dashuri të plotë dhe dëshirë të flaktë flasin për to. Si mund të shlyhen këto të mira të tyre, këto fjalë të tyre të bukura, të cilat i përsëritën gjithmonë: "Subhan-Allah, El-Hamdulil-Allah, La ilahe il-lall-llahu dhe All-llahu ekber."?

Në jetën e kësaj bote këto fjalë e përbënin shtyllën e mirësjelljes së besimtarit, kurse në jetën e botës së ahiretit do ta përbëjnë simbolin e veçantë të banorëve të xhenetit ë begatshëm.

A thua çfarë bënë të tjerët? Të tjerët u treguan të dobët dhe u ndanë (penguan).

Siç thuhet: "Gurët në rrugën e përtacëve janë pengesë, kurse në rrugën e të zellshmëve shkallë, të parët ngecin dhe rrëshqasin (rrëzohen), kurse të tjerët ngrihen lart."

Mu për këtë, mbi shpërblimin e përgatitur për këta më të afërmit e Zotit, thuhet: "*Si shpërblim për atë që kanë punuar.*"

Kur fisnikut i troket në derë një njeri që dëshiron ta vizitojë, ky menjëherë di si ta mirëpresë këtë, di shumë mirë se me çfarë ta gostit këtë njeri të dashur. Çfarë mund të thuhet për banorët e xhenetit të cilët e vizitojnë Zotin e tyre pasi të kthehen tek Ai? E pakta që iu ofrohet këtyre në atë ditë është ajo që ka qenë më e lartë, më e çmuar dhe më e shtrenjtë për mbretërit dhe sunduesit e kësaj bote, me të cilën ata janë dëf-ryer dhe kënaqur!



Ne dimë se në xhenet do të ketë gjëra të cilat syri i njeriut nuk i ka parë e as që veshi i tij i ka dëgjuar, po as që i ka ra ndërmend ndonjëherë ndonjë njeriu të mendojë se mund të ketë gjëra të tilla. Ne e dimë po ashtu se emrat me të cilët quhen gjërat në xhenet kanë për qëllim emërimin aproksimativ. Përmendja e tyre ka si qëllim ta ndezë dëshirën dhe zellin në zemrat e atyre që punojnë punë të mira në këtë botë. Çështja e këtyre gjërave as që mund të paramendohet apo përshkruhet!

Me rëndësi është se banorët e xhenetit – me tërë begatitë dhe dhuntitë e gëzuara - nuk do të jenë banorë të pavyeshëm dhe përtacë. Ata do t'i shoqërojnë me zell të madh dhe vazhdimisht engjëjt të cilët shprehin mirënjohje dhe falënderim ndaj All-llahut. Nuk ka dyshim se këta do të jenë të lumtur e të gëzuar me nderin të cilin do t'ua bëjë All-llahu, mirëpo do të jenë edhe më të gëzuar për mundësinë që iu është dhënë që ta falënderojnë All-llahun, ditën dhe natën, fshehtazi dhe publikisht.

Le ta sqarojmë në vazhdim disa nga shprehjet të cilat me siguri nuk i kemi dëgjuar apo hasur, e të cilat kanë të bëjnë me përshkrimin e xhenetit:

- "Ata do të qëndrojnë në divane të stolisura me ar e gurë të çmuar."

Divane të stolisura me ar e gurë të çmuar të nxjerrë nga minierat më të shtrenjta.

- "Të mbështetur në to përballë njëri-tjetrit."

Do të jenë nëpër ndeje të dashura ku do të jenë përballë njëri tjetrit dhe do ta shohin njëri tjetrin.

- "Do t'u sillen rreth (për shërbim) djelmosha përherë të rinj, me kupa, ibrikë dhe gota pije të kullu-

ar, që rrjedh, e prej së cilës nuk do t'u dhembë koka dhe nuk do t'u humbë mendja. E me fruta të cilat do t'i zgjedhin vetë."

Në xhenet do të jenë edhe hyritë symëdha (bashkëshortet e banorëve të xhenetit). Sipas asaj që kujtojmë, hyritë symëdha të xhenetit do të jenë bijat e Ademit (gratë e besimtarëve), kuptohet, pasi t'i ketë shndërruar All-llahu nga gra të rëndomta në hyri symëdha dhe të bukura. Ato nuk plaken kurrë, do të kenë gjithmonë një moshë dhe plot bukuri! Këto do të jenë krijesa të tjera të cilat All-llahu i Madhëruar i ka krijuar në formë të vajzave me sy të mëdhenj dhe mahnitës dhe me të cilat do të dëfrehen dhe kënaqen banorët e xhenetit. Siç duket, hyritë symëdha do të jenë nga të dyja palët (nga bijat e Ademit dhe krijesa të tjera që qëndrojnë në xhenet). Ndryshime të mëdha do të ndodhin në trupat e njerëzve dhe grave si dhe në formën e tyre. Ky ndryshim pa dyshim se do të jetë më i çmuar dhe më i lartë. Bijtë e Ademit nuk do të ndiejnë nevojë për nxjerrjen e mbetur të ushqimit nga trupi i tyre. Familja myslimane do të jetë e bashkuar në dashuri dhe kënaqësi, siç thotë All-llahu i Madhëruar: *"Xheneti i Adnit, në të cilin do të hyjnë ata dhe besimtarët e ndershëm prej prindërve të tyre, grave dhe pasardhësve të tyre. dhe engjëjt do të hyjnë tek ata nga çdo derë (e xhenetit). (e do t'u thonë). "Shpëtimi qoftë mbi ju, për durimin që e keni treguar (në jetën e kësaj bote)! Sa vendbanim i bukur që është ky."*<sup>210</sup>

Është fakt se trupi i njeriut, sado që i krijuar në formën më të bukur, ka nevoja shqetësuese. Përjetimi

<sup>210</sup> Er-Rra'd, 23-24

i xhenetit kërkon që të korrigojen këto gjymtyrë në një formë më të lartë, më të bukur, më të pastër dhe më të fortë.

Në Kur'anin famëlartë nuk haset ndonjë sure e veçantë e cila në vete i ngërthen të gjitha të mirat dhe shpërblimet e përgatitura për vepërmirët dhe mirëbërësit. Çdo sure e ilustron ndonjë nga këto të mira të cilat i përshtaten sures e të cilat e kënaqin zemrën e lexuesit dhe e nxisin dëshirën, dashurinë dhe shpresën e tij.

Në suren El-Vakia i hasim të mirat e veçanta të cilat janë të përgatitura për të përparmit dhe për ata me fat të cilët do të jenë në numër më të madh se grupi i parë: *"Për njerëzit e së djathtës (fatlumët). Janë shumë nga të parët e shumë edhe nga të mëvonshmit."*

Ajetet e kësaj sureje i shfaqin shpërblimet e përgatitura për këta mirëbërës:

*"E njerëzit e së djathtës – sa të nderuar që janë fatlumët! Ata do të qëndrojnë në mes të lotuesve pa gjemba, bananeve të mbushura me fruta, nën hije të gjera, pranë një uji rrjedhës, dhe mes frutave të llojllojshme, të cilat kurë nuk sosen, as nuk janë të ndaluara dhe në shtroje të ngritura. Ne i kemi krijuar hyrjet në një formë të veçantë (jo të lindura), dhe i kemi bërë ato virgjëresha, të dashura për bashkëshortët e tyre dhe moshatare me ta, për njerëzit e së djathtës."*

Për ta do të ketë lumenj që ngrihen përpjetë, do të jenë nën hije të përhershme, ndër pemë shumëllojesh që nuk mbarojnë me përfundimin e stinës, për to nuk ka kohë dhe stinë: *"Xheneti që u është premtuar besimtarëve është i tillë që nëpër të rrjedhin lumenj; fruta dhe*

*freskia e tij janë të përhershme. Ky është fundi i besimtarëve, kurse fundi i jobesimtarëve është zjarri.”<sup>261</sup>*

Aty do të ketë gra të një moshe dhe të dashura për banorët e xhenetit.

Siç mund të shohim, të tëra këto janë lajme të mira për Umetin e Muhammedit s.a.v.s, i cili do të jetë shumë i madh në Ditën e Kiametit, disa prej tyre do të jenë në grupin e të përparmëve, kurse disa të tjerë në grupin e atyre me fat.

Më pas, surja vazhdon të flasë për çështjen e atyre të pa fat. Janë këta që nuk e besuan All-llahun, ateistët, keqbërësit dhe përgënjeshtuesit të cilët u sollën mundime të mëdha të dërguarëve, që e kundërshtuan fenë, që mbetën të kënaqur me jetën e kësaj bote, u bënë të qetë dhe të sigurt në të, përqeshën dhe morën objekt talljeje jetën e botës tjetër, në këtë botë nuk deshën të njohin tjetër veçse interesin dhe dobinë e tyre vetjake.

Surja El-Vakia e përshkruan dënimin e tyre të dhembshëm në Ditën e Kiametit.

*“Ata do të jenë në afshin përcëllues të zjarrit dhe ujit të vluar.”*

Në një vapë të madhe dhe në një ujë i cili vlon tepër.

*“Dhe nën hijen e një tymi të zi.”*

Tym i dendur e i zi, hija e të cilit nuk bën aspak dobi. Mu për këtë në një vend tjetër thuhet: *“Shkoni drejt një hijeje me tri kolona (tymi të xhehenemit), e cila nuk bën hije (freskuese) dhe as nga flaka nuk të shpëton.”<sup>262</sup>*

A thua me çfarë merituan të jenë të pa fat?

<sup>261</sup> Er-Rra'd, 35

<sup>262</sup> El-Murselat, 30-31

Sepse këta nuk mendonin për All-llahun në jetën e kësaj bote, nuk bënë të mira, po bile as që e besuan Atë. Jeta e tyre në këtë botë ishte e mbushur me kënaqësi.

All-llahu i Madhëruar e përshkruan jetën e pabesimtarëve në këtë botë si dhe prirjen e tyre vetëm pas saj: *"Sepse ai jetonte i shkuqdesur në familjen e tij, duke menduar se kurrë nuk do të kthehej (për të dhënë llogari)."*<sup>283</sup>

Ai nuk mendonte se do të kthehej një ditë te Zoti i tij: *"Po, Zoti i tij, sigurisht që i ka ndjekur të gjitha punët e tij."*<sup>284</sup>

Jetën e tyre pabesimtarët e mbështesin në konceptin e mosbesimit në ringjallje, se nuk ka më kthim të dytë në jetë! Një mosbesim i tillë gati se e ka përfshirë sot tërë Lindjen dhe Perëndimin. Ky edhe është shkak kryesor i cili i shtynë edhe më tutje në mëkate dhe të mbështeten në to duke mos ndierë pendim apo keqardhje për kryerjen e tyre. Ky është mëkati i madh për të cilin Kur'ani famëlartë flet: *"Ata, para kësaj, jetonin në luks dhe në vazhdimësi bënë gjynahe të rënda, duke thënë: "Vallë, pasi të vdesim e të bëhemi pluhur e eshtra, vërtet do të ringjallemi?! Thuaju (O Muhamed): "Me siguri, edhe të parët, edhe të mbramët, do të tubohen në një ditë të caktuar."*

Ajetet e përshkruajnë edhe një herë dënimin të cilin do ta përjetojnë ateistët: *"Dhe atëherë ju, o jobesimtarë të humbur, me siguri që do të hani nga pema e Zekumit."*

Zekum është një ushqim i pakëndshëm dhe i hidhur – na ruajt All-llahu prej tij - pas ngrënies së të cilit të merr etje e madhe, kurse njeriu i cili do të hajë

<sup>283</sup> El-Inschikak, 13-14

<sup>284</sup> El-Inschikak, 15

këtë ushqim nuk do të gjejë për të pirë ujë tjetër pos ujit të valë: “.....ku gjynahqarët do të qëndrojnë përherë në zjarr dhe do t'u jepet ujë i vluar, që ua copëton zorrët?!“<sup>285</sup>

Edhe pse ndikimi i tij është i tmerrshëm, ushqimi Zekum do t'i çojë ta shuajnë etjen e cila bëhet e padurueshme!

Kur'ani famëlartë thotë se banorët e xhehenemit do t'i mbushin barqet e tyre nga ky lloj ushqimi (Zekum), e pastaj si të çmendur do të kërkojnë ujë për të shuar etjen e tyre, por mjerë ata, sa larg që është shuarja e etjes së tyre: “Kështu do të jetë gostia e tyre në Ditën e Kiametit.”

Pasqyra (skena) e prezantuar kur'anore rreth shpërblimit dhe dënimit ka për qëllim të nxisë frikën dhe shpresën, përforcimin e edukatës së shëndoshë, në veçanti në kohën e civilizimit modern në të cilën jemi dëshmitarë të një bashkëpunimi tejet të ngushtë mes shkencës, artit, mediave, serioze dhe joserioze, gjë që ndikon në injorimin e Ditës së Ahiretit.

Zgjimi i ndjenjave të frikës dhe shpresës te njerëzit nuk është gjë e mjaftueshme! Por, medoemos të arrijmë ta zgjojmë mendjen njerëzore për të gjykuar dhe menduar, pastaj për të besuar, e më vonë për të vepruar sipas asaj që ai ka menduar dhe gjykuar.

Surja El-Vakia i përmend pesë argumente të cilat kanë të bëjnë me horizontet e larta të gjithësisë dhe përvojën e përditshme të njerëzve, të cilat kanë për qëllim të konfirmojnë se ringjallja vërtet do të ndodhë!!

<sup>285</sup> Muhammed, 15

### Argumenti i parë:

All-llahu i Madhërishëm thotë: *"Ne ju krijuam – e pse nuk e pranoni të vërtetën?"*

Pse të akuzohet Ai i cili i ka krijuar për herë të parë krijesat se nuk mund t'i krijojë për herë të dytë? Kur unë dua të mësoj një tekst mësimor, me siguri që lodhem, ndërsa kur e përsëris të njëjtin, më duket shumë më i lehtë!

Duke e bazuar në këtë koncept të të menduarit, në një ajet tjetër All-llahu i Madhëruar thotë: *"Ai e zë fill krijimin dhe Ai e përsërit atë e për Atë kjo është edhe më e lehtë."*<sup>286</sup>

Mu për këtë edhe vazhdon që në të njëjtin ajet të konfirmojë: *"Atij i përket shembulli më i lartë në qiej dhe në Tokë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti."*

Ky argument është përsëritur në shumë sure të Kur'anit famëlartë dhe atë nuk ka mundësi ta injorojë kush, pos kokëfortit: *"Ata thonë: "Vallë, kur të bëhemi eshtra dhe pluhur, a do të ringjallemi në krijesa të reja? Thuaj: "Bëhuni gurë ose hekur, ose çfarëdo krijese tjetër që është më e madhe sipas jush!" Ata do të thonë: "Kush do të na kthejë ne (në jetë)" Thuaj: "Ai që ju ka krijuar herën e parë". Ata do t'i tundin kokat nga li e do të pyesin: "Kur do të bëhet ajo?" Ti thuaju: "Mund të vijë shpejt."*<sup>287</sup>

Kur'ani famëlartë kërkon vazhdimisht dhe me këmbëngulje që të shqyrtohet dhe analizohet në mënyrë të thukët bota e cila e rrethon njeriun, me që-

<sup>286</sup> Er-Rrum, 27

<sup>287</sup> El-Isra', 49-51

llim që ai ta kuptojë si filloi krijimi dhe si do të përsëritet.

Ne vërtet ekzistojmë, por si u bë të jemi këtu? Kush na solli? Pse jemi? Çfarë bëjmë këtu? S`do mend se ai i cili e shqyrton dhe analizon me vëmendje tërë këtë, e në veçanti jetën dhe ringjalljen në botën tjetër, sheh se ta konsiderosh një ndodhi të tillë të pamundshme është turp dhe çmenduri!

*“Vallë, a nuk e vërejnë ata se si All-llahu e zë fill krijimin, pastaj e ripërsërit atë? Natyrisht, kjo është e lehtë për All-llahun. Thua: “Udhëtoni nëpër Tokë dhe shikoni se si Ai e ka zënë fill krijimin. Pastaj do të jetë All-llahu Ai që do të bëjë krijimin e dytë (ringjalljen). Me të vërtetë, All-llahu është i Fuqishëm për çdo gjë. Ai ndëshkon kë të dëshirojë dhe mëshiron këtë të dëshirojë; tek Ai do të ktheheni.”<sup>288</sup>*

Që të gjitha këto koncepte surja i ngërthen në një ajet të shkurtër: *“Ne ju krijuam – e pse nuk e pranoni të vërtetën?”*

### *Argumenti i dytë:*

Ai i cili për herë të parë e krijoi tokën, nuk ndjeu lodhje, atij nuk iu shter fuqia. Procesi i të krijuarit vazhdon të përrihet gjatë çdo dite, çdo momenti, bile edhe gjatë çdo rrahje të qerpikut! Një gjë e tillë reflektohet qartë në krijimin e njerëzve dhe në procesin e pritjes së foshnjave të reja.

<sup>288</sup> El-Ankebut, 19-21



Ky argument është konfirmuar qartë në fjalët e All-llahut të Madhëruar: *"A e keni parë farën që e hidhni? A jeni ju që e krijoni atë apo ne jemi krijuesit? Ne e caktojmë vdekjen tuaj dhe askush nuk mund të na pengojë që t'ju ndryshojmë trajtën dhe t'ju krijojmë ashtu si nuk e dini."*

Sperma e mashkullit është vërtet një lëng i çuditshëm! Ky lëng për ne i paktë mban në sferën e fuqisë së lartë (sublime) – dyqind milionë spermatozoide. Ky spermatozoid, të cilin ne nuk e shohim sepse është shumë i imët, në qenien e vet i bart të gjitha veçoritë dhe karakteristikat themelore të llojit njerëzor, qofshin ato të natyrës psikike ose fizike.

Një gjë e tillë është e njohur qysh herët. Në biografinë e Pejgamberit s.a.v.s. e hasim rastin e akuzimit të një gruaje për kurvëri, pas së cilës ajo kishte mbetur shtatzënë. Pejgamberi i ndershëm dhe fisnik tha: *"Nëse foshnja vjen me sy të zi, bythë të gjera dhe këmbëtrashë, atëherë ai i takon Sherik ibn Sem' aut, njeriut të akuzuar për kurvëri me të."*

Shiko pra si janë përcjellë veçoritë dhe karakteristikat e tilla nga prindi te foshnja, kuptohet përmes spermatozoideve të cilat më vonë i reflektojnë veçoritë e trashëguara fizike dhe psikike.

A ka diku në botë ndonjë fabrikë të cilën e drejtojnë njerëz gjeni që i prodhon këto karakteristika të njeriut? Nuk ka. Gjëndrat marrin materien nga gjaku, kurse gjaku formohet nga ushqimi, ndërsa ushqimi formohet nga dheu!

Andaj, fillim dhe mbarim fuqia e vetme e cila e mbikëqyr dhe kontrollon procesin e krijimit të këtyre fazave është All-llahu i Madhëruar: *"I Cili ka përsosur*

*çdo gjë që ka krijuar. Ai e ka filluar krijimin e njeriut prej baltës. Pastaj bëri që pasardhësit e tij të krijohen prej një pike të lëngut të shpërfillur, së cilës pastaj i dha trajtë dhe i fryu shpirtin e krijuar prej Tij. Ai ju ka dhënë dëgjimin, shikimin dhe zemrën, por pak prej jush janë mirënjohës.”<sup>209</sup>*

Ç’është më mahnitëse se ajo që njeriu krijohet vetëm përmes një spermatozoidi i cili është i domosdoshëm për ta mbarësuar vezoren femër dhe të fillojë koncepturën e krijimit të njeriut. Të gjitha spermatozoidet e tjera, numri i të cilave arrin dyqind millionë, përfundojnë në toalet! Sikur All-llahu i Madhëruar dëshiron t’i thotë njeriut kryelartë se krijimi yt dhe krijimi i miliona njerëzve të ngjashëm me ty nuk i kushton asgjë All-llahut.

Një herë kisha një bisedë të gjerë me një të marrë që pretendonte se ishte i preokupuar me filozofi dhe i thashë: Më trego se kush i krijoi spermatozoidet të cilat depërtojnë dhe qëndrojnë në mitrën e nënës? Që të gjitha janë pasojë e prindërve të tu të cilët nuk dinë asgjë për to! Kurse ti vjen të më shesësh ateizmin (mosbesimin): “Sigurisht, ju e dini krijimin e parë (pej një pikë fare), atëherë përse nuk mendoni?!”

### *Argumenti i tretë:*

Argumenti i tretë përqendrohet në mrekullitë e llojlojshme të natyrës të cilat shihen për çdo ditë. Toka në të cilën jemi duke jetuar është përplot këso mreku-

<sup>209</sup> Is-Sexhde, 7-9

llirash dhe çudirash që të bëjnë të mahnitësh. Në të ne shohim kopshte të bukura, livadhe dhe pyje, lloj-lloj frytësh, fara të ndryshme, vreshta, rrush, ullinj, lloje të shumta lulesh me aroma të ndryshme e të këndshme...etj.

Kush është krijuesi i të gjitha këtyre gjërave? Bujku vetëm e lëvtron tokën dhe në të e hedh farën për të cilën më pas nuk di se çfarë bëhet! Ai gjithmonë dëshmon se çfarë është duke krijuar apo bërë Fuqia e lartë, ai gjithmonë i përfaqon dhuntitë All-llahut duke iu nënshtruar dhe përkulur vetëm Atij! A thua nuk ekziston diç që e nxit atë drejt njohjes së Krijuesit suprem? A thua nuk e nxitë kjo në njohjen e realitetit të jetës dhe vdekjes?

Në suren El-Vakia bëhet fjalë për nxitjen e besimit në ringjalljen, përmes të mbjellave dhe korrjeve të cilat e manifestojnë argumentin e fortë i cili nxit besimin e ringjalljes: *"A shihni atë që mbillni? Vallë, ju e bëni atë që të mbijë apo jemi Ne rritësit e saj? Nëse duam, Ne e lëmë fyqkë dhe ju do të çuditëni (e do të thoni): "Ne jemi të dëmtuar, madje jemi krejt të privuar (nga furnizimi)!"*

Ringjallja nga vdekja është vetëm një realitet i cili përsëritet në çdo anë të kësaj bote: *"Shenjë për ata është toka e vdekur; Ne e ringjallim atë dhe nga ajo nxjerrim dritëra, me të cilat ushqehen."*<sup>290</sup>

Zhvarrosja e njerëzve nuk është më e rëndë se nxjerrja e bimëve nga errësirat e brendisë së tokës të cilat i përmbajnë të gjitha llojet e mineraleve dhe materieve ushqyese mahnitëse: *"All-llahu ju ka krijuar nga*

<sup>290</sup> Ja Sin, 33

*toka, ashtu si bimët, pastaj ju kthen tek ajo dhe prej saj sërisht do t'ju nxjerrë.*"<sup>291</sup>

Në një sure tjetër gjejmë një sqarim më të plotë: *"Ndërsa Tokën e kemi shtruar dhe në të kemi shpërndarë male të palëvizshme dhe kemi bërë, që nga ajo, të mbijnë gjithfarëlloj bimësh të bukura, si njëfarë ndriçimi të mendjes dhe përkujtesë për çdo rob që i drejtohet Zotit ë vet."*<sup>292</sup>

Drejtimi i mendjes në këtë rreh pendimin e sinqertë të njeriut. Apo e kundërta, pendimi i sinqertë e rreh drejtimin e mendjes: ai më parë ishte në gjumë të thellë dhe u zgjua, ishte i hutuar e pastaj u kthjell dhe u freskua (me besim).

Po, do të dalë nga varri për t'u takuar me All-llahun, për t'u ballafaquar me procesin e llogaritjes, ashtu sikundër bimët dalin nga toka duke e bartur në veten e tyre sheqerin, vajin, aromën, formën dhe shumë të tjera. Është për t'u habitur se si ka mundësi që njeriu ta mohojë ringjalljen kur ai vetë dëshmon se në çdo moment e sheh procesin e ringjalljes.

Bujku ndoshta mendon se ka bërë një punë me të cilën gjithçka përfundon, por All-llahu i Madhëruar ia bën me dije se, po qe se do, gjithë atë që ai e ka bërë, All-llahu e shkatërron dhe e shndërron në ushqim për insektet: *"Nëse duam, Ne e lëmë fyçkë dhe ju do të çuditeni (e do të thonë: „Ne jemi të dëmtuar, madje jemi krejt të privuar (nga furnizimi)!"*

Ringjallja është si mbjellja e tokës, proces në të cilin shfaqet qartë fuqia e Krijuesit të qiejve dhe tokës. Një gjë e tillë medoemos duhet të jetë stimulim dhe

<sup>291</sup> Nuh, 17-18

<sup>292</sup> Kaf, 7-8

nxitje drejt të besuarit në ringjalljen dhe llogarinë para All-llahut.

### *Argumenti i katërt:*

Prova e katërt e shtruar në suren El-Vakia, që ka si qëllim argumentimin e ringjalljes, haset në këto fjalë të All-llahut të Madhëruar: *"A e shihni ujin që e pini? Vallë, ju e zbrisni atë prej reve apo ne e zbresim? Nëse duam, Ne e bëjmë atë të njelmët, andaj përse nuk jeni mirënjohës?"*

Vërtet uji është thelbi i jetës dhe ai e bën të mundur vazhdimin e procesit të saj. All-llahu i Madhëruar thotë: *".....dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi; a nuk besojnë?"* (El-Enbijau, 30)

Ujërat i përbëjnë katër të pestat të sipërfaqes së tokës. Ato kanë një rol të jashtëzakonshëm i cili meriton një shqyrtim dhe vëzhgim të thellë! Erërat i shtyjnë retë nga Paqësori me qëllim që ujërat e tyre të lëshohen në regjionin tonë të banuar me njerëz dhe kafshë. Uji i shfrytëzuar në tokë udhëton pastaj nëpër shtratin e tij, për t'u rikthyer në detet e oqeanet, rrugë të cilën ne nuk e dimë fare. Kur'ani thotë: *"Ne zbresim ujë nga qielli me masë të caktuar, pastaj e depozitojmë atë në Tokë. Por, nëse dëshirojmë, Ne jemi në gjendje ta heqim atë tërësisht."*<sup>293</sup>

Po, vërtet Ai i cili e ka krijuar atë për herë të parë është i aftë që ta humbë!

<sup>293</sup> El-Mu'minun, 18

*“Nëse duam, ne e bëjmë atë të njelmët, andaj përse nuk jeni mirënjohës?”*

Vetëm dëshira e lartë dhe sublime e All-llahut është ajo që vazhdimisht krijon, sjell dhe humb. Uji, duke qenë katalizatori esencial i jetës në këtë botë si dhe i jetës pas vdekjes sonë, është element kryesor i cili gjendet vetëm nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e dëshirës së lartë dhe absolute të All-llahut. Pejgambëri s.a.v.s. thotë:

*“All-llahu i Madhërishëm do të lëshojë shiun si rigë, e prej tij do të mbijnë trupat e njerëzve (pasi të jenë shkatërruar dhe bërë pluhur në varret e tyre).”*

Uji është esenca e jetës në këtë botë!

Shiu pastrohet në qiell (atmosferë) përmes proceseve të ndryshme kimike dhe elektrike të njohura në lëmin e fizikës. Këto procese kimike dhe elektrike përfundojnë gjithashtu me dëshirën dhe vullnetin e All-llahut të Madhëruar.

#### *Argumenti i pestë:*

Argumenti i pestë që e konfirmon ringjalljen qëndron në ajetin kur’anor të sures El-Vakia, në të cilin thuhet: *“A e shihni zjarrin që e ndizni? Vallë, ju i keni bërë drutë për të apo ne i kemi bërë?! Ne e kemi bërë atë përkujtues (të zjarrit të xhehenemit) dhe, që t’u sjellë dobi nevojtarëve.”*

Një gjë e tillë mund të vërtetohet shkencërisht me faktin se njerëzit e marrin oksigjenin, kurse e nxjerrin

jashtë dioksidin e karbonit, proces ky i cili është i kundërt te bimët, që e marrin karbon dioksidin, kurse e nxjerrin oksigjenin. Bimët e gjelbra janë depo e energjisë me të cilat njeriu shërbehet në jetën e tij për ta prodhuar zjarrin dhe nxehtësinë. Jeta dhe vdekja i përngjajnë një procesi të tillë: drutë, së bashku me rrënjët e tyre, degët, dhe fletët e gjelbërta, nuk qëndrojnë gjatë kohë, por kalben dhe shndërrohen në fletë dhe degë të thata me të cilat më vonë do ta ndezim zjarrin.

Veçoritë e materies, të kombinuara apo në vete, ende vazhdojnë të mbesin në fokusin e studimeve dhe analizave. Reaksionet kimike prodhojnë substanca, veçoritë e së cilave dallojnë shumë nga ato prej të cilave përbëhen. Uji, për shembull, përdoret për ta shuar etjen, mirëpo shohim se ai është i përbërë nga dy elemente - oksigjeni dhe hidrogjeni - të cilët janë më afër ndezjes sesa shuarjes!

Kopshtet dhe pyjet janë përplot gjelbërim, përplot lule të bukura, të cilat, pas një kohe i shohim të vyshkura dhe të thata, gati për të ndezur zjarr. Kështu ndodh ndërrimi i gjërave të kundërta. Kur'ani famëlartë thotë: *"Ti bën që nata të hyjë tek dita dhe që dita të hyjë tek nata. Të e nxjerr të gjallën prej së vdekurës dhe të vdekurën e nxjerr prej së gjallës. Ti i jep kujt të duash pa kufij."*<sup>294</sup>

Bimët dhe pemët e ndryshme shndërrohen në pluhur, pastaj ky pluhur shndërrohet në mbeturina të cilat më vonë shërbejnë për rritjen dhe kultivimin e bimëve dhe pemëve, ashtu sikundër bimët dhe pemët të cilat ne i hamë shndërrohen në qeliza të gjalla në trupin tonë!

<sup>294</sup> Ali-Imran, 27

Në të vërtetë, i tërë njerëzimi është para dy afateve: njëri është shumë i afërm, kurse tjetri ec ngadalë. Vdekja nuk do të vonohet dhe çdo njeri patjetër do ta përjetojë. Pastaj do të vijë Dita e Kiametit, e cila do të vijë njëmenjë, pavarësisht nga koha që do të kalojë para se të vijë: *"Është Ai që ju krijoi nga balta dhe pastaj caktoi një afat në këtë botë (vdekjen) dhe një tjetër në botën e përtejme (Ditën e Kiametit). Por përsëri ju dyshoni."*<sup>295</sup>

*"O Zot! ynë! Ti do t'i mbledhësh njerëzit në një Ditë për të cilën nuk ka dyshim. Me të vërtetë, All-llahu nuk e shkel premtimin."*<sup>296</sup>

Përsëritja e qëllimshme e Ditës së Kiametit nuk i kërcënon civilizimet as zhvillimet – siç e kuptojnë mendjehetët – por mëton ta zhdukë kapardisjen dhe mendjemadhësinë.

Njerëzit edhe më tutje kanë nevojë të madhe të përmendet Dita e Kiametit, sepse të përmendurit e kësaj dite mban nën kontroll nefsin dhe babëzinë. Njeriu i cili di të gjykojë, kupton se ndodhia e kësaj dite është e vërtetë, ai nuk lejon që botën tjetër ta flijojë për këtë botë, ai nuk i jep përparësi asaj që humbet ndaj asaj që mbetet përgjithmonë, ai nuk përul vlerën e shpërblimit të Ahiretit, ashtu sikundër është bërë zakon në civilizimin modern bashkëkohor!

Shkenca moderne mbase ka arritur t'i zbulojë disa nga fshehtësitë e materies (botës fizike) dhe të fuqive të gjithësisë. Por, ç' dobi nga kjo? Nuk është për të dyshuar se ajo nuk ia uli vlerën urtësisë së ekzistencës njerëzore në këtë botë sa ia uli vlerën detyrës the-

<sup>295</sup> El-En'am, 2

<sup>296</sup> Al-Imran, 9



melore të qenieve njerëzore në këtë botë, misionit të cilin Kur'ani famëlartë e paraqet shkurtimisht në fjalët e tij të shenjta: *"Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh."*<sup>297</sup>

Sfera e sprovës Hyjnore zgjerohet dhe thellohet edhe më shumë, në masën që njerëzve u krijojnë mundësi më të mëdha materiale dhe shpirtërore (shkencore).

Surja El-Vakia përfundon me sfidën para së cilës të gjitha krijesat do të mbesin të shtangura: *"A mos vallë mund të shpëtojë ndonjëri nga llogaria përfundimtare? A thua mund t'i bëjë ballë ndonjëri prej tyre fuqisë së All-llahut të Madhëruar? A thua është e mundur që njerëzit, sado që të ndihmohen mes vete, ta shmangin dhe largojnë vdekjen, të shpëtojnë nga përfundimi i jetës, të shpëtojnë nga ajo ndonjë të dashur apo mik?"*

Surja El-Vakia thotë: *"Atëherë, përse kur (dikujt) i vjen (shpirti) në grykë para syve tuaj, ndërkohë që Ne jemi më afër atij se ju, por ju nuk e vini re, përse pra, nëse nuk do të gjykoheni (në jetën e përtejme), ju nuk ia ktheni shpirtin atij? përgjigjuni kësaj, nëse thoni të vërtetën."*

Asnjëherë nuk ndodh që shpirti të kthehet në këtë botë pasi të ketë përfunduar afati i caktuar i jetës. Bile njerëzit do të ndahen në shumë grupe, kuptohet sipas asaj që kanë ofruar për Ditën e Kiametit, në gjendjen të cilën e kanë merituar.

*"Kështu, nëse ai (në agoni) është nga ata që janë të afërt (me All-llahun), do të ketë prehje, kënaqësi dhe dhunti të xhenetit."*

<sup>297</sup> El-Mulk, 2

*“E, nëse është nga njerëzit e së djathtës, (ai do të përshëndetet) “Paqë për ty” nga njerëzi e së djathtës.”*

Po, vërtet është një përshëndetje e këndshme e engjëjve për ata të cilët shpëtuan dhe merituan suksesin, për ata të cilët ngadhënjyen në fushëbetejën e kësaj jete. Këta i presin engjëjt fisnikë me qëllim që t’u japin sihariqin e këndshëm në Ditën kur do të kthehen tek All-llahu.

*“Por, nëse (ai në agoní) është nga përgënjeshtuesit e humbur, ai do të gostitet me ujë të vluar dhe do të përcëllohet në Zjarrin e flakëruar (të xhchenemit).”*

Këta janë njerëz pafat, këta do të kenë të ardhme të zezë.

Kështu, fjalët e fundit të kësaj sureje i përforcojnë fjalët e para të saj, me qëllim që së bashku të përbëjnë një tërësi të plotë e cila do ta konfirmojë çështjen e jetës, vdekjes dhe ringjalljes. Por, a thua do të arrijnë ta kuptojnë njerëzit se çfarë i pret në jetën e botës së ardhme? E kuptuan atë apo nuk e kuptuan (e indoruan), e vërteta dhe ndodhia e asaj dite asnjëherë nuk do të ndryshojë: *“Pa dyshim, kjo është e Vërteta e sigurt. Andaj lavdëroje emrin e Zotit ënd të Madhërishëm!”*

## *Tema e pestë*

### *Sfera e edukimit dhe ligjet hyjnore*

Studiuesit e sires (jetës) së Muhammedit s.a.v.s. janë të bindur se ai është njeriu që më së miri e njohu All-llahun dhe se ai jetoi me këtë njohje, shkëlqimi i së cilës e përcolli atë gjatë tërë kohës. Ata gjithashtu janë të bindur se Muhammedi a.s. arriti që me këtë njohje t'i nxjerrë njerëzit nga errësirat në dritë dhe t'i orientojë drejt horizonteve të larta të të menduarit dhe niveleve të larta të edukimit shpirtëror dhe devotshmërisë ndaj All-llahut.

Politikanët e mëdhenj pranë tij duken të vegjël dhe të paketuar kur e kemi parasysh ndryshimin e madh të cilin e bëri ai në botë; formoi shtete të reja duke i fshirë shumë shtete të tjera nga harta e botës ose i krijoi disa nga asgjëja!

Ne në asnjë mënyrë nuk pranojmë që atë ta përshkruajmë se është lider politik, sepse veçori e spikatur e personalitetit të tij është se ai është njeri hyjnor (rebbanij). Roli i tij është që të tjerët t'i njoftojë me All-llahun, zemrat e tyre t'i mbushë me madhështinë për Të, që fjalën e All-llahut ta bëjë më të lartën, në çdo kënd të shpirtit të njeriut dhe në të gjitha sferat e shoqërisë.

Muhammedi i mëson njerëzit se fëlliqësitat janë gjëra të shëmtuara dhe doemos të shpërfillen, ngase

njerëzit që janë të lidhur me All-llahun nuk mund të jenë të pavlerë!

Ai i mësonte njerëzit se vlerat e larta janë të bukura, se ato janë vlerë morale e njeriut të vlefshëm e të lartë, sidomos kur kemi parasysh se për ata është me rëndësi të jenë të sinqertë me All-llahun, përmbushësh të premtimit të Tij dhe të mëshirshëm për hir të All-llahut!

Veçori e spikatur e Umetit të cilin e ndërtoi Muhammedi është "hyjnorja". Ajo është bazë e aktivitetit të tij kur janë të zgjuar, ndërsa freski e ujë kur janë në gjumë.

Civilizimi islam ngrihet në këtë lloj të besimit i cili e bën All-llahun qëllim të çdo veprimi dhe mudi, faktor të çdo lëvizjeje, andaj nuk është çudi që në paqe e në luftë të brohorisin me zë të lartë "All-llahu ekber".

Është dallim i madh, mes civilizimit hyjnor dhe civilizimit modern, i cili vetveten e përshkruan se është njerëzor (human); humaniteti është cilësi e ndershme dhe e lartë, por lidhja me All-llahun është ajo që e ruan dhe e mbron atë nga rrëzimi drejt greminës së egoizmit dhe preokupimit me interesat e kësaj bote!

Veçoria "e hyjnore" (rebbanije) paraqet humanitetin e vërtetë. Është ajo që e njeh të vërtetën e tij dhe rolin e tij dhe që vazhdimisht lëvizë brenda sferës së të vërtetës dhe të mirës!

Bazë e përsosmërisë është besimi i shëndoshë! Nëse besimi nuk është i shëndoshë ose është i pasaktë, atëherë themelet e ndërtesës do të jenë të vendosura në bregun e gërryer që rrokulliset shpejt! Bindja e sinqertë (besimi i shëndoshë), nëse nuk e shtyn njeriun drejt vlerave të larta (ngritjes shpirtërore) dhe vrojtimin e së mirës, është e padobishme!

Metodologjia edukative e Islamit qëndron larg iluzioneve dhe hamendjeve, sepse është metodologji që bazohet në besnikërinë e logjikës së shëndoshë. Ai është larg errësirave, sepse vazhdon të ecë drejt dritës: *"O njerëz! Me të vërtetë, juve ju ka ardhur një provë bindëse (Muhamedi) nga Zoti i juaj dhe ju është zbritur Dritë e dukshme (Kur'ani). Kështu, ata që besojnë All-llahun dhe mbështeten fort tek Ai, (ta dinë se) Ai do t'i fusë në mëshirën dhe mirësinë e Vet dhe do t'i udhëzojë drejt vetes përmes rrugës së drejtë."*<sup>298</sup>

Prova bindëse është rrugë e mendjes, ndërsa drita është rrugë e sjelljes.

Vëzhgimi i misionit të njeriut, ashtu siç e përshkruan Kur'ani, na e bën të njohur shkallën e lartë të kërkuar për të.

Fjalët e All-llahut të Madhërishëm që thotë: *"Kur t'i jap formën dhe t'i fryj prej shpirtit Tim..."*<sup>299</sup> – e nënkuptojnë atë se All-llahu nuk e bëri këtë që njeriu të jetë bishë e egër, por për të qenë krijesë që do të zë vendin e lavdishëm.

Pikërisht kjo fryrje e lartë është ajo që e bëri njeriun të meritonte që t'i thuhet: *"Unë do të krijoj një mëkëmbës në tokë."*<sup>300</sup>

Gjynahu aksidental nuk e rrënon pozitën e lartë që e gëzon njeriu, pos nëse atë e shoqëron ngulmimi dhe rënia morale. Gjynahet e vogla bëjnë pjesë në sferën e faljes së gjerë, e cila i rrethon ato dhe i fshinë gjurmët e tyre.

<sup>298</sup> En-Nisa', 174-175

<sup>299</sup> Prej shpirtit të krijuar nga All-llahu posaçërisht për njeriun. Shpirti i njeriut është krijesë e All-llahut dhe jo pjesë e Qenies së Tij Hyjnore.

<sup>300</sup> El-Bekare, 30

Adhurimi (njohja e All-llahut), për hir të të cilit është krijuar njeriu, duhet të kuptohet në mënyrë të saktë! Zoti i botëve nuk pret nga robërit e Tij ndonjë të mirë ose dobi, por është Ai që i ushqen dhe u jep për të pirë atyre! Njerëzit nuk janë robër që i shërbejnë një zotëriu, i cili fiton nga rraskapitjet e tyre!

E tërë ajo me të cilën janë të ngarkuar njerëzit është njohja e Tij e vërtetë dhe e saktë, njohja e pozitës së tyre ndaj Tij, t'i shoqërojnë engjëjt lart në qiell në tesbih dhe tahmid (madhëri dhe falënderim); njeriut nuk i takon t'i hajë të mirat e All-llahut, ndërsa ta adhurojë dikë tjetër, siç nuk i takon që nga të tjerët të kërkojë atë të cilën e ka në dorë vetëm All-llahu. Pra nuk lejohet që kur të gabojnë ndaj Tij të mos mbështeten dhe të kërkojnë falje prej Tij.

Vallë a thua janë detyra të rënda këto? S'ka dyshim se vetëm të paturpit janë ata që i konsiderojnë ato të rënda! Këtë e nënkuptojnë ajetet në vijim: *"Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm të Më adhurojnë. Unë nuk kërkoj prej tyre risk, as nuk dëshiroj që të Më ushqejnë. Vërtet, All-llahu është Furnizuesi i vetëm, i Fuqishmi, i Plotfuqishmi."*<sup>301</sup>

Misioni i njeriut në tokë plotësohet me njohjen e urtësisë së tretë të krijimit të tij: *"Ai ju krijoi nga toka dhe ju vuri të jetoni në të; andaj, kërkon falje nga Ai dhe kthehuni me pendim tek Ai! Pa dyshim, Zoti im është afër dhe u përgjigjet (lutjeve)."*<sup>302</sup>

Jeta në tokë kërkon aftësi të rralla, mendjempërhtësi të veçantë, aktivitet të vazhdueshëm, dituri që do

<sup>301</sup> Edh-Dharijat, 56-58

<sup>302</sup> Hud, 61

t'i zbulojnë fuqitë dhe sekretet e fshchura, duar të mundshme për ta punuar tokën dhe për t'i shfrytëzuar të mirat e saj, siç kërkon nënshtrimin e tyre në mbështetje të besimit dhe principeve të larta.

Turpërohem kur i shoh popujt që i përkasin islamit, ndërsa jetojnë me aftësi të vyshkura e me duar të paralizuara, që jetojnë në faqe të dheut si dhelpira, që hanë nga mbeturinat e luanëve; me sy të përlotur, të dobët e të dëshpëruar i shikojnë duart e të tjerëve duke i kërkuar gjërat që i kanë; ata janë lypsa e të varfër!

S'ka dyshim se këta njerëz nuk e njohin misionin e tyre në jetë (ashtu siç kërkon islami). Ata nuk i njohin kërkesat e xhihadit për ta mbrojtur të vërtetën, andaj u bënë të pavlefshëm, e me ta u bë e pavlefshme edhe e vërteta.

Edukata e shëndoshë mbështetet në vetëdijen e përgjithshme mbi qëllimet e larta të ekzistencës, në njohjen e hollësishme të mësimëve të përsosmërisë të cilat në hollësi i shpjegon feja dhe të cilat burojnë nga Libri i All-llahut dhe Suneti i të Dërguarit s.a.v.s

Psikologët i përmendin tre fenomene të ndjenjave duke e bërë të qartë lidhshmërinë mes tyre. Ato janë: njohja shkencore, të cilën e ndjek natyra e teuhidit dhe tendenca e sjelljes. Ndriçimi i mendjes zakonisht krijon gjurmë në zemër, që më vonë si rezultat i domosdoshëm të krijohet puna.

Ata që e njohin All-llahun, medoemos duhet t'i nënshtrohen Atij. Ndërkaq fushat e nënshtrimit janë shumëdegëshe, ato shpërndahen në jetë njësoj siç shpërndahen venat në tërë trupin e njeriut.

Mirëpo, jo çdoherë punët rrjedhin me lehtësi në praktikë! Shumë herë ndodhë që gjatë kryerjes së tyre të dalin pengesa të cilat e këpusin lidhjen mes diturisë dhe punës, mes dëshirës dhe zbatimit.

Pikërisht për këtë themi se edukimi i suksesshëm është detyrë e rëndë; prodhimi i njeriut është mjeshtëria më e ndërlikuar në këtë botë.

Megjithatë edukimi i njeriut është i domosdoshëm. Në të kundërtën, njeriun e lëmë të bie në fund të pusit, sidomos e lëmë Umetin islam ta harrojë misionin e tij, ta shpërfillë të vërtetën të cilën ia dha All-llahu dhe të bëhet burim i çrregullimit të verbër në tokë, ashtu siç është tani! Iman i pafrytshëm (shterpë), ndërsa kufër aktiv! Islam me krah të tharë, ndërsa ateizëm me armë të mprehtë! Pretendim takvallëku, por i njollosur me padituri, ndërsa shpërfillje dhe haresë e All-llahut, por i shoqëruar me përparim të lartë shkencor në tokë, det dhe ajër!

Të mos vajtojmë, por ta fillojmë punën. Të mos e harrojmë urtësinë e krijimit tonë. Kujtoj se është e radhës që ta marr këtë Umet për dorë dhe ta udhëzojë drejt gjërave të bukura të kësaj feje.

### *Atë që All-llahu e do dhe atë që nuk e do*

Shprehja "All-llahu e do dhe All-llahu nuk e do" i nënkuptojnë themelet e para të edukimit të shëndoshë. Besimtari i denjë shpejton pas kënaqësisë së All-llahut dhe punëve të mira. Ai gjithmonë i punon gjërat e duhura, ndërsa u shmanget gjërave të ndaluara.



Besimtari i denjë fillon t'i dashurojë gjërat që All-llahu i do dhe t'i urrejë ato që Ai nuk i do. S'ka dyshim se këto gjëra ia pastrojnë shpirtin dhe e ngrenë pozitën e tij lart në horizontet e tëra të jetës. Nuk është e thënë që adhurimi të jetë brenda në xhami, por ai duhet të jetë në çdo vend.

*All-llahu nuk i do ata që e kalojnë kufirin*

Janë këto fjalët e para që i lexova në Mus'hafin e madhërishtëm: "*Mos e kaloni kufirin, se All-llahu nuk i do ata që e kalojnë kufirin.*"<sup>303</sup> Që pastaj, vetëm pas pak rreshtave t'i lexoja këto fjalë: "*Por bëni të mira, se All-llahu me të vërtetë i do bamirësit.*"<sup>304</sup>

Në det dhe xhungël mbisundon ligji i cili e paralajmëron luftën e pamëshirshme për të mbijetuar. Thënë ndryshe, është ky ligji i fuqisë, i cili na mëson se i fuqishmi e gëlltit të dobëtin; peshqit e mëdhenj i gëlltisnin të vegjlit, ndërsa bishat e egra i hanë kafshët e buta dhe ato shtëpiake. Këtu nuk ka vend për logjikë e as për drejtësi!

A thua ky ligj i mbisundon sot njerëzit? Ka njerëz që janë shumë të pasur, që kanë kohë, mençuri dhe mundësi të jashtëzakonshme, por që duan t'ua plaçkitin të tjerëve pasurinë dhe t'ua cenojnë të drejtat dhe nderin.

Bota qysh moti është duke i përjetuar gjurmët e këtyre vështirësive dhe padrejtësive. Shpallja e lartë i

<sup>303</sup> El-Bekare, 190

<sup>304</sup> El-Bekare, 195

thërret njerëzit ta ndihmojnë njëri-tjetrin në punë të mira dhe ruajtjen nga të këqijat dhe jo në gjynahë dhe armiqësi!

Gjatë jetës më kishte bërë vaki të isha i pranishëm në marrëveshjet e qirasë që nënshkruheshin mes qiradhënësit dhe qiramarrësit. Më kishte ndodhur ta shihja qiramarrësin duke e nënshkruar fletën e pastër të marrëveshjes duke e lënë qiradhënësin ta caktonte vlerën të cilën e dëshironte, sot apo nesër! Siç i kam parë punëtorët të cilët punonin gjatë tërë vitit dhe në fund e falënderonin All-llahun për shëndetin dhe punën e kryer, pa marrë parasysh se sa kanë fituar.

Por, bota ndryshoi, marrëveshja e qirasë mori kuptim tjetër; në fakt, ajo u shndërrua në marrëveshje pronësie, qiramarrësi nuk del nga toka e pronarit të vërtetë, madje nëse i zoti i tokës dëshiron ta shesë atë, atëherë qiramarrësi i thotë: "Mos u lodh, merri gjysmat e të hollave dhe shporru!".

Kështu, njeriut të cilit iu është bërë e padrejtë bëhet zullumqar, njëjtë sikur shoqëria të gjykojë me rregullin: All-llahu i do ata që e kalojnë kufirin!

Para disa viteve më ra të dëgjoj për vrasjen e dhjetë dijetarëve myslimanë në një vend islam, që e kishin refuzuar revolucionin komunist që do ta shuante dritën e islamit! Lajmi erdhi nga një radio evropiane, sepse radiostacionet arabe e preferuan heshtjen!

Komiteti Ndërkombëtarë për Amnisti (Amnesty international) e ngriti zërin lart dhe e dënoi ashpër ngjarjen! Thashë me vete: Njerëz me natyrë të shëndoshë, që nuk e pranojnë heshtjen për krimet që i bënë njerëzit e veshur me petkun e fesë (gënjeshtarë), disa

që ishin vrasës, e disa të tjerë që në shenjë kënaqësie preferuan heshtjen ose që nga frika nuk thanë gjë ose që nuk çanë fare kokë për krimet e vrasjeve!

E vërteta është se vazhdimi e armiqësisë dhe pranimiti i tyre pa ndjenja (gjakftohtësi, apati) duke u përhapur në Umetin islam nuk mund të jetë besim (i-man)! Sjelljet armiqësore i bëjnë njerëzit të mos e njohin All-llahun dhe të mos çajnë kokë për atë se çfarë do dhe çfarë nuk do Ai!

A nuk është çudi që Umeti ynë të bie në këtë nivel të ulët?

Sjelljet armiqësore, politike ose ekonomike më vonë bëhen pjesë e pandashme e umetit. Njerëzit fillojnë të mësohen me to, ndërsa siguria bëhet mirazh. Pikërisht kjo e bën të pamundshme predikimin e mirëfilltë të islamit.

Le t'i dëgjojmë fjalët e të dërguarit Muhammed s.a.v.s. që flasin për këtë çështje.

Ai thotë: *"Ruajuni padrejtësisë, sepse padrejtësia do të jetë errësirë në Ditën e Kiametit; ruajuni veprave të pahijshme, sepse All-llahu nuk e do atë që bën vepra të pahijshme dhe të paturpshmin (njeriun amoral), ruajuni koprracisë, sepse koprracia i ka bërë ata që ishin para jush ta derdhin gjakun e njëri-tjetrit dhe t'i lejojnë gjërat e ndaluara."*<sup>305</sup>

*"Në Ditën e Kiametit do të ndodhë që njeriut t'i jepet libri i tij i shënimeve të veprave të mira, sa që do të mendojë se ka shpëtuar, por do ta ndjekin padrejtësitë që ua ka bërë njerëzve dhe kështu nuk do t'i mbetet asnjë e mirë, ndërsa do të ngarkohet me të këqijat e tyre."*<sup>306</sup>

<sup>305</sup> Transmeton Ahmedî nga Ebu Hurejra, vëll. II, faq. 431.

<sup>306</sup> Transmeton Bejhekiu

*“Myslimani i cili heq dorë nga mbështetja e një njeriu mysliman në vendin ku atij i cenohet e drejta dhe nderi, All-llahu do të heqë dorë nga mbështetja e atij në vendin ku ai do ta dëshirojë ndihmën e Tij; ndërsa myslimani i cili e ndihmon myslimanin në vendin ku i cenohet e drejta dhe nderi, la ta dijë se All-llahu ka për ta ndihmuar në vendin ku ai e dëshiron ndihmën e Tij.”<sup>307</sup>*

*“Sikur banorët e qiejve dhe të Tokës të bashkohen për ta vrarë një mysliman, All-llahu do t’i hedhë të gjithë me fytyrë përmbys në zjarr.”<sup>308</sup>*

*“Më janë prezantuar tre të parët që do të hyjnë në xhennem: udhëheqësi tiran, i pasuri që nuk e jep hakun e All-llahut të caktuar për pasurinë e tij dhe i varfëri mburravec.”<sup>309</sup>*

All-llahu është Ai që më së miri i di njerëzit. Ai e di më së miri se çfarë u duhet e çfarë nuk u duhet. Ne medoemos duhet ta ndërtojmë edukimin islam mbi bazat e respektimit të të drejtave dhe detyrave dhe kur të dëgjojmë se All-llahu e do një gjë, të shpejtojmë ta bëjmë atë. E kur të dëgjojmë se Ai e urren një gjë, të largohemi dhe ta urrejmë atë.

Çfarë do të ishte vlera e përkatësisë islame e shoqërive të cilat i cenojnë të drejtat e njerëzve dhe nuk i respektojnë detyrat e shenjta? Çfarë do të ishte vlera dhe dobia e kësaj përkatësie nëse preferohen mashtruesit dhe dinakët, ndërsa shpërfillen të mençurit dhe të drejtët?

<sup>307</sup> Transmeton Ebu Davudi, vëll. IV, faq. 271, numër: 4884 / dhe Ahmed, vëll. IV, faq. 30

<sup>308</sup> Transmeton Tabreani në *Xhemiu es-Sagir* nga Ebu Bekreto, marrë nga *Et-Tergîb ve't-Terkîb*, vëll. III, faq. 294

<sup>309</sup> Transmeton Ibn Hazime dhe Ibn Hibani në dy përmbledhjet e tyre të *sahihëve*, marrë nga *Et-Tergîb ve't-Terkîb*, vëll. III, faq. 174

Shterja e burimeve të edukimit të mirëfilltë dhe të hollësishëm nënkupton aktivizimin e të gjitha motiveve të së keqes, që pastaj të mos shohim tjetër, veçse çartjen e bishave dhe ngatërresave mes ngadhënjimtarëve dhe të ngadhënjyerve.

Transmeton Aisha – All-llahu i Madhërishëm qoftë e kënaqur me të – se i Dërguari s.a.v.s. ka thënë: *“Janë gjashtë vetë që i kam mallkuar unë dhe që i ka mallkuar All-llahu, ndërsa lutja e të Dërguarit është e pranuar:*

1 - Ai që shton gjëra në Librin e All-llahut (me risi dhe besëtytni).

2 - Mohuesi i kaderit të All-llahut (që mendon se bota funksionon vetë).

3 - Ai që e udhëheq Umetin tim me ashpërsi (tirani), e përul atë që All-llahu e ka ngritur, ndërsa e ngritë atë që All-llahu e ka përulur (janë shumë të tillë në histori, si në të kaluarën ashtu edhe sot).

4 - Ai që i lejon gjërat e ndaluara (haramet, fëlliqësirat dhe gjynahet i llogarit të lejuara).

5 - Ai që e lejon vrasjen e anëtarëve të familjes sime, që All-llahu e ka ndaluar.

6 - Shpërfillësi i Sunetit (ai që nuk pranon të punohet sipas tij).<sup>310</sup>

Ky hadith i përmban disa forma të çrregullimit shoqëror, të cilat përhapen me çrregullimin e sigurisë, rritjen e rasteve të armiqësisë dhe cenimin e të drejtave.

<sup>310</sup> Transmeton Taberaniu në *El-Kebir* dhe Ibn Hibani në *Sahihun* e tij dhe Hakimi. Hadithi është me *sened sahih*, marrë nga *El-Tergib ve'l-Terhib* vëll. I, faq. 84

*Bamirësia - Ihsani*

Është ky elementi i dytë i edukimit të shëndoshë dhe të vetëdijshëm, që ne e marrim nga fjalët e All-llahut të madhërishëm: *"Por bëni të mira, se All-llahu me të vërtetë i do bamirësit."*<sup>311</sup>

Bamirësia (ihsani) në formën e saj më të lartë është veçori e Zotit të botëve, sepse keqbërja lind nga injoranca, paaftësia, shkujdesi etj., gjë që paraqesin veçori absurde për All-llahun!

All-llahu i Madhërishëm flet për krijimin e Tij të gjithësisë së gjerë dhe thotë: *"E tillë është fuqia e All-llahut, i Cili ka përsosur çdo gjë. Ai di mirë çdo gjë që bëni ju."*<sup>312</sup>

Ai u bëri thirrje njerëzve dhe prej tyre kërkoi që ta hulumtojnë ndonjë të metë në këtë fuqi dhe krijim të përsosur, i cili do ta shëmtonte atë bukuri të mahnitur të krijimit të Tij. Por, ajo është e pamundur, sepse: *"Nuk mund të gjesh në krijimin e të Gjithëmëshirshmit kurrfarë ceni. Hidhe vështrimin; a sheh ndonjë plasaritje? Pastaj hidhe sërish vështrimin; sytë e tu do të kthehen të lodhur e të molisur."*<sup>313</sup>

Fuqinë e lartë e cila e krijon njeriun e shohim në krijimin e tij fazë pas faze në një errësirë të trefishtë,<sup>314</sup> krijim pas krijimi, organ pas organi, derisa në fund të bëhet krijesë e plotë për nga krijimi dhe forma! Kush

<sup>311</sup> El-Bekare, 195

<sup>312</sup> En-Neml, 88

<sup>313</sup> El-Mulk, 3-4

<sup>314</sup> Shkencë bashkëkohore pohon se errësirat e trefishta janë:

- Shtresa e jashtme e barkut të femrës,
- Shtresa uterinare,
- Membrana amniokoronike

është Ai që e bëri këtë? Është All-llahu: *"I Cili ka përsosur çdo gjë që ka krijuar. Ai e ka filluar krijimin e njeriut prej baltës."*<sup>315</sup>

All-llahu i Madhërishëm, pasi e krijoi njeriun dhe e bëri të jetonte në faqe të dheut dhe pasi ia bëri të qartë misionin e jetës – për të qenë njeriu i pajisur me veçori të larta të besimit – e urdhëroi të bënte punë të mira, që me të ta arrinte shkallën e përsosmërisë. E në qoftë se atë e mund natyra e botës dhe ai nuk e arrin këtë shkallë të lartë, atëherë ai do të duhet t'i përsërisë përpjekjet dhe të mos i nënshtrohet paaftësisë dhe plogështisë, por të vazhdojë të përpiqet, derisa me punët e tij ta arrijë shkallën e lartë të kërkuar, kuptohet në saje të mundësive të tij.

I Dërguari s.a.v.s. thotë: *"Me të vërtetë, All-llahu e ka bërë obligim mirësinë në çdo gjë (ihsanin)."*<sup>316</sup>

I Dërguari i All-llahut kaloi pranë një njeriu i cili e kishte vënë këmbën në qafë të deles e po e mprehte thikën, ndërkaq ajo po e vërente me shikimin e saj, andaj i tha: *"Po pse nuk e bërë më herët.....a dëshiron ta vrasësh dy herë? Pse nuk e mprehe thikën para se ta kishë rrëzuar përtokë?"*<sup>317</sup>

Transmeton Ibn Sirini se Omeri – All-llahu i Madhërishëm qoftë i kënaqur me të – e pa një njeri që po e tërhiqte zvarrë një dele për këmbën e saj për ta prerë, andaj i tha: *"Mjerë për ty, merre drejt vdekjes në mënyrë të bukur."*<sup>318</sup>

<sup>315</sup> Es-Sexhde, 7

<sup>316</sup> Transmeton Muslimu, vëll. III, faq. 1548, numër: 1955 / Gjuetia dhe prerja e kafshës.

<sup>317</sup> Transmeton Taberaniu në *Xhamiu el-Këbir dhe El-Evsat* dhe Hakimi. Marrë nga *El-Tergib ve't-Terhib*, vëll. III, faq. 204

<sup>318</sup> Transmeton Abdurrezaku me *sened mevkuf*, marrë nga *El-Tergib ve't-Terhib*, vëll. III, faq. 205

Nëse feja nuk është ngritje e nivelit të lartë të njeriut, atëherë çfarë është?

Për fat të keq, myslimanët sot janë njerëzit që rrinë shumë larg realitetit të mirësisë (ihsanit)! Shtëpitë e tyre janë të vjetra e të prishura, rrugët e tyre janë të këqija dhe të palëvizshme, por edhe mënyra e jetës së tyre është e paedukuar! Prodhimi i mallrave nuk u afrohet prodhimeve të të tjerëve, sikur që prodhimi i tyre të jetë i bërë me duar të tjera! Myslimanët sot nuk janë korrektë në punë, sidomos kur kemi parasysh se një punë e vogël u merr shumë kohë dhe mund! Sigurisht që nuk duhet të flasim për shkallën e përsosmërisë së punës së tyre, se edhe ajo me siguri se është në shkallën më të ulët të tij. Të tjerët janë të aftë që këtë shkallë ta arrijnë për një kohë më të shkurtët dhe me një mund shumë më të vogël! Sikur ata të jenë të krijuar nga një baltë tjetër, e jo nga balta nga e cila janë krijuar të gjithë njerëzit!!

Ekziston një dyshim i madh në përkatësinë e vërtetë të këtyre njerëzve ndaj Islamit! Kujtoj se ata kanë nevojë për një reformim mendor dhe moral, natyrisht nëse duan t'i kthehen Islamit. Ne duam që myslimanët të jenë më korrektë në punët e tyre, i duam punët që kryhen me të gjitha fuqitë e tyre, fizike dhe shpirtërore, që punët e tyre të jenë të shëndosha e të çmuara, veçmas kur kemi parasysh se jetojmë në civilizimin industrial ku gjërat maten me "milimetër" ose me më pak se ajo. Koha bashkëkohore nuk i merr parasysh mendjelehtësitë (aventurat dhe rreziqet e pastuduara), shpërfilljet dhe ko incidencat e panjohura.



Mirësia e përmendur në Kur'anin famëlartë i përmban disa kuptime, varësisht se në çfarë konteksti janë përdorur. Fjalët e All-llahut të Madhërishëm: *"Në të vërtetë, All-llahu urdhëron drejtësinë dhe mirësinë..."*<sup>319</sup> – e shënojnë hirin me drejtësinë. Drejtësia është e nevojshme për rregullimin e gjërave dhe vendosjen e drejtësisë mes njerëzve.

Transmeton Ibn Ebi Hatim se Muhammed ibn Ka'b el-Kuredhi ka thënë: "Më thirri Omer ibn Abdul-Azizi, dhe më tha: "Ma përshkruaj drejtësinë. E unë i thashë: "Ah, ke pyetur për një gjë shumë të rëndësishme: për fëmijët e vegjël bëhu baba, për të mëdhenjtë bëhu fëmijë, për moshatarin bëhu i njëjtë, kështu bëhu edhe për gratë! Njerëzit dënoi në saje të gjynaheve të tyre dhe mos u bë nga ata që e kalojnë kufirin, ndoshta je i zemëruar dhe në atë moment e godet me një rrahje më shumë."

Ky është përshkrimi i drejtësisë, ndërsa hiri përshkruhet me përshkrim tjetër. Transmeton Ali ibn Ebi Talibi – All-llahu i Madhërishëm qoftë i kënaqur me të – se i Dërguari i s.a.v.s. i ka thënë: "A të njoftoj me vlerat më të shtrenjta morale në këtë botë dhe në ahiret? Ta vizitosh atë që nuk të viziton (që i ka ndërprerë lidhjet me ty); t'i japish atij që nuk të jep (të privon nga dhënia) dhe t'ia falësh atij që të ka bërë padrejtësi." Kjo është mirësia e plotë. Me siguri se këtë mirësi e nënkuptojnë fjalët e All-llahut të Madhërishëm: *"Të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. All-llahu i do bamirësit."*<sup>320</sup>

<sup>319</sup> En-Nahl, 90

<sup>320</sup> Ali-Imran, 134

Mposhtja e zemërimit është gradë e lartë! Zemërimi mund të jetë nga fshehtësitë që qëndrojnë pas armiqësive dhe grindjeve të shumta në jetë. S'ka dyshim se grada më e lartë është falja e fajit të njerëzve kur e kemi mundësinë e hakmarrjes. Pikërisht kjo është grada e bamirësisë (ihsanit)!

Fjalët e All-llahut të Madhërishëm: *"Shpenzojeni pasurinë në rrugën e All-llahut dhe mos e çoni veten tuaj në shkatërrim, por bëni të mira; All-llahu me të vërtetë i do bamirësit."*<sup>321</sup> – theksojnë një kuptim tjetër të bamirësisë (ihsanit); popujt nuk i shërbejnë misionit të tyre me koprraci dhe urrejtje të shpenzimit të pasurisë në rrugë të All-llahut! Luftërat, si në të kaluarën ashtu edhe sot, kërkojnë shpenzime të mëdha të pasurisë. Tatimet e Luftës së Dytë Botërore kanë arritur 90% të të ardhurave të njerëzve! Çfarë do të themi për luftërat atomike, të cilat kërkojnë harxhime marramendëse, shpenzim të arit dhe argjendit të grumbulluar, përgatitje e predhave, orientim drejt cakut, stërvitje e ushtarëve dhe popujve për ballafaqim me këto luftëra dhe bartje e pasojave të tyre.

Muslimanët detyrohen t'i njohin këto të vërteta; që feja e tyre të shpëtojë, ndërsa vendet e tyre të mbeten të paprekura, patjetër duhet të zgjerohen në shpenzimet luftarake dhe të përsosen metodat e çdo gjëje për fitoren e luftës.

Këtë e provojnë ajetet e tjera të cilat flasin për të vërtetën e bamirësisë (ihsanit) dhe të sferës së saj të gjerë; ato nënkuptojnë këmbënguljen dhe trimërinë

<sup>321</sup> El-Bekare, 195

deri në gramat e fundit: *"Ata vetëm thoshin: "O Zoti ynë! Na i fal gjynahet tona dhe teprimin në punën tonë, na i forco këmbët (në istikam) dhe na ndihmo kundër popullit jobesimtar! Dhe All-llahu u dhuroi atyre shpërblimin e kësaj bote dhe shpërblimin më të mirë të jetës tjetër. All-llahu i do bamirësit."*<sup>322</sup>

Kështu shohim se bamirësia e përfshinë individin, shoqërinë dhe shtetin. Edukata e shëndoshë dhe e drejtë do të ndërtohet vetëm atëherë kur do ta mbjellim kuptimin e bamirësisë (ihsanit) në shpirtat e njerëzve; ajo është nga gjërat që All-llahu i Madhërishëm i do.

Pse disa njerëz përpiqen të bëjnë çrregullime në Tokë, edhe pse në të është vënë rregulli i All-llahut, janë vënë ligjet e Tij dhe është zbritur Shpallja? Pse disa njerëz dëshirojnë që me çrregullimin e bërë të krijojnë kaos, shkujdesje dhe mosmirënjohje?

A thua njerëzit janë krijuar për ta përhapur këtë çrregullim (kotësi, papunë, nënçmim)?

I kemi parë ata që punojnë gjëra të kota dhe nuk çajnë kokë për rezultatet përfundimtare të tyre. Këta nuk e ndiejnë çrregullimin që janë duke e bërë, shkatërrimin e të mbjellave dhe bagëtisë. A nuk e dinë ata se All-llahu i Madhërishëm thotë: *"All-llahu nuk e do shkatërrimin?"*<sup>323</sup> Se All-llahu i Madhërishëm iu drejtua Karunit dhe i tha: *"Mos kërko ngatërresa në Tokë, sepse All-llahu nuk i do ngatërrestarët!"*<sup>324</sup>

Çrregullimi përmban shumë dukuri. E para është dalja nga sfera e ligjeve kozmike dhe shoqërore të

<sup>322</sup> Ali-Imran, 147-148

<sup>323</sup> El-Bekare, 205

<sup>324</sup> El-Kasas, 77

vëna nga All-llahu i Madhërishëm dhe zgjidhja e çështjeve të njerëzve me mendjehhtësi dhe çmenduri.

Çrregullimi (lexo: ngatërresat) ndodhë të fillojë me gjëra të parëndësishme, si p.sh. kur njeriu e lë të hapur çezmën e ujit ose të prishur dhe nuk merr masa për ta rregulluar atë ose kur bën që gjëra të parëndësishme të shndërrohen në probleme të ndërlikuara, këto bëhen gaca zjarri që më vonë shndërrohen një zjarr të madh!

Bota e tretë është duke i vuajtur dëmet e mëdha të çrregullimit administrativ! Posti publik është bërë dëfrim i posaçëm ose famë personale. Njeriu që zë post publik nuk e di se ai është përgjegjësi e madhe dhe amanet i vështirë. Prandaj, ai nuk çanë kokë për kërkesat e postit në fjalë dhe nuk merret me detyrat e tij! Më kanë befasuar sjelljet e sferës administrative: të udhëheqësit dhe të udhëhequrit vazhdimisht mendojnë se si të ikin nga vendi i punës dhe detyrat që i kanë! Zemërimi im bëhet edhe më i madh kur dëgjoj se si disa e marrin për arsye faljen e namazit për t'i lënë punët një orë apo gjysmë ore, që mjetet e punës të shkatërrohen ose që kështu të ngecë prodhimi!!

Në disa vende të tjera shohim se si punëtorët bëjnë gara mes vete se cili do ta kryejë punën sa më shpejtë, me më pak mund dhe në mënyrën më të bukur, ndërkaq që ne jemi në anën tjetër të bregut të përfshirë nga shkujdesi dhe lajthitja.

Administrimi është art që ndërtohet mbi bazat e mendjemprehtësisë, kujdesit dhe shpikjes. Janë këto veçori që i bënë arabët të jenë fuqi e parë në botë më herët.

Ata që e studiuuan planin e Halid ibn Velidit në Luftën e Jermukut dhe planin e sahabëve në Luftën e

Ahzaibit, mbetën të mahnitur nga superioriteti administrativ i myslimanëve.

Për fat të keq, sot ne jemi dëshmitarë që metodat tona të punës nuk burojnë nga mendja e mprehtë ose vendosmëria e paluhatshme, andaj cila është vlera e besimit (imanit) që i ka humbur këto elemente?

Misionet madhështore arrijnë sukses vetëm atëherë kur atij i shërbejnë dhuntitë dhe aftësitë madhështore. Këto dhunti dhe aftësi madhështore fillojnë me adaptimin e rendit, zhvillimin e aftësive dhe zbulimin e përvojave dhe mundësive; krijimin e harmonisë me natyrën e All-llahut të krijuar në shpirt dhe gjithësi; urrejtjen e madhe të mendjelehtësisë, dembellëkut dhe paaftësisë; urrejtjen më të madhe të krijimit të çrregullimit dhe ngatërresës; vënies re se si kaosi i fut gishtat në çdo gjë dhe të ndërtuarën e bënë gërmadhë (tokën pjellore e shndërron në jopjellore), ndërsa fenë prapambeturi, shpërfillje dhe të dështuar para ateizmit që është duke ardhur dhe para epsheve të ndezura!!

*All-llahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet)*

Është ky një horizont tjetër i përsosmërisë materiale dhe shpirtërore, të cilin Kur'anë famëlartë e përshkruan me këto fjalë: "Pa dyshim, All-llahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen."<sup>325</sup> Pra, All-llahu e do pastërtinë shpirtërore dhe përsosmëri në trupore, ashtu siç na mëson ajeti në fjalë.

<sup>325</sup> El-Bekare, 222

Trupi ka nevojë për pastrim të rregullt, ndërsa papastërtia e nxit neveritjen. Nuk është e rastit që islami preferon marrjen e abdesit pesë herë në ditë dhe kujdesin për pastërtinë e përgjithshme të trupit, rrobave dhe të vendit. Temperaturat e larta dinë ta ndotin lëkurën e njeriut, duke krijuar djersë që ndonjëherë bëhen të padurueshme.

Islami është feja e vetme e cila i dha rëndësi të madhe bukurisë së trupit dhe pastërtisë së tij. Pastërtia e trupit ka qenë shenjë me të cilën myslimanët janë dalluar nga popujt e tjerë.

Në hadith thuhet se i Dërguari s.a.v.s. ka arritur te varret dhe ka thënë: *"Paqja qoftë mbi ju, o besimtarë! Në dashtë Zoti, ne shumë shpejt do t'ju bashkëngjitem! Kisha dashur sikur t'i kishim parë vëllezërit tanë! Të pranishmit thanë: "Po, a nuk jemi ne vëllezërit e tu, o i Dërguari i All-llahut? Ju jeni shokët e mi! Vëllezërit tanë janë ata që ende nuk kanë ardhur. Ata thanë: "Po si do t'i njohim ata që ende nuk kanë ardhur, e që janë nga Umeti yt, o i Dërguari i All-llahut? Ai tha: "A e keni parë njeriun që ka një kalë, ballëbardhë, me tri këmbë të bardha, përpara i përhimë pa lara, a nuk e njeh kalin e tij? Gjithsesi, o i Dërguari i All-llahut, thanë ata! Ai tha: "Pra, ata do të vijnë ballëbardhë, me këmbë të bardha, nga gjurmët e abdesit! Ndërkaq, unë do të jem udhërrëfyesi i tyre për te havdi<sup>326</sup> (burimi)."<sup>327</sup>*

Është zakon që njeriu të pastrohet dhe të zbukurohet e rregullohet, veçmas kur bëhet gati për të dalë

<sup>326</sup> Mund ta ketë edhe kuptimin: "Unë do t'u mbushë atyre ujë te havdi (burimi)".

<sup>327</sup> Transmeton Muslimi, vëll. I, faq. 218, numër: 249/ Pastërtia.

para të tjerëve. Njeriu nuk dëshiron që njerëzit ta shohin të parregulluar dhe të papastër. S'ka dyshim se këto ndjenja janë të bukura. Më e bukur se kjo do të ishte kujdesi i tij për përsosmërinë e pastërtisë dhe pamjes së tij, qoftë kur është vetëm ose në shoqëri me njerëz, kur bie në shtrat të gjumit ose kur është i zgjuar. Jo për tjetër, por vetëm për atë se duhet të jetë i bukur dhe All-llahu ta shohë në formën më të bukur. Sepse, All-llahu është i bukur dhe e do bukurinë.

Të shohim se çfarë na thotë i Dërguari s.a.v.s. për këto gjëra! Transmeton Ibn Abasi se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: *"Pastroni trupin tuaj (para se të bini në gjumë), ju pastroftë All-llahu i Madhërishëm! Nuk ndodhë që dikush prej jush të bjerë në gjumë i pastër e të mos i vjen një engjëll, që çdoherë që përpushet në ndonjë moment të natës, e të mos thotë: "O Zot, falja këtij, sepse në gjumë ka rënë i pastër."*<sup>328</sup>

Transmeton Muadh ibn Xhebeli se i Dërguari s.a.v.s. ka thënë: *"Nuk ndodhë që myslimani të bjerë në shtrat i pastër, e të përpushet në ndonjë moment të natës – të zgjohet – e të kërkojë prej All-llahut ndonjë të mirë nga të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër pa ia dhënë All-llahu atë."*<sup>329</sup>

Muslimani është shembull i lartë dhe i mrekullueshëm i pastërtisë dhe i bukurisë. Ai është kështu vetëm atëherë kur i zbaton porositë e fesë së tij. Ku është sot pastërtia e trupit tonë, e rrugëve tona, e fshatrave dhe qyteteve tona, në krahasim me këto porosi të shkëlqyera?

<sup>328</sup> Transmeton Taberaniu në *El-Ësat me sened xhejîd*, marrë nga *Et-Tergîb ve'l-Terhîb*, vëll. I, faq. 409

<sup>329</sup> Ebu Davudi, vëll. IV, faq. 310, numër: 5042

Duhet ta dimë se bukuria e jashtme nuk është aspak më e parëndësishme se pastërtia e brendshme. Shtëpia ngjyrëçelët nuk ka vlerë nëse muret e saj janë të pangjyrë dhe në to lëvizin merimangat dhe papastërtitë e tjera!

Pikërisht për këtë islami urdhëron zbukurimin e brendshëm dhe pastërtinë e shpirtit nga të metat dhe të shëmtuarat.

Islami nuk e kërkon pagabueshmërinë e përherëshme, se kjo është e pamundur - ne nuk jemi engjëj, të pastër, të pagabueshëm e gjithmonë të lidhur me qiellin dhe dritën e tij. Ne jemi njerëz, gabojmë dhe e qëllojmë, rrëzohemi dhe ngrihemi, ndotemi dhe pastrohemi! Nga ne kërkohet që kur të gabojmë, ta përmirësojmë gabimin. Do të jetë i shkatërruar (i rrëzuar për tokë) ai që ngulmon në gabime dhe mbulohet nga fajet e veta. Transmeton Ebu Hurejre se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: *“Kur besimtari bën gjynah, në zemrën e tij bëhet një pikë e zezë. Nëse pendohet dhe heq dorë nga gjynahu dhe kërkon falje, atëherë pastrohet prej saj. E nëse e rrit gjynahun, edhe ajo rritet – pika e zezë – derisa ta mbulojë tërë zemrën e tij. Ky është “mbulimi” të cilin e përmend All-llahu në Librin e Tij: “Nuk është ashtu! Por veprat e tyre (të këqija) ua kanë mbuluar zemrat.”<sup>330</sup>*

Bërja gabim është në natyrën e njeriut, prandaj edhe pendimi duhet të jetë i domosdoshëm! Butësia e All-llahut dhe mëshira e Tij janë ato që e gëzojnë njeriun kur pendohet. Ato e freskojnë shpirtin e atij, që pasi ishte i devijuar e gjen rrugën e vërtetë. Transme-

<sup>330</sup> Ibn Maxhe, vëll. II, faq. 1418, numër: 4244 / Përmendja e gjynaheve, ajeti është i sures El-Mutaffifin, 14



ton Ebu Musa se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: *"Vërtet All-lahu i Madhërishëm gjatë natës e mban të shtrirë dorën për të pranuar pendimin e gjynahqarëve të ditës dhe e shtrin dorën gjatë ditës për ta pranuar pendimin e gjynahqarëve të natës, derisa të lind dielli nga perëndimi."*<sup>331</sup>

Vallë, pse është lidhur pranimi i pendimit me këtë ndodhi të madhe? Përgjigja do të ishte: koha e lindjes së diellit nga perëndimi e paralajmëron fundin e shtyrjes së afatit të caktuar për njerëzit për të besuar! Nxënësi shënon sukses në provim vetëm atëherë kur shkruan nga mendja e tij, ngase kur fillon të shkruajë nga libri që e ka përpara, atëherë është i pasuksesshëm.

Pikërisht për këtë themi se pendimi është i papranuar kur fundosemi. Nuk ka pendim në çastin e fundit (grahmën e fundit). Transmeton Abdullah ibn Omeri se i Dërguari s.a.v.s. ka thënë: *"Vërtet All-lahu i Madhërishëm e pranon pendimin e robit të Vet deri para gargarës (frymës së tij të fundit)."*<sup>332</sup>

Joshjet e devijimit dhe shastisjes janë të shumta. Ato e ndotin shpirtin sikur që e ndotin trupin djersët dhe jashtëqitjet e tij. Prandaj është i domosdoshëm pastrimi i shpirtit me pendim, ndërsa i trupit me ujë, ngase që të dyja këto pastrojnë. Ky është kuptimi i ajetit: *"Pa dyshim, All-lahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen."*<sup>333</sup>

Islami pohon se vetë njeriu është ai që e pastron veten e tij dhe që i shlyen gjynahet. Është ai që vetë e

<sup>331</sup> Muslimi dhe Nesaiu, marrë nga *Et-Tergib ve'l-Terib* vëll. IV, faq. 88

<sup>332</sup> Ibn Maxhe dhe Tirmidhiu, hadithi është *hasen*, vëll. IV, faq. 93

<sup>333</sup> El-Bekare, 222

ndërton të ardhmen e tij tek All-llahu, andaj është e pamundur që të tjerët të kenë në dorë diç nga këto gjëra. Andaj njeriu të mos e fajësojë asnjërin për këtë. Është e papranuar thënia se filani është mbytur për pastrimin e shpirtit ose është vetëflijuar për hir të gjynahqarëve!

Rrobat e tua të ndotura nuk mund t'i pastrojë dikush tjetër! Në qoftë se të gjithë njerëzit i pastrojnë rrobat e tyre, kjo nuk do të thotë se edhe rrobat e tua do të pastrohen. Gjendja jote do të mbetet e pandryshuar, derisa të mos i pastrosh vetë rrobat e tua. Transmeton Ebu Hurejre se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: *"Sikur të gaboni, derisa – gabimet dhe gjynahet e juaja – të arrijnë qiellin, e pastaj pendoheni, ta dini se All-llahu do t'ua pranojë pendimin (do t'u falë)."*<sup>334</sup>

#### *All-llahu ia heq çdo përfitim kamatës*

Në botë ka njerëz që nuk dinë të thonë tjetër, veçse "më jep"! Ata rendin pas dynjasë vetëm për të marrë, e jo për të dhënë, e nëse e marrin, atëherë në shpirtin e tyre ndizen dëshirat për t'i shtuar ato. Njeriu i tillë ha dhe nuk ngopet, pasuria e tij e bën të pandjeshëm ndaj nevojave të të tjerëve, ai nuk çan kokë për atë se pasurinë dhe pozitën e tij e përfiton mbi shpinën dhe djersën e të tjerëve! Ai nuk jep sada-ka, sepse duhet për të dhënë, nuk ruhet nga lakmia e vetvetes, ndërsa në tregti dhe në paratë që i teprojnë, ai kërkon përfitim të menjëhershëm ose të mëvon-

<sup>334</sup> Ibn Mashe, marrë nga *Et-Targîb ve't-Terhîb* vëll. IV, faq. 90

shëm! Kamata në logjikën e tij është metodë natyrore për të cilën nuk duhet të pyesim!

Ai nuk çan kokë për dhembjet e njerëzve, sepse ato nuk kanë vend në shpirtin dhe logjikën e tij. Ai është i preokupuar vetëm me ambiciet e tij personale. Pikërisht për këtë grup të njerëzve bisha, All-llahu i Madhërishtëm thotë: *"All-llahu ia heq përfitimin kamatës, kurse e rrit përfitimin e bamirësisë (sadaqasë). All-llahu nuk i do ata që janë mohues – gjynahqarë."*<sup>335</sup>

Shprehja ".....që janë mohues" e përshkruan njeriun i cili qëmoti e ka harruar All-llahun dhe i ka kaluar kufijtë e tij, saqë në shpirtin e tij mohimi është bërë errësi që rri njëra mbi tjetrën.

#### *Civilizimi modern është me vlera të dobëta morale*

Civilizimi modern na bën me dije se bota e parë dhe e dytë janë huadhënësit e popullit të varfër e të mjerë të botës së tretë. Ata i thonë: T'i jap një mijë, prej tyre treqind janë çmimi i mallit që është prodhim i yni për të cilën ti ke nevojë në përpilimin e projekteve për zhvillim, ndërsa treqind të tjera janë pagë e inxhinierëve dhe punëtorëve të cilët do t'i mbikëqyrin mjetet e punës dhe do t'i menaxhojnë projektet! Pjesa tjetër do të mbetet për harxhime që do të dalin papritmas. Ty të mbetet që në fund të vitit të paguash 15% kamatë të sasisë së tërë. Dhe, pas shtatë vjetëve, del se huamarrësi i mjerë ka paguar më shumë seç ka marrë, ndërsa borxhi i mbetet i pandryshuar fare. Huadhënësi

<sup>335</sup> El-Bekare, 276

është i kënaqur, meqë e ka shitur mallin dhe i ka punësuar fëmijët e tij! Këtij nuk i mbetet tjetër, veçse të presë nga huamarrësi t'ia paguajë shumën e parave të huazuara.

Civilizimi modern është i ashpër dhe me vlera të dobëta morale, andaj mjerë për ata që i mbështeten atij dhe nuk ia ka frikën kompleteve të tij.

Është e qartë se pas këtyre kompleteve qëndrojnë idetë hebraike. Për fat të keq, politikanët arabë kanë humbur çdo imunitet fetar për ta kundërshtuar politikën e kamatës. S'ka dyshim se shtetet e botës së tretë janë duke u dridhur nën presionin e borxheve që i kanë rraskapitur. Ne nuk duam t'ia marrim apo mohojmë të drejtën dikujt tjetër, por duhet të themi se islami e ka ndaluar rreptësishtë ngrënien e pasurive të njerëzve me të padrejtë; ai i paralajmëron huadhënësit që të mos luajnë me amanetet e njerëzve, sepse ajo që sot është duke ndodhur është rezultat i lakmisë së të pasurve dhe i të padrejtës së të fuqishmëve.

*Islami është mëshirë për borxhliun që është ngushtë*

Islami përmban shumë mësimë të cilat i përgëzojnë me mëshirë dhe i joshin të pasurit që t'ia falin borxhliut që është ngushtë.

Transmeton Burejde nga babai i tij, i cili thotë se e ka dëgjuar të Dërguarin s.a.v.s. duke thënë: "Kush e pret borxhliun që është ngushtë, për të çdo ditë do të ketë sadaka aq sa i ka dhënë. Pastaj e dëgjova të thotë: "Kush e pret borxhliun që është ngushtë, për të çdo ditë do të ketë sadaka dyfish sa i ka dhënë. Unë i thashë: "O i Dërguari i

All-llahut! Të dëgjova që thoshe: "Kush e pret borxhliun që është ngushtë, për të çdo ditë do të ketë sadaka aq sa i ka dhënë. E pastaj të dëgjova që thoshe: "Kush e pret borxhliun që është ngushtë, për të çdo ditë do të ketë sadaka dyfish sa i ka dhënë?! Ai tha: "Për çdo ditë ka sadaka aq sa i ka dhënë, para se t'ia paguajë borxhin, e nëse ia paguan, por ky ia shtynë afatin (e pret), atëherë ka dyfish sadaka."<sup>336</sup>

Hudhejfe - All-llahu i Madhërishëm qoftë i kënaqur me të – thotë: "All-llahu e sjell një rob nga robërit e Tij, të cilit i ka dhënë pasuri dhe i thotë: "Çfarë ke bërë në dynja?<sup>337</sup> Ai thotë: "O Zot! Ti më dhe pasuri, e unë tregtoja me njerëzit. (O Zot) Kisha një veçori morale, atë që shumë herë i toleroja, ata që kishin mundësi ta paguanin borxhin, nuk i ngarkoja, ndërsa borxhliun që ishte ngushtë e prisja. Atëherë All-llahu i tha: "Unë meritoj më shumë se ti të jem tolerant, prandaj (o ju engjëj) tolerojeni robin Tim."<sup>338</sup> Ukbe ibn Amir dhe Ebu Mes'ud el-Ensari thonë: "Kështu e kemi dëgjuar nga goja e të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s."

Transmeton Es'ad ibn Zurare se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: "Kush dëshiron që All-llahu ta futë Ditën e Kiametit nën hijen e arshit të Tij, atë ditë kur nuk ka hije pos hijes së Tij, le t'ia lehtësojë borxhliut që është ngushtë (pagesën e borxhit) ose le t'ia falë".<sup>339</sup>

S'ka dyshim se kamata është haram (e ndaluar rreptësisht)! Haram është edhe lakmia, egoizmi i pangopur, adhurimi i dynjasë dhe vetadhurimi. Prandaj

<sup>336</sup> Et-Tergîb ve't-Terkîb vëll. II, faq. 44

<sup>337</sup> All-llahut nuk mund t'i fshihin asnjë fjalë.

<sup>338</sup> Transmeton Muslimi.

<sup>339</sup> Taberaniu në El-Kebir.

ne me plot gëzim e kemi mirëpritur themelimin e bankave islame, të cilat do të na shpëtojnë nga kamatat dhe format e saj të fëlliqura.

*Me të vërtetë All-llahu i do ata që janë të devotshëm*

Islami është pastrim i shpirtit dhe moral i bukur, është mendjemprehtësi, buzëqeshje dhe dinjitet. Ai, sikur që e ndalon kumatën, e ndalon edhe zemërashpërsinë, mendjehhtësinë, paedukatën dhe vetëpëlqimin e disa njerëzve, të cilët sillen vetëm përreth vetes dhe nuk njohin gjë tjetër e as që i ndiejnë nevojat e të tjerëve.

All-llahu i Madhërishëm thotë: *".....kushdo që plotëson premtimin e tij dhe ruhet nga të këqijat, (ta dijë se) All-llahu, me të vërtetë, i do ata që janë të devotshëm."*<sup>340</sup>

E vërteta e devotshmërisë qëndron në kujtimin e përhershëm të madhësisë së All-llahut, i Cili e mbikëqyrë çdokënd se çfarë punon dhe se ky kujtim i përhershëm kërkon shpejtimin drejt punëve të mira dhe largimin nga punët e këqija. Devotshmëria e përmendur krijon mbrojtje të fuqishme kundër bërjes së gjynaheve apo shpërfilljes së detyrave.

Ndodhë që frika të jetë ajo që e krijon këtë mbrojtje, po pse të mos jetë, kur All-llahu është Ai që meriton më shumë t'ia kenë frikën njerëzit. Megjithatë ndodhë që edhe turpi të jetë ai që e krijon këtë mbrojtje, po pse të mos jetë kur All-llahu është Ai nga i Cili duhet të turpërohem.

<sup>340</sup> Ali-Imran, 76

Devotshmëria nuk është gjendje shpirtërore, e cila p.sh, nxit për namaz dhe agjërime, ose që pengon nga kamata dhe mashtrimi. Ajo është shkallë e lartë e vetëpërbajtjes, që i përcakton qëndrimet e njeriut që qëndrojnë pas traditave, ibadeteve, marrëdhënieve ndër-njerëzore dhe situatave të ndryshme të njeriut në jetë.

Ajeti i sipërpërmendur e nënkupton qëndrimin e hebrenjve ndaj të tjerëve, të cilët besojnë se janë popull i zgjedhur i Zotit ose se janë bijtë e All-llahut dhe të dashurit e Tij. Ata mendojnë se prejardhja e tyre e veçantë ua jep të drejtën e eksploatimit të të tjerëve, cenimit të të drejtave të tyre, bile ata besojnë se popujt e tjerë janë krijuar për t'u shërbyer atyre, se vetëm ata meritojnë t'i kenë paratë e tyre në duar: *"Kjo është kështu, ngase ata thonë: "Ne nuk kemi ndonjë detyrim ndaj analfabeteve (arabë)". Ata flasin gënjeshtër për All-llahun me vetëdije."*<sup>341</sup>

Hebrenjtë i quajnë analfabetë të gjithë popujt e tjerë, pra jo vetëm arabët. Hebrenjtë edhe sot e kësaj dite vazhdojnë t'i shikojnë të tjerët me kryelartësi duke besuar se vetëm drejtimi i tyre është i vyeshëm dhe i saktë! Islami na mëson se më i nderuari tek All-llahu është ai që i frikësohet më shumë Atij, se gjaku, prejardhja, pasuria dhe të mirat e tjera të kësaj bote nuk kanë vlerë: *"Ti (o Muhamed) mos u mashtro nga breddhja e jobesimtarëve nëpër botë! Kjo mirëqenie është e shkurtër; pastaj, strehimi i tyre është xhehenemi. Eh, sa shtrat i keq është ai vend! Por, ata që i frikësohen Zotit të tyre do të kenë kopshte nëpër të cilat do të rrjedhin lumenj*

<sup>341</sup> Ali-Imran, 75

*dhe ku do të banojnë përjetësisht, si dhuratë prej All-llahut. Dhe ajo që është tek All-llahu, është dhurata më e mirë për besimtarët e vërtetë.*"<sup>342</sup>

Muslimanët urdhërohen t'i frikësohen Zotit të tyre në çdo gjë, qoftë e vogël ose e madhe. Transmeton Ebu Sa'sa'a ibn Jezid se një njeri e kishte pyetur Ibn Abasin dhe i kishte thënë: "Kur jemi në luftë, ndodhë të marrim nga pasuritë e dhimijve"<sup>343</sup> pula dhe dele! Ibn Abasi tha: "E, çfarë thoni (kur bëni kështu)? Njeriu tha: "Them se nuk ka gjë për të cilën duhet të brengosemi (se na është e lejuar). Atëherë Ibn Abasi tha: "Kështu kanë thënë ithtarët e Librit: "Ne nuk kemi ndonjë detyrim ndaj analfabetëve! Nëse ata e japin xhizjen, atëherë nuk ju lejohet pasuria e tyre, përveç nëse ata ua japin me dëshirë."<sup>344</sup>

Seid ibn Xhubejri thotë: "Kur ithtarët e Librit thanë: "Ne nuk kemi ndonjë detyrim ndaj analfabetëve", i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. tha: "Kanë gënjyer armiqët e All-llahut! Të gjitha gjërat e periudhës së xhahilijetit i kam futur nën këto dy këmbë të mia, përveç amanetit, ai duhet të përmbushet, qoftë për njeriun e mirë ose për të keqin (gjynahqarin)."<sup>345</sup>

Është e vërtetë se vlerat (e mira) nuk ndahen. Njeriu nuk mund të jetë besnik me njërin, ndërsa tradhtar me tjetrin! Njeriu dinjitoz është i shquar me sjellje të larta në të gjitha gjërat.

<sup>342</sup> Ali-Imran, 196-198

<sup>343</sup> Dhimij quhen njerëzit që jetojnë nën juridiksionin e shtetit islam dhe janë të garantuar në çdo aspekt: në aspekt të pasurisë, gjakut, nderit, jetës dhe fesë.

<sup>344</sup> *Shih Xhamiu-l-Bejan fi Tefsiri el-Kur'an* Imam Taberiu, vëll. III, faq. 227

<sup>345</sup> *Shih Xhamiu-l-Bejan fi Tefsiri el-Kur'an* Imam Taberiu, vëll. III, faq. 227



Devotshmëria nuk është shpallje e luftës kundër trupit e as përmbysje e ashpër e ndjenjave! Ajo është rrugë e drejtë e jetës, të cilën e shoqëron kënaqësia e All-llahut dhe ajo rregullohet me vendosjen e normave të sheriatit.

Ndodhë të jesh në armiqësi, por megjithatë duhet të jesh i drejtë: *"Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë..."*<sup>346</sup>

Ndoshta ke urrejtje, por mos e harro bamirësinë dhe gjërat e bukura: *"Grave të ndara u takon sigurimi i caktuar i shpenzimeve të jetesës. Kjo është detyrë e besimtarëve."*<sup>347</sup>

Disa herë sinqeriteti të brengos! Por, mos u mërzit dhe kurrë mos heq dorë nga ai: *"Frikësojuni All-llahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe vepra)."*<sup>348</sup>

Me rëndësi është që veprat dhe fjalët e tua të jenë gjithmonë të lidhura me Zotin tënd dhe ti t'i përmbahesh udhëzimit të Tij. Besimtari punëtor e fillon ditën me këtë bindje. Është bukuri e rrallë e të Dërguarit të mëshirës, i cili e mëson besimtarin mysliman për vlerat e larta, që nëse nuk arrin t'i plotësojë dhe ta realizojë qëllim të tij, së paku mund t'u afrohet atyre! Ai na mëson se në jetë duhet të ndihmohemi që me mëngjesin e parë dhe që në fillimin e natës, si dhe në një pjesë të natës. Ai thotë: *"Vërtet feja është lehtësi, kushdo që e vështirëson fenë (me shtesa) ajo e ngadhënjën atë (duke e kthyer në gjendje normale, andaj drejtohuni (kërkoni të saktën), afrohuni (njëri me tjetrin, ose nëse nuk mund ta*

<sup>346</sup> El-Maide, 8

<sup>347</sup> El-Bekare, 241

<sup>348</sup> Et-Tevbe, 119

*arrini përsosmërinë, atëherë afrojuni asaj), dhe përgëzoni, shfrytëzoni dhe ndihmohuni me ecje të mëngjesit (punën e mëngjesit), të nibrëmjes dhe të pasdarkes (shfrytëzoni një pjesë të natës për punë)."<sup>349</sup>*

Puna e cila e shfaq devotshmërinë tënde ndaj Zotit tënd fillon nga çasti i daljes nga shtëpia jote, e deri në shkollë nëse je mësues, ose në kompaninë tënde, në zyrën tënde, në dyqanin ose në arën tënde etj. S'ka dyshim se çdo fushëveprim i jetës e shfaq devotshmërinë tënde ndaj All-llahut.

Puna e njeriut ka nevojë për një program të lehtë e të saktë, pa ndonjë ngarkesë të thellë. Besimtari musliman e di se qëllimi i punës së tij është kënaqësia e Zotit, shërbimi i fesë dhe ngritja e Umetit islam. Në hadith thuhet se: "*Ai (i Dërguari) më së shumti e donte fenë (adhurimin) e atij personi i cili ishte i vazhdueshëm në të.*"<sup>350</sup>

Transmeton Enesi dhe thotë: "*I Dërguari i All-llahut s.a.o.s. më tha: "O biri im! Nëse mund të zgjohesh nga gjumi dhe të biesh në gjumë, e në zemrën tënde të mos ketë asnjë tradhti për asnjërin, bëje! Pastaj tha: "O biri im! Kjo është nga suneti im, e ai i cili e do sunetin tim, më do edhe mua, kurse ai që më do mua, do të jetë me mua në xhenet."*"<sup>351</sup>

Ndoshta disa mendojnë se këto porosi janë të lehta! Por, unë kam parë se lufta e bukës ka lënë pas plagë të pashëruara në shpirt, bile më të thella dhe më të ashpra se lufta e pozitës!!

<sup>349</sup> *Fet'hu-l-Beri*, vëll. I, faq. 93, numër: 39/ Besimi – Feja është lehtësim

<sup>350</sup> *Fet'hu-l-Bari*, vëll. I, faq. 101, numër: 43/ Besimi – Feja më e dashur tek All-llahu është ajo e cila vazhdon.

<sup>351</sup> Tirmidhiu, vëll.V, faq. 2678/ Dituria

S'ka dyshim se mashtrimi, tradhtia dhe errësira e zemrës janë ato që e kanë shkatërruar shoqërinë tonë dhe e kanë përmbysur politikën tonë. Sikur të ishim të preokupuar me devotshmëri, me siguri se do të ishim më punëmirë dhe më fjalëmirë. Ashpërsia e zemrës është pjesë e mallkimit të cilin All-llahu e zbriti për ithtarët e Librit, ngase e thyen premtimin dhe i ndoqën epshet.

Kontempluesi i historisë së Umetit tonë vëren se viruset e të parëve janë ato që na kanë goditur neve sot. Pikërisht ashtu sikur na frikësoi dhe paralajmëroi i Dërguari fisnik: *"Do t'i ndiqni hapat e atyre që ishin para jush, pëllëmbë pas pëllëmbë.....do t'i ndiqni edhe nëse hynë në orimën e hardhucës. Sahabët thanë: "Hebrenjtë dhe të krishterët? Ai tha: "Po cilin pra?"<sup>352</sup>*

Në një transmetim tjetër thuhet: *"O i Dërguari i All-llahut, sikur persianët dhe romakët? Ai tha: "Po kush tjetër pos atyre?"<sup>353</sup>*

*All-llahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburravecë*

All-llahu i Madhërishëm thotë: *"Në të vërtetë, All-llahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburravecë."<sup>354</sup>*

Arroganca nënkupton ndjenjën fëmijërore të mbështjellë me forcë (mendjemadhësi), ndërsa mburrësia nënkupton njeriun që flet për veten – ose për popullin e tij – me admirim dhe krenari. Që të dyja

<sup>352</sup> Muslimi, vëll. IV, faq. 2054, numër: 2669

<sup>353</sup> Fet'hu-l-Bari, vëll. XIII, faq. 300, numër: 7319

<sup>354</sup> En-Nisa', 36

këto veçori janë produkt i injorancës, paditurisë së mjaftueshme, shpërfilljes së të drejtave të të tjerëve ose mburrje me gjërat që janë prezentë, edhe në qoftë se janë të parëndësishme dhe zhvleftësim i gjërave që nuk janë prezentë, edhe në qoftë se janë të rëndësishme!

Njeriu që di pak, i duket se është më i dituri dhe më i mençuri! Për fat të keq, për të themi se ai nuk e di se sa gjëra të rëndësishme nuk i di apo sa gjëra të mëdha i kanë kaluar.

Postet kryesore në mjediset e prapambetura bëhen liri e qetë e mendjemadhësisë dhe arrogancës. Të sëmurët me çmendurinë e mendjemadhësisë fryhen sa s'flitet me ta dhe nuk çajnë kokë nëse i dëmtojnë të tjerët! Mjediset që gëzojnë shëndet psikik, nuk e lejojnë këtë shtrembërim, sepse pasojat e vetëmashtrimit janë të dëmshme.

Islami lufton ashpër kundër arrogancës dhe mendjemadhësisë. I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. thotë: *"Në të vërtetë All-llahu më ka shpallur që të bëheni modest, me qëllim që të mos mburret njëri ndaj tjetrit, e as që ndonjëri t'i bëjë padrejtësi dikujt tjetër."*<sup>355</sup>

Njohuritë e mëdha, aftësitë e shtrenjta dhe karakteri i lartë duhet të mbështillen me petkun e nënshtrimit të All-llahut dhe ndjenjën e dhuntisë së Tij të lartë. All-llahu është Dhuruesi i çdo të mire e të bukure. Vetëm Ai është Përkujdesësi i të mirave dhe mirënjohjeve. Transmeton Seid el-Hudëriu se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: *"Ai që për një shkallë tregohet modest për hir të All-llahut, All-llahu do ta ngritë për një*

<sup>355</sup> Muslimi, vëll. IV, faq. 2198/ Xheneti – Veçoritë me të cilat njihen banorët e xhenetit në dynja.

*shkallë, derisa ta vendosë në maje të atyre që janë të lartë. Ndërkaq ai që për një shkallë tregohet mendjemadh ndaj All-llahut, All-llahu do ta ulë një dërxhe, derisa ta vendosë në gjendjen më të ulët.*"

Në një transmetim tjetër është thënë edhe kjo: *"Sikur dikush të ketë punuar në brendi të shkëmbit të mbyllur, që nuk ka derë e as vrimë, me siguri se puna e tij që e ka fshchur prej njerëzve ka për të dalë, çfarëdo që të jetë."*<sup>356</sup>

Duket se në brendi të punëve të mira – sado që të mbulohen – ekziston natyra e aromës së freskët, e cila, sado që të fshihet, vetvetiu paraqitet dhe del jashtë. Nëse për virtytet e lavdishme nuk flet i zoti i tyre, atëherë medoemos për to të flet koha, e sotmja ose e nesërmja. Modestia do ta përcaktojë nivelin e tij të lartë.

Habitemi nga njeriu i cili është i varfër, e megjithatë tregohet mendjemadh! I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: *"Ruajuni mendjemadhësisë, sepse mendjemadhësia është në njeriun edhe në gunën që e mban (në trup)"*.<sup>357</sup> Pra, ai mban cergë mbi supe.

Transmeton Ebu Hurejre se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: *"Më janë prezantuar tre të parët që do të hynë në xhechenem: udhëheqësi tiran, i pasuri që nuk e jep hakun e All-llahut të caktuar për pasurinë e tij që e ka dhe i varfëri mburraoec."*<sup>358</sup>

<sup>356</sup> Transmeton Ibn Maxhe dhe Ibn Hibani në *Sahihun* e tij, pjesa e dytë e hadithit nuk është e transmetuar nga Ibn Maxhe: "Sikur dikush...", marrë nga *Et-Terhüb ve'l-Tergüb* vëll. III, faq. 560

<sup>357</sup> Taberaniu në *El-Eusat*, transmetuesit e tij janë të besueshëm (thikatun), marrë nga *Et-Terhüb ve'l-Tergüb* vëll. III, faq. 565

<sup>358</sup> Muslimi dhe Tirmidhiu, marrë nga *Et-Terhüb ve'l-Tergüb* vëll. III, faq. 567

S'ka dyshim se i varfëri mburravec nxit habinë, ngase njeriu mund të shkel çdo cak me pasuri, por të shkel çdo cak me varfëri, kjo nuk bëhet!

Njeriu tregohet mendjemadh me veshjet e shtrenjta. Por, le ta dijë se ndodhë që toka ta përmbysë (ta gëlltitë në brendi), siç përmendet në hadithin e të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s.! Të tregohet njeriu mendjemadh me zhveshje, kjo na habit!

Abas el-Akkadi thotë: "Mendjemadhësia është armiqësi ose reflektim i armiqësisë."

Kjo është thënie e vërtetë. Disa mendjemëdhenj i kalojnë kufijtë dhe shkaktajnë trazira! Këtu kemi të bëjmë edhe me disa të tjerë që ndiejnë se nuk vlerësohen sa duhet, ndaj edhe reflektojnë mendjemadhësi, që atyre u ndihmon për t'i mbuluar të metat dhe për ta mbuluar të vërtetën. S'do mend se i pari është më i keq se i dyti, megjithëse i dyti – për ta mbrojtur qenien e tij – ndodhë që ta teprojë dhe ky teprim t'i bëhet i këndshëm dhe pastaj të futet në telashe të mëdha dhe sjellje arrogante.

Përkufizimi më i mirë i mendjemadhësisë është thënia e të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s.: "*Mendjemadhësia është refuzim i pranimin të së vërtetës dhe nënçmim i njerëzve të tjerë.*"<sup>309</sup>

Refuzimi i pranimin të së vërtetës për inat dhe kokëllartësi është veçoria më e ulët, është padrejtësi që i bëhet të vërtetës, ndonëse çdoherë duhet të jemi korrekt ndaj saj. Inatçiu nuk pranon t'i nënshtrohet të vërtetës, andaj vazhdimisht i preferon kënaqësinë e

<sup>309</sup> Muslimi dhe Taberaniu, marrë nga *Et-Terğib ve'l-Terhib* vëll. III, faq. 565

epshit të tij. S'ka dyshim se në këtë rast mendjemadhësia bëhet rrugë e cila e çon drejt kufrit, nëse nuk është pikërisht ky kufër. Me siguri se këtë e nënkuptojnë fjalët e të Dërguarit s.a.v.s.: *"Nuk do të hyjë në xhenet kush ka në zemrën e tij sa një grimë mendjemadhësi."*<sup>360</sup>

All-llahu i Madhërishëm thotë: *"Në Ditën e Kiametit do t'i shihni me fytyra të nxira ata që kanë tri-luar gënjeshtër për All-llahun. Vallë, a nuk është xehenemi vend për ata që janë mendjemëdhenj?"*<sup>361</sup>

Ndoshta jemi mësuar që padrejtësi ta quajmë shpërfilljen e të drejtave të caktuara materiale dhe shpirtërore, por All-llahu na mëson se shpërfillja e të vërtetave është më e dëmshme dhe më e ashpër.

Padrejtësia më e madhe është shpërfillja e të vërtetës absolute, teuhidit (njëshmërisë së All-llahut). Këtë e nënkupton porosia e Lukmanit: *"O djali im, mos i shoqëro All-llahut asgjë (në adhurim)! Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe."*<sup>362</sup>

Dhe fjalët e All-llahut të Madhërishëm: *"Sa për ata që besojnë dhe nuk e molepsin besimin e tyre me padrejtësi (idhujtari), pikërisht atyre u takon siguria dhe ata janë të udhëzuar."*<sup>363</sup>

Mendjemadhësia është e refuzuar dhe nuk vlen në asnjë vend, qoftë kur bëhet fjalë për të vërtetat ose për të drejtat! I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. thotë: *"Kush ka në zemrën e tij sa kokrra e sinapit mendjemadhësi, (le ta dijë) All-llahu do ta përmbysë me fytyrë në xhchenem."*<sup>364</sup>

<sup>360</sup> Muslimi dhe Taberaniu, marrë nga *Et-Tergib ve'l-Terhib* vëll. III, faq. 565

<sup>361</sup> *Ez-Zumer*, 60

<sup>362</sup> *Lukman*, 13

<sup>363</sup> *El-En'am*, 82

<sup>364</sup> Tirmidhiu, hadithi është *kasesen*, marrë nga *Et-Tergib ve'l-Terhib* vëll. III, faq. 571

Pse njeriu e mban veten në të madh dhe nuk çan kokë për asgjë, ndërsa e di se po të mos ishte vlerësi i All-llahut, ai do të mbetej i pavlerë, ndërsa sikur të mos ishte mbulimi i Tij, ai do të ishte i shpalosur?! Vallë, a nuk e dinë njerëzit se të mirat që i gëzojnë, mençuri qoftë ose pasuri, janë prej All-llahut? A nuk pyesin për to?

*"Hiri është në Dorë të All-llahut, Ai ia jep atë kujt të dojë."*<sup>265</sup>

Sikur Dhuruesi ta ndërpresë furnizimin e Tij, me siguri se gjeniu do të transferohej në spitalin e të sëmurëve psikik, ndërsa i pasuri do ta shtrinte dorën dhe do të bëhej lypës: *"Kush janë ata, që do t'ju japin mjete jetese, në qoftë se Ai jua ndalon ato?"*<sup>266</sup>

Madhështia i takon Atij që e ushqen botën, ndërsa Vetë nuk ushqehet, i Cili mbron, por prej Tij nuk mund të mbrohet askush, Atij që gjykon, por që askush nuk mund ta thyejë gjykimin e Tij, Atij që gjithmonë është Ngadhënjimtarë dhe tek i Cili çdo gjë kthehet, Atij që i përkulen (i bie në sexhde) të gjithë banorët e qiejve dhe të Tokës dhe ato që janë midis tyre. Andaj si është e mundur që njeriu të marrë guxim e ta kundërshtojë Atë. Ky njeri që është i pambrojtur dhe të cilin një mikrob i vogël ia merr jetën për një çast!? Si është e mundur që njeriu të bëhet kryelartë ndaj krijesave të All-llahut?

Ka njerëz që dëshirojnë të tjerët të përkulen para tyre, që goja e tyre t'i zë vetëm emrat e tyre dhe që pas hapave të tyre ta dëgjojnë trokëllimën e hapave të

<sup>265</sup> Ali-Imran, 72

<sup>266</sup> El-Mulk, 21



atyre që u shkojnë mbrapa! Pikërisht për këta dhe të tillët Ibn Abasi dhe të tjerët thonë se i Dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: *"All-llahu i Lartëmadhëruar thotë: "Madhështia është petku Im, kurse Laodia është izari Im. Atë që mundohet ta kontestojë njëri prej tyre, do ta hedh në xhehenem."*<sup>367</sup>

I Dërguari i Allahut s.a.v.s. thotë: *"Njeriu vazhdon duke ecur me kryelartësi derisa të shkruhet me tiranët, e pastaj ta godet ajo çka i ka goditur edhe ata."*<sup>368</sup>

*All-llahu nuk do që të thuhet hapur fjalët e këqija, përveçse nga të dëmtuarit*

Nuk ka më të dëmshme, më të paudhë dhe më vrasëse për devotshmërinë se gjuha e ligë e cila i thotë hapur fjalët e këqija!

Fjalët e pamatura dhe vendimet e paudha kanë shkaktuar shumë brenga në jetën morale dhe shoqërore të njerëzve. Këto brenga i kanë shkaktuar edhe sjelljet e njerëzve që janë bazuar në paragjykime dhe thashetheme! Në jetë kam parë se si njëri flet për ta lavdëruar veten, ndërsa tjetri për ta qortuar ndonjërin, njëri që dëshiron shpalosjen e gjërave të fshehura ose gabimeve të dukshme, njërin që dëshiron zhvlefësimin e një njeriut të madh ose nënçmimin e ndonjë fisniku, një tjetër që i qesëndis të tjerët me nofka të këqija, njërin që dëshiron të nxisë qeshjen dhe talljen, e

<sup>367</sup> Transmeton Ibn Maxhe në *sahihun* o tij, marrë nga *Ei-Tergib ve't-Terhib* vëll. III, faq. 563

<sup>368</sup> Tirmidhiu, që thotë se hadithi është *hasen*, marrë nga *Ei-Tergib ve't-Terhib* vëll. III, faq. 571

një tjetër që me fjalët e kota e të padobishme e dëshiron humbjen e kohës!

Fjalët e këqija e asgjësojnë burrërinë, e vdesin sinqeritetin dhe e ndërprejnë atë që e ka urdhëruar All-llahu për ta mbajtur lidhur (lidhjet farefisnore). All-llahu nuk lejon të thuhet hapur fjalët e këqija, përveçse në një rast: që i dëmtuari të flet për të keqen që ia ka bërë dëmtuesi, me qëllim që të shpëtojë dhe të kërkojë drejtësi. All-llahu i Madhërishëm thotë: *“All-llahu nuk do që të thuhet hapur fjalët e këqija, përveçse nga të dëmtuarit. All-llahu dëgjon dhe di gjithçka. Në qoftë se ju bëni ndonjë vepër të mirë hapazi ose fshehurazi ose falni ndonjë vepër të keqe, All-llahu është Falës i madh dhe i Plotfuqishëm.”*<sup>269</sup>

Dijetari i nderuar El-Kattan, thotë: *“All-llahu i Madhërishëm e mbron famën e njerëzve, përderisa ata nuk i dëmtojnë të tjerët. E nëse i dëmtojnë, atëherë nuk e meritojnë këtë mbrojtje. Pikërisht atëherë të dëmtuarit i lejohet t’i thotë hapur fjalët e këqija për atë që e ka dëmtuar. Përmes kësaj islami e realizon përputhshmërinë mes drejtësisë dhe moralit. Megjithatë islami i fton njerëzit që të bëjnë mirë dhe t’i falin veprat e këqija.”*<sup>270</sup>

Fjalët janë pasqyrë reale e asaj që është në shpirt, qoftë e mirë ose e keqe, si dhe pasqyrë e asaj që është në mendje, qoftë e thellë ose e cekët. Mirëpo, ndodh që gjuha të thotë gjëra të pamenduara mirë, andaj fjalët e pakontrolluara bëhen pa ndikim.

Çrregullimi i gjuhës (fjalët e pamenduara) shumë herë di të krijojë gabime të rrezikshme. Transmeton

<sup>269</sup> En-Nisa’, 148-149

<sup>270</sup> *Shih Tefsiri et-Tefsir* Shej Ibrahim el-Kattan, vëll. I

Sufjan ibn Abdul-llah eth-Thekafiu dhe thotë: "Thashë: "O i Dërguari i All-llahut! Më thuaj për Islamin atë çka nuk do kem nevojë ta pyes askënd përveç teje." Tha: "Thuaj, Zoti im është All-llahu, e pastaj vazhdo me ngulm (në këtë)." Pastaj i thashë: "O i Dërguari i All-llahut! Më trego se çfarë është ajo që më shumë ke frikë për mua?" Ai e morri gjuhën e vet dhe tha: "Kjo."<sup>371</sup>

Transmeton Mugire ibn Shu'be dhe thotë se e ka dëgjuar të Dërguarin e All-llahut duke thënë: "All-llahu i ka bërë tri gjëra të padëshiruara për ju: thashethemet, harxhimin e tepruar të pasurisë dhe pyetjet e shumta"<sup>372</sup>

Abdul-llah ibn Mes'udi thotë se e ka dëgjuar të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s. duke thënë: "Gabimet më të shumta të birit të Ademit janë në gjuhën e tij."<sup>373</sup>

Ka disa njerëz që mbahen për fetarë prej të cilëve të tjerët ikin, ngase janë mendjemëdhenj dhe të vetëpëlqyer. Ata i shohin të tjerët me shpërfillje, veçmas kur janë të devijuar ose bukëshkalë. Ata flasin për të tjerët çka u vjen në gojë e pastaj kështu shpresojnë të afrohen më shumë te All-llahu!

Këta u gëzohen fatkeqësive të tjerëve dhe e përvehtësojnë çdo akuzë që vjen në adresë të tyre, veçmas për plagët që i godasin në jetë!!

S'ka dyshim se ky lloj i të qenit fetar është bela e madhe që do të jetë kundër të zotit të tij dhe kundër

<sup>371</sup> Ahmedî, vëll. III, faq. 413, Tirmidhiu, Ibn Maxhe, Ibn Hibani dhe Hakimi, marrë nga *Et-Tergîb ve't-Terhîb* vëll. III, faq. 537

<sup>372</sup> Buhariu, Muslimi dhe Ebu Davudi, marrë nga *Et-Tergîb ve't-Terhîb* vëll. III, faq. 540

<sup>373</sup> Taberianiu, shumica e transmetuesve të këtij hadithi janë të saktë; marrë nga *Et-Tergîb ve't-Terhîb* vëll. III, faq. 534

njerëzve! Njerëzit zemërashpër nuk kanë fare peshë, sa do që të jenë të ditur!

Transmeton Imam Maliku në Muvetta-në e tij një hadith të cilin duhet ta shqyrtojmë gjerë e gjatë dhe me vëmendje të plotë. Ai thotë: “Më kanë treguar se Isai alejhi-selam, i biri i Merjemes, thoshte: “Mos flisni shumë pa e përmendur All-llahun, e t’ju ashpërsohen zemrat; se zemra e ashpër është shumë larg All-llahut, por ju nuk e dini!

Mos i shikoni gjynahet e njerëzve sikur ju të jeni zota, por shikoni gjynahet e juaja sikur të jeni robër! Dijeni se njerëzit janë dy llojesh: i sprovuar (me fatkeqësi, sëmundje, varfëri etj) dhe i shpëtuar (i shëndoshë), andaj mëshironi të sprovuarit dhe falënderojeni All-llahun për atë që ju ka shpëtuar.”<sup>374</sup>

Sot ka njerëz që mbahen për fetarë, por janë zemërashpër. Ata nuk i shërojnë të sëmurët, por i vrasin të shëndoshët, janë fjalëkeq dhe nuk bëjnë mirë.

Ne nuk po e mbrojmë kriminelin e as që mbështesim të devijuarin, por nuk duam ta ndihmojmë as djallin kundër njeriut ose t’i japim fund jetës së atij që njëherë ka shkarë dhe është i aftë për ta rifilluar rrugën nëse ne e marrim për dore dhe e ndihmojmë të ngrihet.

#### *All-llahu nuk i do tradhtarët gjynahqarë*

Gjynahet e gjymtyrëve të trupit janë shumë, por njeriu jeton me shpresë se All-llahu i Madhërishëm do t’ia falë ato! Mirëpo, çfarë ndodh kur gjynahqari shndërrohet në keqbërës inatçi dhe të këqijave të tij

<sup>374</sup> Muvetta’, marrë nga El-Targhīb ve’l-Terhīb vëll. III, faq. 538

ua bashkëngjit ngulmimin dhe mendjemadhësinë?! S'ka dyshim se në këtë rast e vërteta dhe interesi tregohen të ashpër me të dhe ia tregojnë kufijtë.

Këtë e nënkuptojnë fjalët e All-llahut të Madhërishtëm: *"Dhe mos i mbro ata që mashtrojnë vetveten! Se All-llahu nuk i do tradhtarët gjynahqarë!"*<sup>275</sup>

Sferat e tradhtisë dhe gjynahut janë të njohura për njerëzit. Ato fillojnë nga fjala, të cilën ai kërkon të mbetet e fshehtë, por të tjerët e përhapin për qëllime të këqija apo për përfitime të ndryshme! Sferat e tradhtisë dhe gjynahut përhapen dhe arrijnë në maje të shoqërisë, në rezidencën presidenciale të shtetit dhe në vendet ku merren vendimet e rëndësishme! Pastaj, ato përhapen dhe i përfshijnë të gjitha punët administrative, artistike dhe kulturore, gjëra që e lëvizin jetën...

Mësimet e sakta islame kanë për qëllim krijimin e një jete me përgjegjësi për të cilën njeriu llogaritet, janë këto përgjegjësi të cilat njeriun e çojnë përpara ose e ngecin mbrapa, varësisht nga qëndrimi i tij ndaj tyre.

Mexhliset (ndejat) janë amanet, biseda e shokut tënd e bërë me ty është amanet, andaj mos i përhapë fshehtësitë, se bëhesh tradhtar dhe gjynahqar! Le të mbeten këto fshehtësi për ty sikur janë të vendosura në thellësi të shkëmbit ku nuk i sheh askush!

Fjalët dinë të stërmadhohen. Ato çdoherë bëhen më të mëdha e më të mëdha, të ndryshuara ose të shtuara, të thëna ndryshe ose...! Amanetet – sipas mësimëve islame – e rregullojnë jetën e njeriut, besimtarin

<sup>275</sup> En-Nisa', 107

musliman e bëjnë që, qoftë në shtëpi a në rrugë, ndaj përgjegjësi të mëdha materiale dhe kulturore të veprorë me vetëdije të plotë dhe me kujdes të madh.

Ky edhe është thelbi i thënies së të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. që e transmeton Enes ibn Maliku: *"Nuk ka besim ai që nuk ka amanet (nuk e mban amanetin) dhe nuk ka fe ai që nuk e përmbushë premtimin."*<sup>376</sup>

Transmeton Ali ibn ebi Talibi se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. thotë: *"Siguria e muslimanëve ndaj të pafesëve është një, por e cila i përfshinë të gjithë. Kush ia kthen shpinën muslimanit, mbi të do të jetë mallkimi i All-llahut, i engjëjve dhe i të gjithë muslimanëve. Ditën e Kiametit All-llahu nga ai nuk do ta pranojë as punën e as drejtësinë (as të obliguarat as vullnetaret)."*<sup>377</sup>

Është e vërtetë se ne i duam postet e larta dhe nxitojmë t'i marrim ato, por a thua në vendin e punës sonë shkojmë ashtu siç shkojmë në xhami për t'u falur për hir të All-llahut? A s'na bie ndërmend se këto poste të larta janë amanet i rëndë dhe se shpërfillja e tyre është rrugë drejt fundit të xhehenemit!? A thua e dimë këtë? A e kemi kuptuar? Apo jemi nga ata që e duan postin e lartë vetëm për t'i ngopur kënaqësitë e epshit ose që t'i përgjigjemi çmendurisë së lavdisë?

Dashuria e postit i solli muslimanët në këtë gjendje të ulët. Lufta për post bëri që arabët sot të jenë në gjendjen më të ulët në mesin e popujve të botës. Gjatë shqyrtimit të thënies së të Dërguarit s.a.v.s., na bëhet e ditur se ai e njeh mirë natyrën e njeriut. Të shohim se çfarë thotë ky i Dërguar: *"Ju vërtet do të tregoni kuj-*

<sup>376</sup> Ahmedî, vëll. III, faq. 135

<sup>377</sup> Muslimi, vëll. II, faq. 994, numër: 1370/ Hashi - Vlora e Medines

*des të madh për udhëheqësi (postin e lartë), por ai do të jetë pendim në Ditën e Kiametit....*"<sup>378</sup>

Muslimani i mirë qëndron larg indikacioneve të lakmisë, dyshimit dhe kureshtjes. Ai e pranon postin vetëm atëherë kur të tjerët e kërkojnë për ta marrë atë dhe e kërkon hirin e All-llahut në të, duke e shpresuar ndihmën e Tij. Përndryshe, më mirë për të është të qëndrojë larg asaj!

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. thotë: *"Kush e kërkon (dëshiron) postin, e pastaj pyet për të ndihmës, do të lihet të mbështetet në vetvete, ndërsa kush detyrohet ta marrë atë, All-llahu do t'ia zbret një engjëll që do ta mbështesë (ndihmon)."*<sup>379</sup>

Janë të shumta shkaqet civilizuese, kulturore dhe shoqërore, që i bëjnë kurejshët të jenë udhëheqësit e Umetit islam. Këtë e di edhe vetë i Dërguari i All-llahut s.a.v.s., andaj dhe thotë: *"Kjo gjë (udhëheqja) do të jetë në mesin e kurejshëve; (do të jetë në mesin e tyre) derisa të tjerët kërkojnë mëshirë e këta t'i mëshirojnë, kur të gjykojnë, të jenë të drejtë, e kur të ndajnë, të jenë të paanshëm, e nëse nuk veprojnë kështu, mbi ta do të jetë mallkimi i All-llahut, i engjëjve dhe i të gjithë njerëzve, atyre nuk do t'u pranohet as puna as drejtësia (as e obliguara as vullnetarja)."*<sup>380</sup>

A e kuptuan kurejshët këtë? Apo, a e kuptuan arabët këtë? Ata në çastin kur filluan të luftojnë mes vete për postet e larta dhe për ardhjen në pushtet, pikërisht atëherë e goditën islamin në zemër!

<sup>378</sup> Ahmedî, vëll. II, faq. 352

<sup>379</sup> Ebu Davudi, vëll. III, faq. 300, numër: 3578

<sup>380</sup> Ahmedî, vëll. IV, faq. 396

Postet, të mëdha qofshin apo të vogla, janë amanet e jo përfitim, janë detyrë e jo lavdi, janë ibadet e jo sundim, janë provim i rëndë e jo kafshatë e ëmbël dhe e këndshme.

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. thotë: *"Kushdo që nga ju merr përsipër ndonjë nga çështjet e këtij Umeti, e pastaj nuk tregohet i drejtë në mesin e tyre, (ta dijë se) All-llahu do ta përmbysë në xhehenem."*<sup>281</sup>

Abdullah ibn Mes'udi thotë: *"Ryshfeti në vendime është kufër! Ai është fitim i paligjshëm në mesin e njerëzve."*

Në fakt strukturat politike dhe kulturore në vendet tona janë duke përjetuar parregullsi të tmerrshme, bile mund të them se parregullsitë që ndodhin në vendet tona janë më të tmerrshme se ato që ndodhin në vendet që nuk e njohin Islamit dhe që nuk i kanë dëgjuar porositë e tij!

Muslimanët do të arrijnë ta rikthejnë lavdinë e tyre të mëhershme dhe ta realizojnë misionin e tyre të shenjtë vetëm atëherë kur interesat dhe pasuritë e përgjithshme të bëhen më të shenjta se interesat dhe pasuritë personale. Të drejtat që i përfaqësojnë institucionet politike, shoqërore dhe ekonomike janë të sferave të gjera dhe përfshijnë mijëra e mijëra njerëz.

#### *Tradhti dhe mashtrim (pabesë)*

Format e tradhtisë në përgjithësi janë një e keqe e shëmtuar, por veçanërisht bëhen edhe më të këqija

<sup>281</sup> *Et-Targîb ve't-Tekwîl* vëll. III, faq. 173



dhe më të shëmtuara kur shoqërohen me mashtrimin (pabesën). Këtë e nënkuptojnë fjalët e All-llahut të Madhërishëm: *"Krijesat më të këqija tek All-llahu janë ata që mohojnë dhe që nuk do të besojnë: janë ata me të cilët ke bërë marrëveshje, por që çdo herë e shkelin atë dhe nuk i frikësohen All-llahut. Nëse ti i ndesh ata në luftë, shpartalloji, që të vënë mend ata që vijnë pas tyre. Nëse ke frikë se ndonjë fis e thyen besën, edhe ti prishja marrëveshjen me të njëjtën mënyrë, sepse All-llahu nuk i do ata që tradhtojnë."*<sup>382</sup>

Para se të futemi në shpjegimin e çështjes në fjalë, është e udhës që të japim një përshkrim të shoqërisë medinase menjëherë pas shpërnguljes së të Dërguarit s.a.v.s.!

Dijetari Ibrahim el-Kattan thotë: *"Pas ardhjes së Pejgamberit s.a.v.s. në Medinë, jobesimtarët u bënë tri grupe: grupin e parë e përbënin njerëzit me të cilët i Dërguari bëri marrëveshje paqësore dhe u pajtuan që të mos e luftojnë atë, të mos e kundërshtojnë dhe të mos u ndihmojnë kundërshtarëve të tij! Këta, megjithëse nuk besonin, ia siguruan jetën dhe pasuritë. Grupin e dytë e përbënin ata të cilët e luftuan dhe i shkaktuan armiqësi! Ndërsa grupin e tretë e përbënin njerëzit të cilët e lanë anash, as nuk bënë marrëveshje paqësore e as nuk e luftuan, por u bënë prej atyre që pritnin se si do të përfundonte puna e të Dërguarit me kundërshtarët e tij."*<sup>383</sup>

Në grupin e parë bënin pjesë hebrenjtë e Medines. Ata ishin fisi benu kurejdha, benu nadir dhe benu kajnaka'! Myslimanët e respektuan traktatin e ratifi-

<sup>382</sup> El-Enfal, 55-58

<sup>383</sup> *Tejâru et-Tefâir* Ibrahim el-Kattan, vëll. II

kuar me këto fise, por a thua hebrenjtë vepruan njësoj? Kurrresi! Zemrat e tyre vlonin nga pezmi kur dëgjonin se thirrja islame po shënonte sukses dhe përparim. Pikërisht për këtë ata nuk lanë asnjë rast të volitshëm për tradhti që nuk e shfrytëzuan për kurthe!

Ngadhënjimi i myslimanëve në Bedër ndaj idhujtarisë do ta shënojë hovin e madh të suksesit të thirrjes islame në Gadishullin Arab dhe më gjerë. Kësaj radhe hebrenjtë do të jenë edhe më të pezmatuar. Pikërisht Ka'b ibn Eshrefi do të shkojë në Mekë dhe do të lidhë aleancë me idhujtarët për luftë kundër të Dërguarit dhe atyre që e ndjekin atë. Ky njeri që ishte i njohur me armiqësi kriminele, i vajtoi idhujtarët e vrarë në Luftën e Bedrit dhe i nxiti për hakmarrje! Ka'bi u kthye në Medinë, ku jetën e rregullonte marrëveshja e ratifikuar me të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s.

Prandaj i Dërguari s.a.v.s. e urdhëroi vrasjen e tij, me çka pushuan trazirat e mundshme që ai mund t'i shkaktonte.

Ajetet e përmendura nënkuptojnë urrejtjen e tradhtisë dhe mashtrimit (pabesës), si dhe edukimin e tradhtarëve dhe të pabesëve në mënyrë që të tjerët të vënë mend dhe t'i dinë kufijtë që i kanë: "...shpartalloyi, që të vënë mend ata që vijnë pas tyre."

Është interesant fakti se këto ajete e nënkuptojnë zhvillimin e luftës haptazi, pa hile, që armiku dhe miku ta dinë se çfarë është duke ndodhur, se nuk ka vend për komplete në errësirë dhe metoda të fëlliqura tradhtare.

Vetë thirrja islame është ajo e cila sillet rreth këtij boshti të hapur e të qartë, me qëllim që të vërtetat e

saj të jenë të njohura për të gjitha palët që janë në përleshje: "Thua: "Mua më është shpallur që Zoti juaj është një Zot i vetëm; pra, a jeni myslimanë?" E, nëse ata i shmangen (thirrjes sate), ti thua: "Unë ju kam lajmëruar të gjithëve pa dallim dhe nuk di a është afër apo larg ajo, që ju është premtuar."<sup>384</sup>

Ky është mjedisi i pastër dhe i lavdishëm ku prezantohet thirrja islame. Qëndrimi i qartë i kësaj thirrjeje bënte që çdo mashtrues të frikësohet nga mashtrimi dhe tradhtia.

Transmeton Bejheku se i Dërguari s.a.v.s. ka thënë: "Në tri raste myslimani dhe jobesimtari janë të barabartë! Përmbushe besëlidhjen e atij të cilën e ke marrë mbi vete, mysliman qoftë ose jobesimtar, sepse përmbushja e besëlidhjes i takon All-llahut. Mbaj lidhjet familjare të cilat janë të vendosura mes teje dhe dikujt tjetër, mysliman qoftë ose jobesimtar. Dhe, përmbushe amanetin e atij që të ka dhënë diçka në besim, mysliman qoftë ose jobesimtar."

Mbeta i habitur kur njëherë më takoi profesori Hamza Da'bes dhe më tha: "Kryetari i një xhemati islam kërkon mbajtjen e një debati publik e të lirë me dijetarë eminent të Az'harit për një çështje shumë me rëndësi. Unë thashë: "Çfarë është ajo çështje?". Ai tha: "Ai mendon se Islami e lejon atentatin! Para se ta përfundonte bisedën, unë thashë: "Çfarë është kjo marrëzi?". Ai tha: "Ai për argument e ka vrasjen e Ka'b ibn Eshrefit!". Unë i thashë: "O miku im, kjo është mosdije e plotë për Librin e All-llahut, Sunetin e të Dërguarit të Tij dhe për historinë!"

<sup>384</sup> El-Enbija', 108-109

Fatkeqësia e tyre është se ata e hapin një libër të hadithit dhe lexojnë informacione të pambaruara, duke mos e ditur se çfarë i ka paraprirë kësaj ngjarje dhe çfarë ka ndodhur pas saj, që pastaj të japin vendime të rrejshme që nuk përputhen me Librin e All-llahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Tij.

Më duke se tashmë e kuptuam se All-llahu nuk i do tradhtarët! Siç e morëm vesh se përmbushja e besëlidhjes është detyrë e rëndësishme, qoftë ai besimtar ose jobesimtar.

Ky Ka'bi e kishte thyer besëlidhjen që e kishte marrë mbi vete dhe i shpalli luftë islamit dhe të Dërguarit s.a.v.s. Përveç kësaj, ai kishte filluar t'i afronte përreth vetes grupet jobesimtare për luftë kundër islamit, andaj kryetari i shtetit – në këtë rast i Dërguari i All-llahut – dha urdhër për vrasjen e tij. Vendimi për vrasjen e tij ishte i drejtë, sepse vrasja e tij ishte vrasje e kokës së trazirave në vend. Andaj si mund të thuhet se ky vendim ishte atentat?

Vallë, a thua do t'i lejonin myslimanët Ka'bit të hynte në Medinë duke e bartur në dorë armën e fitores? Ai ishte njeri tradhtar, mashtrues, dinak dhe pikërisht për këtë e morri atë që e meritoi! O miku im! Mos ia vë veshin këtyre që flasin për islam, ndërsa janë të paditur, sepse prirja e tyre në fetva është tradhti ndaj thirrjes islame.

Profesori Hamza Da'bes tha: "Ky që flet në emër të islamit mendon se duhet t'i shpallet luftë sunduesit tiran!"

Unë thashë: "Po, është e vërtetë se sunduesi tiran meriton të edukohet, megjithëse ne i urrejmë zullum-

qarët më shumë se që i urren ky i paditur, por ne refuzojmë mendjehhtësinë dhe hamendjen”.

Nuk është e udhës që dikush të nxitë luftë në emër të islamit, ndërsa islami është i papërgatitur! Ky njeri është i kobshëm. Ai e planifikon dështimin e thirrjes islame dhe errësimin e të ardhmes së tij!

I Dërguari Muhammed s.a.v.s. nuk veproi kështu! Ai, pas njëzet viteve erdhi në Mekë për ta bërë Qaben tavaf kur, siç dihet, përreth saj ishin qindra idhuj. Megjithatë ai asnjërin nuk e theu e as që i shkoi ndër mend ta bëjë një gjë të tillë!

Vallë, a thua kjo e nënkupton dashurinë e idhujve? Kurrsesi! Ende nuk ishte koha për luftë me idhujtarët, sepse, kur të vijë koha, burrat do të jenë të gatshëm për ta kryer detyrën e tyre.

Pastaj, ku është arma me të cilën këta të paditur duan të luftojnë? Me siguri se ata janë duke menduar se ku do ta blejnë atë, në Lindje apo në Perëndim!

Kujtoj se këta kanë nevojë për udhëzim dhe mësim të shëndoshë, për mendjehollësi, hapje të horizonteve të reja dhe shumëçka që nuk dinë.

Unë e urrej injorancën dhe mendjemadhësinë, dua që ata që i mbajnë me të madh me njerëzit të mësojnë dhe të bëhen modest.

Kufri nënkupton zemrën e zbrazur nga besimi në All-llahun, vrojtimin e verbër dhe të menduarit e palogjikshëm. Njeriu që është në këtë gjendje nuk meriton të ketë punë të mirë që do të vihet në peshojat e së mirës ose që të jetë e pranuar tek All-llahu i Madhërishëm.

Ndërkaq imani (besimi) fillon me mendje të vetëdijshme dhe me zemër që i nënshtrohet vetëm All-llahut, të Cilin ai e shpreson dhe të Cilit i frikësohet.

Besimtari mysliman arrin që në jetë të furnizohet me fuqinë e besimit, e cila e mbështet të mirën dhe e mposht të keqen.

Kufri dhe imani nuk janë pikëpamje emocionale ose ndjenja të përkohshme. Në botën e njerëzve ato e paraqesin lidhjen me All-llahun dhe mësimet e Tij ose mosrespektimin dhe mosnënshtrimin.

Civilizimet dhe shtetet janë ato që ndërtohen mbi këto dy gjëra! Le të dihet se asnjëri nuk ka për të dalë nga kjo botë, pa iu bërë i njohur qëndrimi i tij që e ka pasur ai ndaj Zotit të tij dhe pozitën që e ka gëzuar në mesin e popullit të tij.

Kur'ani famëlartë na mëson se kufri dhe imani spikaten përmes sjelljeve të dukshme dhe bashkëngjijtes së njeriut ndaj njëres nga dy palët: palës së All-llahut ose palës së djallit: *"Thuaju: "Bindjuni All-llahut dhe të Dërguarit!" në qoftë se kthejnë shpinën, (dijeni se) All-llahu, me të vërtetë, nuk i do jobesimtarët."*<sup>385</sup>

Mendo rreth fjalëve të All-llahut të Madhërishëm: *"Drejtohu ti me përkushtim në fenë e drejtë, para se të vijë prej All-llahut Dita, e cila nuk mund të shtyhet. Atë ditë, njerëzit do të ndahen: ata që nuk kanë besuar, do të mbajnë pasojat e mohimit, kurse ata që kanë bërë vepra të mira, i kanë përgatitur vetes 9 të mira). Ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, All-llahu do t'i shpërblejë nga dhuntitë e Veta. Në të vërtetë, Ai nuk i do mohuesit."*<sup>386</sup>

Përkushtimi në fenë e drejtë me sjellje dhe metode, është imani i vërtetë. Para njerëzve janë vetëm dy rrugë: e drejta dhe e shtrembëta.

<sup>385</sup> Ali-Imran, 32

<sup>386</sup> Er-Rrum, 43-45

Kur'ani famëlartë e përshkruan rrugën e të pavërtetës (mohimit) dhe rrugën e të vërtetës. Ai gjithashtu e përshkruan gjykimin final që bie mbi të dyja palët. All-llahu i Madhërishëm thotë: "Në të vërtetë, ata që nuk besojnë prej ithtarëve të Librit dhe idhujtarëve, do të hyjnë në zjarrin e xhehenemit, në të cilin do të mbeten përgjithmonë. Ata janë krijesat më të këqija."

Ky është përshkrimi i jobesimtarëve dhe ky është fati i tyre përfundimtar! A thua cili është përshkrimi i besimtarëve dhe fati i tyre?

All-llahu i Madhërishëm thotë: "*Pa dyshim, ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira – pikërisht ata janë krijesat më të mira.*"

Siç mund të vërejmë, imani dhe vepra e mirë janë ato që e bëjnë njeriun të lumtur dhe të merituar për këtë vend të lartë. Pastaj vijnë ajetet të cilat e përshkruajnë shpërblimin e merituar të besimtarëve: "*Shpërblimi i tyre është te Zoti i tyre: kopshtet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të banojnë përherë.*"<sup>387</sup>

Ky është shpërblimi! Po cilat janë veçoritë tjera për arritjen e kësaj fitoreje?

"*All-llahu është i kënaqur me ata, por edhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është dhurata për ata që e kanë frikë Zotin e vet.*"

Të jesh i kënaqur me All-llahun dhe t'i frikësohesh Atij! Kënaqësia është ndjenjë që lind pas stërvitjes me kaderin, njeriu disa herë tregohet mirënjohës, e disa herë durimtarë! Ndërsa frika është ndjenjë që lind nga kundërshtimi i dëshirave të parëndësishme dhe zgjuarsive të ndërgjegjes së pastër.

<sup>387</sup> El-Bejjine, 6-8

Feja e drejtë nuk është prejardhje që trashëgohet; ajo nuk është lëkurë e bardhë ose e zezë që, pa dëshirën tonë na vishet!

Feja e drejtë është përpjekje shpirtërore dhe shoqërore që na çon drejt arritjes së përsosmërisë individuale, e pastaj drejt mbështetjes së fesë së drejtë kudo në botë dhe në çdo horizont të jetës.

*All-llahu i do ata që mbështeten tek Ai*

*“Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek All-llahu. Vërtet, All-llahu i do ata që mbështeten tek Ai.”<sup>348</sup>*

Mbështetja tek All-llahu (tevekkuli) është bindje e thellë në Zotin, është shpresë që e shoqëron punën, është vendosmëri, shkëlqimin e së cilës nuk mund ta humbin hallet e dynjasë sado që të jenë ato.

Burimet e mbështetjes tek All-llahu janë të shumta. S’ka dyshim se natyra e teuhidit na mëson për këtë bindje të thellë. Është ajo që na mëson për emrat e bukur të All-llahut dhe për atributet e Tij sublime: “All-llahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai është mbikëqyrësi i çdo gjëje. Të Tij janë çelësat e qiejve e të Tokës...”<sup>349</sup>

*“All-llahu është Ai që ju ka bërë Tokën vendbanim e qiellin kulm, ju ka dhënë formë e ju ka përsosur atë dhe ju ka furnizuar me ushqime të mira. Ja, ky është All-llahu, Zoti juaj. Qoftë i lartësuar All-llahu, Zoti i botëve! Ai është i Përrjetshmi, s’ka zot tjetër përveç Tij. Prandaj lutjuni vetëm Atij, duke iu drejtuar me adhurim të sinqertë. Qoftë i laudëruar All-llahu, Zoti i botëve!”<sup>350</sup>*

<sup>348</sup> Ali-Imran, 159

<sup>349</sup> Ez-Zumer, 62-63

<sup>350</sup> El-Cafir, 64-65



Nëse nuk i mbështetemi Atij që e ka pushtetin mbi çdo gjë, kujt do t'i mbështetemi pra?

Në sunetin e të Dërguarit s.a.v.s. gjejmë një bisedë të ëmbël që engjëlli fisnik ia frymëzoi Ubejj ibn Ka'bit, kur ai kishte thënë: "Do të hyj në xhami, do të falem dhe do ta falënderoj All-llahun me falënderime që askush nuk e ka falënderuar!

Pasi u fal dhe u ul për ta falënderuar All-llahun dhe për ta lavdëruar, kur ja, një zë i lartë pas tij, u dëgjua të thoshte: *"O Zoti im, Ty të takon i tërë falënderimi, Ty të takon i tërë sundimi, në dorën Tënde është e tërë e mira, tek Ti kthehet çdo gjë, e dukshme dhe e padukshme, Ty të takon falënderimi, Ti je i plotfuqishëm mbi çdo send. M'i fal mua mëkatet e kaluara, dhe më mbro në pjesën e jetës që më ka mbetur, më furnizo me vepra të shkëlqyera me të cilat Ti do të jesh i kënaqur me mua dhe ma prano pendimin."*

Ubejj ibnu Ka'bi erdhi dhe i rrëfeu të Dërguarit çka i kishte ndodhur, ndërsa i Dërguari i tha: *"Ka qenë Xhibrili alejhis-selam"*

Me cilin do t'i përforcojmë lidhjet tona, nëse nuk i përforcojmë me Zotin, plot Madhëri dhe Nderim? Me Atë që i takon pushteti në Tokë dhe në qiej, me Atë që edhe fytyrat i përulen, që asgjë nuk ndodhë pa lejen e Tij, që nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveç sa dëshiron Ai...

Unë thashë më vete: "Cili do të kishte qenë motivi psikologjik (shpirtëror), i cili e kishte bërë Ubejj ibn Ka'bin – All-llahu i Madhërishëm qoftë i kënaqur me të – të shkonte në xhami me aq shpejtësi për t'i përvetësuar të mirat, që t'i thotë vetes se sot do të falem dhe

do ta falënderoj All-llahun me falënderime që askush nuk e ka falënderuar?

Përgjigjen e kisha afër! Është i zoti i Shpalljes së fundit (Muhammedi a.s.), ai i cili i mësoi se për të në këtë botë nuk ka më të dashur se falënderimi dhe lavdërimi i All-llahut. A nuk është ky që thotë: *“Që të them: subhanall-llah (i Lartësuar qoftë All-llahu), ve-l-hamdu lil-lah (i Falënderuar qoftë All-llahu) dhe la ilahe illa-ll-llahu vall-llahu ekber (S’ka të adhuruar tjetër përveç All-llahut, Një të pashoq, All-llahu është më i Madhi), është më mirë për mua se lindja e diellit.”*<sup>391</sup>

Falënderimi dhe lavdërimi i All-llahut janë gjërat më të këndshme dhe më të ëmbla për të, janë më të vlefshme se çdo gjë tjetër që është në faqe të dheut!

Njohja e All-llahut përmes këtyre lavdërimeve dhe mirënjohjeve është bazë e mbështetjes (tevekulit) tek Ai dhe i lidhshmërisë së fortë me Atë; është burimi i parë i burimeve të mbështetjes (tevekulit).

Burim tjetër i mbështetjes tek All-llahu janë hallet e dynjasë, numri i madh i armiqve që vazhdimisht e vëzhgojnë njeriun dhe ndjenja e njeriut për nevojë të jashtëzakonshme për ndihmës dhe dashamir që do t’ia largojë jetërsimin, ndërsa ndihmës që do ta mbështetë në luftë dhe përpjekje.

Kur’ani famëlartë dhe historia njerëzore na mësojnë se mbështetja tek All-llahu (tevekuli) është mik i afërt i xhihadit të vështirë. Sa shumë që janë të këqijat e njerëzve, sa e ashpër është smira e tyre dhe dëmi që bie mbi qafën e të sinqertëve dhe këshilluesve.

<sup>391</sup> Muslimi dhe Tirmidhiu

Kur banorët e Medjenit kërkuan nga besimtarët që të largohen nga vendi i tyre ose të kthehen në fenë e të parëve dhe të braktisin fenë që e përqaftuan, ata u përgjigjën: "Nëse do të ktheheshim në fenë tuaj, pasi All-llahu na shpëtoi nga ajo, atëherë do të shpifnim gënjeshtër kundër All-llahut. Ne nuk mund të kthehemi në të, përveçse po të dojë All-llahu, Zoti ynë. Ai përfshin çdo gjë me dijeninë e Vet dhe tek Ai mbështetemi. O Zoti ynë, gjyko drejt midis nesh dhe popullit tonë! Ti je Gjykatësi më i mirë."<sup>392</sup>

Ndihmuesit e të Vërtetës i durojnë vështirësitë e mëdha që u dalin në rrugë, por ëmbëlsia e imanit dhe madhështia e së vërtetës së tij, si dhe mburrja me lavdinë e tij, janë ato që i bëjnë ata të durojnë dhe të qëndrojnë të pathyeshëm: "E përse të mos mbështetemi tek All-llahu, kur Ai tashmë na ka treguar rrugën e drejtë, në të cilën po ecim? Ne do t'i durojmë përndjekjet tuaja e ata që besojnë, le të shpresojnë vetëm tek All-llahu!"<sup>393</sup>

Nëse qëllimi i parëndësishëm u kushton mund dhe vështirësi të zotëve të tyre, atëherë çfarë mbetet për qëllimet e larta e të lavdishme? Pse njeriu derdh djersë duke rendur pas pozitës dhe famës? Pozitës së udhëheqësit ose ministrit! S'ka dyshim se çmenduria e lavdisë është ajo që e ka mbizotëruar, e pastaj e ka rrëzuar përtokë, duke e lënë të pandihmë në qëllimin e tij të poshtër! Megjithatë, ai vazhdon ta mashtrojë vetveten ose atë ta mashtrojë vetvetja. E shëmtoftë All-llahu emrin dhe të emëruarën! A kësaj i thonë përpjekje e lavdishme?

<sup>392</sup> El-A'raf, 83

<sup>393</sup> Ibrahim, 12

Lavdi e ndershme është t'i udhëzosh të humburit, t'i mësosh të paditurit dhe t'i nxjerrësh njerëzit nga errësira në dritë.

Lavdi është t'i njoftosh njerëzit me Zotin e tyre, t'i shpëtosh nga epshet e tyre dhe t'i mbrosh nga poshtërimi i dynjasë dhe dënimi i botës tjetër.

Lavdi është ta ndërtosh jetën në bazë të së vërtetës, që në të ta përhapësh drejtësinë dhe që në tokën e saj t'i mbjellësh vlerat e larta dhe traditat e mirëfillta.

Pse njeriu dëshiron që të tjerët t'ia zënë emrin në gojë? Pse ai dëshiron që vetëm ai të jetë në qendër të vëmendjes? A nuk i bie ndërmend se kjo do ta bëjë të jetë vetëm një idhull i gjallë, i cili më vonë patjetër do ta shijojë fatin e idhujve të ndërtuar nga druri dhe guri?!

Të Dërguarit e All-llahut janë udhëheqësit e rrugës së qartë... me siguri se Imami i tyre<sup>394</sup> i vetëm është njeriu i cili u obligua me përplasje me fuqitë e së keqes dominuese në Tokë dhe për udhëheqjen e një-pasnjëshme të brezave drejt shenjave të Shpalljes. Njeriu, të cilit iu tha: *"Dhe nuk të kemi dërguar ty (o Muhammed), veçse mëshirë për botët."*<sup>395</sup> Ndërkaq, për veten e tij – në çastet kur po i përjetonte vështirësitë dhe ofendimet e mëdha dhe kur iu tha të lutej kundër atyre që e dëmtonin – ai tha: *"Unë jam mëshirë e dhuruar!"*

Në çastet kur litari shtrëngohej për fyti, kur numri i zullumqarëve dita-ditës bëhej edhe më i madh, ndërsa inati dhe përplasjet për çdo ditë bëheshin të paduruara, atij iu shpallën këto fjalë: *"Dhe thua ju atyre që nuk besojnë: "Ju bëni çfarë të mundni, edhe ne do të bëjmë"*

<sup>394</sup> I pari i tyre, Muhammedi s.a.v.s.

<sup>395</sup> El-Enbija', 107

*çfarë të mundim, dhe pritni, nëse do të prisni, se edhe ne do të presim! All-llahu i di të fshehtat e qiejve dhe të Tokës dhe çdo gjë kthehet tek Ai. Lutju Atij dhe mbështetu tek Ai! Zoti yt nuk është i pavëmendshëm ndaj asaj që bëni ju.*"<sup>396</sup>

Për çudi, mbështetja (tevekuli) sot është flamur të cilin e mbajnë në duar të papunët, e jo punëtorët e të vyeshmit, është në duar të atyre që janë larg sferave të lodhjes, e jo të atyre që e luftojnë çrregullimin dhe shtypjen.

Besimtari mysliman qysh në mëngjes kur del nga shtëpia për t'iu përkushtuar punës së tij të zakonshme, thotë: *"Me emrin e All-llahut, në All-llahun u mbështeta. O Zoti im, kërkoj mbrojtjen Tënde që të mos shkoj në humbje (dalalet), e as dikush të mos më shtpie në humbje (dalalet); kërkoj mbrojtjen Tënde të mos shkas (nga e vërteta), e as që dikush të më bëjë të shkas (nga e vërteta); kërkoj mbrojtjen Tënde që të mos e dëmtoj askënd e as dikush të më dëmtojë mua."*<sup>397</sup>

Ndërkaq pas përfundimit të punës dhe kthimit në shtëpi, ai thotë: *"O Zoti im, kërkoj prej Teje hyrjen më të mirë dhe daljen më të mirë; me emrin e All-llahu hymë dhe me emrin e All-llahut dolëm; tek All-llahu, Zoti ynë, mbështetemi..., e pastaj e përshëndet familjen e tij."*<sup>398</sup>

Dallimi mes besimtarit dhe jobesimtarit qëndron në faktin se i pari beson bindshëm në mbikëqyrjen e All-llahut për çdo gjë dhe në strehimin e çdo qenie mes vullnetit dhe fuqisë së All-llahut! Është kjo bindje e cila e bën besimtarin të mbështetet në Zotin e tij.

<sup>396</sup> Hud, 121-123

<sup>397</sup> El-Edhkar Neveviu, faq. 38

<sup>398</sup> El-Edhkar Neveviu, faq. 38

Çfarë bëhet me jobesimtarin? Është ai i cili nuk e njeh Zotin dhe nuk e sheh fare Atë, që beson se gjërat në gjithësi lëvizin vetvetiu dhe se rastësitë janë ato që e përcaktojnë fatin e njerëzve dhe të gjërave.

Unë thashë më vete: po ku është veprimi i këtyre rastësive në sistemet e përkryera dhe të rregulluara të gjithësisë? A nuk janë valët e radios ato që lëvizin sipas caktimit të përsosur të Zotit?!

Edhe erërat fryjnë sipas ligjeve të caktuara të All-llahut të Madhërishëm: *"Çdo gjë tek Ai është me masë."*<sup>399</sup>

Çdo gjë që është në Tokë dhe në qiej është e drejtuar nga ligji i përsosur i All-llahut. Prandaj si është e mundur që vetëm veprat e njerëzve të vazhdojnë të orientohen sipas rastësive të verbëta? E vërteta është se besimi dhe mbështetja (imani dhe tevekuli) janë dy gjëra të pandara dhe përbëjnë dituri të bindshme, se ateizmi dhe shpërfillja janë gjithashtu dy gjëra të pandara dhe janë injorancë e paturpshme që përhapet nën emrin e rastësive të verbëta, ndërkaq verbëria është vetëm në trurin e jobesimtarit.

Mbështetja në All-llahun na bën ta ndiejmë se jemi më të fuqishëm dhe të pathyeshëm, për dallim nga robërit e rastësive të pakuptimta dhe shkaqeve të shkëputura. Pse të mos jem i fuqishëm dhe i pathyeshëm kur jam i lidhur me All-llahun? Pse të mos jem më i lartë dhe më krenar kur jam me Atë? Pse të lejoj që të tjerët, të cilët mbështeten në njerëz të fuqishëm e të pasur, të jenë më të fuqishëm se unë? Çfarë u sjell atyre pozita, pasuria dhe autoriteti? Unë jam ai që

<sup>399</sup> Er-Ra'd, 8

mbështetem në All-llahun e Plotfuqishëm dhe jam më i kënaqur se të gjithë të tjerët ose, siç më ka thënë i Dërguari s.a.v.s., *"Ajo që është në duart e All-llahut të jetë më e sigurt se të jetë në dorën tënde."*<sup>400</sup>

S'ka dyshim se historinë e famshme islame e krijuan një grup besimtarësh të mbështetur te All-llahu, që nuk u frikësuan nga fuqitë e të pavërtetës që dominonin në Lindje dhe në Perëndim, që me fuqi dhe aftësi të jashtëzakonshme i luftuan ato, gjatë kësaj duke qenë të bindur në premtimin e All-llahut për fitore: *"Thuaj: "Ai është i Gjithëmëshirshmi, ne Stë besojmë dhe tek Ai mbështetemi e ju, sigurisht, do ta merrni vesh se kush është i humbur plotësisht."*<sup>401</sup>

Muslimanët bashkëkohorë, që do të jenë shumë nga më të mëvonshmit, doemos duhet të mbeten të paluhatshtëm dhe të pathyeshëm kundrejt sulmeve të cilat kanë për qëllim dëbimin e besimit (imanit) nga faqja e dheut.

S'ka dyshim se vendosmëria e tillë edhe mbështetja e fortë tek All-llahu do ta rëndojnë peshojën e forcës kundër armiqve të All-llahut dhe atë ditë besimtarët do të gëzohen për ndihmën e All-llahut.

*All-llahu nuk i do ata që e teprojnë*

Në rini isha i preokupuar me shumë gjëra të mëdha të cilat kërkonin të konsumoja ushqime të ndryshme, sepse ishte e pamundur që trupi im të

<sup>400</sup> Tirmidhiu, vëll. IV, faq. 494, numër: 2340 dhe Ibn Maxhe, vëll. II, faq. 1373, numër: 4100

<sup>401</sup> El-Mulk, 29

mbijetonte pa ato. Mirëpo leximi i librave sufiste që i kisha trashëguar nga babai im – All-llahu i Madhëri-shëm e mëshiroftë – më ndryshuan për një kohë. Dëshira ime për ushqimet e këndshme sikur filloi të zbutej, andaj edhe i shpalla luftë hajes dhe pijes. Por, nuk zgjati shumë kohë dhe trupi im filloi të rraskapitet, ndërsa punën që e bëja më herët tash më nuk isha në gjendje as ta paramendoja. Prandaj përsëri u ktheva në fillimin e jetës sime. E kuptova se çështja nuk ishte ashtu sikur më dukej mua, porse duhet të studiohet me vëmendje dhe vetëdije të plotë.

Trupi i njeriut ka nevojë për konsumimin e të gjitha gjërave që do ta furnizonin atë me energji dhe zhvillim dhe që në qenien e tij do ta krijonin imunitetin e duhur për rezistimin e sëmundjeve dhe fatkeqësive. Feja e All-llahut nuk i konteston këto kërkesa të logjikshme, sepse: *“O të dërguar! Hani nga të lejuarat dhe bëni vepra të mira...”*<sup>402</sup>

*“O besimtarë! Hani nga ushqimet e lejuara që ju kemi dhënë dhe, nëse jeni adhures të All-llahut, falënderojeni Atë!”*<sup>403</sup>

I Dërguari i All-llahut thotë: *“Ha çfarë të duash dhe vish çfarë të duash, por dy gjërave nuk mund t’u ikësh: tepërimin dhe mendjemadhësisë.”*<sup>404</sup>

Prandaj murgëria, si armike e trupit, dhe zuhdi, që shtyp nevojat esenciale dhe kënaqësitë e zakonshme të tij, janë pjellë e fanatikëve, e jo gjëra të fesë së All-llahut.

<sup>402</sup> El-Mu’minun, 51

<sup>403</sup> El-Bekare, 172

<sup>404</sup> Fet’hu-J-Beri, vëll. Xi, faq. 252



Askush nuk mund ta mohojë faktin se njeriu disa herë zgjerohet në epshet e tij, jeton me luks dhe i kapërcen kufijtë e caktuar të jetës derisa të ngopet dhe të sëmuret. Feja dhe logjika e shëndoshë e refuzojnë teprimin dhe e tërheqin vërejtjen nga pasojat e tij.

Sot ka shumë njerëz të uritur që kërkojnë përmëshjen e nevojave esenciale, andaj ata nuk duhet të shpërfillen e të lihen në harresë. Është islami dhe humanizmi njerëzor ato që kërkojnë ngushëllimin e të uriturve.

Në këtë bazë i kuptojmë thëniet e të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. lidhur me ushqimin, që po ashtu nuk dalin jashtë sferës së fjalëve të All-llahut të Madhërishtëm: *"Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë."*<sup>405</sup>

Transmeton Xhabir ibn Abdull-llahu dhe thotë: "Një ditë, gjersa po kthehesha nga tregu ku kisha blerë mish për një dërhëm, më takoi Omer ibn el-Hattabi dhe më tha: "Ç'është kjo, o Xhabir?" Një copë mishi për familjen time që e bleva për një dërhëm, i thashë! E ai filloi të përsëriste: "Një copë mishi për familjen time...", derisa u bëra pishman dhe thashë më vete: "Sikur të më kishin humbur paratë e të mos e kisha takuar fare Omerin!".

Kujtoj se këto fjalë kanë nevojë për një shpjegim. Omeri nuk ua ndalon mishin njerëzve, se kjo nuk i takon atij dhe askujt tjetër, por gjendja ekonomike që atëkohë mbretëronte në Medinë kërkonte politikën e zhvillimit të jetës së rëndomtë dhe kujdesin e skamno-

<sup>405</sup> El-A'raf, 31

rëve. Siç duket, Xhabiri e kishte tepruar me blerjen e copës së mishit. Këtë e provon transmetimi i Malik ibn Jahjasë dhe Seidit se Omeri – All-llahu i Madhërishëm qoftë i kënaqur me të – e kishte takuar Xhabirin, ndërsa me të ishte hamalli, i cili mbi shpinë mbante copën e madhe të mishit – pra kishte blerë sasi të madhe të mishit që kishte nevojë ta mbajë hamalli – dhe i tha: “A dëshiron dikush prej jush që barkun e fqinjit të tij ta merr uria? Ose të djalit të axhës së tij? Po ku mbeten për ju fjalët e All-llahut të Madhërishëm: “Ju keni shfrytëzuar gjithë të mirat në jetën tuaj në tokë dhe jeni kënaqur me to...” – Kështu nuk veprojnë të devotshmit! Sidomos nëse ka kriza të përgjithshme.”<sup>406</sup>

I Dërguari i All-llahut s.a.v.s. thotë: “Barku është ena më e keqe të cilën e mbushë i biri i Ademit, atij i mjaftojnë dy-tri kafshata, sa për ta mbajtur trupin drejt.”<sup>407</sup>

Dhe thënia tjetër e Muamedit s.a.v.s.: “Në Ditën e Kiametit do ta sjellin një njeri, i madh e i gjatë, i ngrënë e i pirë, por tek All-llahu nuk do të peshojë as sa krahu i mushkonjës, lexoni pra nëse doni fjalët e All-llahut: “Punët e tyre do të fshihen, andaj ne nuk do të vëmë kurrfarë peshe për ta (për veprat e tyre), në Ditën e Kiametit.”<sup>408</sup>

Tema në fjalë kërkon shpjegim më të gjerë, me qëllim që të bëhet e qartë e ndaluara dhe e lejuara. Andaj unë mendoj se eksitojnë paqartësi që kanë rol të madh në këtë dispozitë. Sot kemi njerëz që e adhu-

<sup>406</sup> Maliku, vëll. II, faq. 936, numër: 36, shih *Et-Tergib ve't-Terhüb* vëll. III, faq. 141, ajeti është pjesë e sures *El-Ahkaf*, 20

<sup>407</sup> Tirmidhiu dhe Ibn Maxhe, marrë nga *Et-Tergib ve't-Terhüb* vëll. III, faq. 136

<sup>408</sup> *El-Kehf*, 105, hadithin e transmeton Bejhoku, marrë nga *Et-Tergib ve't-Terhüb* vëll. III, faq. 138

rojnë jetën e kësaj bote dhe nuk çajnë kokë për atë që do të vijë pas. Këta janë ata për të cilët All-llahu i Madhërishëm thotë: *"Ndërsa ata që nuk besojnë dhe kënaqen e hanë ashtu siç gëlltisnin bagëtitia, do të kenë Zjarrin si vendbanim!"*<sup>409</sup>

*"Lëri ata që të hanë e të kënaqen dhe le t'i mashtrojë shpresa; ata do ta marrin vesh!"*<sup>410</sup>

Zemërtharët – ata që nuk besojnë All-llahun – i godet tërbim i furishëm gjatë rendjes pas epsheve dhe arritjes së tyre. Gëzimin e tyre nuk e prishë asgjë, ndërsa dëfrimi i tyre nuk njih kufij. Ata janë të dehur dhe nuk bien në vete para Ditës së Ringjalljes, Ditës që njërit prej tyre, duke qenë në dënime e sipër, do t'i thuhet: *"Sepse ai jetonte i shkujdesur në familjen e tij, duke menduar se kurrë nuk do të kthehej (për të dhënë llogari). Po, Zoti i tij, sigurisht që i ka ndjekur të gjitha punët e tij!"*<sup>411</sup>

S'ka dyshim se jeta e këtyre jobesimtarëve dhe fati i tyre nuk do të jetë i barabartë me jetën e besimtarëve dhe fatin e tyre. Këta hanë për të jetuar, ngopen për të luftuar dhe kënaqen me të mirat, me qëllim që t'u shmangen të këqijave. Janë porositë e All-llahut ato që i udhëzojnë për gjërat që i marrin dhe që i lënë.

Teprimi në kënaqësi (luks) dhe mbushja e tryezave me ushqime të ndryshme mund të jetë rezultat i injorancës dhe shkujdesjes (gafletit), siç mund të jetë edhe sa për sy e faqe, për kërkim të lavdisë dhe reno-mesë. Pikërisht për këtë i Dërguari i All-llahut s.a.v.s.

<sup>409</sup> Muhammed, 12

<sup>410</sup> El-Hixh, 3

<sup>411</sup> El-Insikak, 13-15

ka ndaluar të prezantohet në dasmat të cilat bëhen për mburrje (lavdërim). Transmeton Abdullah ibn Abasi: se i Dërguari s.a.v.s. ka ndaluar të hahet ushqimi i garuesve (atyre që bëjnë gara në ushqimet e gostisë)<sup>412</sup>

S'ka dyshim se sot krijohen gara të përhershme në gëzimet familjare dhe në dasmat e njerëzve. Prandaj do të ishte e udhës dhe e dobishme të bëhet rregullimi këtyre traditave.

Është e udhës të theksojmë që nijeti zë vend të rëndësishëm në punën e njeriut. Ai bën që puna të pranohet dhe të lavdërohet. Ne e vërejmë se Ibrahim alejhis-selam shpejtoi për ta prerë viçin që e kishte për gostinë e tre mysafirëve që i erdhën në shtëpi, ngase nderimi i mysafirit është nga feja.

Për çudi, civilizimi modern nuk di gjë për nderimin e mysafirit dhe nuk di për mirëpritjen e të huajve (panjohurve)! Edhe përkundër numrit të tyre të madh dhe bollëkut që e kanë, ata vazhdojnë të hanë me masë, të urinojnë me masë dhe të mos mendojnë fare për të tjerët...

*All-llahu nuk i do ata që ngazëlleen*

All-llahu i Madhërishëm në rrëfimi për Karunin na mëson se Ai i urren dy gjëra të cilat e shoqërojnë pasurinë e pamasë:

- Ngarkimin e shpirtit me ngazëllim të fëlliqur, dhe

<sup>412</sup> Ebu Davudi, marrë nga *El-Terzib ve'l-Terhib* vëll. III, faq. 146

- Padrejtësinë, vetëmashtrimin, përqeshjen e të tjerëve dhe vetadhurimin.

Populli i Karunit e kishte vërejtur këtë tek ai, prandaj edhe thanë: "Mos u ngazëlle me pasurinë që e ke, sepse All-llahu nuk i do ata që ngazëllehen."<sup>413</sup>

Po çfarë duhet të bëjë njeriu të cilit All-llahu i ka dhënë shumë pasuri dhe të mira?

"Por përpiqu me atë që të ka dhënë All-llahu të fitosh jetën e botës së ardhme, duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë. Bëju mirë të tjerëve, ashtu si të ka bërë mirë ty All-llahu. Mos kërko ngatërresa në Tokë, sepse All-llahu nuk i do ngatërrestarët."<sup>414</sup>

Kuptohet që pasuria e madhe dhe pushteti absolut janë dy faktorë të përvuajtjes së njerëzve dhe shkatërrimit të vendeve. Ka kohë që edhe myslimanët janë duke i përjetuar fatkeqësitë e këtyre dy faktorëve.

#### *All-llahu i do të drejtët*

Islami na mëson se sevapet e adhurimeve individuale janë të kufizuara në krahasim me sevapet e adhurimeve në shoqëri; agjërimi ditën është i vlefshëm, namazi i natës është i vlefshëm, falja e namazeve është e vlefshme, haxhi është i vlefshëm....dhe:

<sup>413</sup> El-Kasas, 76

<sup>414</sup> El-Kasas, 77

*“Një ditë e udhëheqësit të drejtë është më e vlefshme se adhurimi gjatë dhjetë vjet.”<sup>415</sup>*

Udhëheqësi i drejtë do të jetë i pari i shtatë personave që All-llahu do t'i vendosë nën hijen (mbrojtjen) e Tij atë ditë kur nuk do të ketë hije tjetër, përveç hijes së Tij. Transmeton Abdull-llahu ibn Amri se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: *“Të drejtët tek All-llahu do të jenë të ulur në kolltukë, do të jenë në të djathtë të të Gjithëmëshirshmit – kurse të dy duart e Tij janë të djathtë – janë ata që punojnë drejtë kur gjykojnë, janë të drejtë me familjet e tyre dhe të drejtë me ata që i kanë përsipër (që i sundojnë).”<sup>416</sup>*

Ijadi thotë: *“E kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut s.a.v.s. duke thënë: “Banorë të xhenetit janë tre persona: udhëheqësi i drejtë që u përmbahet këshillave, njeriu i mëshirshëm zemra e të cilit është e butë për çdo të afërm dhe për çdo mysliman, si dhe njeriu i pastër e i ndershëm, i cili ka shumë fëmijë.”<sup>417</sup>*

All-llahu i Madhërishëm thotë: *“E, nëse i gjykon, gjykoji me drejtësi! Vërtet, All-llahu i do të drejtët.”<sup>418</sup>*

Sistemi demokratik në Evropë – disa herë i shëmtuar me devijime individuale – ka arritur ta përmbushë jetën e evropianëve me drejtësi të plotë dhe siguri të thellë, është treguar korrekt me skamnorët dhe të paafitit, ai i ka çrrënjësuar rrënjët e faraonëve dhe karu-

<sup>415</sup> Taberani në *El-Kebir* dhe *El-Eusat*, marrë nga *Et-Tergib ve't-Terhib* - vëll. III, faq. 167

<sup>416</sup> Muslimi dhe Nesaiu

<sup>417</sup> Muslimi

<sup>418</sup> El-Maide, 42

nëve:<sup>419</sup> punëtori, qoftë edhe ai që punon në minierat e thella, e gëzon të drejtën ta sulmojë dhe kritikojë qeverinë, duke mos u frikësuar nga asgjë!!

Umeti ynë nuk i njeh këto gjëra të vlefshme edhe pse në të kaluarën ishin pjesë e historisë së tij.

Disa që mbahen fetarë edhe më tej vazhdojnë ta shpërfillin vlerën e drejtësisë, e cila është garanci e shoqërisë së shëndoshë dhe e shtetit të sigurt, sepse ata janë të preokupuar me mbajtjen e shkopit dhe shkurtimin e mustaqeve!!<sup>420</sup>

Shtrembërimi që sot e ka goditur logjikën fetare ka bërë që besimtarët të mos dinë se çfarë bëjnë, siç ka bërë që shumë çështje me rëndësi të jetës të përditshme të shkëputen nga Islami, ndërkohë që bëhet kiameti për gjëra që nuk kanë fare peshë në jetën e myslimanëve!

S'ka dyshim se myslimanët, nëse vazhdojnë kështu, do të mbeten qytetarë të rendit të tretë. Siç duket, në duart tona nuk ka mbetur asgjë nga kjo botë, përveç lotit në sy, jemi bërë qyqarë, pa pozitë e pa prejardhje, pa miq e pa dashamirë që do të na ngushëllojnë.

<sup>419</sup> Pushtetarëve tiranë dhe të pasurve zullumçarë.

<sup>420</sup> Për fat të keq, disa myslimanë edhe më tej vazhdojnë të preokupohen me këto gjëra!!

*All-llahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij*

Umeti ynë ka nevojë për rindërtim dhe ngritje, për heqje të amullisë, për orientim drejt përmbushjes së misionit të tij dhe për t'u kapur fort për Islamin me të cilin është nderuar përgjithmonë. S'ka dyshim se një gjë e tillë kërkon mund të jashtëzakonshëm (xhihad të madh).

Forcat kundërshtarë të islamit shumë herë janë treguar të ashpra dhe të pamëshirshme, megjithëse ato kurrë nuk mund të na ngadhënjë nëse ne bashkohemi rreth një fjale, nëse i përmbahemi fjalës së teuhidit dhe i bashkojmë radhët tona për lartësimin e fjalës së All-llahut.

Historia na mëson se vetë ne kemi qenë shkak i disfatave në luftërat që janë zhvilluar më parë. Shpërfillja dhe përçarja jonë kanë qenë pikat depërtuese të armikut në radhët tona për ta nxirë fytyrën tonë.

Xhihadi është punë kolektive, barrën e së cilës e bart i tërë Umeti, ndërsa shteti është ai që e mbikëqyrë organizimin e tij. Xhihadi kurrë nuk mund të jetë adhurim individual i veçuar! Xhihadi i nënkupton ushtritë e mëdha dhe të radhitura fort, fuqitë që e mbështetin njëra-tjetrën dhe armët e drejtuara drejt caqeve të caktuara mirë, të planifikuara dhe të studiuara.

Me rëndësi është që individi të jetë me besim të shëndoshë, zbatues i mirë i detyrave që i kërkohen,



trim, i paluhatshtëm dhe i pathyeshëm, që radhët të jenë të forta, sikur të jenë mur i fortë, ku armiku nuk mund të depërtojë, qoftë kur sulmon ose kur dëshiron të tërhiqet.

Natyrisht që kjo kërkon burra të vërtetë e të paluhatshtëm, të gatshëm për t'i mbushur radhët nëse ato mbeten të zbrazëta dhe për t'i rregulluar nëse ndodhë ndonjë çrregullim i papritur.

Lufta është kulmi i sprovës së njerëzimit, çasti kritik i cili bën që besimtari t'i shkelë e t'i hedhë nën këmbë të gjitha kënaqësitë e jetës dhe dëshirat e dynjasë, të ecë përpara me besim të plotë, i vendosur dhe i gatshëm për ta kryer detyrën e tij dhe për ta takuar Zotin e tij...; aty nuk ka vend për pretendime dhe lojë: *"Është shumë e urryer për All-llahun të thoni atë që nuk e bëni! Vërtet, All-llahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij, të radhitur si të ishin një ndërtesë solide."*<sup>421</sup>

I Dërguari s.a.v.s. thotë: *"Qëndrimi i njeriut në radhë në rrugë të All-llahut (për luftë) është më me vlerë tek All-llahu se adhurimi i njeriut për gjashtëdhjetë vjet."*<sup>422</sup>

Në një transmetim tjetër thuhet: *"Qëndrimi i njërit nga ju në rrugën e All-llahut është më i vlefshëm se namazi i tij në shtëpinë e tij shtatëdhjetë vjet. A nuk dëshironi ju që All-llahu t'ju falë dhe t'ju futë në xhenet? Luftoni në rrugën e All-llahut! Kush lufton në rrugën e All-llahut aq sa*

<sup>421</sup> Es-Saff, 3-4

<sup>422</sup> Hakimi, marrë nga El-Tergib ve'l-Terehib vëll. II, faq. 285

*është koha ndërmjet dy mjeljeve të devesë, për të është i sigurt xheneti.”<sup>43</sup>*

Paraqitja para armikut, qoftë edhe për një çast të shkurtër, është më e vlefshme se e tërë jeta; ajo i hap dyert e amshueshmërisë...

Islami refuzon ashpër që xihadi të jetë i përzier me epshe të posaçme; ai duhet të jetë i pastër nga çdo njollë e epshit dhe të jetë vetëm për hir të All-llahut të Madhërishëm. Vetëm atëherë lëvizjet e luftëtarit do të jenë sikur lëvizjet e rukusë dhe të sexhdes – adhurim i plotë dhe i pastër.

I Dërguari s.a.v.s. thotë: *“Janë dy çaste në të cilat hapen dyert e qiellit dhe rrallëherë ndodh që lutësit t’i refuzohet lutja e tij: lutja gjatë thirrjes së ezanit dhe lutja në luftë në rrugë të All-llahut.”<sup>44</sup>*

Islami nxit fort në bashkëngjitjen me ushtri dhe në përgatitjen për përleshje me armikun. Transmeton Ebu Ejubi se i Dërguari i All-llahut s.a.v.s. ka thënë: *“Një ecje e mëngjesit ose një ecje e mbrëmjes në rrugën e All-llahut është më e mirë se bota dhe çdo gjë në të.”<sup>45</sup>*

Po pse e tërë kjo nxitje? Sepse xihadi është garanci e fortë e ngeljes së të vërtetave që nuk mund t’i shlyejnë ngatërrestarët dhe gjynahqarët gënjeshtarë, si dhe i ngeljes së të drejtave që nuk mund t’i cenojnë shkelësit dhe keqbërësit.

<sup>43</sup> Tirmidhiu

<sup>44</sup> Ebu Davudi dhe Ibn Hibani në sahihun e tij, Marrë nga *Et-Tergib ve’l-Terchib* vëll. II, faq. 295

<sup>45</sup> Muslimi dhe Nesaiu

Më vjen keq që sot jam duke e parë islamin që u bë këtë gjendje të mjeruar, të përndjekur e të përzënë nga çdo sferë ndërkombëtare. Sikur ata që flasin në emër të tij të jenë të padëshirueshëm! Shoh se ngjallja e mësimëve të tij është bërë akuzë e poshtër! Ndërkaq pasuesit e tij jam duke i parë të humbur e të plaçkitur, tokën e tyre të uzurpuar dhe gjakun e tyre të lirë që derdhet kudo, ndërkaq i përshkruan se ata janë terroristë!

Mohimi i All-llahut sot zë vend të lart në arenat ndërkombëtare, ndërsa fjala La ilahe Il-la-ll-llahu është bërë fjalë që e shënon prapambeturinë dhe e nxit neveritjen! Shoqatat për kujdesin e kafshëve dhe mbrojtësit e ambientit janë të gatshëm ta bëjnë kiametin nëse vriten një mijë qenë, ndërkaq vrasja e mijëra myslimanëve nuk nxit fare habi dhe kujdes!

Xhihadi i kohës moderne është i njëjtë me xhihadin në kohës së të dërguarve, xhihad i ballafaqimit të këtyre të dërguarve me djajtë dhe tiranët e ashpër dhe me besëtytnitë që e ngufatnin Shpalljen.

S'ka dyshim se myslimanët nuk kanë zgjedhje tjetër: ose të jetojnë me fenë e tyre ashtu siç duan ose të humben nga faqja e dheut! Sot xhihadi është bërë farzi ajn.<sup>426</sup> Prandaj ne me kujdes të madh duhet t'i shqyrtojmë dhe t'i analizojmë thellë fjalët e të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s., i cili thotë: "All-llahu ka garantuar për atë që del në rrugën e Tij – e atë nuk e nxjerr tjetër përveçse lufta për hir të rrugës Sime, besi-

<sup>426</sup> Detyrë e secilit.

mí në Mua dhe vërtetimi i të dërguarve të Mi – se është i garantuar, se do ta fusë në xhenet ose do ta kthejë në shtëpinë e tij nga e cila ka dalë me shpërbli-  
met të mëdha të fituara ose me pasuri të luftës... Pasha Atë në duart e të Cilit është shpirti i Muham-  
medit, çdo i plagosur që është plagosur në rrugën e All-llahut do të vijë në Ditën e Kiametit me po atë pla-  
gë sikur ditën që është plagosur duke i rrjedhë plaga e tij gjak; gjaku i plagës do të jetë në ngjyrë të gjakut, kurse aroma e tij do të jetë aromë e miskut... Pasha Atë në duart e të Cilit është shpirti i Muhammedit, do të kisha dashtë të luftoj në rrugë të All-llahut e të vri-  
tem, e pastaj prapë të luftoj e të vritem, e pastaj prapë të luftoj e të vritem...”

Xhiahadi është adhurim kolektiv, e jo individual. Ndodhë që vetmia të jetë më e mirë se ndeja me një bashkëbisedues të keq, por bashkëbiseduesi i mirë është më i mirë se vetmia.

Njeriut i duket mirë që të falet vetëm dhe t’i lutet Zotit të tij në vetmi, por më e mirë se kjo është që lutjet e tij që i ka në kraharor t’i bashkoj me jehonën e zërit të luftës dhe me syrin e shpirtit ta shohë Zotin e tij, me qëllim që fjala e All-llahut të jetë lart, ndërsa fjala e atyre që nuk besuan të jetë poshtë.

Armiqtë e Islamit e shpresojnë përçarjen e Umetit dhe shpartallimin e shoqërisë në individë ku çdonjëri do të kujdeset për vetveten dhe çështjen e tij! Një gjendje e tillë do të bëjë që çdo individ të niset drejt

vendit të vrasjes, ashtu sikur që kafshët e kanë vendin e tyre për therje!

Xhemati (kolektivi) është simbol i Islamit dhe myslimanët duhet të kujdesen për bashkimin e tyre dhe t'i kundërshtojnë të gjitha shkaqet e përçarjes dhe izolimit.

Fjalët e të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. e nënkuptojnë fshehtësinë e krahasimit mes adhurimit të cilin e kryen individi dhe xihadit që bëhet nga një grup i madh i bashkuar i besimtarëve: *"Qëndrimi njëmujaor në fushëbetejë është më i mirë se agjërimi i tërë kohës. Ai që vdes luftëtar në rrugë të All-llahut do të jetë i sigurt nga trishtimi i madh i Ditës së Kiametit, do të furnizohet me furnizimet e xhenetit dhe aromën e xhenetit dhe atij do të vazhdojnë t'i rrjedhin shpërblimet e luftëtarit derisa All-llahu i Lartëmadhëruar ta ringjallë."*<sup>427</sup>

Transmeton Muxhahidi dhe thotë se Ebu Hurejre ka qenë në një nga luftërat që zhvilloheshin atëkohë dhe kur njerëzit u tërhoqën drejt bregut, ai nuk lëvizi fare nga vendi. Një njeri kaloi pranë tij dhe e pyeti: "Pse je duke qëndruar këtu, o Ebu Hurejre? Ai iu përgjigj: "E kam dëgjuar të Dërguarin e All-llahut duke thënë: *"Qëndrimi njëorësh (për një çast) në rrugë të All-llahut është më i vlefshëm se falja e namazit natën e lejlekul-kadrit afër Gurit të Zi."*<sup>428</sup>

<sup>427</sup> Taberaniu, transmetuesit e tij janë të besueshëm (thikatun).

<sup>428</sup> Ibn Hibbani dhe Bejhekiu.

Betohem në All-llahun se e ardhmja e Mesxhidil Haramit (Qabes) dhe Mesxhidi Aksasë është e lidhur ngushtë me këto çaste të shtrenjta, çastet e luftës së hidhur dhe përpjekjeve të mëdha për vendosjen e të vërtetës dhe mposhtjen e të pavërtetës.

Këtu ka mbetur pa u përmendur edhe një e vërtetë të cilën nuk e dinë shumica e myslimanëve: xhihadin misionar (kulturore, ideore, shpirtërore) doemos duhet ta shoqërojë xhihadi shkencor dhe industrial i studiuar mirë dhe gjithëpërfshirës! Radha solide e përbërë nga mendimtarët dhe pasanikët duhet t'i mbështesë komandantët e forcave të armatosura. Ndërtesa solide është e ndërtuar nga shumë tulla që e forcojnë njëra-tjetrën dhe e ndihmojnë njëra-tjetrën për ta arritur fitoren e shpresuar në tokë, det ose ajër, me tank, laps, plug dhe çekan.

Ngecja e myslimanëve në shumë fusha ka bërë që ata të dështojnë në shumë sfera të ndryshme, lokale dhe ndërkombëtare. Kujtoj se myslimanët janë të nevojshëm ta rikthejnë lavdinë e tyre të pasur të humbur qëmoti, ndërsa këtë do të mund ta bëjnë vetëm me suksesin e arritur në sferën e arsimimit dhe kulturës, si dhe me suksesin në sferën e industrisë dhe bujqësisë.

Është mrekulli të shihet se si këto fusha sondë-rohen në xhami, se si puna në to bëhet namaz, ndërsa qëllimi i tyre mbetet xhihadi në rrugë të All-llahut.

Kujtoj se është e udhës që në vijim t'i shtrojmë të gjitha ajetet që flasin për atë që All-llahu e do dhe për atë që All-llahu nuk e do:

*All-llahu nuk i do ata që e kalojnë kufirin*

*"...por mos e kaloni kufirin, se All-llahu nuk i do ata që e kalojnë kufirin."<sup>429</sup>*

*"...dhe mos e kaloni kufirin! Vërtet, All-llahu nuk i do ata që e kapërcejnë kufirin."<sup>430</sup>*

*"Lutjuni Zotit tuaj përuulshëm dhe ngadalë! Njëmend, Ai nuk i do ata që e kalojnë kufirin."<sup>431</sup>*

*All-llahu me të vërtetë i do bamirësit*

*"...por bëni të mira, All-llahu me të vërtetë i do bamirësit."<sup>432</sup>*

*"...e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. All-llahu i do bamirësit."<sup>433</sup>*

*"Dhe All-llahu u dhuroi atyre shpërblimin e kësaj bote dhe shpërblimin më të mirë të jetës tjetër. All-llahu i do punëmirët."<sup>434</sup>*

<sup>429</sup> El-Bekare, 190

<sup>430</sup> El-Maide, 87

<sup>431</sup> El-A'raf, 55

<sup>432</sup> El-Bekare, 195

<sup>433</sup> Ali-Imran, 134

<sup>434</sup> Ali-Imran, 148

*"Pra, falua fajet dhe mos i qorto! Se, All-llahu i do bamirësit."*<sup>435</sup>

*All-llahu nuk i do ngatërrestarët*

*"All-llahu nuk e do shkatërrimin."*<sup>436</sup>

*"Ata përpiqen të shkaktojnë ngatërresa në Tokë, por All-llahu nuk i do ngatërrestarët."*<sup>437</sup>

*"Mos kërko ngatërresa në Tokë, sepse All-llahu nuk i do ngatërrestarët."*<sup>438</sup>

*All-llahu i do ata që pendohen dhe ata që pastrohen*

*"Pa dyshim, All-llahu i do ata që pendohen dhe ata që pastrohen."*<sup>439</sup>

*"Aty ka njerëz që duan të pastrohen. All-llahu i do ata që pastrohen shpesh."*<sup>440</sup>

*All-llahu nuk i do ata që janë mohues*

*"All-llahu ia heq çdo përfitim kamatës, kurse e rrit përfitimin e bamirësisë. All-llahu nuk i do ata që janë mohues – gjynahqarë."*<sup>441</sup>

<sup>435</sup> El-Maide, 13

<sup>436</sup> El-Bekare, 205

<sup>437</sup> El-Maide, 64

<sup>438</sup> El-Kasas, 77

<sup>439</sup> El-Bekare, 222

<sup>440</sup> Et-Teube, 108



*"Në qoftë se kthejnë shpinën, (dijeni se) All-llahu, me të vërtetë, nuk i do jobesimtarët."*<sup>442</sup>

*"Ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, All-llahu do t'i shpërblejë nga dhuntitë e Veta. Në të vërtetë, Ai nuk i do mohuesit."*<sup>443</sup>

*All-llahu nuk i do punëmbropshtët*

*"Ndërsa atyre që besojnë dhe punojnë vepra të mira, Zoti do t'u japë shpërblimin e merituar. All-llahu, nuk i do punëmbropshtët."*<sup>444</sup>

*"...që All-llahu t'i dallojë besimtarët dhe për t'i bërë disa nga ju dëshmorë. All-llahu nuk i do keqbërësit."*<sup>445</sup>

*"Por, atë që fal dhe pajton, e pretë shpërblimi i All-llahut. Ai, në të vërtetë, nuk i do të padrejtët."*<sup>446</sup>

*All-llahu i do ata që janë të devotshëm*

*"Jo! Por kushdo që plotëson premtimin e tij dhe ruhet nga të këqijat, (ta dijë se) All-llahu, me të vërtetë, i do ata që janë të devotshëm."*<sup>447</sup>

<sup>441</sup> El-Bekare, 276

<sup>442</sup> Ali-Imran, 32

<sup>443</sup> Er-Rum, 45

<sup>444</sup> Ali-Imran, 57

<sup>445</sup> Ali-Imran, 140

<sup>446</sup> Esh-Shura, 40

<sup>447</sup> Ali-Imran, 76

*“Respektojeni marrëveshjen me ta deri në fund. Me të vërtetë, All-llahu i do ata që i frikësohen Atij.”<sup>448</sup>*

*“Sa kohë që ata t’i përmbahen marrëveshjes – përmbajuni edhe ju, sepse All-llahu i do ata që i frikësohen Atij.”<sup>449</sup>*

*All-llahu i do durimtarët*

*“...as nuk u dobësuan e as nuk u nënshtruan. All-llahu i do të duruarit.”<sup>450</sup>*

*All-llahu i do ata që mbështeten tek Ai*

*“Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek All-llahu. Vërtet, Ai i do ata që mbështeten tek Ai.”<sup>451</sup>*

*All-llahu nuk i do mendjemëdhënjtë e mburracakët*

*“Në të vërtetë, All-llahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburraveçë.”<sup>452</sup>*

*“Mos i trajto njerëzit me nënçmim dhe mos ec në tokë me mendjemadhësi, se All-llahu nuk i do mendjemëdhënjtë e mburracakët.”<sup>453</sup>*

<sup>448</sup> Et-Teube, 4

<sup>449</sup> Et-Teube, 7

<sup>450</sup> Ali-Imran, 146

<sup>451</sup> Ali-Imran, 159

<sup>452</sup> En-Nisa, 36

<sup>453</sup> Lukman, 18

*"...edhe për të mos u gëzuar së tepërmi për atë që Ai ju ka dhënë. All-llahu nuk i do kryelartët mburravecë."*<sup>454</sup>

*All-llahu nuk i do ata që tradhtojnë*

*"Dhe mos i mbro ata që mashtrojnë vetveten! Se All-llahu nuk i do tradhtarët dhe gjynahqarët."*<sup>455</sup>

*"Nëse ke frikë se ndonjë fis e thyen besën, edhe ti prishja marrëveshjen me të njëjtën mënyrë, sepse All-llahu nuk i do ata që tradhtojnë."*<sup>456</sup>

*"All-llahu, në të vërtetë, i mbron besimtarët. Ai nuk i do tradhtarët mohues."*<sup>457</sup>

*All-llahu nuk do që të thuhet hapur fjalë të këqija*

*"All-llahu nuk do që të thuhet hapur fjalë të këqija, përveçse nga të dëmtuarit. All-llahu dëgjon dhe di gjithçka."*<sup>458</sup>

*All-llahu i do të drejtët*

*"E, nëse i gjykon, gjykoji me drejtësi! Vërtet, All-llahu i do të drejtët."*<sup>459</sup>

<sup>44</sup> El-Hadid, 23

<sup>45</sup> En-Nisa', 107

<sup>46</sup> El-Enfal, 58

<sup>47</sup> El-Haxhë, 38

<sup>48</sup> En-Nisa', 148

<sup>49</sup> El-Maide, 42

*"E, nëse kthehet, atëherë pajtojini ata midis tyre, me drejtësi dhe paanësi, sepse All-llahu i do ata që veprojnë me drejtësi."*<sup>460</sup>

*"Me të vërtetë, All-llahu i do të drejtët."*<sup>461</sup>

*All-llahu nuk i do ata që e teprojnë*

*"...dhe jepni atë që është detyrë në ditën e vjeljes së tyre! por mos e teproni, se All-llahu nuk i do ata që e teprojnë."*<sup>462</sup>

*"Hani e pini, por mos e teproni, se Ai nuk i do ata që e teprojnë."*<sup>463</sup>

*All-llahu nuk i do mendjemëdhenjtë*

*"S'ka dyshim se All-llahu di gjithçka që ata fshëhin dhe që shfaqin haptazi. Me të drejtë, Ai nuk i do mendjemëdhenjtë."*<sup>464</sup>

*All-llahu nuk i do ata që ngazëlleshin*

*"Njerëzit e popullit të tij i thanë: "Mos u ngazëlleshin me pasurinë që ke, sepse All-llahu nuk i do ata që ngazëlleshin."*<sup>465</sup>

<sup>460</sup> El-Huxhurat, 9

<sup>461</sup> El-Mumtehine, 8

<sup>462</sup> El-En'am, 141

<sup>463</sup> El-A'raf, 31

<sup>464</sup> En-Nahl, 23

<sup>465</sup> El-Kasas, 76

*All-llahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij*

*"Vërtet, All-llahu i do ata që luftojnë në rrugën e Tij,  
të radhitur si të ishin një ndërtesë solide."<sup>466</sup>*

*All-llahu e thotë të vërtetën*

<sup>466</sup> Es-Saff, 4



*Copyright©Logos-A, 2009*

*[www.logos-a.com.mk](http://www.logos-a.com.mk)*



All-llahu është Një dhe i Vetëm  
Gjithësia e dëshmon Krijuesin e saj  
Rrëfimet kur'anore  
Ringjallja, llogaria dhe shpërblimi  
Edukata dhe ligjet hyjnore

Janë këto pesë temat qendrore për të cilat Kur'ani famëlartë flet gjerë e gjatë. Dijetari, mësuesi dhe imami ynë, Muhammed el-Gazali, erdhi në përfundim se këto pesë tema qendrore të Kur'anit famëlartë janë thelbi i të gjitha çështjeve të tjera të cilat radhiten nën to. Ai është i mendimit se muslimanët e trajtojnë komentin e Kur'anit famëlartë me një trajtim pjesor dhe tekstual, duke mos i shtjelluar të dhënat kur'anore në nivelin e tyre të duhur dhe prej tyre t'i nxjerrin vlerat kur'anore të cilat i vendosi All-llahu i Madhërishëm për t'i udhëzuar mysliimanët – me Kur'anin – drejt asaj që është më e mirë dhe më e qëndrueshme!

Qëllimi kryesor i trajtimit të këtyre rrëfimeve është që mysliimanët t'i kuptojnë ligjet e All-llahut që funksionojnë në shoqëri dhe gjithësi dhe të mos mëtojnë t'i kapërcejnë ato. Mysliimanët duhet ta kenë të qartë se bashkëveprimi i saktë me këto ligje është faktori i vetëm që i bën ata ta meritojnë sundimin dhe përqendrimin në këtë botë.

Janë këto pesë temat qendrore të Kur'anit famëlartë për të cilat shkroi dora e shtrenjtë e mësuesit dhe imamit tonë të nderuar Muhammed el-Gazali. S'do mend se ai është njëri nga ata që qëndron në maje të lartë të atyre që sot numërohen si të rrallë.

